



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LIGJ

Nr. 56/2020

**PËR SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

SEKSIONI 1

OBJEKTI DHE ZBATIMI

Neni 1

**Objekti dhe fusha e zbatimit**

1. Ky ligj rregullon:

- a) themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve, të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të shoqërive administruese të fondeve të investimeve alternative, në Republikën e Shqipërisë;
- b) themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë;
- c) themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë;
- ç) shitjen dhe marketimin në Republikën e Shqipërisë të sipërmarrjeve të investimeve

---

*1 Ky ligj është përafruar pjesërisht me:*

- "Direktivën 2009/65/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT)", të ndryshuar. Numri CELEX 32009L0065, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 302, datë 17.11.2009, faqe 32-96.

- Direktivën 2011/61/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2011, "Mbi administruesit e fondit të investimeve alternative dhe që ndryshon Direktivat 2003/41/KE dhe 2009/65/KE dhe Rregulloret (KE) nr.1060/2009 dhe (BE) Nr.1095/2010", të ndryshuar. Numri CELEX 32011L0061, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 174, datë 1.7 2011, faqe 1-73.

kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet shoqërive administruese të fondeve, vendase ose të huaja;

d) marketimin dhe administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive jashtë Republikës së Shqipërisë nga shoqëri administruese të themeluara në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet e licencuara, të njohura ose të regjistruara nga autoriteti, që kryejnë veprimtari ose kanë lidhje me kryerjen e veprimtarisë së mbledhjes së fondeve, me qëllim diversifikimin e riskut, sipas dispozitave të këtij ligji, duke përfshirë: sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqërinë administruese, administruesin e fondeve të investimeve alternative, degën e shoqërisë së huaj administruese, degën e shoqërisë vendase në një vend të huaj, administruesin e huaj të fondeve të investimeve alternative, depozitarin ose depozitarin e fondeve të investimeve alternative, agjentët/distributorët e shitjeve në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo subjekt tjetër që kryen veprimtaritë e sipërpërmendura pa miratimin dhe licencimin e dhënë nga autoriteti, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Ky ligj zbatohet rast pas rasti edhe për personin, të cilit subjektet e sipërpërmendura i kanë deleguar funksione në zbatim të këtij ligji.

## Neni 2

### **Përkufizime**

I. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrimi i fondit të investimeve alternative” është administrimi i portofolit dhe administrimi i riskut të fondeve të investimeve alternative.

2. “Administruesi i fondit të investimeve alternative (AFIA)” është personi juridik i licencuar nga një autoritet rregullator i huaj, aktiviteti tregtar i të cilit është administrimi i fondeve të investimeve alternative, i cili kryen gjithashtu edhe funksionet e administrimit dhe të marketimit të fondeve të investimeve alternative.

3. “Agjent i lidhur” është personi i pavarur juridik ose fizik, i cili promovon shërbimet e investimeve dhe/ose shërbimet ndihmëse te klientët ekzistues ose ato potencialë, merr dhe përcjell udhëzime ose urdhra nga klientët lidhur me shërbimet e investimeve ose instrumentet financiare, blen instrumente financiare ose këshillon klientët ekzistues ose ato potencialë lidhur me këto instrumente financiare ose shërbime. Ai vepron në emër të vetëm një shoqërie administruese dhe nën përgjegjësinë e plotë dhe të pakushtëzuar të saj.

4. “Anëtari i pavarur i këshillit të administrimit”, lidhur me shoqërinë e investimeve, është anëtari joekzekutiv i këshillit të administrimit të shoqërisë së investimeve, i cili vepron në mënyrë të pavarur nga shoqëria administruese e kësaj sipërmarrjeje dhe nga subjektet, të cilave u është deleguar administrimi i investimeve nga shoqëria administruese. Ai gjithashtu vepron në mënyrë të pavarur nga audituesi, këshilltari juridik, depozitari dhe kujdestari, si dhe nuk është anëtar i këshillit të administrimit, punonjës, ortak, funksionar apo këshilltar profesionist i asnjë prej subjekteve të sipërpërmendura në këtë pikë dhe i cili nuk ka vepruar me këtë cilësi në tri vitet e fundit.

5. “Auditim ligjor” është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara dhe ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

6. “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

7. “Autoriteti i huaj rregullator” është autoriteti kombëtar i një shteti tjetër, i cili, sipas ligjit ose aktit nënligjor në fuqi, mbikëqyr sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët e themeluar jashtë Republikës së Shqipërisë.

8. “Autoriteti rregullator” është autoriteti i cili, sipas ligjit ose akteve nënligjore në fuqi, regjistron dhe/ose licencën e mbikëqyr sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqëritë administruese, administruesin e investimeve alternative, depozitarin e fondeve të investimeve alternative ose depozitarin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

9. “Autoriteti rregullator i vendit të origjinës” është autoriteti rregullator përgjegjës për mbikëqyrjen e sipërmarrjes së investimeve kolektive, operatorit të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive në vendin e origjinës.

10. “Autoriteti rregullator i vendit pritës” është autoriteti rregullator i një vendi, i ndryshëm nga vendi i origjinës së sipërmarrjes së investimeve kolektive ose subjektit operator të sipërmarrjes së investimeve kolektive, ku sipërmarrja e investimeve kolektive kryen veprimtari ose ku subjekti operator ka degë ose ofron shërbime.

11. “Bashkim”, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive, është bashkimi i dy a më shumë sipërmarrjeve të investimeve kolektive ose nënfondeve të tyre, ose nëpërmjet përthithjes së një a më shumë sipërmarrjeve a nënfondeve në një tjetër sipërmarrje të investimeve kolektive apo nënfond, ose nëpërmjet kalimit të aktiveve të sipërmarrjeve ekzistuese në një sipërmarrje të re të investimeve kolektive ose nënfond të ri.

12. “Bashkimi ndërkufitar” është bashkimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive:

a) ku të paktën dy prej të cilave janë themeluar në vende të ndryshme; ose

b) të cilat janë të themeluara në të njëjtin vend dhe bashkohen në një sipërmarrje të investimeve kolektive të krijuar rishtazi në një vend tjetër.

13. “Dega” është vendi i ushtrimit të veprimtarisë tregtare që është pjesë e shoqërisë administruese të fondeve, e cila nuk ka personalitet juridik dhe që ofron shërbimet për të cilat është autorizuar nga shoqëria administruese e fondeve.

14. “Depozita” ka të njëjtin kuptim që përcaktohet në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

15. “Depozitari” është banka ose shoqëria komisionere e licencuar nga autoriteti rregullator të kryejë si veprimtari ruajtjen e pasurisë së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe e cila ka detyrat dhe funksionet e parashikuara në seksionin 2, të kreut III, të këtij ligji.

16. “Depozitari i fondeve të investimeve alternative” është banka ose shoqëria komisionere e licencuar nga autoriteti rregullator të kryejë si veprimtari ruajtjen e pasurisë së fondit të investimeve alternative dhe i cili ka detyrat dhe funksionet e parashikuara në seksionin 3, të kreut III, të këtij ligji.

17. “Dita e tregtimit” është periudha gjatë një dite pune, gjatë së cilës shoqëria administruese është e hapur për të ushtruar veprimtari në përputhje me dispozitat e prospektit të SIK-ut.

18. “Dokumenti themelues” është statuti ose akti i themelimit të shoqërisë së investimeve; marrëveshja midis ortakëve të shoqërisë kolektive ose komandite, dhe rregullorja e fondit ose një dokument i barasvlershëm i fondit të investimeve.

19. “Emetues” është personi juridik ose çdo subjekt tjetër juridik i rregulluar me këtë ligj, përfshirë qeverinë ose një organizatë financiare ndërkombëtare të miratuar, i cili emeton tituj.

20. “Shoqëri komisionere” është çdo person juridik, profesioni ose veprimtaria e të cilit është ofrimi i një ose më shumë shërbimesh të investimeve të të tretëve dhe/ose kryerja e një ose më shumë veprimtarish të rregulluara, sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

21. “Fondet e veta” janë burime financiare që shoqëria administruese e fondeve ose depozitari i fondeve të investimeve alternative ose depozitari duhet të zotërojë, sipas këtij ligji.

22. “Fondi i fondeve” është sipërmarrja e investimeve kolektive, e cila investon jo më pak se 85% të vlerës së aktiveve të veta, në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive.

23. “Fondi i investimeve” është sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar me kontratë si grupim i veçantë aktivesh, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit të investimeve.

24. “Fond i investimeve alternative (FIA)” është sipërmarrja e investimeve kolektive, përfshirë edhe nënndarjet ose nënfondet e investimit të saj, e cila siguron kapital nga një numër investitorësh, me qëllim investimin e tij në përputhje me një politikë të përcaktuar investimi për realizimin e përfitimeve për investitorët dhe që nuk licencohet si sipërmarrje e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, sipas këtij ligji.

25. “Fondi i huaj i investimeve alternative” është fondi i investimeve alternative i krijuar në zbatim të ligjit të një vendi të ndryshëm (tjetër) nga Republika e Shqipërisë, i cili në zbatim të ligjit në fjalë nuk lejohet t’i shesë publikut në atë vend.

26. “Fondi i tregtuar në bursë” është sipërmarrja e investimeve kolektive që ndjek një indeks, sipas të cilit tregtohet gjatë gjithë ditës një klasë kuotash ose aksionesh në një platformë tregtimi dhe me një krijues tregu, i cili garanton që çmimi i kuotave ose aksioneve të tij në treg nuk ndryshon ndjeshëm nga vlera neto e aktiveve dhe, sipas rastit, nga vlera neto orientuese e aktiveve.

27. “Huadhënia e titujve” në lidhje me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, është dhënia hua e instrumenteve financiare nga njëra palë një pale tjetër, sipas një norme të përcaktuar interesi dhe sipas një afati kohor të përcaktuar.

28. “Indeks” është çdo shifër:

a) që publikohet ose që i bëhet e ditur publikut;

b) që përcaktohet rregullisht:

i. plotësisht ose pjesërisht duke përdorur një formulë ose një metodë tjetër llogaritjeje ose duke përdorur një metodologji vlerësimi; dhe

ii. që përcaktohet në bazë të vlerës së një ose më shumë aktiveve përbërëse ose çmimeve, përfshirë çmimet e vlerësuara përafërsisht, normat e interesit faktik ose të vlerësuara përafërsisht, kuotimet indikative ose të ekzekutueshme, ose vlerat apo analizat e tjera dhe që përdoret nga sipërmarrja e investimeve kolektive ose nënfondi, si matje e performancës së sipërmarrjes së investimeve kolektive ose me qëllim ndjekjen e kthimit nga investimi të këtij indeksi ose përcaktimin e shpërndarjes së aktiveve të një portofoli.

29. “Instrumente financiare” janë instrumentet financiare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

30. “Instrument financiar i listuar” është çdo instrument financiar i listuar në cilindo segment tregu të bursës.

31. “Instrument i tregut të parasë” është ai titull borxhi, i cili i jep pronarit të drejtën e pakushtëzuar për të marrë një shumë të përcaktuar fikse parash në një datë të përcaktuar dhe që emetohet me vlerë të skontuar në varësi të normës së interesit dhe kohës së mbetur deri në afatin e shlyerjes. Këtu përfshihen edhe bonot e thesarit, dëftesat tregtare dhe financiare, dëftesat e garantuara nga bankat dhe certifikatat e negociueshme të depozitës me afat fillestar shlyerjeje, jo më shumë se një vit, si edhe letra afatshkurtra të emetuara nga një njësi e organizuar për emetimin e letrave afatshkurtra.

32. “Instrument i tregut të parasë i SIK” është një instrument i tregtueshëm në tregun e parasë që përmbush kërkesat e autoritetit, lidhur me likuiditetin dhe vlera e të cilit mund të përcaktohet me saktësi në çdo kohë.

33. “Interes i mbartur”, lidhur me fondin e investimeve alternative, është pjesa e fitimit të fondit të investimeve alternative që i llogaritet shoqërisë administruese të fondit të investimeve alternative si kompensim për administrimin e fondit të investimeve alternative dhe që

përrjashton çdo ndarje fitimi të fondit të investimeve alternative, që i takon shoqërisë administruese të këtij fondi, në formë fitimi ose çdo investim të kryer nga administratori i fondit të investimit alternativ në fond.

34. “Kapital fillestar” është kapitali i shlyer, i nënshkruar nga aksionarët ose pronarët, por që nuk përfshin aksionet kumulative preferenciale.

35. “Klient” është çdo person fizik ose juridik, të cilit firma e investimeve i ofron shërbime investimi dhe/ose shërbime mbështetëse dhe përfshin dy lloj klientësh, si më poshtë:

35.1. “Klient profesionist” është klienti që përmbush kriteret e mëposhtme:

a) Subjektet, të cilat licencohen ose njihen për të ushtruar veprimtari në tregjet financiare:

i. bankat dhe degët e bankave të huaja;

ii. firmat e investimeve;

iii. institucione të tjera financiare të licencuara apo të njohura;

iv. shoqëritë e sigurimeve;

v. sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe shoqëritë administruese të këtyre sipërmarrjeve;

vi. fondet e pensionit vullnetar dhe shoqëritë administruese të këtyre fondeve;

vii. tregtuesit e mallrave bazë në formën e instrumenteve financiare dhe të derivativëve të mallrave bazë;

viii. firmat vendore që ofrojnë shërbime të investimeve;

ix. investitorë të tjerë institucionalë.

b) Ndërmarrje të mëdha që përmbushin të paktën dy nga kriteret e mëposhtme:

i. shuma totale e aktiveve në bilanc është të paktën 2,6 miliardë lekë;

ii. xhiroja neto është të paktën 5,2 miliardë lekë; ose

iii. kapitalet e veta janë të paktën 260 milionë lekë.

c) Njësitë e qeverisjes qendrore dhe rajonale, organet publike që administrojnë borxhin publik, bankat qendrore, institucionet ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve dhe organizata të tjera të ngjashme ndërkombëtare.

ç) Investitorë të tjerë institucionalë, veprimtaria kryesore e të cilëve është investimi në instrumente financiare, përfshirë subjektet e dedikuara në titullimin e aktiveve ose transaksioneve të tjera financiare.

35.2. “Klient individ” është çdo klient që nuk është klient profesionist.

35.3 “Klient i kualifikuar” është çdo person, juridik ose fizik, që kategorizohet si klient joprofesionist, por që, me kërkesë të tij, trajtohet si klient profesionist, kur përmbush të paktën dy prej kriterëve të mëposhtme:

i. klienti ka kryer transaksione në madhësi të konsiderueshme në tregun përkatës, me një frekuencë mesatare prej 10 operacionesh për tremujor përgjatë katër tremujorëve të mëparshëm;

ii. madhësia e portofolit të instrumenteve financiare të klientit, përfshirë depozitat në para dhe instrumentet financiare tejkalon 65 milionë lekë;

iii. klienti punon ose ka punuar në sektorin financiar për të paktën një vit në një pozicion profesional, i cili kërkon njohuri të transaksioneve ose shërbimeve të parashikuara.

Për kualifikimin si klient i kualifikuar ndiqet procedura e mëposhtme:

a) klienti duhet t’i deklarojë me shkrim shoqërisë se dëshiron të trajtohet si klient profesionist në përgjithësi ose në lidhje me një shërbim apo transaksion të caktuar, ose me një lloj transaksioni ose produkti;

b) shoqëria duhet t’i japë klientit një paralajmërim të qartë me shkrim lidhur me mbrojtjen dhe të drejtat e kompensimit të investitorit që klienti mund të humbasë si rrjedhojë e cilësimit si klient i kualifikuar;

c) klienti duhet të deklarojë me shkrim në një dokument të veçantë nga kontrata se është në

dijeni të pasojave të humbjes së mbrojtjes që i ofrohet klientëve joprofesionistë.

36. “Komisioni i daljes” është komisioni që nënshkruesi i paguan subjektit operator të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e shlyerjes së pjesëmarrjes në sipërmarrje.

37. “Komisioni i hyrjes” është komisioni që nënshkruesi i paguan subjektit operator të sipërmarrjes së investimeve kolektive, në momentin e nënshkrimit të pjesëmarrjes në sipërmarrje.

38. “Komisioni vjetor i administrimit” është tarifa periodike që i paguhet shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose një nënfondi, e përlllogaritur në bazë të një përqindjeje vjetore, sipas vlerës së pasurisë së çdo sipërmarrjeje ose nënfondi.

39. “Kontrolli” është marrëdhënia ndërmjet subjektit mëmë dhe subjektit të kontrolluar, ose një marrëdhënie e ngjashme ndërmjet çdo personi fizik ose juridik, si dhe çdo subjekt apo subjekti të kontrolluar nga një subjekt i kontrolluar që konsiderohet gjithashtu si subjekt i kontrolluar i subjektit mëmë.

40. “Kujdestari” është ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare për llogari të klientëve.

41. “Kuotë” është çdo pjesëmarrje e barabartë përpjesëtimore, që rezulton pas pjesëtimit të interesave përfitues në aktivet, objekt i sipërmarrjes së investimeve kolektive të fondit të investimeve.

42. “Kuotë në të ardhura” është kuota në një sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur të investimeve ose në një sipërmarrje me intervale, e cila shpërndan periodikisht të ardhura dhe nuk i krediton këto të ardhura drejt kapitalit.

43. “Leva financiare”, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive, është çdo metodë nëpërmjet së cilës shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive e rrit ekspozimin e sipërmarrjes, nëpërmjet huamarrjes, nëpërmjet derivativëve ose nëpërmjet mënyrave të tjera.

44. “Lidhje pronësie” është marrëdhënia ku dy apo më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur përmes:

a) pjesëmarrjes në formën e pronësisë, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet kontrollit të 20 % ose më shumë të të drejtave të votës apo të kapitalit të subjektit;

b) kontrollit, sipas pikës 39 të këtij neni;

c) një lidhjeje të përhershme të të gjitha palëve me të njëjtin person, nëpërmjet një marrëdhënieje kontrolli.

45. “Ligji i AMF-së” është legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

46. “Likuidues” është personi i emëruar për të mbyllur veprimtaritë e sipërmarrjes së investimeve kolektive, shoqërisë administruese të fondeve ose të depozitarit.

47. “Llogaria e shpërndarjes” është llogaria në të cilën transferohet të ardhurat nga pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive në fund të çdo periudhe vjetore kontabël.

48. “Marketimi” është ofrimi ose hedhja në treg në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga shoqëria administruese të pjesëmarrjes, të zotëruar nga sipërmarrja e investimeve kolektive të administruar nga kjo shoqëri administruese.

49. “Marrje në administrim” është procesi i vënies së personit juridik të licencuar në zbatim të këtij ligji, në administrim dhe në kontroll të një administratori të përzgjedhur dhe të emëruar nga autoriteti në rastet e parashikuara në nenin 178 të këtij ligji.

50. “Mbajtës kuotash” është çdo person, i cili zotëron kuota ose aksione ose investon kapital në sipërmarrjen e investimeve kolektive, i cili si rrjedhojë përfiton një pjesë përpjesëtimore të pasurisë së sipërmarrjes.

51. “Mjet i qëndrueshëm komunikimi” është çdo instrument, i cili i mundëson marrësit të ruajë informacionin drejtuar personalisht atij, në mënyrë që të shihet dhe të përdoret për një

periudhë kohore të mjaftueshme për qëllimet e informacionit dhe që mundëson kopjimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.

52. “Nënfondi” është nëndarja e investimeve, e cila është pjesë më vete e pasurisë së sipërmarrjes ombrellë dhe që bashkohet, administrohet dhe kontabilizohet veçmas dhe pasuria e të cilit është, në kuptim të përfitimit, në pronësi të pjesëmarrësve të këtij nënfondi.

53. “Njësia akumuluese ose kuota akumuluese” është njësia ose kuota në një sipërmarrje të investimeve kolektive, e cila akumulon të ardhurat nëpërmjet kreditimit periodik në kapital, në ndryshim nga shpërndarja.

54. “Oferta publike e instrumenteve financiare” është komunikimi në çfarëdolloj forme dhe me çfarëdolloj mjeti i informacionit të mjaftueshëm për kushtet e ofertës dhe për instrumentet financiare që ofrohen, në mënyrë që investitori të vendosë për blerjen apo nënshkrimin e instrumenteve financiare. Ky përkufizim vlen edhe për hedhjen në treg të instrumenteve financiare nëpërmjet ndërmjetësve financiarë.

55. “Të ardhurat nga pasuria” janë interesat, dividendët, të ardhurat dhe qiraja nga pasuritë e paluajtshme që subjekti operator, në konsultim me audituesin, i konsideron si të ardhura të arkëtuara ose të arkëtueshme për llogaritë dhe lidhur me pasuritë e sipërmarrjes së investimeve kolektive, por që nuk përfshin shumat që për momentin janë pjesë kreditore e llogarisë së shpërndarjes pas përfundimit të periudhës vjetore të raportimit.

56. “Pasuri kapitale” janë pasuritë e sipërmarrjes, me përjashtim të pasurive në të ardhura dhe të çdo shume që për momentin është pjesë kreditore e llogarisë së shpërndarjes.

57. “Pasuri e paluajtshme” është toka, troje dhe çdo ndërtim apo punim me natyrë të përhershme që ndodhen në to dhe gjithçka që është pjesë integrale e tyre.

58. “Pasuri e sipërmarrjes” është pasuria - objekt e sipërmarrjes së investimeve kolektive e krijuar prej saj. Pra, me fjalë të tjera, është pasuria kapitale dhe të ardhurat nga pasuria.

59. “Pengu” është kolaterali i përdorur për të garantuar një hua a kredi.

60. “Persona kyç” janë persona fizikë, të cilët, sipas dispozitave të legjislacionit ose të dokumenteve të themelimit, përfaqësojnë subjektin ose depozitarin, ose të cilët përcaktojnë në mënyrë efektive politikën e subjektit ose të depozitarit, përfshirë edhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo të këshillit të administrimit të këtij subjekti.

61. “Personel kyç” janë personat fizikë në poste të larta, të cilët janë përgjegjës për funksionet kyç të operatorit ose të depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive përfshirë, ndër të tjera, në rastin e subjektit operator, drejtorin e administrimit të investimeve, drejtorin e marketingut, drejtorin e burimeve njerëzore, drejtorin e auditimit të brendshëm, drejtorin e administrimit të riskut dhe drejtorin e përputhshmërisë dhe, në rastin e depozitarit, drejtorin e shërbimeve të depozitarit, drejtorin e auditimit të brendshëm, drejtorin e administrimit të riskut dhe drejtorin e përputhshmërisë.

62. “Personi fizik i lidhur” është personi kyç i sipërmarrjes së investimeve kolektive ose i subjektit të lidhur të kësaj sipërmarrjeje, si më poshtë:

a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit /bashkëshortes;

b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;

c) një i afërm me lidhje farefisnore të drejtpërdrejtë vertikale ose horizontale të shkallës së dytë me këtë person;

ç) birësuesi dhe i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;

d) anëtari i këshillit të administrimit të çdo shoqërie tregtare, në të cilën sipërmarrja ka një interes prej më shumë se 20 %; dhe

dh) çdo i afërm tjetër i personit kyç, i cili banon në të njëjtën familje me këtë person prej të paktën një viti nga data e transaksionit personal.

63. “Person i njohur” është personi juridik ose fizik, i cili ka marrë licencë nga një autoritet i huaj rregullator që njihet nga autoriteti si i barasvlershëm me licencën që lëshon vetë autoriteti.

64. “Pjesëmarrës” është çdo person që zotëron kuota ose aksione ose çdo formë tjetër pjesëmarrjeje apo të drejte ose interesi në sipërmarrjen e investimeve kolektive si rezultat i investimit në kapital të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

65. “Pjesëmarrja” përfshin, rast pas rasti, aksionin, kuotën apo çdo instrument tjetër apo interes tjetër që jep të drejta proporcionale mbi pasurinë e sipërmarrjes së investimeve kolektive, si dhe të ardhurat dhe kthimet e kapitalit, të fituara nëpërmjet pasurisë së sipërmarrjes së investimeve kapitale.

66. “Pjesëmarrja influencuese” është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i 10 % ose më shumë i kapitalit ose të drejtave të votës ose zotërimi i pjesëmarrjes, e cila mundëson ushtrimin e influencës së konsiderueshme lidhur me administrimin e një shoqërie administruese të fondeve, depozitarin ose administruesin e fondeve të investimeve alternative ose depozitarin e fondeve të investimeve alternative në të cilën ekziston kjo pjesëmarrje.

67. “Pikë vlerësimi” është momenti i ditës në periudha të rregullta specifike të përcaktuara në prospektin SIK, gjatë të cilit bëhet llogaritja e vlerës neto të aktiveve dhe pjesëmarrjes së sipërmarrjes (ose nënfondit) dhe të çmimeve për tregtimin e pjesëmarrjeve në rastin e sipërmarrjeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale të sipërmarrjes (ose nënfondit).

68. “Prospekti SIK” është dokumenti i shkruar, ku përcaktohen kushtet e ofertës të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

69. “Raporte dhe pasqyra financiare të ndërmjetme” janë raportet për veprimtarinë, performancën financiare dhe gjendjen financiare të sipërmarrjes së investimeve kolektive, për gjashtëmujorin e parë të vitit kontabël.

70. “Raporte dhe pasqyra financiare vjetore” janë raportet për veprimtarinë, performancën financiare dhe gjendjen financiare të sipërmarrjes së investimeve kolektive, gjatë vitit kontabël, përfshirë edhe raportin e audituesit.

71. “Sipërmarrje furnizuese e investimeve kolektive” është sipërmarrja me pjesëmarrje të hapur e investimeve kolektive ose nënfondi i saj që investon jo më pak se 85 % të aktiveve të veta në pjesëmarrje, në një tjetër sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur të investimeve kolektive ose nënfondi (“sipërmarrja kryesore e investimeve kolektive ose nënfondi kryesor”).

72. “Sipërmarrje e huaj e investimeve kolektive” është sipërmarrja e investimeve kolektive, sipas legjislacionit të një vendi tjetër të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë.

73. “Sipërmarrja e investimeve kolektive (SIK)” është çdo formë organizimi lidhur me çdolloj pasurie, përfshirë monetare, qëllimi i së cilës është mundësimi i personave që marrin pjesë në këtë formë organizimi (“pjesëmarrësit”), të bëhen pronarë të pasurisë ose të një pjese të saj, të përfitojnë fitime ose të ardhura që rrjedhin nga marrja, mbajtja, administrimi ose shitja e pasurive ose shumave të paguara nga këto fitime ose të ardhura dhe që ka karakteristikat e mëposhtme:

a) forma e organizimit përmbush përcaktimet e mëposhtme:

i. pjesëmarrësit nuk kanë kontroll të përditshëm mbi administrimin e pasurive në fjalë, pavarësisht nëse kanë apo jo të drejtën për t’u konsultuar apo për të dhënë udhëzime; dhe

ii. forma e organizimit ka një të dyja karakteristikat e përcaktuara më poshtë:

- kontributet e pjesëmarrësve dhe fitimet ose të ardhurat nga të cilat bëhen pagesat mbahen bashkë; dhe

- pasuria në fjalë administrohet si e tërë nga ana e subjektit operator, ose për llogari të tij, të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

iii. pasuria i përket dhe administrohet nga ana e ose në emër të një shoqërie ose investitorëve në një bashkim kontraktor ose në një subjekt apo formë organizimi tjetër që ka për qëllim



investimin e fondeve të veta, me synim shpërndarjen e riskut të investimit dhe përfitimit anëtarëve të saj si rezultat i administrimit të këtyre fondeve nga ana e ose në emër të kësaj shoqërie, trusti, subjekti apo shoqërie administrimi;

b) nëse forma e organizimit parashikon një bashkim si ai i përcaktuar në shkronjën “a”, nënndarja “ii”, të kësaj pike në lidhje me pjesë të veçanta të pasurisë, dhe secila prej këtyre pjesëve mbahet në një portofol, që mbahet veçmas nga aktivet e tjera të sipërmarrjes në librat e sipërmarrjes (“nënndarja e investimeve” ose “nënfondi”), atëherë organizimi konsiderohet, gjithsesi, si sipërmarrje e investimeve kolektive, e cila konsiderohet si sipërmarrje ombrellë, me kusht që pjesëmarrësit të kenë të drejtë t’i shkëmbejnë të drejtat nga njëra pjesë në tjetrën;

c) nëse secila pjesë e pasurive të sipërmarrjes mbahet veçmas në librat e sipërmarrjes ombrellë dhe është nënfond atëherë:

i. pasuria objekt i nënfondit është në pronësi të pjesëmarrësve të këtij nënfondi dhe nuk përdoret për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësve të një nënfondi tjetër;

ii. çdo detyrim i pjesëmarrësve të nënfondit, i cili lind nga marrja, administrimi ose shitja e pasurive, objekt i nënfondit, shlyhet vetëm me këto pasuri;

iii. pjesëmarrësi i sipërmarrjes ombrellë nuk mban përgjegjësi për detyrimet që lindin nga marrja, administrimi ose shitja e pasurive objekt i një nënfondi, në të cilin pjesëmarrësi ka pjesëmarrje përtej shumës që, në afatin e shlyerjes së borxhit, është e barabartë me vlerën në atë moment të pjesëmarrjeve të pjesëmarrësit në nënfondin në fjalë.

74. “Sipërmarrje me intervale” është sipërmarrja, e cila në bazë të dokumentit themelues shlyen pjesëmarrjet, sipas një çmimi të lidhur me vlerën neto të aktiveve për pjesëmarrje të sipërmarrjes të përcaktuar, në përputhje me këtë ligj sipas një baze periodike të rregullt por jo më pak se dy herë në vit.

75. “Sipërmarrje kryesore” është sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur ose nënfondi i sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur, e cila ka të paktën një sipërmarrje furnizuese ndër pjesëmarrësit e saj dhe e cila vetë nuk është sipërmarrje furnizuese dhe nuk zotëron pjesëmarrje në një sipërmarrje furnizuese.

76. “Sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike” është sipërmarrja e investimeve kolektive e krijuar sipas këtij ligji dhe e licencuar nga autoriteti për të kryer veprimtari në Republikën e Shqipërisë, e cila nuk është sipërmarrje për investime kolektive në tituj të transferueshëm. Investimet dhe huamarrja e kësaj sipërmarrjeje është në përputhje me kreun VII, seksionet 1, 2 dhe 4 të këtij ligji.

77. “Sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm (SIKTT)” është sipërmarrja e investimeve kolektive e krijuar sipas këtij ligji dhe e licencuar nga autoriteti për të kryer veprimtari në Republikën e Shqipërisë, investimet e së cilës janë në përputhje me kërkesat e parashikuara me rregullore nga autoriteti, në bazë të kreut VII, seksioni 3, të këtij ligji.

78. “Sipërmarrje për investime kolektive në tituj të transferueshëm” është sipërmarrja e investimeve kolektive, investimet dhe kufizimet në huamarrje të së cilës janë në përputhje me kërkesat e kreut VII, seksioni 3, të këtij ligji.

79. “Sipërmarrje ombrellë” është sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur ose me intervale e cila, në varësi të kushteve të miratuara nga autoriteti ose nga një autoritet i huaj ndahet në një numër nënfondesh ku pjesëmarrësit mund t’i shkëmbejnë të drejtat e nënfondeve dhe ku “nënfondi” krijohet në përputhje me këtë ligj.

80. “Sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur” është sipërmarrje me numër fiks aksionesh ose kuotash të emetuara, e cila nuk ka asnjë detyrim për t’i shlyer këto aksione ose kuota.

81. “Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur” është sipërmarrja, e cila, në bazë të dokumentit themelues, shlyen pjesëmarrjet çdo ditë pune, sipas një çmimi të llogaritur në bazë të vlerës neto të aktiveve për pjesëmarrje të sipërmarrjes, të përcaktuar në përputhje me këtë ligj.

82. “Sipërmarrje e investimeve kolektive në tregun e parasë” është sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur, objektivi parësor i së cilës është ruajtja e vlerës neto të aktiveve të sipërmarrjes, ose me vlerë nominale konstante (pasi zbriten fitimet), ose me vlerën e kapitalit fillestar të pjesëmarrësve plus fitimet. Kjo sipërmarrje shet dhe shlyen pjesëmarrjet e saj çdo ditë pune.

83. “Sipërmarrje e veçantë e investimeve kolektive” (“sipërmarrje e veçantë”) është sipërmarrja e investimeve kolektive që nuk është sipërmarrje ombrellë ose nënfond.

84. “Subjekt i lidhur”, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, janë personat juridikë të mëposhtëm:

- a) shoqëria mëmë e shoqërisë administruese;
- b) shoqëria e kontrolluar e shoqërisë mëmë të shoqërisë administruese;
- c) shoqëria administruese e sipërmarrjes;
- ç) të deleguarit e shoqërisë administruese;
- d) depozitari i sipërmarrjes;
- dh) të deleguarit e depozitarit;
- e) audituesi i jashtëm i sipërmarrjes;
- ë) këshilltari juridik i sipërmarrjes;
- f) çdo *broker* që kryen transaksione në emër të sipërmarrjes;
- g) çdo bankë investimi ose subjekt tjetër që vepron si nënshkruer i emetimit të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive;
- gj) çdo agjent, agjent i lidhur ose distributor i emëruar sipas nenit 102 të këtij ligji;
- h) lidhur me shoqërinë e investimeve, çdo shoqëri tregtare, këshilli i administrimit të së cilës përfshin një anëtar të këshillit të administrimit të shoqërisë së investimeve;
- i) në lidhje me shoqërinë e investimeve, çdo person i cili ka lidhje pronësie me një anëtar të këshillit të administrimit të shoqërisë së investimeve ose çdo person fizik i lidhur me një anëtar të këshillit të administrimit të shoqërisë së investimeve.

Kur personi juridik është përcaktuar si subjekt i lidhur, përkufizimi i subjektit të lidhur përfshin edhe personat me lidhje pronësie ose lidhje të ngushtë me subjektin e lidhur ose personat fizikë të lidhur, sipas përkufizimeve të këtij ligji.

85. “Subjekti operator i sipërmarrjes së investimeve kolektive”, personi juridik i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme të administrimit dhe funksionimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive, ku mund të përfshihen këshillimi mbi investimet dhe shërbimet operative.

86. “Shlyerje fizike” është dorëzimi aktual i mallit, i ndryshëm nga shlyerja në para.

87. “Shoqëri administruese” është subjekti i themeluar, veprimtaria tregtare e të cilit është administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përfshirë sipërmarrjet për investimin kolektiv në tituj të transferueshëm, i licencuar në zbatim të këtij ligji ose të një ligji të barasvlershëm të huaj në fuqi.

88. “Shoqëria administruese e fondeve” është personi juridik i licencuar për të kryer veprimtaritë e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të parashikuara në këtë ligj.

89. “Shoqëria administruese e fondit të investimeve alternative (SHAFIA)” është personi juridik i licencuar nga autoriteti, veprimtaria e të cilit është administrimi i një ose më shumë fondeve të investimeve alternative dhe i cili, krahas kësaj, mund të marrë përsipër funksionet e administrimit dhe të marketimit të fondeve të investimeve alternative, siç përcaktohet në këtë ligj.

90. “Shoqëri investimi” është sipërmarrja e investimeve kolektive e themeluar si shoqëri aksionare, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, objekti parësor i së cilës është investimi i diversifikuar i pasurisë në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme të çdo lloji.

91. “Shoqëria e investimeve me pjesëmarrje të mbyllur” është shoqëria e investimeve që ka një numër fiks aksionesh apo kuotash në emetim, e cila është sipërmarrje investimesh kolektive.

92. “Shoqëri e listuar” është shoqëria që regjistron titujt e saj në cilindo segment tregu të një burse dhe përfshin:

a) çdo shoqëri që ka instrumentet e saj financiare të listuara në një bursë të licencuar me ofertë publike; dhe

b) çdo shoqëri tregtare që nuk është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, por që është pranuar në listën zyrtare të një burse.

93. “Shoqëria mëmë” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

94. “Tituj të transferueshëm” janë:

a) aksione në shoqëri tregtare dhe tituj të tjerë të barasvlershëm me aksionet në shoqërinë tregtare (aksionet);

b) obligacione dhe forma të tjera të borxhit në tituj (tituj të borxhit);

c) çdo formë tjetër titujsh me vlerë të negociueshme, të cilat mund të blihen nëpërmjet nënshkrimit ose këmbimit.

Titulli nuk është i transferueshëm nëse titulli i pronësisë nuk mund t’i kalohet dikujt tjetër ose mund t’i kalohet një tjetri vetëm me pëlqimin e palës së tretë.

95. “Treg i rregulluar” është sistemi shumëpalësh që shfrytëzohet dhe/ose administrohet nga një subjekt operator tregu, i cili bashkon ose ndihmon në bashkimin e interesave të shumtë të shitblerjes që kanë të tretët për instrumente financiare, në përputhje me rregulloret e detyrueshme të tij. Instrumentet financiare pranohen për tregtim sipas rregulloreve dhe/ose sistemeve të tregut të rregulluar dhe ai licencohet, regjistrohet ose njihet nga autoriteti. Ky përkufizim përfshin gjithashtu tregjet mbi banak, ku titujt janë emetuar dhe garantuar nga Qeveria qendrore e Republikës së Shqipërisë, me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga autoriteti, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut.

96. “Vend anëtar” është vendi që është shtet anëtar i Bashkimit Europian ose vendi anëtar i zonës ekonomike europiane.

97. “Vend i huaj” është çdo vend i ndryshëm nga Republika e Shqipërisë.

98. “Vendi i origjinës” është:

a) në rastin e shoqërisë administruese ose administruesit të investimeve alternative ose depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, vendi në të cilin ndodhet selia e regjistruar ose nëse subjekti, sipas legjislacionit të tij kombëtar nuk ka seli të regjistruar, vendi në të cilin ndodhet selia e tij qendrore;

b) në rastin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, vendi në të cilin licencohet kjo sipërmarrje;

c) në rastin e fondit alternativ të investimeve, vendi në të cilin licencohet ose regjistrohet ky fond sipas legjislacionit të zbatueshëm kombëtar, ose në rastin e disa licencave apo regjistrimeve, vendi në të cilin ky fond licencohet ose regjistrohet për herë të parë; ose nëse fondi alternativ i investimeve nuk licencohet apo regjistrohet në asnjë vend, vendi në të cilin ky fond ka selinë e regjistruar dhe/ose selinë qendrore.

99. “Vendi pritës” është:

a) në lidhje me shoqërinë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, vendi që nuk është vendi i origjinës në territorin e të cilit shoqëria administruese ka një degë ose administron sipërmarrje të investimeve kolektive ose ofron shërbime apo marketon sipërmarrje të investimeve kolektive;

b) në lidhje me sipërmarrjen e investimeve kolektive, vendi që nuk është vendi i origjinës, në të cilin marketohen pjesëmarrjet e kësaj sipërmarrjeje;

c) në lidhje me shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesin e fondeve të investimeve alternative, vendi që nuk është vendi i origjinës, në të cilin shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i fondeve të investimeve alternative administron fonde të investimeve alternative ose marketon pjesëmarrje të fondeve të investimeve alternative.

100. “Veprimtari promocionale” është komunikimi lidhur me ofertën e instrumenteve financiare, që i bëhet i ditur publikut ose komunikimi lidhur me pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, me synim promovimin veçanërisht të nënshkrimit ose blerjes së mundshme të instrumenteve financiare.

101. “Vlera neto e aktiveve” është vlera e agreguar e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive (ose e nënfondit) pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive (ose nënfondit) në momentin e llogaritjes.

102. “Vlera neto e aktiveve për kuotë” është vlera neto e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive (ose të nënfondit) e pjesëtuar me numrin e kuotave në emetim në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve.

103. “Vlerësimi” është procesi i përcaktimit të vlerës aktuale të fondit.

II. Titujt dhe krerët në këtë ligj janë përdorur vetëm për orientim e referim dhe nuk kanë për qëllim të kushtëzojnë ose të kufizojnë interpretimin e përcaktimeve dhe të dispozitave të këtij ligji.

III. Në këtë ligj, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e dispozitës.

IV. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe ato në gjininë femërore dhe anasjelltas.

### Neni 3

#### **Sipërmarrjet e investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive, e themeluar në Republikën e Shqipërisë krijohet si:
  - a) fond investimesh; ose
  - b) shoqëri aksionare, në bazë të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (“shoqëri investimi”); ose
  - c) shoqëri komandite, në bazë të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (“shoqëri komandite e sipërmarrjes së investimeve kolektive”).
2. Fondi i investimeve i themeluar në Republikën e Shqipërisë krijohet si:
  - a) sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur;
  - b) sipërmarrje me intervale; ose
  - c) sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur.
3. Fondi i investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike i themeluar në Republikën e Shqipërisë, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni, është:
  - a) sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike; ose
  - b) sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm.
4. Sipërmarrja e investimeve kolektive e themeluar në Republikën e Shqipërisë që është sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni, ose sipërmarrje me intervale, sipas shkronjës “b”, të pikës 2 të këtij neni, është edhe:
  - a) sipërmarrja e veçantë; ose
  - b) sipërmarrja ombrellë.
5. Sipërmarrja e investimeve kolektive që është sipërmarrje e veçantë me pjesëmarrje të hapur, sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij neni, është:

a) sipërmarrje kryesore; ose

b) sipërmarrje furnizuese.

6. Nënfondi i sipërmarrjes ombrellë që është sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni, është:

a) nënfond kryesor; ose

b) nënfond furnizues.

7. Sipërmarrja e investimeve kolektive e themeluar në Republikën e Shqipërisë sipas mënyrës së organizimit është:

a) sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike e administruar nga një shoqëri administruese; ose

b) fond investimesh alternative i administruar nga një shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative.

8. Shoqëria administruese e fondit të investimeve ose nënfondit të fondit të investimeve vepron në emër të pjesëmarrësve të fondit ose nënfondit në çdo proces gjyqësor në lidhje me kontratat e miratuara dhe ekzekuton çdo vendim gjyqësor.

9. Për qëllime të këtij ligji, nënfondi konsiderohet si sipërmarrje e veçantë dhe dispozitat e kreut VII, të këtij ligji, zbatohen përkatësisht. Autoriteti i ushtron kompetencat e tij në këtë rast sikur nënfondi të ishte sipërmarrje e veçantë.

10. Sipërmarrja e investimeve kolektive nuk ofron garanci apo siguri të çfarëdo lloji lidhur me ecurinë e të ardhurave apo të kapitalit.

11. Pronësia e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nënfondeve u takon mbajtësve të pjesëmarrjeve në këtë sipërmarrje ose nënfond dhe jo shoqërisë administruese të sipërmarrjes, depozitarit apo depozitarit të fondeve të investimeve alternative të sipërmarrjes ose nënfondit përveç detyrimit që sipërmarrja ose nënfondi ka kundrejt këtyre subjekteve.

#### Neni 4

### Përfundime

1. Nuk quhen sipërmarrje investimesh kolektive subjektet, veprimtaritë ose strukturat e mëposhtme të organizimit:

a) veprimtaria që kryhet nga një person, e cila nuk është veprimtari tregtare;

b) struktura organizimi, ku secili pjesëmarrës kryen veprimtari tregtare që nuk ka lidhje me tregtimin, organizimin e tregtimeve, administrimin ose këshillimin për titujt ose investimet dhe bëhet pjesë e organizimit për qëllime tregtare që lidhen me këtë veprimtari tregtare;

c) struktura organizimi, ku secili pjesëmarrës është shoqëri tregtare e të njëjtit grup ku bën pjesë shoqëria administruese e sipërmarrjes;

ç) shoqëritë *holding*;

d) strukturat e mëposhtme të organizimit ku:

i. secili prej pjesëmarrësve është punonjës pa pagesë ose ish-punonjës, ose bashkëshorti/bashkëshortja, vejani/vejusha, fëmija/thjeshtri/thjeshtra, nën moshën 18 vjeç e punonjësit ose ish-punonjësit në fjalë të një shoqërie në të njëjtin grup ku bën pjesë shoqëria administruese; dhe

ii. pasuria e strukturës së organizimit përbëhet nga aksione ose kuota, obligacione, aksione hua ose instrumente të tjera, që krijojnë ose konfirmojnë borxh ose vërtetime ose certifikata që japin të drejta në lidhje me këto investime, ku në çdo rast investimi është investim në grup ose individual në këtë grup;

dh) struktura organizimi me marrëveshje *franchise*, në bazë të së cilës personi përfiton fitime ose të ardhura nga shfrytëzimi i së drejtës së përdorimit të një emri ose skeme tregtare

apo pasurie tjetër intelektuale ose të reputacionit të mirë që lidhet me të, sipas marrëveshjes në fjalë;

e) veprimtaria, qëllimi kryesor i së cilës është mundësimi i personave pjesëmarrës të shfrytëzojnë një pasuri të caktuar ose mundësimin e kalimit të së drejtës për shfrytëzim të kësaj pasurie pa pagesë të një palë e tretë;

ë) struktura organizimi, ku të drejtat ose interesat e pjesëmarrësve janë në formën e certifikatave ose instrumenteve të tjera që mbartin të drejta në lidhje me tituj që nuk janë aksione ose kuota në një shoqëri investimesh;

f) kontrata e sigurimit;

g) shoqëria e investimeve me pjesëmarrje të mbyllur, që është krijuar nga një subjekt operator i një sipërmarrjeje tjetër të investimeve kolektive, me qëllim mbajtjen e investimeve, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në emër të kësaj sipërmarrjeje ose të një vargu sipërmarrjesh të investimeve kolektive të krijuara nga i njëjti financues për të investuar paralelisht me një tjetër (“sipërmarrje zotëruese”), si dhe aksionet ose kuotat e së cilës nuk u marketohen ose nuk u vihen në dispozicion pjesëmarrësve që nuk janë sipërmarrje zotëruese;

gj) bankat;

h) banka qendrore;

i) skema e pensionit profesional ose fondi i pensionit vullnetar;

j) organizata ndërkombëtare në rastin kur administron fonde të investimeve alternative në interesin publik;

k) pushteti qendror, vendor dhe bashkiak ose organizata apo institucioni që administron fonde në mbështetje të skemës së sigurimeve shoqërore dhe sistemeve të pensioneve;

l) skema me pjesëmarrje të punonjësve dhe skema të kursimeve të punonjësve;

ll) subjekte të krijuara veçanërisht për titullzimin e aktiveve;

m) shoqëria kooperativë, përfshirë shoqërinë funerale;

n) bashkim krediti;

nj) personat e tjerë, të përjashtuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti që nuk është sipërmarrje e investimeve kolektive, apo sipas një ligji të barasvlershëm të huaj nuk përdor në emrin apo përshkrimin e tij fjalët “sipërmarrje e investimeve kolektive” apo një term apo përshkrim të një sipërmarrjeje të tillë, sipas këtij ligji, dhe asnjë term të ngjashëm që nënkupton të njëjtin kuptim.

## Neni 5

### **Sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe personat e palicencuar**

1. Asnjë person nuk krijon, administron ose vepron si sipërmarrje investimesh kolektive në Republikën e Shqipërisë apo premtion të krijojë, të shfrytëzojë ose të administrojë një sipërmarrje të tillë, apo vepron ose premtion të veprojë si depozitar apo subjekt operator i një sipërmarrjeje në Republikën e Shqipërisë nëse ky person:

a) nuk është person i licencuar nga autoriteti, siç është parashikuar nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi për tregjet e kapitalit;

b) nuk është person i njohur nga autoriteti si person që i plotëson kushtet për të krijuar, administruar ose vepruar si sipërmarrje e investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë.

2. Asnjë subjekt nuk mund të publikojë ose t'i kërkojë një të treti të publikojë veprimtari promociionale ku ofrohen pjesëmarrje në sipërmarrje investimesh kolektive në Republikën e Shqipërisë, nëse ky subjekt nuk është i licencuar ose nuk njihet nga autoriteti, sipas parashikimeve të këtij ligji ose të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe sipërmarrja

në fjalë nuk është licencuar ose njohur nga autoriteti në bazë të këtij ligji.

3. Autoriteti nuk autorizon një sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm nëse:

a) në rastin e shoqërisë së investimit, shoqëria e investimit nuk vepron në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

b) shoqëria administruese e huaj nuk është e licencuar për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të huaja nga vendi i origjinës së Bashkimit Europian.

#### Neni 6

### **Ndalimi i shndërrimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, vazhdon të jetë sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike, deri në rastin e përfundimit të procedurave të mbylljes së kësaj sipërmarrjeje dhe anulimit të licencës apo regjistrimit nga autoriteti.

2. Sipërmarrja e regjistruar e investimeve kolektive, vazhdon të jetë sipërmarrje e regjistruar e investimeve kolektive, deri në rastin e përfundimit të procedurave të mbylljes së kësaj sipërmarrjeje dhe anulimit të regjistrimit nga autoriteti.

3. Sipërmarrja e investimeve kolektive, që është sipërmarrje me ofertë publike për investime kolektive në tituj të transferueshëm, sipas këtij ligji, vazhdon të jetë sipërmarrje me ofertë publike për investime kolektive në tituj të transferueshëm, deri në rast të përfundimit të procedurave të mbylljes së kësaj sipërmarrjeje dhe anulimit të licencës nga autoriteti.

#### Neni 7

### **Regjimi tatimor për sipërmarrjet e investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë**

1. Administrata tatimore në Republikën e Shqipërisë, me kërkesë të shoqërisë administruese ose të administratorit të fondit të investimeve alternative, për qëllime të tatimit, lëshon certifikatën e rezidencës, që vërteton regjimin tatimor për sipërmarrjen e investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë.

2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni tatimor, sipërmarrja e investimeve kolektive, për qëllime të tatimit, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aktiveve të sipërmarrjes, si dhe personi i fundit përfitues.

## SEKSIONI 2

### **REGJISTRAT E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, SUBJEKTEVE OPERATORE DHE DEPOZITARËVE TË TYRE**

#### Neni 8

### **Regjistrat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, subjekteve operatore dhe depozitarëve të tyre**

1. Të gjitha sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe nënfondet e regjistruara ose të njohura nga autoriteti, sipas këtij ligji, regjistrohen në regjistrin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, subjekteve operatore dhe depozitarëve të tyre në Republikën e Shqipërisë.

2. Të gjitha shoqëritë administruese, administruesit e fondeve të investimeve alternative, depozitarët dhe depozitarët e fondeve të investimeve alternative të licencuar/njohur nga autoriteti, sipas këtij ligji, regjistrohen në regjistrin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, subjekteve operatore dhe depozitarëve të tyre të Republikës së Shqipërisë.

3. Autoriteti është përgjegjës për regjistrin dhe garanton që është i plotë, gjithëpërfshirës dhe i përditësuar në çdo moment.

4. Autoriteti bën publik regjistrin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuara dhe të njohura dhe të nënfondeve të licencuara dhe të njohura të shoqërive administruese të licencuara dhe të njohura, të administruesve të licencuar dhe të njohur të fondeve të investimeve alternative, si dhe të depozitarëve të licencuar dhe të njohur, duke përfshirë edhe depozitarët e fondeve të investimeve alternative.

5. Regjistri përmban:

a) në lidhje me sipërmarrjen e investimeve kolektive ose nënfondin, emrin e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose të nënfondit; emrin e shoqërisë së saj administruese ose të administruesit të fondeve të investimeve alternative; adresën e regjistruar; objektivat e investimit; natyrën juridike; nëse është sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur, me pjesëmarrje të hapur ose me intervale; statusin e licencimit të sipërmarrjes ose të nënfondit si e njohur apo e regjistruar dhe emrin e rregullatorit; në rastin e shoqërisë së investimeve, emrat e personave kyç të miratuar dhe datën e regjistrimit në regjistër;

b) në lidhje me shoqërinë administruese të fondeve, administruesin e fondeve të investimeve alternative, depozitarin ose depozitarin e fondeve të investimeve alternative, emrin dhe adresën e regjistruar; statusin e licencimit si i regjistruar dhe emrin e rregullatorit; emrat e personave kyç të miratuar dhe anëtarëve të personelit kyç, si dhe datën e regjistrimit në regjistër.

Neni 9

### **Regjistrimi në regjistër**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive, nënfondi, shoqëria administruese e fondeve, administruesi i fondeve të investimeve alternative, depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative regjistrohet në regjistër sapo licencohet, regjistrohet ose njihet nga autoriteti.

2. Autoriteti i lëshon çdo sipërmarrje ose nënfondi, shoqërie administruese të fondeve, administruesi të fondeve të investimeve alternative, depozitari ose depozitari të fondeve të investimeve alternative një numër të veçantë dhe të pandryshueshëm.

Neni 10

### **Njoftimi i regjistrimit në regjistër**

Autoriteti publikon regjistrimin në regjistër të sipërmarrjes ose nënfondit të licencuar/njohur të investimeve kolektive, shoqërisë administruese të licencuar/njohur të fondeve, administruesit të licencuar/njohur të fondeve alternative, depozitarit të licencuar/njohur ose depozitarit të licencuar/njohur të fondeve të investimeve alternative në faqen e tij të internetit.



## KREU II

### SHOQËRITË ADMINISTRUESE TË FONDEVE

#### SEKSIONI 1

#### KRIJIMI DHE VEPRIMTARIA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE

##### Neni 11

#### **Veprimtaria e shoqërisë administruese**

1. Administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe i fondeve të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë kryhet vetëm nga shoqëria e licencuar ose e njohur administruese e fondeve, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, të ndryshuar.

2. Licencimi dhe njohja e shoqërisë administruese të fondeve bëhet vetëm nga autoriteti nëse shoqëria administruese e fondeve i përmbush kërkesat e këtij ligji.

3. Shoqëria administruese e fondeve, e licencuar sipas pikës 2, të këtij neni, licencohet si një shoqëri administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose si një shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative, që ofron fonde të investimeve alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar ose si të dyja bashkë.

4. Shoqëria administruese e fondeve, e licencuar sipas pikës 2, të këtij neni, gjithashtu, licencohet nga autoriteti edhe si:

a) shoqëri administruese sipas legjislacionit në fuqi që rregullon fushën e fondeve të pensionit vullnetar;

b) administrues i portofoleve të investimeve, përfshirë edhe portofolet në pronësi të fondeve të pensionit, në përputhje me mandatet diskrecionale të dhëna nga investitorët, për të menaxhuar portofolet e klientëve veç e veç, sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

5. Shoqëria administruese e fondeve, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mëposhtme:

a) garanton caktimin e depozitarit për secilën sipërmarrje që administron dhe që depozitarit të sipërmarrjes t'i kërkohet të identifikojë qartë të gjitha pasuritë e sipërmarrjes së investimeve kolektive si pasuri të asaj sipërmarrjeje dhe garanton që këto pasuri mbahen nga depozitari veçmas, të ndara nga pasuritë e shoqërisë administruese dhe nga pasuritë e sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të operuara nga e njëjta shoqëri administruese dhe nga klientët e tjerë të shoqërisë administruese dhe të depozitarit;

b) ofron të gjitha shërbimet administrative që kërkon sipërmarrja, përfshirë edhe mbajtjen e evidencave;

c) nëse e parashikon akti themelues i fondit krijon dhe mban regjistrin e pjesëmarrësve dhe shërbimet e transferimit;

ç) ofron, marketon dhe shpërndan aksionet ose kuotat e sipërmarrjes;

d) në rastin e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale tregton pjesëmarrjet e sipërmarrjes, përfshirë shitjen dhe shlyerjen e kuotave dhe urdhëron depozitarin të emetojë ose të anulojë kuota dhe të kryejë pagesa përkundrejt mbajtësit të kuotave në rastin e shlyerjes së kuotave;

dh) krijon dhe mban të dhëna kontabël të plota dhe të përditësuara të sipërmarrjes dhe kontabilizon aktivet, të ardhurat dhe shpenzimet e sipërmarrjes, në mënyrë që të gjitha aktivet dhe pasivet e sipërmarrjes të identifikohen menjëherë në çdo moment;

e) bën vlerësimin e sipërmarrjes dhe llogarit vlerën neto të aktiveve të sipërmarrjes dhe vlerën neto të aktiveve për çdo aksion ose për çdo kuotë të sipërmarrjes dhe llogarit çmimin për pjesëmarrje për shitjen dhe shlyerjen e kuotave, me përjashtim të rastit kur aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike janë të listuara në një treg të rregulluar, sipas parashikimeve të këtij ligji;

ë) përpilon deklaratat tatimore;

f) kryen administrimin e investimeve, në veçanti merr vendime lidhur me elementet përbërëse të pasurive të sipërmarrjes, në përputhje me aktin themelues dhe prospektin SIK të sipërmarrjes dhe objektivin dhe politikën e përcaktuar për investimin e sipërmarrjes ose nënfondit në fjalë dhe ushtron të drejtat e votës, që u përkasin instrumenteve financiare që ka në administrim;

g) kryen administrimin e risqeve, përfshirë monitorimin dhe matjen në çdo moment të riskut të pozicioneve të sipërmarrjes ose nënfondit të riskut të likuiditetit dhe kontributeve të tyre në profilin e përgjithshëm të riskut të portofolit të kësaj sipërmarrjeje ose nënfondi dhe kryen provat përkatëse të rezitencës dhe harton e zbaton planet përkatëse rezervë;

gj) urdhëron me shkrim depozitarin, lidhur me ushtrimin e të drejtave që u përkasin pasurive të sipërmarrjes;

h) përpilon informacionet e sipërmarrjes lidhur me përmbajtjen dhe shpërndarjen e informacioneve në fjalë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj;

i) monitoron në vazhdimësi përputhshmërinë me këtë ligj të funksionimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike;

j) trajton kërkesat për informacion ose ankesat lidhur me sipërmarrjen;

k) është përgjegjëse për auditimin e brendshëm;

l) depoziton pranë autoritetit të gjitha raportet e kërkuara lidhur me sipërmarrjen, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj; dhe

ll) çdo funksion tjetër të përcaktuar nga autoriteti me akt nënligjor, rregullor, kod etik dhe udhëzues, në bazë të këtij ligji ose të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

6. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative është përgjegjëse për funksionet e mëposhtme lidhur me fondet e investimeve alternative:

a) kryen administrimin e portofoleve dhe administrimin e risqeve të fondit;

b) krahas veprimtarive të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike, angazhohet në veprimtari administrative dhe marketimi të fondeve të investimeve alternative, të cilat i administrojnë dhe merr përsipër veprimtari në lidhje me aktivet e fondit;

c) në kuptim të shkronjës “b”, të kësaj pike, me veprimtari administrative nënkuptohen:

i. shërbimet juridike dhe shërbimet e kontabilitetit të administrimit të fondit;

ii. trajtimi i kërkesave për informacion që vijnë nga klientët;

iii. vlerësimi dhe vendosja e çmimit, përfshirë deklaratat tatimore;

iv. monitorimi i përputhshmërisë me kërkesat rregullatore;

v. mbajtja e regjistrit të pjesëmarrësve të fondit;

vi. shpërndarja e të ardhurave;

vii. shlyerja e kontratave (përfshirë edhe dorëzimin e certifikatave); dhe

viii. mbajtja e evidencave;

ç) në kuptim të shkronjës “b”, të pikës 6, të këtij neni, veprimtaritë e lidhura me aktivet e fondit përfshijnë:

i. shërbimet që nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat ligjore të administruesit;

ii. administrimi i objekteve dhe shërbimeve;

iii. shërbimet administrative për pasuritë e paluajtshme;

iv. këshillimi për personat juridikë lidhur me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale

dhe çështje të lidhura me këto;

v. shërbime të tjera të lidhura me administrimin e fondit të investimeve alternative dhe shoqëritë dhe aktivet e tjera në të cilat ka investuar.

7. Shoqëria administruese e fondeve krijon dhe mban për çdo sipërmarrje ose nënfond, për llogari të të cilit vepron, të dhënat që janë të nevojshme:

a) për t'i dhënë mundësi sipërmarrjes, nënfondit dhe shoqërisë administruese të jetë në përputhshmëri me këtë ligj dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji; dhe

b) për të dëshmuar arritjen e një përputhshmërie të tillë.

8. Evidencat e sipërmarrjes dhe nënfondit mbahen në mënyrë që autoritetit t'i mundësohet vlerësimi i menjëhershëm i tyre dhe mundësimi i korigjimit apo ndryshimit përkatës. Përmbajtja e këtyre evidencave përpara korigjimeve ose ndryshimeve duhet të jetë lehtësisht e kuptueshme dhe të mos lejohet që evidencat të manipulohen apo të ndryshohen në mënyra të tjera. Këto evidenca duhet të mbahen për aq kohë sa përcaktohen nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi.

9. Shoqëria administruese e fondeve, e licencuar në bazë të pikës 2, të këtij neni, për të administruar sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, miratohet nga autoriteti edhe për të kryer këto shërbime të tjera shtesë:

a) këshillim në investime në bazë të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit;

b) administrim të portofoleve individuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e tregjeve të kapitalit.

10. Shoqëria administruese e fondeve nuk kryen veprimtaritë në zbatim të pikës 9, të këtij neni, pa qenë e licencuar, sipas legjislacionit në fuqi, legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, nëse këto shërbime mbulohen nga legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

11. Shoqëria administruese e fondeve, e licencuar në zbatim të pikës 2, të këtij neni, për të administruar fonde të investimeve alternative, krahas veprimtarive të parashikuara në pikën 6, të këtij neni, miratohet nga autoriteti për të marrë dhe transmetuar urdhërporosi në emër të klientëve lidhur me një ose më shumë instrumente financiare.

12. Shoqëria administruese e fondeve, e licencuar në zbatim të pikës 2, të këtij neni, për të administruar sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike nuk angazhohet në veprimtari të tjera të ndryshme nga ato që parashikohen në pikat 3, 4, 5, 7, 8 dhe 9, të këtij neni, dhe të ndryshme nga ato veprimtari që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse.

13. Shoqëria administruese e fondeve, e licencuar në zbatim të pikës 2, të këtij neni, për të administruar fonde të investimeve alternative, nuk angazhohet në veprimtari të tjera të ndryshme nga ato që parashikohen në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 10, të këtij neni, dhe të ndryshme nga ato veprimtari që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse.

14. Autoriteti miraton rregulla shtesë mbi kushtet e licencimit të shoqërisë administruese. Nëse është e nevojshme, me qëllim mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike ose të interesave të publikut, në raste të veçanta, autoriteti mund të miratojë kushte të reja ose t'i ndryshojë kushtet ekzistuese për licencën e shoqërisë administruese.

Neni 12

### **Kushtet për licencimin si shoqëri administruese e fondeve**

1. Licenca si shoqëri administruese e fondeve i lëshohet nga autoriteti vetëm shoqërisë aksionare që e ka selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore në Republikën e Shqipërisë.

2. Shoqëria administruese e fondeve zotëron llojet dhe sasi të kapitalit, sipas parashikimeve të nenit 13, të këtij ligji, dhe vërteton ligjshmërinë e burimit të kapitalit.

3. Zotëruesit e pjesëmarrjeve influencuese të shoqërisë administruese të fondeve duhet të përmbushin kërkesat për përshtatshmërinë dhe aftësinë, të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji.

4. Personat kyç dhe personeli kyç i shoqërisë administruese të fondeve duhet të përmbushin kërkesat për përshtatshmërinë dhe aftësinë, të parashikuara në nenin 14, të këtij ligji, dhe duhet të kenë kualifikimet dhe përvojën profesionale përkatëse në përmbushje të kërkesave të parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

5. Sistemet, procedurat dhe masat kontrolluese të shoqërisë administruese të fondeve duhet të jenë në përputhje me nenin 16 të këtij ligji.

6. Veprimtaria tregtare e shoqërisë administruese të fondeve duhet të kryhet nga jo më pak se dy persona fizikë, të cilët plotësojnë kërkesat për aftësinë dhe përshtatshmërinë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

7. Shoqëria administruese e fondeve nuk vepron si depozitar.

8. Shoqëria administruese e fondeve nuk është pronare e një depozitari.

9. Shoqëria administruese e fondeve cakton një auditues të pavarur, që i plotëson kushtet, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

10. Shoqëria administruese e fondeve informon autoritetin për çdo zëvendësim të personave të parashikuar në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, dhe jep informacionet e nevojshme për të vlerësuar nëse personat zëvendësues përmbushin kërkesat e pikave 3 dhe 4 të këtij neni.

## Neni 13

### **Kapitali i shoqërisë administruese të fondeve**

1. Shoqëria administruese e fondeve emeton vetëm aksione të regjistruara, ku një aksion ka të drejtën e një vote.

2. Çdo aksion i emtuar deri në shumën e kapitalit të shlyer të shoqërisë administruese të fondeve shlyhet plotësisht vetëm me mjete monetare, me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë nuk zbatohet për shkak të bashkimit me një shoqëri tjetër administruese.

3. Shoqëria administruese e fondeve zotëron kapital të shlyer, jo më pak se 15 800 000 lekë.

4. Shoqëria administruese e fondeve duhet të zotërojë në çdo moment fonde të veta, të cilat janë:

a) jo më pak se 15 800 000 lekë, dhe në rast se totali i aktiveve nën administrim tejkalon shumën 31 600 000 000 lekë, fondet e veta rriten me 0,02 % të totalit të aktiveve nën administrim që tejkalon kufirin prej 31 600 000 000 lekësh, deri në maksimumi 1 300 000 000 lekë;

b) jo më pak se 1/4 e shpenzimeve fikse të shoqërisë administruese të llogaritura, bazuar në pasqyrat financiare të vitit paraardhës;

c) në kuptim të shkronjës “a”, të kësaj pike, përjashtohen portofolet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që shoqëria i administron në formë të deleguar.

Forma, llogaritja dhe shuma e fondeve të veta, që duhet të kenë detyrimisht shoqëritë administruese, përcaktohen me rregullore të AMF-së.

5. Përcaktimi i kërkesës për fonde të vetat, sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij neni, që e tejkalon kërkesën për kapital të shlyer, sipas pikës 3, të këtij neni, mund të mos përmbushet deri në 50 % të kërkesës për fonde të vetat nëse ato përfitojnë një garanci të së njëjtës shumë, të lëshuar nga një bankë ose shoqëri sigurimesh.

6. Shoqëria administruese e fondeve mund të ketë fonde të vetat, të tjera shtesë ose sigurim

të përgjegjësive profesionale për të mbuluar risqet e mundshme të përgjegjësive që lindin nga pakujdesia profesionale.

7. Fondet e veta investohen vetëm në aktive që përmbushin kërkesat e përcaktuara në rregulloret e miratuara nga autoriteti.

8. Shoqëria administruese e fondeve nuk jep drejtpërdrejt ose tërthorazi kredi apo lëshon dorëzani për blerjen e aksioneve të saj apo për blerjen e aksioneve të personave me të cilët ka lidhje pronësie ose është subjekt i lidhur.

9. Shumat e kapitalit, të parashikuara në këtë ligj, mund të rriten nga autoriteti herë pas here, por jo më shpesh se një herë në vit, në përputhje me normën zyrtare të inflacionit.

#### Neni 14

### **Kërkesat për aftësinë dhe përshtatshmërinë**

1. Shoqëria administruese e fondeve nuk licencohet nga autoriteti nëse aksionarët dhe personat që ushtrojnë funksion kontrolli nuk përmbushin kërkesat për aftësi dhe përshtatshmëri për të ushtruar funksionet e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Autoriteti vlerëson nëse personi është i aftë dhe i përshtatshëm e nëse përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) zotëron cilësitë e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës në shoqëri;

b) ka integritet, ndershmëri dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave;

c) zotëron kualifikimin e nevojshëm dhe përvojën profesionale, në përputhje me përgjegjësitë e pozicionit përkatës;

ç) ruan pavarësinë, në mënyrë që të mos cenohen interesat e shoqërisë nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Autoriteti bën edhe një vlerësim të veprimtarisë tregtare ose financiare dhe sjelljes e personit në të shkuarën, përfshirë, ndër të tjera, shqyrtimin nëse ka prova që dëshmojnë se:

a) personi është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare; për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

b) personi është i përfshirë ose i lidhur me një humbje financiare, që ka ndodhur për shkak të pandershmërisë, paaftësisë ose praktikës jo të mirë në sigurimin e shërbimeve financiare apo në administrimin e shoqërive të tjera;

c) personi është angazhuar në praktika tregtare, të cilat autoriteti i gjykon si praktika mashtruese, dhunuese ose të papërshtatshme, ose që në një farë mënyre pasqyrojnë mangësi vlerash të një personi në kryerjen e shërbimeve financiare dhe veprimeve të tjera tregtare;

ç) personit i është refuzuar ose hequr licenca nga një autoritet rregullator financiar ose i është tërhequr akreditimi nga një shoqatë profesionale.

4. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi zbatohen që nga fillimi i veprimtarisë dhe duhet të përmbushen nga personat e mësipërm, për aq kohë sa ushtrojnë funksione pranë shoqërisë së administrimit.

#### Neni 15

### **Kualifikimet dhe përvoja profesionale**

Personat kyç dhe personeli kyç i shoqërisë administruese të fondeve duhet të përmbajnë të

paktën dy persona fizikë, të cilët përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) kanë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në pozicion profesional ose drejtues në një institucion financiar të licencuar lidhur me analizën e portofoleve, administrimin e portofoleve ose administrimin e aktiveve dhe pasiveve;

b) kanë kualifikim ndërkombëtar ose vendas në analizën e investimeve, administrimin e investimeve ose administrimin e fondeve, të cilat përmbushin kriteret e themeluara e të përcaktuara nga autoriteti me akt nënligjor;

c) vërtetojnë se kanë njohuri të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje me të, sipas mënyrës dhe standardit të përcaktuar nga autoriteti me akt nënligjor;

ç) nuk mbajnë aktualisht një pozicion në administratën publike.

## Neni 16

### **Procedurat, sistemet dhe masat kontrolluese**

1. Shoqëria administruese e fondeve duhet të ketë:

a) burimet e mjaftueshme dhe të duhura për administrimin e veprimtarisë;

b) procedura të qarta kontabël, administrative dhe të kontrollit, si edhe masa mbrojtëse e rregulla për transaksionet personale të punonjësve të tij;

c) mekanizma të qartë të kontrollit të brendshëm, përfshirë procedurat për të siguruar se çdo transaksion të mund të gjurmohet dhe të dokumentohet që nga fillimi dhe se dokumentacioni përkatës të vërtetojë qartësisht se aktivet e çdo fondi dhe nënfondi administrohen në përputhje me aktin themelues të fondit dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Në rastin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, shoqëria administruese e fondeve duhet:

a) të jetë e organizuar në mënyrë që të minimizojë riskun e konfliktit të interesit midis shoqërisë administruese dhe klientëve të saj, midis dy klientëve të saj, midis njërit prej klientëve të saj dhe një sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike dhe midis dy ose më shumë sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

b) të mos investojë aktivet e klientit në sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike të administruara nga shoqëria, nëse klienti nuk ka dhënë pëlqimin e tij për këtë me shkrim, nëse shoqëria ofron shërbime të administrimit të portofolit, sipas shkronjës "b", të pikës 4, të nenit 11, të këtij ligji;

c) të zbatojë procedura të brendshme për ankesat e klientëve.

3. Shoqëria administruese e fondeve duhet të ketë procedura të brendshme për të siguruar përmbushjen e pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti mund të përcaktojë parashikime të mëtëjshme për kërkesat lidhur me procedurat, sistemet dhe masat kontrolluese të shoqërive administruese të fondeve, përfshirë kërkesat për trajtimin e ankesave që i drejtohen shoqërisë administruese.

## Neni 17

### **Licenca si shoqëri administruese e fondeve**

1. Shoqëria administruese e fondeve nuk ofron ose premtion të ofrojë apo të krijojë një sipërmarrje të investimeve kolektive pa u licencuar më parë nga autoriteti.

2. Kërkesa për licencë për të ushtruar veprimtari si shoqëri administruese e fondeve shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumente që dëshmojnë se kapitali minimal fillestar është paguar plotësisht në para dhe

se kapitali rrjedh nga burime legjitime. Për të vërtetuar burimin e kapitalit minimal fillestar dhe shtesën e këtij kapitali, në autoritet depozitohet informacioni dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

Për personat juridikë:

i. dëshmi për burimin e krijimit të kapitalit, si: raporti i audituesit të licencuar, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të shoqërisë administruese të fondeve;

ii. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore;

iii. raporti i kredimarrësit nga regjistri i kredive ose vërtetim për gjendjen e kredive në sistemin bankar.

Për personat fizikë:

i. dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata,

ii. paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

iii. vërtetime që dëshmojnë shlyerjen e detyrimeve tatimore;

iv. vërtetim për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

b) dokumente që dëshmojnë pronësinë në shoqëri, përfshirë të dhëna për pjesëmarrjet influencuese, nëse ka, dhe vlerën e këtyre pjesëmarrjeve;

c) dokumente që dëshmojnë se pronarët, personat kyç dhe personeli kyç i shoqërisë administruese të fondeve janë veçmas dhe bashkërisht të aftë e të përshtatshëm, përfshirë kualifikimet akademike, profesionale dhe administruese; CV-të dhe emrat e kontaktet e personave, dëshmi mbështetëse për saktësinë e informacionit të dhënë në CV, si dhe një deklaratë të nënshkruar për çdo person se nuk ka asnjë hetim penal, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare; për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ç) dokumente që vërtetojnë programin e veprimtarisë dhe një përshkrim të organizimit të shoqërisë administruese të fondeve, dokumente që vërtetojnë planin e biznesit dhe planin financiar, përfshirë edhe funksionin e auditimit të brendshëm;

d) deklaratë konflikti interesi të personave kyç ose personelit kyç nëse janë anëtarë të këshillit të administrimit ose aksionarë të palëve të lidhura;

dh) dokumente ku përcaktohen sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, që do të administrohen, përfshirë të dhëna për informimin e investitorëve sipas seksionit 2, të kapitullit V, të këtij ligji;

e) dokumente që përmbajnë të dhëna mbi fondet e investimeve alternative që do të administrohen, nëse ka, përfshirë edhe të dhëna mbi informimin paraprak të investitorëve, sipas nenit 125 të këtij ligji;

ë) dokumente që vërtetojnë programin e veprimtarisë ku paraqitet struktura organizative e subjektit, përfshirë informacionin lidhur me planifikimin e përmbushjes së detyrimeve të mëposhtme lidhur me:

i. përputhshmërinë në vijimësi me kërkesat mbi licencimin në zbatim të këtij ligji, si dhe të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe të aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtyre ligjeve;

ii. kushtet e veprimtarisë për shoqërinë administruese të fondeve, sipas këtij ligji, si dhe legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtyre ligjeve, përfshirë edhe delegimin e detyrave;

iii. parandalimin dhe administrimin e konfliktit të interesit në bazë të këtij ligji, si dhe

legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtyre ligjeve;

iv. kërkesat për transparencën dhe dhënien e informacioneve shpjeguese, në bazë të këtij ligji, si dhe legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtyre ligjeve;

v. kërkesat për administrimin e riskut dhe të likuiditetit në bazë të këtij ligji;

vi. detyrimet e raportimit lidhur me shoqërinë administruese dhe fondet e administruara në bazë të këtij ligji, si dhe legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtyre ligjeve;

vii. kërkesat për administrimin e llojeve të veçanta të fondeve të administruara në bazë të këtij ligji, si dhe legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtyre ligjeve;

viii. marketimin e fondeve në administrim nga shoqëria administruese në Republikën e Shqipërisë ose në vende të huaja;

ix. administrimin e fondeve të huaja të marketuara në vende të huaja;

f) vërtetim se skemat e shpërblimit të punës janë në përputhje me këtë ligj dhe me politikat dhe praktikat e pagave të personelit, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti;

g) rregullat përkatëse për delegimin dhe nëndelegimin tek të tretët, të funksioneve që janë përgjegjësi e shoqërisë administruese në bazë të këtij ligji ose të aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji;

gj) vërtetim mbi fondet e tjera të veta që mund të përdoren për të mbuluar risqet e mundshme, që lindin nga pakujdesia profesionale ose për sigurim të përgjegjësive profesionale për detyrime, që lindin nga pakujdesia profesionale që është në përputhje me risqet e mbuluara, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti;

h) përshkrim i standardeve të qeverisjes së brendshme, sipas praktikave më të mira të qeverisjes në bazë të standardeve të përcaktuara nga autoriteti;

i) vërtetim se vlerësimi kryhet nga një njësi, e cila nga ana funksionale është e pavarur nga administrimi i portofolit dhe politikat e shpërblimit dhe masat e tjera garantojnë parandalimin e konfliktit të interesit dhe pengojnë ushtrimin e ndikimit të parregullt mbi punonjësit në rastin e fondeve të investimeve alternative kur vlerësimi kryhet nga vetë shoqëria administruese dhe jo nga një vlerësues i jashtëm;

j) draftmarrëveshjen ndërmjet subjektit dhe depozitarit;

k) draftmarrëveshjen ndërmjet subjektit dhe audituesit të pavarur, i cili është person juridik i licencuar ose i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë për ta ushtruar këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

3. Kërkesa për t'u licencuar si shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative, e paraqitur nga personi juridik, i cili në momentin e kërkesës është i licencuar si shoqëri administruese për sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike nuk shoqërohet nga dokumentet dhe informacionet e paraqitura më parë për këtë licencë, me kusht që ky informacion të jetë ende i vlefshëm dhe i saktë.

4. Autoriteti, nëse e sheh të nevojshme, miraton rregulla shtesë lidhur me kërkesat për licencim si shoqëri administruese të fondeve dhe procedurat e miratimit të kësaj kërkesë.

Neni 18

### **Dhënia e licencës si shoqëri administruese**

1. Autoriteti konsultohet paraprakisht me autoritetin rregullator vendas apo të huaj të shoqërisë mëmë, të shoqërisë administruese të fondeve, në rastet kur shoqëria mëmë e



shoqërisë administruese të fondeve është një bankë, shoqëri e huaj komisionere, si dhe shoqëri e huaj sigurimesh.

2. Autoriteti vlerëson nëse kërkesa është e plotë ose jo dhe informon për këtë subjektin kërkuar.

3. Autoriteti e informon subjektin kërkuar brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë, lidhur me miratimin ose refuzimin e licencës.

4. Kërkesa për licencë mund të tërhiqet me njoftim me shkrim, në çdo moment përpara se autoriteti të marrë vendim për të.

5. Autoriteti informon dhe jep me shkrim arsyet për refuzimin e licencës.

6. Shoqëria administruese e fondeve fillon veprimtarinë e saj menjëherë pas miratimit të licencës.

7. Autoriteti mund të kufizojë objektin e licencës së dhënë një shoqërie administruese të fondeve, që administron sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, në veçanti lidhur me strategjitë e investimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike që lejohen të administrohen nga shoqëria administruese.

## Neni 19

### **Refuzimi i licencës**

Autoriteti refuzon dhënien e licencës shoqërisë administruese të fondeve, si më poshtë:

a) nëse subjekti kërkuar nuk përmbush përcaktimet e neneve 12-17, të këtij ligji, dhe, në veçanti nëse, duke mbajtur parasysh garantimin e administrimit të kujdesshëm të shoqërisë administruese të fondeve, autoriteti gjykon se nuk përmbushen kërkesat për aftësinë dhe përshtatshmërinë e pronarëve, të punonjësve kyç ose të personelit kyç;

b) nëse gjykon se shoqëria nuk përmbush kushtet e këtij ligji; dhe

c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve mbikëqyrëse të autoritetit pengohet nga:

i. lidhjet e pronësisë midis shoqërisë administruese të fondeve dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër që rregullojnë personat fizikë ose juridikë me të cilët ka lidhje pronësie shoqëria administruese e fondeve;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative; dhe

ç) nëse nuk është paguar tarifa e kërkuar.

## Neni 20

### **Miratimi i ndryshimeve të rëndësishme**

1. Shoqëria administruese e fondeve informon autoritetin për çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve të licencës, sidomos për çdo ndryshim për informacionet, në përputhje me shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 17, të këtij ligji. Njoftimi i jepet autoritetit jo më pak se tre muaj përpara implementimit të çdo ndryshimi të rëndësishëm.

2. Shoqëria administruese e fondeve implementon ndryshimet e njoftuara sipas pikës 1, të këtij neni, nëse autoriteti, deri në tre muaj pas marrjes së njoftimit nuk ka shprehur kundërshtim për ndryshimet ose nuk ka themeluar kushte për ndryshimet e njoftuara me shkrim.

3. Nëse shoqëria administruese e fondeve nuk garanton dot që sipërmarrja e investimeve kolektive apo personi që vepron në emër të saj të jetë në përputhshmëri me këtë ligj, shoqëria

administruese e fondeve informon menjëherë autoritetin dhe, nëse është e nevojshme, autoritetin e huaj rregullator të shoqërisë administruese të fondeve.

4. Marrja në pronësi e një pjesëmarrjeje influencuese në një shoqëri administruese të fondeve kryhet vetëm pasi marrësi ta ketë informuar për këtë autoritetin. E njëjta kërkesë zbatohet për pjesëmarrjen që arrin ose kalon nivelin 20 %, 30 % ose 50 % të kapitalit aksionar ose të votave të shoqërisë.

5. Shoqëria administruese e fondeve e licencuar mund të zotërojë aksione në një shoqëri tjetër administruese të licencuar vetëm kur blen dhe zotëron 100 % të aksioneve të shoqërisë administruese të licencuar.

6. Autoriteti refuzon marrjen në pronësi, sipas pikës 4, të këtij neni, nëse aksionari nuk konsiderohet i aftë dhe i përshtatshëm në bazë të nenit 14, të këtij ligji, në mënyrë që të garantohet administrimi i kujdesshëm dhe i matur i shoqërisë administruese të fondeve.

7. Autoriteti mund të përcaktojë një kuotë maksimale që mund t'i lejohet një personi lidhur me pjesëmarrjen influencuese ose mund të përcaktojë rritje të pjesëmarrjes influencuese në një shoqëri administruese.

8. Heqja nga pronësia e një pjesëmarrjeje influencuese në një shoqëri administruese të fondeve kryhet vetëm pasi marrësi ta ketë informuar për këtë autoritetin. E njëjta kërkesë zbatohet për pjesëmarrjen që bie nën nivelin 20 %, 30 % ose 50 % të kapitalit aksionar ose të votave të shoqërisë.

9. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë lidhur me blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjes influencuese, si dhe lidhur me detyrimin për njoftim.

## Neni 21

### **Zëvendësimi i shoqërisë administruese**

1. Shoqëria administruese e fondeve e licencuar mund t'ia transferojë të drejtën për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive një shoqërie tjetër administruese, që është e licencuar nga autoriteti në përputhje me procedurën, e cila parashikohet me akt nënligjor nga autoriteti dhe, në rastin e shoqërisë së investimit, pasi është marrë miratimi me anë të një vendimi të jashtëzakonshëm të aksionarëve.

2. Transferimi i propozuar i njoftohet paraprakisht me shkrim autoritetit, i cili jep miratimin përpara implementimit të transferimit.

3. Shoqëria administruese që transferon administrimin informon mbajtësit e aksioneve dhe të kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike nën administrim lidhur me transferimin, tre muaj përpara implementimit të transferimit. Gjatë kësaj periudhe nuk zbatohet asnjë komision për daljen nga sipërmarrja.

4. Shoqëria administruese që transferon të drejtën për administrim nënshkruan një kontratë për transferimin e administrimit me një shoqëri tjetër administruese të licencuar, kontratë e cila përmban:

a) përshkrimin specifik të të gjitha procedurave dhe veprimeve që do të ndërmerren nga të dyja shoqëritë për transferimin e administrimit;

b) një grafik kohor që fillon me informimin e mbajtësve të aksioneve ose kuotave dhe mbaron me përfundimin e transferimit.

5. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë lidhur me transferimin e së drejtës për administrim nga shoqëria administruese e fondeve veçanërisht lidhur me procedurat, afatet kohore dhe përmbajtjen e kontratës, sipas pikës 4 të këtij neni.

### **Emërtimi i shoqërisë administruese**

Emërtimi “shoqëri administruese”, “shoqëri administruese e fondeve të investimeve”, “shoqëri administruese e fondeve”, “shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative”, “administrues i fondeve të investimeve alternative” ose çdo emërtim i ngjashëm me këto përdoret në Republikën e Shqipërisë vetëm nga persona që kanë licencën përkatëse të lëshuar nga autoriteti, në zbatim të këtij ligji ose që janë njohur nga autoriteti se kanë licencë të lëshuar nga një autoritet i huaj rregullator në zbatim të një ligji të barasvlershëm.

## **SEKSIONI 2**

### **DETYRAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE**

#### **Detyrat e shoqërisë administruese**

1. Shoqëria administruese e fondeve ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj, me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të tij dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, rast pas rasti, si dhe vepron me ndershmëri, drejtësi, profesionalizëm, pavarësi dhe vetëm në interes të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

2. Shoqëria administruese e fondeve vepron gjithmonë në interesin më të mirë të investitorëve dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive që administron, si dhe garanton pacenueshmërinë e tregut:

a) duke vepruar në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj;

b) duke përdorur aftësitë dhe dijet e nevojshme, duke vepruar me korrektësi dhe me kujdesin e duhur;

c) duke pasur dhe duke përdorur me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë;

ç) duke shmangur konfliktet e interesit për të garantuar që interesat e investitorëve në çdolloj sipërmarrjeje të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve kanë përparësi dhe qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të shoqërisë administruese të fondeve, interesat e tyre dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të;

d) duke siguruar trajtim të drejtë, të njëjtë dhe të barabartë të mbajtësve të pjesëmarrjeve në sipërmarrjet e investimeve kolektive që administron.

3. Të gjitha pjesëmarrjet në fond kanë të njëjtat të drejta mbi aktivet dhe fitimet e fondit, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktet themeluese.

4. Shoqëria administruese e fondeve, që kryen edhe administrimin e portofoleve në mënyrë individuale nuk i investon këto aktive në fondin që administron pa marrë miratimin paraprak të klientit.

5. Krahas detyrimeve kundrejt aksionarëve të shoqërisë administruese të fondeve, të cilat parashikohen në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, pikat 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen për personat kyç dhe personelin kyç, si dhe punonjësit e shoqërisë administruese të fondeve.

6. Personat kyç, personeli kyç dhe punonjësit e shoqërisë administruese të fondeve trajtojnë

si konfidencial dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo informacion mbi pjesëmarrësit që mund të marrin dijeni për shkak të detyrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me akte ligjore dhe nënligjore. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për personat që kryejnë detyra në emër të shoqërisë administruese të fondeve, përfshirë subjektet të cilave u është deleguar në zbatim të nenit 25, të këtij ligji, si dhe punonjësve të tyre. Dispozitat e kësaj pike nuk zbatohen për rastet e mëposhtme:

a) kur mbajtësi i aksionit ose kuotës në fond shprehet dakord me shkrim për përhapjen e disa të dhënave të caktuara konfidenciale;

b) kur të dhënat i kërkon autoriteti, gjykata ose një autoritet tjetër rregullator në funksion të një procedure të kryer brenda kompetencave të tij dhe për këtë i jep subjektit kërkesë me shkrim për informacionin;

c) kur të dhënat i bëhen të ditura shoqërisë mëmë lidhur me mbikëqyrjen, në përputhje me këtë ligj ose në përputhje me ligjin që rregullon grupimet financiare.

7. Shoqëria administruese e fondeve mban përgjegjësi përpara investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike për mospërbushje të veprimtarive ose detyrave në bazë të këtij ligji, akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji, aktit themelues dhe prospektit SIK dhe kontratës së administrimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike. Kufizimi në çfarëdolloj mënyre i përgjegjësisë vlerësohet i pavlefshëm.

## Neni 24

### **Konflikti i interesit**

1. Shoqëria administruese e fondeve parandalon konfliktin e interesit që lind në lidhje me veprimtarinë e saj tregtare. Shoqëria administruese e fondeve ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për të identifikuar dhe monitoruar konfliktin e interesit që lind në lidhje me administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Kjo përfshin konfliktin e interesit midis:

a) shoqërisë administruese të fondeve, përfshirë punonjësit e drejtuesit e saj dhe personat me të cilët ka lidhje pronësie ose një subjekt i lidhur i saj dhe çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive nën administrim të shoqërisë administruese të fondeve dhe investitorëve në këtë sipërmarrje;

b) sipërmarrjes së investimeve kolektive ose investitorëve në këtë sipërmarrje dhe një klienti tjetër të shoqërisë administruese të fondeve;

c) sipërmarrjes së investimeve kolektive ose investitorëve në këtë sipërmarrje dhe çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive nën administrim të shoqërisë administruese të fondeve ose investitorëve të kësaj sipërmarrjeje;

ç) dy klientëve të shoqërisë administruese të fondeve.

2. Shoqëria administruese e fondeve duhet të ketë ndarje organizative midis fushave të biznesit, të cilat mund të krijojnë konflikt interesi.

3. Kur hapat e ndërmarrë, në bazë të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, nuk janë të mjaftueshme për të mbrojtur interesat e investitorëve, shoqëria administruese informon investitorët për konfliktin e mundshëm të interesit. Shoqëria administruese nuk mund të kryejë veprimtari tregtare për llogari të investitorit përpara se të informojë investitorin.

4. Personi kyç ose personeli kyç i shoqërisë administruese të fondeve, i cili ka konflikt interesi lidhur me transaksionet e kryera nga shoqëria administruese e fondeve informon me shkrim lidhur me këtë konflikt interesi auditin e brendshëm përpara se të marrë pjesë në çdo lloj

vendimi që ka lidhje me këtë konflikt interesi, si dhe në çfarëdolloj mbledhjeje ku lind ky konflikt interesi. Personi kyç ose personeli kyç, i cili nuk përmbush kërkesën e kësaj pike, nuk lejohet për pesë vjet, duke filluar nga data e shkeljes së detyrimit të kësaj pike, të zgjidhet apo të emërohet si person kyç ose si personel kyç në asnjë institucion që mbikëqyret nga autoriteti.

5. Shoqëria administruese e fondeve, lidhur me çdo sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike që administron, nuk kryen asnjë transaksion me persona me të cilët ka lidhje pronësie ose me të cilët është subjekt i lidhur që rezultojnë në përfitime të padeklaruara për secilën nga të dyja palët ose kur përfitimet, që rrjedhin nga transaksioni nuk do të kishin lindur nëse transaksioni do të ishte kryer me kushte normale tregu në momentin e transaksionit.

## Neni 25

### **Delegimi nga shoqëria administruese**

1. Shoqëria administruese e fondeve mund të delegojë funksionimin e disa pjesëve të veprimtarisë së saj tregtare te një palë e tretë, me përjashtim të rastit nëse ky delegim është i shkallës apo i një mënyre të tillë, që të konsiderohet si jo i kujdesshëm apo që vështirëson mbikëqyrjen e veprimtarisë tregtare të deleguar ose të gjithë veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese të fondeve apo pengon shoqërinë administruese të fondeve, që të veprojnë në interesin më të mirë të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike që administron.

2. Shoqëria administruese e fondeve mund të delegojë te një palë e tretë kryerjen e funksioneve të përcaktuara, në bazë të pikave 5 dhe 6, të nenit 11, të këtij ligji. Shoqëria administruese e fondeve vazhdon të jetë përgjegjëse për funksionet e deleguara, për mbarëvajtjen e funksioneve dhe për mbikëqyrjen e personave, të cilëve u delegohen me kontratë këto funksione, përfshirë edhe përputhshmërinë në vazhdimësi me kërkesat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 4, të këtij neni. Shoqëria administruese e fondeve garanton bashkëpunim efektiv ndërmjet saj dhe subjektit që i janë deleguar funksionet dhe garanton që mbikëqyrja efektive nga ana e autoritetit të mos pengohet për shkak të delegimit.

3. Shoqëria administruese e fondeve informon autoritetin përpara hyrjes në fuqi të çdo kontrate për delegimin e funksioneve, që mbulon administrimin e portofolit, administrimin e riskut, vlerësimin, funksionet administrative dhe marketimin.

4. Delegimi nga shoqëria administruese e fondeve duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) shoqëria administruese e fondeve duhet të justifikojë me arsye objektive të gjithë strukturën e delegimit;

b) delegimi të mos pengojë efektivitetin e mbikëqyrjes mbi shoqërinë administruese të fondeve dhe sidomos të mos pengojë shoqërinë administruese të fondeve që të veprojnë, ose që të administrojnë fondet në interesin e investitorëve;

c) i deleguari të ketë burime të mjaftueshme për kryerjen e detyrave përkatëse, si dhe personat që ushtrojnë veprimtarinë tregtare, të deleguarit të jenë të aftë dhe të përshtatshëm dhe të kenë përvojë të mjaftueshme;

ç) kur delegimi lidhet me administrimin e portofoleve ose administrimin e riskut, delegimi të kryhet vetëm nga persona që janë të licencuar ose të regjistruar, me qëllim administrimin e investimeve dhe që janë objekt mbikëqyrjeje ose, kur nuk mund të përmbushet ky kusht, vetëm me miratimin paraprak të autoritetit;

d) shoqëria administruese e fondeve të vërtetojë se i deleguari është i kualifikuar dhe i aftë për të ndërmarrë funksionet në fjalë dhe se shoqëria administruese e fondeve në çdo moment

është në gjendje të monitorojë me efektivitet veprimtarinë e deleguar, të japë udhëzime të mëtejshme dhe të anulojë delegimin në mënyrë të menjëhershme nëse kjo është në interes të investitorëve;

dh) kur delegimi lidhet me administrimin e investimeve dhe i delegohet një sipërmarrjeje në një vend tjetër, duhet të sigurohet bashkëpunimi midis autoritetit rregullator të atij vendi dhe autoritetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse autoriteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me autoritetin e huaj rregullator përkatës;

e) prospekti për sipërmarrjet e investimeve kolektive nën administrimin e shoqërisë administruese të fondeve të listojë të gjitha funksionet që i lejohet të delegojë shoqërisë administruese të fondeve;

ë) çdo subjekt tek i cili delegohet, duhet të ketë licencën e nevojshme për të kryer funksionet e deleguara në bazë të këtij ligji ose në bazë të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, ose të ligjit të huaj, i barasvlershëm më të, ose në rastin e një subjekti të huaj, që është njohur nga autoriteti.

5. Administrimi i portofoleve ose administrimi i risqeve nuk i delegohet:

a) depozitarit ose të deleguarit të depozitarit; ose

b) subjektit, interesat e të cilit mund të bien ndesh me interesat e shoqërisë administruese të fondeve ose të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, me përjashtim të rastit kur ky subjekt ka ndarje hierarkike dhe funksionale të kryerjes së detyrave të administrimit të portofolave dhe të administrimit të risqeve nga detyrat e tjera që mund të bien ndesh me to, dhe nëse konflikti i interesit identifikohet, administrohet, monitorohet dhe i njoftohet investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive që administron shoqëria administruese e fondeve.

6. I deleguari mund të bëjë nëndelegim vetëm nëse bie dakord paraprakisht me shoqërinë administruese të fondeve dhe nëse nga i nëndeleguari përmbushen kërkesat e pikës 4, të këtij neni, dhe nëse autoriteti informohet për delegimin e këtyre funksioneve, në përputhje me pikën 3 të këtij neni. Shoqëria administruese e fondeve kryen monitorim të vazhdueshëm të shërbimeve që delegon dhe i deleguari kryen monitorim të vazhdueshëm të shërbimeve që nëndelegon. Çdo nëndelegim i mëtejshëm nga i nëndeleguari duhet të jetë në përputhje me këtë nen.

7. Përgjegjësia e shoqërisë administruese të fondeve kundrejt sipërmarrjes së investimeve kolektive në administrim dhe kundrejt investitorëve nuk preket nga delegimi i funksioneve tek të tretët apo nga nëndelegimi.

8. Nuk lejohet nëndelegimi i vlerësimit të jashtëm nga vlerësuesi i jashtëm i fondit të investimeve alternative.

## Neni 26

### **Politika e shpërblimit**

1. Shoqëria administruese e fondeve vendos dhe zbaton politika të shpërblimit të punës, e cila nxit administrim të suksesshëm dhe mbajtje nën kontroll të riskut të subjektit dhe e cila është në përputhje me profilin e riskut dhe strategjinë e saj afatgjatë. Politika e shpërblimit të punës nuk përkrah marrjen përsipër të riskut të tepruar që nuk përputhet me profilet e riskut, aktet themeluese ose prospektet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive që administrojnë.

2. Shoqëria administruese e fondeve që administron sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike garanton që politika e shpërblimit të punës të mos cenojë përmbushjen e detyrimit të shoqërisë administruese për të vepruar në interes të investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

3. Politika e shpërblimit e të gjitha llojeve të shoqërive administruese të fondeve përfshin

personat kyç dhe personelin kyç dhe punonjësit, detyrat e të cilëve kanë rëndësi materiale për ekspozimin ndaj riskut të shoqërisë administruese të fondeve ose të sipërmarrjeve të investimeve kolektive që administrojnë dhe përfshin edhe punonjësit e tjerë me të njëjtin shpërblim pune si personat kyç, veprimtaritë profesionale të të cilëve kanë ndikim material në profilin e riskut të shoqërisë administruese të fondeve ose të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike që administrojnë.

4. Politikat e shpërblimit janë të përshtatshme me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të shoqërisë administruese të fondeve.

5. Politika e shpërblimit përfshin shpërblimin fikse dhe shpërblimin e ndryshueshëm dhe çdo përfitim pensionesh të parashikuar nga vetë subjekti dhe rishikohet rregullisht.

## Neni 27

### **Administrimi i risqeve**

1. Shoqëria administruese e fondeve veçon funksionin e administrimit të risqeve nga njësitë operacionale, përfshirë funksionet e administrimit të portofoleve, në mënyrë që shoqëria administruese e fondeve të garantojë se masat specifike mbrojtëse kundër konfliktit të interesit të mundësojnë kryerjen e pavarur të veprimtarive të administrimit të risqeve dhe se procesi i administrimit të risqeve të jetë efektiv në vazhdimësi.

2. Shoqëria administruese e fondeve krijon sisteme të administrimit të risqeve, të cilat identifikojnë, masin, administrojnë dhe monitorojnë në vazhdimësi të gjitha risqet e lidhura me objektivin dhe strategjinë e investimit të secilës prej sipërmarrjeve të investimeve kolektive ose nënfond që administrojnë dhe ndaj të cilave mund të ekspozohet çdo fond. Kjo përfshin procedura për analizimin e investimeve në emër të çdo sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondi, në përputhje me objektivin dhe strategjinë e investimit dhe profilin e riskut të sipërmarrjes ose nënfondit në fjalë. Shoqëria administruese e fondeve garanton që profili i riskut të sipërmarrjes ose nënfondit që administrojnë të përkojë me madhësinë, strukturën e portofoleve, strategjinë e investimit dhe objektivat e investimit të sipërmarrjes ose nënfondit siç parashikohen në aktin themelues, prospektin SIK ose dokumentin tjetër të ofertës, përfshirë edhe nëpërmjet kryerjes së provës së rezistencës.

3. Funksioni i administrimit të riskut ka këto përgjegjësi:

a) krijimin dhe sugjerimin të personat kyç, të miratimit të një sistemi për administrimin e riskut në çdo sipërmarrje të investimeve kolektive ose nënfond, që përfshin monitorimin e politikave të miratuara, themeluar në mënyrë që të gjitha risqet kryesore të identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen, në mënyrë të vazhdueshme;

b) krijimin e sistemit të administrimit të riskut, që monitoron risqet, ndaj të cilave është e ekspozuar shoqëria dhe sipërmarrja e investimeve kolektive që administrojnë, përfshirë riskun e tregut, riskun e kreditit, riskun operacional, riskun ligjor dhe reputacional dhe riskun në lidhje me veprimet që bien në kundërshtim me interesat e pjesëmarrësve dhe të aksionarëve;

c) mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve dhe të mënyrës së saj të administrimit e të çdo sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe dhënien e orientimeve të përditshme për të garantuar që shoqëria administruese e fondeve, në funksionet e veta dhe gjatë administrimit të fondeve, vepron brenda kufijve të risqeve, të përcaktuara nga personat kyç dhe të parashikuara në aktin themelues e prospektin SIK të çdo sipërmarrjeve.

4. Shoqëria administruese e fondeve rishikon rregullisht sistemet e administrimit të risqeve, por jo më pak se një herë në vit.

5. Krahas përmbushjes së kërkesave të parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, shoqëria administruese e fondeve që administrojnë sipërmarrje të investimeve kolektive me

ofertë publike, kryen rregullisht provën e rezistencës, në kushte normale dhe në kushte të jashtëzakonshme likuiditeti, të cilat i japin mundësi të vlerësojë dhe të monitorojë riskun e likuiditetit të çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike dhe nënfondi në administrim.

## Neni 28

### **Administrimi i likuiditetit**

1. Shoqëria administruese e fondeve zbaton një sistem të përshtatshëm të administrimit të likuiditetit për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive dhe nënfond në administrim.

2. Shoqëria administruese e fondeve zbaton procedura që monitorojnë riskun e likuiditetit të fondeve në administrim dhe garanton që profili i likuiditetit të investimeve të çdo fondi është në përputhshmëri me detyrimet përkatëse.

3. Shoqëria administruese e fondeve kryen provën e rezistencës në kushte normale dhe në kushte të jashtëzakonshme likuiditeti, duke mundësuar vlerësimin dhe monitorimin e riskut të likuiditetit të çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive ose nënfondi në administrim. Këto kryhen sipas shpeshësisë së nevojshme në bazë të natyrës së portofolit të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose të nënfondit, por jo më pak se një herë në vit me intervale të rregullta.

4. Shoqëria administruese e fondeve garanton që, për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive ose nënfond në administrim, objektivi dhe strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes së kuotave të jenë të qëndrueshme.

5. Parashikimet e përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, nuk zbatohen për fondet e investimeve alternative me pjesëmarrje të mbyllur.

## Neni 29

### **Përgjegjësia për vlerësimin**

1. Shoqëria administruese e fondeve zbaton procedura për vlerësimin e saktë dhe të pavarur të aktiveve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive nën administrim. Metoda e llogaritjes së vlerës që përdoret miratohet nga shoqëria administruese e fondeve dhe nga depozitari dhe përshkruhet në mënyrë të përgjithshme në prospektin SIK. Kjo zbatohet në mënyrë të njëjtë në çdo llogaritje të vlerës neto të aktiveve.

2. Shoqëria administruese e fondeve është përgjegjëse për vlerësimin e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe të çdo nënfondi që administrojnë dhe përgjegjëse për vendosjen e drejtë të çmimit të pjesëmarrjeve në sipërmarrje ose në nënfond.

3. Për të përcaktuar vlerën e pjesëmarrjes në sipërmarrjen e investimeve kolektive ose në nënfond, shoqëria administruese e fondeve kryen një vlerësim të rregullt dhe të saktë të të gjitha aktiveve që i përkasin fondit ose nënfondit, në përputhje me aktin themelues të sipërmarrjes dhe me prospektin SIK dhe me këtë ligj dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

4. Në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, zbatohen përcaktimet e mëposhtme:

a) shoqëria administruese e fondeve është përgjegjëse për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për aksion ose për kuotë të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe nënfondeve dhe të çmimit me të cilin kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike u shiten ose u shlyhen investitorëve dhe me të cilin krijohen ose anulohen kuotat;



b) depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike garanton që:

i. shitja, emetimi, shlyerja dhe anulimi i kuotave të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale të kryera në emër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive nga shoqëria administruese kryhen me një çmim që lidhet ngushtë me vlerën neto të aktiveve, në përputhje me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

ii. çmimi i aktiveve të portofolit të sipërmarrjes ose nënfondit është përcaktuar në përputhje me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

iii. vlera neto e aktiveve të aksioneve dhe kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit është llogaritur në përputhje me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

c) llogaritja e vlerës neto të aktiveve për aksion ose kuotë i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga depozitari, i cili, në këtë rast është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes. Depozitari nënshkruan dokumentin që përmban përcaktimin e vlerës së aktiveve dhe mban një kopje në dosjen e vet, e cila i vihet në dispozicion autoritetit për inspektim sipas kërkesës;

ç) audituesi i jashtëm i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike kryen kontrole herë pas here gjatë auditimit vjetor për të siguruar që janë respektuar kërkesat e vlerësimit në bazë të këtij ligji ose të aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji, që çmimi i llogaritur i kuotave ose aksioneve është i saktë dhe që tarifat e administrimit dhe kosto të tjera të faturuara janë në përputhje me këtë ligj dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

5. Lidhur me fondet e investimeve alternative, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i fondeve të investimeve alternative i informon investitorët për vlerësimet dhe llogaritjet, sipas parashikimeve të aktit themelues të fondit përkatës të investimeve alternative.

## Neni 30

### Frekuenca e llogaritjes së vlerës

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike kryen llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për aksion ose kuotë:

a) në rastin e sipërmarrjes me pjesëmarrje të mbyllur, jo më pak se një herë në vit me intervale të rregullta, siç përcaktohet në prospektin SIK, me përjashtim të periudhës së ofertës fillestare me çmim të pandryshuar;

b) në rastin e sipërmarrjes ose nënfondit me pjesëmarrje të hapur, çdo ditë pune, siç përcaktohet në prospektin SIK, me përjashtim të periudhës së ofertës fillestare me çmim të pandryshuar;

c) në rastin e sipërmarrjes ose nënfondit me intervale, jo më pak se një herë në gjashtë muaj, me intervale të rregullta, siç përcaktohet në prospektin SIK, me përjashtim të periudhës së ofertës fillestare me çmim të pandryshuar;

ç) në rastin e sipërmarrjes ose nënfondit të investimeve kolektive në tregun e parasë, jo më pak se një herë në çdo ditë pune.

2. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative vlerëson aktivet e fondit ose nënfondit të investimeve alternative dhe llogarit vlerën neto të aktiveve për kuotë ose aksion të paktën një herë në vit, rregullisht, në mënyrë periodike:

a) për fondet e investimeve alternative me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, ky vlerësim bëhet më shpesh nëse është i nevojshëm, sipas aktiveve të fondit të investimeve

alternative apo aktit themelues të fondit të investimeve alternative apo të këtij ligji;

b) në rastin e fondit të investimeve alternative me pjesëmarrje të mbyllur, këto vlerësime dhe llogaritje kryhen në rast të zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit të fondit të investimeve alternative, kur kryhet një emetim i ri aksionesh ose kuotash ose anulim aksionesh ose kuotash ekzistuese.

## Neni 31

### **Koha e llogaritjes së vlerës**

1. Shoqëria administruese e një fondi investimesh të hapur me ofertë publike ose nënfondi ose fondi me interval me ofertë publike kryen llogaritjen e vlerës në një orë të përcaktuar (pika e vlerësimit) të vendosur nga shoqëria administruese, si koha më e përshtatshme për vlerësimin e llojit të aktiveve në pronësi të sipërmarrjes ose nënfondit të deklaruar në prospektin SIK.

2. Gjatë periudhës së ofertës fillestare me çmim fiks nuk kërkohet pikë vlerësimi.

3. Shoqëria administruese e fondit ose nënfondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale kryen llogaritjen e vlerës menjëherë përpara se të krijojë një çmim, me të cilin shiten ose shlyhen kuotat. Shoqëria administruese nuk duhet të shesë apo të shlyejë kuota dhe as nuk mund të krijojë dhe anulojë kuota me çmime të llogaritura, përpara pikës së ardhshme të vlerësimit pas marrjes së një porosie të vlefshme për nënshkrim ose shlyerje të kuotave.

4. Shoqëria administruese mund të kryejë në çdo moment llogaritje shtesë ose më të shpeshta të vlerës, pasi bie dakord me autoritetin, nëse e konsideron si të nevojshme për ruajtjen e rregullsisë kundrejt investitorëve ose nëse një gjë e tillë kërkohet nga autoriteti.

5. Pika e vlerësimit për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për aksion ose për kuotë apo të çmimit të kuotës vetëm për qëllim publikimi nuk konsiderohet si pikë vlerësimi për shitjen, shlyerjen ose anulimin e kuotave nëse nuk përcaktohet si e tillë në prospektin SIK të sipërmarrjes.

6. Shoqëritë administruese të fondeve përjashtohen nga përcaktimet e këtij neni lidhur me fondet e investimeve alternative që administrojnë.

## Neni 32

### **Llogaritja e vlerës neto të aktiveve**

1. Shoqëria administruese nuk kryen transaksione për shitjen ose shlyerjen ose krijimin apo anulimin e kuotave të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe fondeve të investimeve me intervale nën administrim me vlera neto të aktiveve ose çmime për kuotë, përveç atyre që llogariten në përputhje me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe prospektin SIK të sipërmarrjes, përveçse kur kuotat shiten me çmim të pandryshueshëm gjatë ofertës fillestare.

2. Shoqëria administruese e shoqërisë së investimeve nuk publikon vlerë neto të aktiveve për aksion, përveç asaj që llogaritet në përputhje me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe prospektit SIK të shoqërisë së investimeve.

3. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike zbaton politika dhe procedura kontabël të themeluara, të zbatuara dhe të rishikuara në vazhdimësi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit të vendit të origjinës të sipërmarrjes, në mënyrë që të garantohet që llogaritja e vlerës neto të aktiveve të çdo sipërmarrjeje që administron të bëhet me saktësi në bazë të kontabilitetit dhe që urdhrat e emetimit, shitjes, shlyerjes apo anulimit të mund të ekzekutohen rregullisht me këtë vlerë neto të aktiveve.

4. Politikat dhe procedurat kontabël, të përmendura në pikën 3, të këtij neni, mundësojnë shoqërinë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit të llogarisë me saktësi vlerën e aktiveve të sipërmarrjes ose nënfondit në çdo pikë vlerësimi dhe të llogarisë çmimet e tregtimit për fondet ose nënfondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, duke u bazuar në këtë vlerësim.

5. Në rastin e ekzistencës së klasave të ndryshme aktivesh duhet të mundësohet që nga evidencat kontabël të nxirret vlera neto e aktiveve e çdo klase të ndryshme.

6. Llogaritja e vlerës së aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike mbështetet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe lidhur me të zbatohen parimet e mëposhtme:

a) instrumentet financiare që janë të listuara dhe tregtohen në tregje të rregulluara, përfshirë aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara dhe të tregtuara në këto tregje, vlerësohen në bazë të çmimit më të fundit të tregut në momentin e vlerësimit, me përjashtim të rastit kur vlerësohen në zbatim të shkronjës “b” të kësaj pike;

b) në rastin e instrumenteve financiare pa çmim të zbatueshëm tregu, të cilat përmbushin kërkesat e shkronjës “a”, të kësaj pike, shoqëritë administruese garantojnë që metodika dhe procesi i vlerësimit të aktiveve, që nuk tregtohen apo që tregtohen rrallë, të jenë të standardizuara dhe dakordësohen me depozitarin dhe autoritetin dhe zbatohen në çdo rast;

c) në rastin e depozitave, llogarive rrjedhëse dhe mjeteve monetare, të drejtave afatshkurtra dhe detyrimeve njëvjeçare në momentin e vlerësimit, të ardhurave dhe shpenzimeve të ardhshme përdoret vlera nominale ose e amortizuar në rastin e titullit të emtuar me skontim ose e rritur me interesin e akumuluar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me akt nënligjor nga autoriteti;

ç) në rastin e transaksioneve të kontratave private të së ardhmes “*forward*” dhe të derivativëve që nuk janë të regjistruar dhe nuk tregtohen në një bursë të rregulluar derivativësh, autoriteti miraton me rregullore mënyrat e llogaritjes së vlerës së këtyre aktiveve;

d) në rastin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, përdoret çmimi i shlyerjes së aksionit ose kuotës, përveç rastit kur kërkohet ndryshe me rregullore ose me urdhër nga autoriteti ose kur autoriteti gjykon se është e nevojshme të mbrohen interesat e pjesëmarrësve në sipërmarrjen e investimeve kolektive ose në nënfond;

dh) në rastin e aktiveve në monedhë të huaj, kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike është e shprehur në të njëjtën monedhë përdoret kjo monedhë; nëse sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike është e shprehur në lekë përdoret kursi më i fundit i këmbimit valutor i Bankës së Shqipërisë përpara llogaritjes së vlerës së aktiveve, në përputhje me rregulloren e miratuar nga autoriteti;

e) në rastin e aktiveve të tjera, të cilat nuk kanë çmim tregu, përdoret vlera e drejtë e këtyre aktiveve. Procedurat për vlerësimin e vlerës së drejtë përcaktohen me rregullore nga autoriteti. Metodikat e lejuara mund të përfshijnë flukset monetare të skontuara, krahasimet me aktive të ngjashme me çmim të ditur tregu, metodat e vlerësimit të opsioneve dhe mënyra të tjera të përcaktuara me rregullore nga autoriteti.

### Neni 33

#### **Auditimi i brendshëm**

1. Shoqëria administruese e fondeve ka një strukturë të auditimit të brendshëm, me madhësi dhe kapacitet të përshtatshëm për veprimtarinë tregtare që kryen.

2. Shoqëria administruese veçon funksionin e auditimit të brendshëm nga njësitë operationale.

3. Funkzioni i auditimit të brendshëm të shoqërisë administruese zbaton metodologjinë me bazë rreziku, për kryerjen e detyrave të mëposhtme:

a) kontrollon nëse shoqëria administruese është e organizuar në mënyrë të tillë që të nxisë administrimin efektiv dhe të kujdesshëm të veprimtarisë tregtare, si dhe monitoron këshillin për përmbushjen e kësaj cilësie administrimi;

b) garanton që të gjithë punonjësit janë të trajnuar siç duhet, i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë dhe pajisen me manuale për procedurat;

c) garanton që i gjithë personeli operativ zbaton rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me pozicionet e tyre të veçanta;

ç) identifikon pikat e dobëta të sistemeve dhe masave kontrolluese që mund të çojnë në humbje ose në mospërputhshmëri;

d) kontrollon zbatimin e parimeve të qeverisjes së shoqërisë, këshillon personat kyç për përcaktimin e politikave dhe strategjive për respektimin e këtyre parimeve, si dhe konstaton çdo vit zbatimin e këtyre politikave dhe strategjive;

dh) garanton që funksioni i kontabilitetit i shoqërisë administruese ofron informacione të sakta dhe në kohën e duhur lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe me rentabilitetin;

e) garanton që sistemet, të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin, caktimin e çmimit dhe komunikimin me depozitarin, funksionojnë siç duhen dhe nuk kanë gabime;

ë) garanton mjaftueshmërinë e kontrollit financiar dhe respektimin e kufizimeve të miratuara të përgjegjësisë për kryerjen e shpenzimeve;

f) identifikon dhe heton rastet e mundshme të vjedhjes, mashtrimit ose shkeljeve në detyrë nga ana e personelit;

g) u bën rekomandime personave kyç për shqyrtim dhe miratim prej tyre, për përmirësimin ose rishikimin e objektivave, strategjisë, planeve të biznesit dhe politikave kryesore që rregullojnë veprimtarinë e subjektit;

gj) u jep personave kyç informacionin e nevojshëm e të hollësishëm për t'u mundësuar shqyrtimin e objektivave, të strategjisë dhe të politikave të biznesit, si dhe i kërkon llogari nivelit të lartë drejtues për veprimtarinë.

Neni 34

### **Kontabiliteti i shoqërisë administruese**

1. Shoqëria administruese zbaton kërkesat e mëposhtme lidhur me kontabilitetin:

a) mban libra dhe evidenca të sakta, të plota dhe të përditësuara kontabël për të paraqitur qartë e në mënyrë korrekte veprimtarinë, për të shpjeguar veprimtaritë, transaksionet dhe pozicionin financiar të saj dhe për t'i dhënë mundësi autoritetit të konstatojë nëse zbatohen kërkesat e këtij ligji;

b) harton pasqyra financiare vjetore dhe të ndërmjetme në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të cilat paraqesin me saktësi dhe vërtetësi pozicionin financiar të veprimtarisë tregtare gjatë periudhës ushtrimore dhe ditën e fundit të punës të vitit financiar dhe të rezultatit të operacioneve gjatë periudhës ushtrimore dhe paraqesin çdo çështje që prek ose ndikon në çështje financiare të shoqërisë administruese të fondeve;

c) në rastin e shoqërisë së kontrolluar përgatit dhe paraqet pasqyra financiare vjetore të audituara individuale dhe të konsoliduara;

ç) përpilon dhe vë në dispozicion:

i. pasqyrën e bilancit përfshirë edhe shënimet, shpjegimet, opinionin e audituesit dhe dokumentet përkatëse;

ii. pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshirë edhe shënimet, shpjegimet,

opinionin e audituesit dhe dokumentet përkatëse;

iii. pasqyrën e flukseve monetare.

2. Pasqyrat financiare të audituara të shoqërisë administruese i dorëzohen autoritetit brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar.

Neni 35

### **Emërimi i audituesit**

1. Shoqëria administruese, emëron një auditues të jashtëm, që i përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, si dhe është i pavarur nga shoqëria administruese dhe nga personat me të cilët shoqëria administruese ka lidhje pronësie, për të audituar pasqyrat e kërkuara financiare, në bazë të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 34, të këtij ligji.

2. Audituesi nuk vepron si auditues i jashtëm i së njëjtës shoqëri administruese për një periudhë kohore prej më shumë se 4 vjetësh radhazi.

3. Autoriteti, nëse nuk është dakord me raportin e auditimit, mund t’i kërkojë audituesit:

a) informacione të tjera shtesë;

b) të japë shpjegime për raportin e auditimit;

c) të zgjerojë objektin e auditimit apo të kryejë procedura të tjera, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Në rast se autoriteti nuk është dakord edhe pas këtyre hapave, mund të kërkojë kontrollin e cilësisë së auditimit, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

4. Autoriteti, nëse e gjykon të nevojshme, mund të refuzojë raportin e auditimit dhe të kërkojë kryerjen e një auditimi të ri me shpenzimet e shoqërisë administruese, audituesit të jashtëm ose të dyve.

5. Në rast të refuzimit të raportit të auditimit, autoriteti kërkon dhe aprovon emërimin e një audituesi tjetër për llogari të shoqërisë administruese dhe përcakton shpërblimin që i duhet paguar audituesit nga shoqëria administruese për auditimin e dytë.

6. Autoriteti, me njoftim me shkrim, mund t’i kërkojë një personi, i cili është ose ka qenë auditues i jashtëm i shoqërisë administruese ose i një shoqërie të kontrolluar apo shoqërie të lidhur të shoqërinë administruese, të japë informacione për shoqërinë administruese, shoqërinë e kontrolluar apo shoqërinë e lidhur që autoriteti i konsideron si të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij.

7. Pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera, audituesi i shoqërisë administruese nuk do të konsiderohet se ka shkelur asnjë dispozitë ligjore në fuqi, për shkak të informimit të autoritetit në mirëbesim, të kërkuar apo jo nga ky i fundit, i informacioneve ose opinioneve për një çështje, për të cilën audituesi vihet në dijeni në cilësinë si auditues i shoqërisë administruese dhe të cilat kanë lidhje me funksionet e autoritetit në bazë të këtij ligji.

8. Nëse audituesi, të cilit i kërkohet dhënia e informacionit, refuzon ose neglizhon të japë këtë informacion ose jep informacione të rreme ose keqorientuese, autoriteti mund ta raportojë audituesin te Bordi i Mbikëqyrjes Publike në Republikën e Shqipërisë dhe të kërkojë marrjen e masave ndaj tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

9. Shoqëria administruese nuk emëron si auditues një person ndaj të cilit janë marrë masa disiplinore, nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar,

për aq kohë sa kjo masë është në fuqi.

10. Nëse mandati i emërimit të audituesit të jashtëm përfundon për arsye të ndryshme, audituesi i jashtëm i paraqet autoritetit një deklaratë, ku shpjegon arsyen e përfundimit të detyrës dhe informon me shkrim autoritetin për çdo çështje që ka lidhje me shoqërinë administruese, për të cilat audituesi i jashtëm ka marrë dijeni gjatë kryerjes së funksioneve të auditimit dhe që, sipas mendimit të audituesit mund të dëmtojë aftësinë e shoqërisë administruese për të vepruar, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

### KREU III

#### DEPOZITARI

#### SEKSIONI 1

### THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I DEPOZITARËVE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

#### Neni 36

#### **Emërimi i depozitarit**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike emëron një depozitar të vetëm.
2. Depozitari licençohet nga autoriteti si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.
3. Depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike mund të ndryshohet vetëm me miratimin paraprak të autoritetit.
4. Emërimi i depozitarit kryhet në përputhje me kontratën e nënshkruar me shkrim nga të dyja palët në praninë e noterit. Kontrata mbulon detyrimet kryesore të secilës palë, sipas kërkesave të këtij ligji dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji. Kontrata përmban parashikime që rregullojnë qarkullimin e informacioneve të nevojshme për t'i dhënë mundësi depozitarit të kryejë funksionet e veta për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike.
5. Depozitari, shoqëria administruese e fondeve dhe sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, e cila është shoqëri investimesh, nuk mund të jenë nën të njëjtin administrim, sipas përcaktimeve të mëposhtme:
  - a) asnjë person nuk mund të jetë në të njëjtën kohë person kyç ose anëtar i personelit kyç të shoqërisë administruese të fondeve dhe person kyç ose anëtar i personelit kyç të depozitarit;
  - b) asnjë person nuk mund të jetë në të njëjtën kohë person kyç ose anëtar i personelit kyç të shoqërisë administruese të fondeve dhe punonjës i depozitarit;
  - c) asnjë person nuk mund të jetë në të njëjtën kohë person kyç ose anëtar i personelit kyç të depozitarit dhe punonjës i shoqërisë administruese të fondeve ose i shoqërisë së investimeve.
6. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike apo investitori në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike nuk i paguan depozitarit asnjë pagesë të asnjë lloji, nëse natyra, shumat dhe arsyet e pagesës nuk i bëhet e ditur qartë investitorit përpara se investitori të investojë në sipërmarrje.
7. Depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike nuk nxjerr përfitime të tjera nga kjo detyrë, përveç se nëpërmjet pagimit të shpërblimit, që lejohet në bazë të këtij ligji dhe në bazë të kontratës me shkrim për ofrimin e shërbimeve sipërmarrjes.

### **Kushtet për licencimin e depozitarëve**

1. Depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të jetë një nga subjektet e mëposhtme:

a) bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë ose degë e një banke të huaj me zyrë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbime të kujdestarisë, depozitarit dhe të besimit; ose

b) lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm të themeluar në një vend të huaj, në zbatim të nenit 95, të këtij ligji, kategori të tjera institucionesh që përmbushin kushtet për të qenë depozitar i sipërmarrjes së investimeve kolektive në tituj të transferueshëm.

2. Depozitari duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:

a) të ketë infrastrukturën e nevojshme për të mbajtur në kujdestari instrumentet financiare që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit;

b) të ketë politika dhe procedura të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të siguruar përputhshmërinë e subjektit, përfshirë edhe administratorët dhe punonjësit e tij, me detyrimet sipas këtij ligji;

c) të ketë procedura të shëndosha administrative dhe kontabël, mekanizma të kontrollit të brendshëm, procedura efektive për vlerësimin e riskut dhe masa efektive të kontrollit dhe mbrojtjes për sistemet e përpunimit të informacionit;

ç) të mbajë dhe të operojë masa efektive organizative dhe administrative, me qëllim marrjen e të gjithë hapave të arsyeshëm që kanë për qëllim parandalimin e konfliktit të interesit;

d) të marrë masat për mbajtjen e evidencave për të gjitha shërbimet, veprimtaritë dhe transaksionet që kryen, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi autoritetit të përmbushë detyrat mbikëqyrëse, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji;

dh) të marrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar vijueshmërinë dhe rregullsinë në kryerjen e funksioneve të depozitarit përmes përdorimit të sistemeve, burimeve dhe procedurave të duhura dhe proporcionale përfshirë edhe kryerjen e veprimtarive të depozitarit;

e) personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit të jenë në çdo moment të aftë dhe të përshtatshëm të zotërojnë dijet, aftësitë dhe përvojën e duhur dhe të kenë aftësitë e përvojën që të mund të kuptojnë veprimtaritë e depozitarit, përfshirë edhe risqet kryesore;

ë) personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit të veprojnë me ndershmëri dhe integritet;

f) personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit të kenë përvojën e mjaftueshme. Të dhënat identifikuese të personave kyç dhe i anëtarëve të personelit kyç, si dhe i çdo personi që i zëvendëson ato në detyrë i njoftohen autoritetit.

3. Depozitari nuk është i regjistruar apo licencuar si shoqëri investimi.

4. Depozitari nuk është i licencuar si shoqëri administruese e fondeve, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri të kontrolluar, e cila mund të ketë licencë si shoqëri administruese e fondeve.

5. Depozitari nuk vepron si depozitar i sipërmarrjes së investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e kontrolluar e depozitarit që është shoqëri administruese e fondeve.

6. Depozitari i licencuar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike mund të licencohet edhe si depozitar i fondeve të investimeve alternative.

7. Subjekti që paraqet kërkesën për licencim si depozitar duhet të ketë raporte auditimi financiar me opinion pa rezerva për tri vitet e fundit.

## Neni 38

### **Licenca e depozitarit**

1. Depozitari i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike nuk fillon veprimtarinë e tij, pa u licencuar më parë nga autoriteti.

2. Kërkesa për licencën për të ushtruar aktivitet si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë:

a) dokumente që vërtetojnë se subjekti përmbush kërkesat e pikës 1, të nenit 37, të këtij ligji;

b) dokumente që vërtetojnë se personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit janë të aftë dhe të përshtatshëm, në bazë të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, përfshirë kualifikimet akademike, profesionale dhe administruese; CV, emrat dhe kontaktet e personave dhe dëshmi mbështetëse për saktësinë e informacionit të të dhënave të përfshira në CV, si dhe vërtetime mbi gjendjen gjyqësore;

c) dokumente që vërtetojnë që subjekti përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 37, të këtij ligji;

3. Autoriteti miraton rregulla në lidhje me kërkesat për paraqitjen dhe përpunimin e kërkesës për licencë si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

## Neni 39

### **Dhënia e licencës së depozitarit**

1. Autoriteti konsultohet paraprakisht me Bankën e Shqipërisë, në lidhje me bankat apo degët e bankave të huaja, të cilat kërkojnë të licencohen si depozitar në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në një vend të huaj, autoriteti konsultohet me autoritetin rregullator të depozitarit të këtyre sipërmarrjeve.

2. Autoriteti vlerëson nëse kërkesa është e plotë ose jo dhe e informon për këtë subjektin kërkuar.

3. Autoriteti informon subjektin kërkuar brenda tre muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë lidhur me miratimin ose jo të licencës.

4. Kërkesa për licencë mund të tërhiqet, me njoftim me shkrim, në çdo moment përpara se autoriteti të marrë vendim për të.

5. Autoriteti, në rast të refuzimit, jep me shkrim arsyet për mosdhënien e licencës.

6. Depozitari i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike fillon ushtrimin e veprimtarinë menjëherë pas miratimit të licencës.

## Neni 40

### **Refuzimi i licencës**

Autoriteti refuzon licencën e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, nëse:

a) subjekti kërkuar nuk i përmbush kërkesat e nenit 37, të këtij ligji, dhe përkatësisht nëse autoriteti, duke pasur parasysh garantimin e administrimit të shëndoshë dhe të matur të depozitarit, gjykon se subjekti nuk i përmbush kërkesat për përshtatshmërinë e aksionarëve të tij ose të personave ose personelit kyç, si dhe nëse:



- b) gjykon se shoqëria nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat e këtij ligji;
- c) ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:
  - i. lidhjet e pronësisë midis depozitarit dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;
  - ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër, që rregullojnë personat fizikë ose juridikë me të cilët ka lidhje pronësie depozitari;
  - iii. vështirësitë e përfshira në zbatimin e këtyre ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative; dhe
- ç) nuk është paguar tarifa e kërkuar.

Neni 41

### **Miratimi i ndryshimeve të rëndësishme**

1. Depozitari i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike informon paraprakisht autoritetin për çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve të licencës ose, nëse nuk është i mundshëm njoftimi paraprak, informon menjëherë, sidomos për çdo ndryshim lidhur me informacionet e vëna në dispozicion, në përputhje me shkronjat “e” dhe “f”, të pikës 2, të nenit 37, të këtij ligji. Njoftimi i autoritetit kryhet jo më pak se tre muaj para implementimit të ndryshimit të rëndësishëm.

2. Depozitari implementon ndryshimet e njoftuara sipas pikës 1, të këtij neni, nëse autoriteti, tre muaj pas marrjes së njoftimit, nuk ka shprehur kundërshtim për ndryshimet ose nuk ka themeluar kushte për ndryshimet.

Neni 42

### **Emërtimi i depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike**

Emërtimi “depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”, “depozitar” ose terma të ngjashëm përdoren vetëm nga personat juridikë që kanë licencë të lëshuar nga autoriteti, në zbatim të këtij ligji ose janë njohur nga autoriteti si subjekte që kanë licencë të lëshuar nga një autoriteti i huaj rregullator, në zbatim të një ligji të barasvlershëm.

## **SEKSIONI 2**

### **DETYRIMET E DEPOZITARIT TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

Neni 43

#### **Detyrimet e depozitarit**

1. Depozitari vepron me ndershmëri, rregullsi, profesionalizëm, pavarësi dhe vetëm në interes të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmbush përcaktimet e mëposhtme:

- a) garanton se shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i aksioneve ose kuotave janë në përputhje me këtë ligj dhe aktin themelues të sipërmarrjes;
- b) siguron se vlera neto e aktiveve të kuotave ose njësisive të sipërmarrjes është llogaritur në

përputhje me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

c) përmbush dhe zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese nëse nuk bien ndesh me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji ose me aktin themelues të sipërmarrjes;

ç) garanton kthimin e çdo shume përkatëse sipërmarrjes, brenda afateve kohore të përcaktuara lidhur me transaksionet që përfshijnë aktivet e sipërmarrjes;

d) garanton se të ardhurat e sipërmarrjes përdoren në përputhje me këtë ligj dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

dh) garanton që flukset monetare të sipërmarrjes monitorohen si duhet, në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët, ose në emër të investitorëve, me nënshkrimin e aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe se të gjitha mjetet monetare të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të sipërmarrjes, shoqërisë administruese për llogari të sipërmarrjes ose të depozitarit për llogari të sipërmarrjes;

e) lidhur me llogaritë e hapura, në bazë të shkronjës “dh”, të kësaj pike, depozitari merr masat e nevojshme për të siguruar që fondet e sipërmarrjes SIK të depozituara pranë një banke qendrore, një banke në Republikën e Shqipërisë apo një banke të licencuar në një vend tjetër ose në një fond të tregut të parasë të SIK mbahen në një llogari ose disa llogari të identifikuara më vete nga çdo llogari e përdorur për të mbajtur fondet që i përkasin depozitarit apo fondeve a klientëve të tjerë të depozitarit;

ë) kur llogaritë monetare hapen në emër të depozitarit, i cili vepron për llogari të sipërmarrjes, në këto llogari të mos kontabilizohet asnjë mjet monetar i veti i depozitarit apo i subjekteve të përmendura në shkronjën “e” të kësaj pike;

f) në rastin e fondeve të investimeve, emeton e anulon kuotat dhe paguan paratë e shlyerjes mbajtësve të kuotave, sipas udhëzimeve të shoqërisë administruese, kur këto udhëzime janë në përputhje me këtë ligj me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

g) mban regjistrin e mbajtësve të kuotave dhe shërbimet e transferimit për fondet e investimeve me ofertë publike, me përjashtim të rastit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të listuar ose tregtuar në një treg të rregulluar, rast në të cilin regjistri mund të mbahet sipas kërkesave të rregullores së këtij tregu, që rast pas rasti mund të kërkojë mbajtjen e regjistrin në një depozitar qendror të titujve;

gj) i raporton shoqërisë administruese të fondeve për veprimet tregtare lidhur me aktivet e sipërmarrjes së mbajtura në kujdestari dhe ekzekuton udhëzimet e saj.

3. Aktivet e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike i besohen depozitarit për ruajtje në rastet, si më poshtë:

a) për instrumentet financiare që mbahen në kujdestari, depozitari përmbush detyrimet e mëposhtme:

i. mban në kujdestari të gjitha instrumentet financiare që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit;

ii. garanton që të gjitha instrumentet financiare që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit të regjistrohen në librat e depozitarit në llogari të mbajtura veçmas, të hapura në emër të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të shoqërisë administruese që vepron për llogari të sipërmarrjes, në mënyrë që të mund të identifikohen qartë në çdo moment se i përkasin sipërmarrjes në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;

b) për aktivet e tjera, depozitari përmbush detyrimet e mëposhtme:

i. verifikon pronësinë e aktiveve që i përkasin sipërmarrjes së investimeve kolektive me

ofertë publike ose shoqërisë administruese të fondeve, e cila vepron për llogari të sipërmarrjes, duke vlerësuar nëse sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ose shoqëria administruese e fondeve, e cila vepron për llogari të sipërmarrjes e zotëron pronësinë në bazë të informacioneve ose dokumenteve të vëna në dispozicion nga sipërmarrja ose nga shoqëria administruese dhe, kur është e mundur, në bazë të vërtetimeve nga burime të jashtme;

ii. mban evidenca të atyre aktiveve, për të cilat gjykon se sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ose shoqëria administruese e fondeve, e cila vepron për llogari të sipërmarrjes, e zotëron pronësinë dhe i përditëson këto evidenca dhe vendos në dispozicion të shoqërisë administruese të gjitha të dhënat e plota.

4. Aktivet e sipërmarrjes dhe nënfondit veçohen nga aktivet e depozitarit dhe aktivet e klientëve të tjerë të depozitarit, në mënyrë që në çdo moment të mund të identifikohen se i përkasin sipërmarrjes ose nënfondit.

5. Aktivet e mbajtura në kujdestari nga depozitari nuk ripërdoren nga depozitari apo nga asnjë i tretë, të cilit i është deleguar funksioni i kujdestarisë për llogari të tyre. Ripërdorimi përfshin çdo transaksion me aktivet e mbajtura në kujdestari, përfshirë, ndër të tjera, kalimin, lënien peng, shitjen dhe dhënien hua të tyre. Aktivet e mbajtura në kujdestari nga depozitari lejohen të ripërdoren vetëm kur:

a) ripërdorimi i aktiveve bëhet për llogari të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike;

b) depozitari e bën këtë në përmbushje të udhëzimeve të shoqërisë administruese në emër të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike;

c) ripërdorimi bëhet në përfitim të sipërmarrjes dhe në interes të mbajtësve të aksioneve ose kuotave; dhe

ç) transaksioni mbulohet me kolateral cilësor dhe likuid të themeluar në emër të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike me anë të organizimit të transferimit të titullit të pronësisë;

d) vlera e tregut e kolateralit në çdo moment është minimalisht sa vlera e tregut e aktiveve të ripërdorura plus një prim.

6. Depozitari mban evidencat e nevojshme që i japin mundësi të jetë në përputhshmëri me kërkesat e këtij ligji dhe i mban këto evidenca për një periudhë kohore, sipas parashikimeve të legjisllacionit të zbatueshëm në fuqi.

7. Depozitari monitoron përputhshmërinë e investimeve dhe huamarrjes së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe të nënfondeve të saj me kërkesat e kreu VII të këtij ligji.

8. Depozitari njofton autoritetin me shkrim, menjëherë nëse pas një shqyrtimi të fakteve që ka në dispozicion ose të rrethanave, ka arsye për të besuar se shoqëria administruese e fondeve e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ka shkelur dispozitat e këtij ligji ose me dokumentin themelues të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondit. Në këtë rast ai informon autoritetin edhe mbi hapat e ndërmarrë nga depozitari, për të mundësuar që shkelja të ndreqet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe informon mbi afatin e themeluar për ndreqjen e shkeljes në fjalë. Depozitari informon më tej autoritetin nëse ndreqja është përmbushur brenda këtij afati.

Neni 44

### **Konflikti i interesit**

1. Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike ose me shoqërinë administruese që administron sipërmarrjen e investimeve

kolektive me ofertë publike, të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi ndërmjet sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, investitorëve të kësaj sipërmarrjeje, shoqërisë administruese dhe vetë depozitarit, me përjashtim të rastit kur depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme dhe u bëhet i ditur investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Shoqëria e licencuar si depozitar, gjithashtu, nuk zotëron licencë si shoqëri administruese, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri të kontrolluar, e cila mund të ketë licencë si shoqëri administruese e fondeve. Shoqëria e licencuar si depozitar nuk mund të jetë e licencuar si shoqëri investimesh.

3. Kur depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike kryen transaksione me subjekte të lidhura ose persona fizikë të lidhur vendos në zbatim politika dhe procedura të cilat garantojnë se:

- a) identifikohen të gjitha konfliktet e interesit të lindura nga këto transaksione;
- b) ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm për t'i shmangur këto konflikte interesi.

4. Kur nuk mund të shmanget konflikti i interesit, sipas pikës 3, të këtij neni, shoqëria administruese dhe depozitari administrojnë, monitorojnë dhe bëjnë të ditur këtë konflikt interesi, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interesat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe të investitorëve të saj.

## Neni 45

### **Delegimi nga depozitari**

1. Depozitari nuk delegon te palët e treta funksionet e përmendura në shkronjat nga "a" deri në "ë", të pikës 2, të nenit 43 të këtij ligji.

2. Depozitari mund t'ua delegojë të tretëve funksionet e përmendura në pikën 3, të nenit 43, të këtij ligji, por vetëm kur:

- a) detyrat nuk delegohen me qëllim shmangien nga kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji;
- b) depozitari vërteton se delegimi bëhet për arsye objektive;
- c) depozitari ka ushtruar aftësinë, kujdesin dhe vigjilencën e duhur në përzgjedhjen dhe emërimin e personit që do t'i delegohen një pjesë e detyrave dhe vazhdon të ushtrojë të gjithë aftësinë, kujdesin dhe vigjilencën e duhur në shqyrtimin periodik dhe monitorimin e vazhdueshëm të çdo personi të tretë, të cilit i delegohen detyrat dhe të mënyrës së organizimit të palës së tretë në lidhje me çështjet e deleguara.

3. Depozitari i delegon funksionet e parashikuara në pikën 3, të nenit 43, të këtij ligji, vetëm në rast kur pala e tretë, që i delegohen detyrat, përmbush gjatë gjithë kohës përcaktimet e mëposhtme:

- a) ka strukturat dhe ekspertizën e duhur dhe proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të cilat i janë besuar;
- b) për detyrat e kujdestarisë, të përmendura në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, është subjekt i kërkesave të mëposhtme:
  - i. rregullohet në mënyrë prudenciale dhe efektive, përfshirë kërkesat e kapitalit minimal dhe mbikëqyrjes sipas juridiksionit përkatës;
  - ii. auditimit të jashtëm periodik për të siguruar se instrumentet financiare janë në zotërimin e tij;
- c) veçon aktivet e klientëve të depozitarit nga aktivet e veta dhe nga aktivet e depozitarit,

në mënyrë që në çdo moment të mund të identifikohen se u përkasin klientëve të depozitarit në fjalë;

ç) ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që në rast të paaftësisë paguese të palës së tretë, aktivet e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, të cilat mbahen në kujdestari nga pala e tretë, të mos vihen në dispozicion të shpërndarjes të kreditorët e saj dhe të mos shiten për të siguruar mjete monetare për llogari të kreditorëve të lartpërmendur; dhe

d) përmbush detyrimet dhe përcaktimet e përgjithshme, të parashikuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 36, në pikat 1, 4 dhe 5, të nenit 43, si dhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 44 të këtij ligji.

4. Pavarësisht pikës 3, të këtij neni, në rastet kur ligji i një vendi tjetër parashikon që disa instrumente të caktuara financiare të mbahen në kujdestari nga një subjekt vendas dhe kur asnjë subjekt vendas nuk i përmbush kërkesat e parashikuara në ligj, depozitari mund t'ia delegojë funksionet një subjekti të tillë vendas, por vetëm nëse lejohet nga ligji i atij vendi dhe vetëm nëse nuk ka subjekte vendase që përmbushin kërkesat për delegimin, dhe vetëm nëse:

a) informohen rregullisht investitorët e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, përpara se të bëjnë investimin lidhur me faktin se është i nevojshëm të bëhet një delegim i tillë për shkak të kufizimeve ligjore të vendit tjetër për rrethanat që justifikojnë delegimin dhe për risqet që shoqërojnë një delegim të tillë;

b) shoqëria administruese në emër të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike urdhëron depozitarin t'ia delegojë kujdestarinë e instrumenteve financiare një subjekti vendas të tillë.

5. Në kuptim të këtij neni, ofrimi i shërbimeve nga sistemet e shlyerjes së titujve të ngarkuar me shlyerjen ose ofrimin e shërbimeve të ngjashme nga sisteme të shlyerjes së titujve të vendeve të treta nuk konsiderohet si delegim i funksioneve të kujdestarisë.

## Neni 46

### **Përgjegjësia ligjore e depozitarit**

1. Depozitari mban përgjegjësi ndaj sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe ndaj mbajtësve të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes për çdo humbje të shkaktuar nga depozitari ose nga një palë e tretë, së cilës i është deleguar ose nëndeleguar kujdestaria e instrumenteve financiare të mbajtura në kujdestari, në përputhje me pikën 3, të nenit 43, të këtij ligji.

2. Në rastin e humbjes së instrumentit financiar të mbajtur në kujdestari, depozitari garanton kthimin e instrumentit financiar të një lloji identik ose shumë korresponduese sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike. Depozitari nuk mban përgjegjësi nëse vërteton se kjo humbje ka ndodhur si rezultat i rrethanave që janë jashtë kontrollit të depozitarit, pasojat e të cilave do të kishin qenë të pashmangshme pavarësisht nga të gjitha përpjekjet për shmangien e tyre.

3. Depozitari mban gjithashtu përgjegjësi ndaj sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe ndaj investitorëve të sipërmarrjes për të gjitha humbjet e tjera që janë shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së depozitarit apo mospërmbushjes së qëllimshme të detyrimeve të tij, në bazë të këtij ligji dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti.

4. Përgjegjësia e depozitarit, e parashikuar në këtë nen, nuk përjashtohet ose/dhe kufizohet nëpërmjet kontratës apo marrëveshjes. Çdo marrëveshje ose kontratë që bie ndesh me këtë kërkesë është e pavlefshme.

5. Investitorët e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike mund të parashtrajnë pretendime ndaj mospërmbushjes së përgjegjësisë së depozitarit, drejtpërdrejt ose

tërthorazi nëpërmjet shoqërisë administruese apo shoqërisë së investimeve, me kusht që të mos ketë mbivendosje të zgjidhjes ligjore apo trajtim të pabarabartë të mbajtësve të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes.

#### Neni 47

### **Zëvendësimi i depozitarit**

1. Depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike zëvendësohet vetëm me miratimin paraprak të autoritetit.

2. Depozitari i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike nuk mund të zgjidhë vullnetarisht kontratën për të vepruar si depozitar për llogari të sipërmarrjes, nëse nuk është emëruar një depozitar i ri me miratimin e autoritetit.

3. Depozitari që zgjidh kontratën si depozitar për llogari të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, informon depozitarin e ri për çdo rrethanë që ka informuar autoritetin, në bazë të pikës 5 të këtij neni.

4. Depozitari që dëshiron të zgjidhë kontratën e veprimtarisë si depozitar ose të zgjidhë marrëveshjen për shërbimet depozitare lidhur me një ose disa sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, njofton me shkrim, jo më pak se tre muaj përpara datës së zgjidhjes së propozuar të kontratës, autoritetin dhe shoqërinë administruese dhe në rastin e shoqërisë së investimeve, njofton gjithashtu personat kyç të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të cilave u ofron shërbime.

5. Depozitari në njoftimin me shkrim që i dërgon autoritetit, sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij neni, përfshin gjithashtu çdo çështje lidhur me veprimtarinë e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike që depozitari ka marrë dijëni gjatë kryerjes së funksioneve të tij dhe që, sipas mendimit të depozitarit, rrezikon të dëmtojë aftësinë e sipërmarrjes për të vepruar në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

6. Kur shoqëria administruese e fondeve ose personat kyç të shoqërisë së investimeve nuk lidhin marrëveshje/kontratë me depozitarin e licencuar zëvendësues brenda tre muajve pas marrjes së njoftimit, në bazë të pikës 4, të këtij neni, sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, së cilës depozitari i ka ofruar shërbime, likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji. Në këtë rast, depozitari ekzistues vepron si depozitar i kësaj sipërmarrjeje deri në mbylljen e sipërmarrjes së investimeve kolektive.

7. Depozitari zëvendësohet me vendim të shoqërisë administruese të fondit të investimeve ose të personave kyç të shoqërisë së investimeve me një depozitar tjetër të licencuar, në varësi të kushteve përkatëse të parashikuara me marrëveshjen/kontratën me depozitarin dhe me miratim paraprak të autoritetit për depozitarin e licencuar zëvendësues.

8. Depozitari i mëparshëm i transferon të gjitha aktivet e mbajtura në emër të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, për të cilën ka vepruar më parë së bashku me regjistrat shoqërues, depozitarit të ri të licencuar zëvendësues, duke garantuar mbrojtjen në mënyrë efektive të interesave të investitorëve të kësaj sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike.

#### Neni 48

### **Raportimi në autoritet**

1. Depozitari vendos në dispozicion të autoritetit, me kërkesë të këtij të fundit, të gjitha informacionet që ka marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, të cilat mund të jenë të

nevojshme për mbikëqyrjen efektive nga autoriteti të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të shoqërisë administruese.

2. Nëse autoriteti rregullator i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose i shoqërisë administruese nuk është i njëjtë me atë të depozitarit, autoriteti rregullator i depozitarit informon autoritetin rregullator të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të shoqërisë administruese në lidhje më të gjitha informacionet e paraqitura nga depozitari në fjalë.

## SEKSIONI 3

### KËRKESAT LIDHUR ME DEPOZITARËT E FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE

#### Neni 49

#### **Detyrimi për të pasur depozitar**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative garanton që për çdo fond të investimeve alternative që administron të caktohet një depozitar i vetëm.

2. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative mund të caktojë vetëm një depozitar që të administrojë më shumë se 1 fond investimesh alternative ose të gjitha fondet e investimeve alternative.

3. Emërimi i depozitarit bëhet me kontratë/marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët në praninë e noterit. Kontrata përmban të gjitha detyrimet e secilës palë, sipas kërkesave të këtij ligji.

#### Neni 50

#### **Kërkesat për depozitarin**

1. Depozitari i fondit të investimeve alternative mund të jetë një nga subjektet e mëposhtme:

- a) bankë ose degë e një banke të huaj, e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbime të marrjes në kujdestari, depozitarit dhe të besimit;

- b) kategori të tjera institucionesh që përmbushin kushtet si depozitar i fondit të investimeve alternative, sipas ligjit të një vendi tjetër lidhur me fondin e investimeve alternative të themeluar në atë vend;

2. Depozitari duhet të përmbushë minimalisht kërkesat e mëposhtme:

- a) ka infrastrukturën e nevojshme për të mbajtur në kujdestari instrumentet financiare që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit;

- b) zbaton politika dhe procedura adekuate të mjaftueshme për të garantuar përputhshmërinë e subjektit, përfshirë edhe administratorët dhe punonjësit e tij, me parashikimet e këtij ligji;

- c) zbaton procedura të shëndosha administrative dhe kontabël, mekanizma të kontrollit të brendshëm, procedura efektive për vlerësimin e riskut dhe masa organizative efektive të kontrollit dhe mbrojtjes për sistemet e përpunimit të informacionit;

- ç) ndërmer masa efektive organizative dhe administrative me qëllim parandalimin e konfliktit të interesit;

- d) mban evidenca për të gjitha shërbimet, veprimtaritë dhe transaksionet që kryen, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme duke i mundur autoritetit përmbushjen e detyrave mbikëqyrëse të veta dhe marrjen e masave të duhura, sipas dispozitave të këtij ligji;

dh) ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për të garantuar vijueshmërinë dhe rregullsinë në kryerjen e funksioneve të depozitarit përmes përdorimit të sistemeve, burimeve dhe procedurave të duhura dhe proporcionale, përfshirë edhe kryerjen e veprimtarive të depozitarit;

e) personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit gjithmonë janë të aftë dhe të përshtatshëm, zotërojnë dijet, aftësinë dhe përvojën e duhur dhe kanë aftësinë dhe përvojën për të kuptuar veprimtaritë e depozitarit, përfshirë edhe risqet kryesore;

ë) personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit veprojnë me ndershmëri dhe integritet;

f) personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit kanë përvojën e mjaftueshme në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë tregtare të depozitarit. Për këtë qëllim, për të dhënat identifikuese të personave kyç dhe anëtarëve të personelit kyç dhe i çdo personi që i zëvendëson ata në detyrë njoftohet autoriteti.

3. Depozitari nuk është i regjistruar apo i licencuar si shoqëri investimi.

4. Depozitari nuk është i licencuar si shoqëri administruese e fondeve, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri të kontrolluar, e cila ka licencë si shoqëri administruese e fondeve.

5. Depozitari i fondeve të investimeve alternative nuk vepron si depozitar i sipërmarrjes së investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e kontrolluar e depozitarit që është shoqëri administruese e fondeve.

6. Depozitari i fondit të investimeve alternative nuk është i licencuar si shoqëri administruese e fondit, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri të kontrolluar, e cila ka licencë si shoqëri administruese e fondit.

7. Depozitari i licencuar i fondeve të investimeve alternative mund të licencohet edhe si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

8. Depozitari duhet të ketë raporte auditimi financiar me opinion pa rezerva për tri vitet e fundit.

## Neni 51

### **Licenca e depozitarit**

1. Depozitari i fondeve të investimeve alternative nuk fillon veprimtarinë e tij si depozitar pa u licencuar më parë nga autoriteti.

2. Kërkesa për licencën për të ushtruar aktivitet si depozitar i fondeve të investimeve alternative shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) dokumente që vërtetojnë se subjekti përmbush kërkesat e pikës 1, të nenit 50, të këtij ligji;

b) dokumente që vërtetojnë se aksionarët, personat kyç dhe personeli kyç i depozitarit janë të aftë dhe të përshtatshëm, në bazë të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të këtij ligji, përfshirë kualifikimet akademike, profesionale dhe administruese; CV, emrat dhe kontaktet e personave dhe dëshmi mbështetëse për saktësinë e informacionit të përfshirë në CV, si dhe vërtetime mbi gjendjen gjyqësore;

c) dokumente që vërtetojnë se subjekti përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 50, të këtij ligji.

## Neni 52

### **Dhënia e licencës si depozitar**

1. Autoriteti konsultohet paraprakisht me Bankën e Shqipërisë, në lidhje me bankat apo



degët e bankave të huaja, të cilat kërkojnë të licencohen si depozitar në Republikën e Shqipërisë. Në rastin e fondeve të investimeve alternative të themeluara në një vend të huaj, autoriteti konsultohet me autoritetin rregullator të depozitarit të këtyre fondeve.

2. Autoriteti vlerëson nëse kërkesa është e plotë ose jo dhe informon për këtë subjektin kërkuar.

3. Autoriteti e informon subjektin kërkuar brenda tre muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë lidhur me miratimin ose refuzimin e licencës.

4. Kërkesa për licencë tërhiqet me njoftim me shkrim, në çdo moment përpara se autoriteti të marrë vendim për të.

5. Autoriteti, në rast të refuzimit, jep me shkrim arsyet për mosdhënien e licencës.

6. Depozitari i fondeve të investimeve alternative fillon ushtrimin e veprimtarisë menjëherë pas miratimit të licencës.

## Neni 53

### **Refuzimi i licencës**

Autoriteti refuzon licencën e depozitarit të fondeve të investimeve alternative nëse:

a) subjekti kërkuar nuk i përmbush kërkesat e nenit 50, të këtij ligji, dhe përkatësisht duke pasur parasysh garantimin dhe administrimin e shëndoshë dhe të matur të depozitarit gjykon se subjekti nuk përmbush kërkesat për përshtatshmërinë e pronarëve të tij ose të personave kyç ose personelit kyç, si dhe nëse:

b) gjykon se shoqëria nuk është në gjendje të përmbushë kushtet e këtij ligji; dhe

c) ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:

i. lidhjet e pronësisë midis depozitarit dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;

ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër që rregullojnë personat fizikë ose juridikë, me të cilët ka lidhje pronësie depozitari;

iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin me forcë të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative;

ç) nuk është paguar tarifa e kërkuar.

## Neni 54

### **Miratimi i ndryshimeve të rëndësishme**

1. Depozitari i fondeve të investimeve alternative informon paraprakisht autoritetin për çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve të licencës fillestare, sidomos për çdo ndryshim në informacionet e vëna në dispozicion, në përputhje me shkronjat “e” dhe “f”, të pikës 2, të nenit 50, të këtij ligji.

2. Depozitari implementon ndryshimet e njoftuara, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse autoriteti, tre muaj pas marrjes së njoftimit, nuk shprehet me shkrim për të kundërshtuar ndryshimet ose për të themeluar kushte për ndryshimet.

## Neni 55

### **Emërtimi i depozitarit**

Emërtimi “depozitar i fondeve të investimeve alternative” ose një frazë e ngjashme përdoret në Republikën e Shqipërisë vetëm nga persona që kanë licencë të tillë, të lëshuar nga autoriteti

në bazë të këtij ligji ose nga një autoritet i huaj rregullator në bazë të një ligji të barasvlershëm.

## Neni 56

### Detyrat e depozitarit

1. Depozitari vepron me ndershmëri, rregullsi, profesionalizëm, pavarësi dhe në interes të investitorëve të fondit të investimeve alternative.

2. Depozitari i fondit të investimeve alternative ka detyrat e mëposhtme:

a) garanton se shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i pjesëmarrjeve janë në përputhje me këtë ligj dhe aktin themelues të sipërmarrjes;

b) garanton se vlera e aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes është llogaritur në përputhje me këtë ligj dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

c) zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, përveç rasteve kur janë në kundërshtim me këtë ligj ose me aktin themelues të sipërmarrjes;

ç) garanton kthimin e çdo shume përkatëse sipërmarrjes brenda afateve kohore të përcaktuara në lidhje me transaksionet që përfshijnë aktivet e sipërmarrjes;

d) garanton se të ardhurat e sipërmarrjes përdoren në përputhje me këtë ligj dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

dh) garanton që flukset monetare të sipërmarrjes monitorohen si duhet dhe në veçanti, se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët ose në emër të investitorëve me nënshkrimin e pjesëmarrjeve dhe se të gjitha mjetet monetare të sipërmarrjes janë regjistruar në llogaritë monetare në emër të sipërmarrjes, shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative për llogari të sipërmarrjes ose të depozitarit për llogari të sipërmarrjes; dhe kur llogaritë e mjeteve monetare hapen në emër të depozitarit i cili vepron për llogari të sipërmarrjes, në këto llogari të mos kontabilizohet asnjë mjet monetar i veti i depozitarit apo i subjektit të deleguar të depozitarit;

e) nëse e parashikon akti themelues i sipërmarrjes, mban regjistrin e pjesëmarrësve;

ë) i raporton shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative për veprimet korporative lidhur me aktivet e sipërmarrjes së mbajtura në kujdestari dhe ekzekuton urdhrat e saj.

3. Aktivet e fondit të investimeve alternative ruhen nga depozitari në përputhje me parashikimet e mëposhtme:

a) për instrumentet financiare që mbahen në kujdestari, depozitari:

i. mban në kujdestari të gjitha instrumentet financiare, që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit;

ii. siguron që të gjitha instrumentet financiare, që mund të regjistrohen në një llogari të instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit të regjistrohen në llogari të mbajtura veçmas, të hapura në emër të fondit të investimeve alternative ose të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative që vepron për llogari të sipërmarrjes, në mënyrë që të mund të identifikohen qartë në çdo kohë, se i përkasin sipërmarrjes në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;

b) për aktivet e tjera, depozitari:

i. verifikon pronësinë e aktiveve që i përkasin fondit të investimeve alternative ose shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, i cili vepron për llogari të sipërmarrjes, duke vlerësuar nëse fondi i investimeve alternative ose shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative që vepron për llogari të sipërmarrjes e zotëron pronësinë në

bazë të informacioneve ose dokumenteve të vëna në dispozicion nga sipërmarrja, nga fondi i investimeve alternative ose nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative dhe, kur është e mundur bazuar në evidenca të jashtme;

ii. regjistron të gjitha aktivet, për të cilat bindet se fondi i investimeve alternative ose shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative, që vepron për llogari të sipërmarrjes, zotëron pronësinë dhe e mban këtë regjistër të përditësuar.

4. Aktivet e fondit të investimeve alternative veçohen nga aktivet e depozitarit dhe aktivet e klientëve të tjerë të depozitarit, në mënyrë që ato të mund të jenë të identifikueshme se i përkasin fondit të investimeve alternative në çdo moment.

5. Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me fondin e investimeve alternative ose me shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative për llogari të një fondi të investimeve alternative, të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi midis fondit të investimeve alternative, shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative dhe vetë depozitarit, me përjashtim të rastit kur depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të depozitarit nga detyrat e tjera, që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme dhe u bëhet i ditur investitorëve të fondit të investimeve alternative.

6. Aktivet e mbajtura në kujdestari nga depozitari nuk ripërdoren nga depozitari apo nga asnjë palë e tretë, së cilës i është deleguar funksioni i kujdestarisë, për llogari të tyre dhe nuk duhet të ripërdoren pa pëlqimin paraprak të fondit të investimeve alternative ose të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative që vepron për llogari të fondit të investimeve alternative. Ripërdorimi përfshin çdo transaksion me aktivet e mbajtura në kujdestari, përfshirë ndër të tjera kalimin, lënien peng, shitjen dhe dhënien hua të tyre.

7. Depozitari mban evidencat e nevojshme që janë në përputhshmëri me kërkesat e këtij ligji dhe që mbahen për një periudhë kohore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## Neni 57

### **Delegimi nga depozitari**

1. Depozitari nuk delegon detyrat e parashikuara në pikën 2, të nenit 56, të këtij ligji.

2. Depozitari mund të delegojë detyrat e parashikuara në pikën 3, të nenit 56, të këtij ligji, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) detyrat nuk delegohen me qëllim shmangien e kërkesave të këtij ligji;

b) depozitari vërteton se delegimi bëhet për arsye objektive;

c) depozitari ka ushtruar aftësinë, kujdesin dhe vigjilencën e duhur në përzgjedhjen dhe emërimin e personit që do t'i delegohet një pjesë e detyrave dhe vazhdon të ushtrojë të gjithë aftësinë, kujdesin dhe vigjilencën e duhur në shqyrtimin periodik dhe monitorimin e vazhdueshëm të çdo personi të tretë, të cilit i delegohen detyrat, dhe të mënyrës së organizimit të palës së tretë lidhur me çështjet e deleguara; dhe

i. pala e tretë ka strukturat dhe eksperiencën e përshtatshme e proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e aktiveve të fondit të investimeve alternative të cilat i janë deleguar;

ii. lidhur me detyrat e kujdestarisë, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 56, të këtij ligji, pala e tretë është objekt i mbikëqyrjes prudenciale, përfshirë kërkesave për kapital minimal dhe i mbikëqyrjes në vendin përkatës, si dhe është objekt i auditimit të jashtëm periodik për të garantuar se vazhdon t'i mbajë instrumentet financiare;

iii. pala e tretë veçon aktivet e klientëve të depozitarit nga aktivet e veta dhe nga aktivet e depozitarit në mënyrë që të jenë të identifikueshme se u përkasin klientëve të depozitarit në fjalë, në çdo moment;

iv. pala e tretë nuk përdor aktivet pa pëlqimin paraprak të fondit të investimeve alternative ose të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, që vepron për llogari të fondit të investimeve alternative dhe pa njoftuar më parë depozitarin; dhe

v. pala e tretë përmbush detyrimet dhe parashikimet e përgjithshme, të parashikuara në nenin 56 të këtij ligji;

vi. pavarësisht nënndarjes “ii”, të kësaj shkronje, depozitari, në rastet kur e kërkon ligji i një vendi tjetër mund t’ia delegojë funksionet një subjekti të atij vendi tjetër, që nuk i përmbush kushtet e nënndarjes “ii”, të kësaj shkronje, por vetëm për atë që kjo kërkohej nga ligji i atij vendi dhe vetëm për atë kohë sa nuk ka subjekte vendase që përmbushin kërkesat e nënndarjes “ii”. Investitorët e fondit të investimeve alternative informohen se një delegim i tillë kërkohej me ligj dhe administruesi i fondeve të investimeve alternative, i cili vepron për llogari të fondit të investimeve alternative duhet ta udhëzojë për këtë depozitarin.

3. Pala e tretë, së cilës i bëhet delegimi mund t’i nëndelegojë këto funksione me kusht që të plotësohen të njëjtat kërkesa.

## Neni 58

### **Përgjegjësia e depozitarit**

1. Depozitari mban përgjegjësi ndaj fondit të investimeve alternative dhe ndaj investitorëve të fondit të investimeve alternative për çdo humbje të instrumenteve financiare që mban në kujdestari, sipas pikës 3, të nenit 56, të këtij ligji, nga depozitari ose pala e tretë së cilës depozitari i ka deleguar, përveç rastit kur kjo humbje ka ndodhur si rezultat i rrethanave që janë jashtë kontrollit të depozitarit, pasojat e të cilave do të kishin qenë të pashmangshme pavarësisht nga të gjitha përpjekjet për shmangien e tyre.

2. Përgjegjësia e depozitarit nuk cenohet nga delegimi ose nëndelegimi i bërë, sipas nenit 57 të këtij ligji.

3. Përgjegjësia e depozitarit e parashikuar në këtë nen nuk përjashtohet ose/dhe nuk kufizohet nëpërmjet kontratës apo marrëveshjes. Çdo marrëveshje ose kontratë që bie ndesh me këtë kërkesë është e pavlefshme.

4. Në rastin e humbjes së përmendur në pikën 1, të këtij neni, garanton kthimin e instrumentit financiar të një lloji identik ose shumën korresponduese shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, që vepron në emër të fondit të investimeve alternative pa vonesë.

5. Depozitari mban përgjegjësi përpara fondit të investimeve alternative dhe investitorëve të fondit të investimeve alternative për çdo humbje tjetër të shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së depozitarit apo të shkeljes me dashje të detyrimeve të këtij ligji nga ana e depozitarit.

6. Pretendimet në lidhje me mospërmbushjen e përgjegjësisë ndaj investitorëve të fondit të investimeve alternative mund të ngrihen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nëpërmjet shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative.

7. Depozitari vendos në dispozicion të autoritetit, sipas kërkesës të këtij të fundit, të gjitha informacionet që ka marrë gjatë kryerjes së detyrave, të cilat janë të nevojshme për autoritetin.

8. Nëse autoriteti rregullator i fondit të investimeve alternative ose i shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative nuk është i njëjtë me atë të depozitarit, autoriteti shkëmben pa vonesë informacionet e marra me autoritetet e huaja rregullatore të fondit të investimeve alternative dhe të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative.

## KREU IV

### SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE

#### SEKSIONI 1

#### THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I FONDIT TË INVESTIMIT

##### Neni 59

#### **Fondet e investimeve**

1. Fondi i investimeve është sipërmarrje e investimeve kolektive, e krijuar me kontratë si grupim i veçantë aktivesh, që nuk ka personalitet juridik.

2. Fondi i investimeve mund të jetë me pjesëmarrje të hapur, me intervale ose me pjesëmarrje të mbyllur. Fondi me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale është me afat kohëzgjatjeje të papërcaktuar. Fondi i investimeve me pjesëmarrje të mbyllur është me afat të përcaktuar, që nuk zgjat më shumë se dhjetë vjet, me përjashtim të rastit kur fondi i investimeve është i listuar në një treg të rregulluar.

3. Blerja e kuotave të fondit të investimeve nga investitori nënkupton miratimin e kushteve të kontratës së administrimit të fondit të investimeve, të parashikuara në rregullat dhe prospektin e fondit.

4. Shoqëria administruese e fondit të investimeve është subjekti juridik, që e administron dhe e përfaqëson fondin e investimeve në lidhje me palët e treta.

5. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative, ofruar vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar, është subjekti juridik që e administron dhe e përfaqëson fondin e investimeve alternative në lidhje me palët e treta.

6. Shoqëria administruese e fondit të investimit është e pavarur juridikisht dhe funksionalisht nga depozitari i fondit të investimit.

7. Fondi i investimit, që është fond me pjesëmarrje të hapur dhe që nuk është sipërmarrje e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm dhe fondi i investimeve me pjesëmarrje të mbyllur ose me intervale që është fond i investimeve alternative mund të licencohet si fond me ofertë publike nëse përmbush kërkesat e kreut V të këtij ligji.

8. Adresa e regjistruar e fondit të investimeve, që është fond investimesh me ofertë publike, i themeluar në Republikën e Shqipërisë nga një shoqëri administruese e licencuar, në bazë të këtij ligji është adresa e regjistruar e kësaj shoqërie administruese.

9. Adresa e regjistruar e fondit të investimeve, që është fond investimesh me ofertë publike, i themeluar në Republikën e Shqipërisë nga një shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative i licencuar, në bazë të këtij ligji duhet të jetë adresa e regjistruar e kësaj shoqërie administruese të fondeve të investimeve alternative.

10. Mbjtësi i kuotave të fondit të investimeve, që është licencuar si fond i investimeve me ofertë publike nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.

11. Mbjtësi i kuotave të fondit të investimeve që është regjistruar si fond investimesh alternative për t'iu ofruar vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative ose të depozitarit të fondit.

12. Përgjegjësia e mbajtësit të kuotave të fondit të investimeve kufizohet brenda vlerës që,

në momentin kur është i pagueshëm borxhi, është e barabartë me vlerën neto të aktiveve në atë moment të kuotave të mbajtësit.

13. Fondi i investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale mund të jetë sipërmarrje ombrellë ose sipërmarrje e veçantë.

14. Fondi i investimeve me pjesëmarrje të hapur mund të jetë sipërmarrje kryesore ose sipërmarrje furnizuese.

15. Fondi i investimeve me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike regjistrohet në një treg të rregulluar brenda gjashtë muajve pas përfundimit të ofertës fillestare, nëse rregullorja e fondit nuk e kufizon themelimin e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se 7 vjet nga data e mbylljes së periudhës së ofertës fillestare, pas së cilës fondi likuidohet dhe mjetet monetare u shpërndahen mbajtësve të kuotave.

## Neni 60

### **Krijimi i fondit të investimeve**

1. Fondi i investimeve me ofertë publike krijohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nga:

a) shoqëria administruese e licencuar në përputhje me këtë ligj;

b) shoqëria administruese e licencuar nga një autoritet i huaj rregullator ose një degë e një shoqërie të tillë administruese, e cila njihet nga autoriteti në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

c) shoqëria administruese e licencuar nga një autoritet rregullator i një shteti anëtar të Bashkimit Europian ose një degë e një shoqërie të tillë administruese, e cila njihet nga autoriteti në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA-së) BE-Shqipëri.

2. Një fond investimesh, që është fond i investimeve alternative ofruar vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar, krijohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nga:

a) shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative e licencuar në përputhje me këtë ligj; ose

b) administruesi i fondeve të investimeve alternative i licencuar nga një autoritet i huaj rregullator, i cili njihet nga autoriteti në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

c) administruesi i fondeve të investimeve alternative i licencuar nga një autoritet i një shteti anëtar të Bashkimit Europian, i cili njihet nga autoriteti në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA-së) BE-Shqipëri.

## Neni 61

### **Emërtimi i fondit të investimeve**

1. Fondi i investimeve i licencuar ose i regjistruar, në bazë të këtij ligji, përmban në emërtimin e tij fjalët “fond i investimeve”.

2. Emërtimi i fondit të investimeve pasqyron saktë natyrën e fondit dhe nuk duhet të jetë keqorientues.

3. Emërtimi “fond investimesh” ose një frazë e ngjashme mund të përdoret në Republikën e Shqipërisë vetëm nga subjekte juridike që kanë licencë të lëshuar nga autoriteti, në bazë të këtij ligji ose që njihen nga autoriteti se kanë licencë të lëshuar nga një autoritet i huaj rregullator, në bazë të një ligji të barasvlershëm.

## Neni 62

### **Kërkesa për licencim si fond i investimeve**

1. Kërkesa për licencë si fond i investimeve me ofertë publike paraqitet vetëm nga shoqëria administruese e licencuar nga autoriteti, në bazë të këtij ligji, në emër të fondit ose nga shoqëria administruese apo dega e shoqërisë administruese të njohur nga autoriteti në bazë të këtij ligji dhe përmban:

a) dokumente që vërtetojnë statusin e licencimit ose të njohjes së shoqërisë administruese ose të degës dhe emrin e plotë, adresën, numrin e telefonit, si dhe adresën e postës elektronike të përfaqësuesit të autorizuar;

b) informacion për çdo delegim të administrimit të investimeve dhe të funksioneve administrative të fondit;

c) prospektin dhe rregullat e fondit;

ç) informacionet kryesore për investitorët e fondit dhe të çdo nënfondi;

d) marrëveshjen me depozitarin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike;

dh) dokumente që vërtetojnë statusin e licencuar të depozitarit;

e) konfirmim me shkrim për marrëveshjen me një auditues të pavarur për të vepruar me këtë cilësi, kundrejt fondit dhe dokumente që vërtetojnë përputhshmërinë e audituesit me nenin 35 të këtij ligji.

2. Kërkesa për licencë si fond i investimeve me ofertë publike përfshin llojin e kërkesës për licencë si:

a) sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike;

b) sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm.

## Neni 63

### **Dhënia e licencës**

1. Autoriteti konsultohet paraprakisht me autoritetin e huaj rregullator të shoqërisë së huaj administruese lidhur me licencimin e fondit të investimeve në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti vlerëson nëse kërkesa është e plotë ose jo dhe e informon për këtë subjektin kërkuar.

3. Autoriteti informon subjektin kërkuar brenda 2 muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë lidhur me miratimin ose refuzimin e licencës.

4. Kërkesa për licencë mund të tërhiqet me njoftim me shkrim, në çdo moment përpara se autoriteti të marrë vendim.

5. Autoriteti, në rast të refuzimit të licencës, jep me shkrim arsyet për mosdhënien e licencës.

6. Oferta publike e një fondi investimesh mund të fillojë vetëm pas miratimit të licencës nga ana e autoritetit.

## Neni 64

### **Refuzimi i licencës**

Autoriteti vendos refuzimin e licencës për fondin e investimeve nëse:

a) kërkesa nuk përmbush parashikimet e këtij ligji dhe të aktet rregullative të miratuara nga

autoriteti në zbatim të tij lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike ose në rastin e kërkesës për licencë si sipërmarrje e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, në mënyrë të veçantë nuk përmbush kërkesat e kreut VII të këtij ligji;

b) shoqëria administruese nuk është e licencuar apo e njohur sipas këtij ligji;

c) shoqëria administruese dhe depozitari nuk janë të pavarur juridikisht dhe funksionalisht nga njëri-tjetri;

ç) personat kyç dhe personeli kyç i shoqërisë administruese dhe i depozitarit, nuk janë të aftë dhe të përshtatshëm, në bazë të nenit 14, të këtij ligji, ose nuk kanë përvojën e mjaftueshme. Për këtë qëllim, emrat e personave kyç dhe të personelit kyç të shoqërisë administruese dhe depozitarit dhe të çdo pasardhësi të tyre në detyrë, i komunikohen menjëherë autoritetit;

d) fondi i investimeve nuk lejohet me ligj të promovojë kuota publikut në Republikën e Shqipërisë;

dh) nuk është paguar tarifa e kërkuar.

## Neni 65

### **Miratimi i ndryshimeve të rëndësishme**

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me ofertë publike njofton paraprakisht me shkrim autoritetin për:

a) çdo ndryshim të propozuar të rregullave të fondit të investimeve;

b) çdo ndryshim të propozuar të objektivit dhe strategjisë së investimit të fondit;

c) çdo ndryshim të propozuar të shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit të investimeve;

ç) çdo tarifë shtesë kundrejt fondit të investimeve që nuk është e përfshirë më parë në prospekt ose çdo rritje të pagesave të përfshira në prospekt;

d) hapjen e çdo nënfondi të ri në një fond ombrellë të investimeve apo mbylljen e një nënfondi ekzistues;

dh) çdo ristrukturim ose bashkim të propozuar që përfshin fondin e investimeve;

e) çdo propozim për të mbyllur dhe likuiduar fondin e investimeve.

2. Ndryshimi i rëndësishëm i fondit të investimeve me ofertë publike, në bazë të këtij neni, nuk implementohet pa miratimin paraprak me shkrim nga autoriteti.

3. Autoriteti miraton ose pranon propozimin për të ndryshuar shoqërinë administruese, depozitarin apo audituesin e fondit të investimeve me ofertë publike vetëm nëse vlerëson se fondi i investimeve me ofertë publike do të vazhdojë të veprojë në përputhje me këtë ligj edhe pas implementimit të këtij ndryshimi të propozuar.

## Neni 66

### **Regjistrimi si fond investimesh alternative**

1. Kërkesa për regjistrimin e fondit të investimeve alternative ofruar vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar bëhet në emër të fondit nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative, e licencuar nga autoriteti, ose nga administruesi i fondeve të investimeve alternative apo dega e administruesit të fondeve të investimeve alternative e njohur nga autoriteti, në bazë të këtij ligji dhe përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumente që vërtetojnë statusin e licencimit ose të njohjes së shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative ose të administruesit të fondeve të investimeve alternative ose të degës dhe emrin e plotë, adresën, numrin e telefonit, si dhe adresën e postës elektronike



të përfaqësuesit të autorizuar;

b) prospektin dhe rregullat e fondit, të cilat duhet të theksojnë qartë se fondi është një fond investimi alternativ vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar;

c) marrëveshjen me depozitarin e licencuar të fondit të investimeve alternative;

ç) dokumente që vërtetojnë statusin e licencuar dhe të pavarur të depozitarit;

d) konfirmim me shkrim për marrëveshjen e një audituesi të pavarur për të vepruar me këtë cilësi kundrejt fondit dhe dokumente që dëshmojnë përputhshmërinë e audituesit me nenin 35; dh) dokumentet, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

2. Brenda një muaji pas marrjes së kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 1, të këtij neni, autoriteti informon shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesin e fondeve të investimeve alternative për marketimin apo jo të fondit të investimeve alternative.

## SEKSIONI 2

### THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQËRISË SË INVESTIMIT

#### Neni 67

#### **Shoqëritë e investimit**

1. Shoqëria e investimeve themelohet si shoqëri aksionare me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

2. Objektivi i shoqërisë së investimeve është ofrimi i fitimeve për aksionarët nga investimi në një portofol të diversifikuar aktivesh. Shoqëria e investimeve kryen vetëm veprimtari të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e këtij objektivi. Shitblerja e aktiveve të shoqërisë së investimeve përjashtohet nga pika 4, e nenit 82, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

3. Shoqëria administruese e shoqërisë së investimeve me ofertë publike është e pavarur juridikisht dhe funksionalisht nga depozitari i shoqërisë së investimeve.

4. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i fondeve të investimeve alternative i një shoqërie investimi të regjistruar është i pavarur juridikisht dhe funksionalisht nga depozitari i shoqërisë së investimeve.

5. Shoqëria e investimeve nuk licencohet apo vepron si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, administrues i fondeve të investimeve alternative apo si shoqëri administruese.

6. Statuti i shoqërisë së investimeve mund të parashikojë themelimin e saj me afat të përcaktuar ose pa afat.

7. Blerja e aksioneve të shoqërisë së investimeve nga një investitor përbën një marrëveshje dakordësie me kushtet e prospektit.

8. Mbajtësi i aksioneve të shoqërisë së investimeve me ofertë publike nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.

9. Mbajtësi i aksioneve të shoqërisë së investimeve që është fond investimesh alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, të administruesit të fondeve të investimeve alternative ose të depozitarit të fondit.

10. Shoqëria e investimeve është vetëm sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur me një numër fiks aksionesh në emetim. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim për t'i shlyer aksionet e veta, gjatë periudhës kur shoqëria ushtron aktivitetin si shoqëri investimesh me pjesëmarrje të

mbyllur.

11. Shoqëria e investimeve mund të regjistrohet si fond i investimeve alternative për klientë profesionistë në Republikën e Shqipërisë.

12. Shoqëria e investimeve licencohet nga autoriteti për ofertë publike vetëm nëse përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji për shoqëritë e investimeve me ofertë publike.

13. Shoqëria e investimeve e licencuar për të qenë me ofertë publike përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) ka strukturë administrimi me një nivel;

b) listohet në një treg të rregulluar brenda gjashtë muajve pas përfundimit të ofertës fillestare, përveç rastit kur statuti i saj kufizon themelimin e shoqërisë së investimeve, brenda një periudhe jo më të gjatë se 7 vjet nga data e mbylljes së periudhës së ofertës fillestare, pas së cilës shoqëria e investimeve likuidohet dhe mjetet monetare u shpërndahen mbajtësve të aksioneve;

c) vepron në përputhje me kërkesat e seksionit 2, të kreut VII, të këtij ligji.

Neni 68

### **Krijimi i shoqërisë së investimeve**

1. Shoqëria e investimeve me ofertë publike krijohet dhe themelohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nga persona që përmbushin kërkesat e pikave 2, 3, 4, të nenit 14, të këtij ligji.

2. Shoqëria e investimeve, që është fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar krijohet dhe themelohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nga persona që përmbushin kërkesat e pikave 2, 3, 4, të nenit 14, të këtij ligji.

Neni 69

### **Emërtimi i shoqërisë së investimeve**

1. Shoqëria e investimeve e licencuar ose e regjistruar në bazë të këtij ligji përmban në emërtimin e saj fjalët “shoqëri investimesh”.

2. Emërtimi i shoqërisë së investimeve pasqyron saktë natyrën e fondit dhe nuk duhet të jetë keqorientues.

3. Emërtimi “shoqëri investimesh” ose një frazë e ngjashme përdoret në Republikën e Shqipërisë vetëm nga subjekte juridike, që kanë licencë të tillë të lëshuar nga autoriteti në bazë të këtij ligji ose që njihen nga autoriteti se kanë licencë të lëshuar nga një autoritet i huaj rregullator, në bazë të një ligji të barasvlershëm.

Neni 70

### **Kushtet për licencimin e shoqërisë së investimeve**

1. Licenca lëshohet nga autoriteti vetëm për shoqërinë e investimeve që është shoqëri aksionare me seli të regjistruar dhe zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë.

2. Licenca i lëshohet shoqërisë së investimeve me ofertë publike vetëm nëse:

a) personat kyç të shoqërisë së investimeve i përmbushin kërkesat e nenit 72 dhe 73 të këtij ligji;

b) shoqëria e investimeve ka kapitalin e kërkuar nga neni 71 i këtij ligji;

c) të paktën dy persona kyç/anëtarë të këshillit të administrimit kanë kualifikimet përkatëse dhe përvojën profesionale lidhur me strategjitë e investimit që ndjek shoqëria e investimeve dhe përmbushin kërkesat e nenit 73 të këtij ligji;

ç) në rastin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike, shoqëria ka emëruar një shoqëri administruese të fondeve, të licencuar në zbatim të këtij ligji, ose një administrues të fondeve të investimeve alternative, të licencuar nga një autoritet i huaj rregullator ose një degë të një administruesi të tillë të fondeve të investimeve alternative, e cila njihet nga autoriteti në zbatim të këtij ligji;

d) në rastin e shoqërisë së investimeve, që është fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar, shoqëria ka emëruar një shoqëri administruese të fondeve të investimeve alternative të licencuar në zbatim të këtij ligji ose një administrues të fondeve të investimeve alternative të licencuar nga një autoritet i huaj rregullator ose një degë të një administruesi të tillë të fondeve të investimeve alternative, e cila njihet nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

3. Personi i emëruar në zbatim të shkronjave “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij neni, informon autoritetin për çdo zëvendësim të personave, sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni, dhe jep informacionet e nevojshme për të vlerësuar nëse personat zëvendësues përmbushin kërkesat e shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni.

Neni 71

### **Kapitali i shoqërisë së investimeve**

1. Në kohën e paraqitjes së kërkesës për licencë, shuma minimale e kapitalit themeltar të shoqërisë së investimeve duhet të jetë të paktën 20 000 000 lekë.

2. Kapitali minimal themeltar i shoqërisë së investimeve paguhet plotësisht përpara regjistrimit të shoqërisë së investimeve në regjistrin e AMF-së dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose përpara regjistrimit të zmadhimit të kapitalit të regjistruar.

3. Kostot dhe pagesat e lidhura me themelimin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike dhe me zmadhimin e kapitalit mund të shlyhen nga shoqëria e investimeve, vetëm në rast se kjo është përcaktuar në prospekt. Shuma maksimale e këtyre kostove dhe pagesave përcaktohet në prospekt dhe nuk tejkalon 3,5 % të shumës së siguruar nëpërmjet shitjes së aksioneve të shoqërisë së investimeve. Çdo shumë mbi këtë nivel paguhet nga shoqëria administruese. Nëse shoqëria e investimit nuk arrin vlerën minimale të kapitalit të përcaktuar në prospekt, kostot e themelimit i ngarkohen shoqërisë administruese dhe nënshkrimet e bëra nga investitorët u kthehen të plota.

4. Shoqëria e investimeve me ofertë publike emeton vetëm aksione të zakonshme, të cilat u japin të drejta të barabarta aksionarëve.

5. Regjistri i aksioneve të shoqërive të investimeve mbahet në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi që rregullon fushën e tregjeve të kapitalit.

Neni 72

### **Aftësia dhe përshtatshmëria e personave kyç**

1. Personat kyç të shoqërisë së investimeve me ofertë publike duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm, sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji.

2. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi duhet të përmbushen nga personat e mësipërm gjatë gjithë kohës që ata janë në detyrë.

## Neni 73

### **Kërkesat mbi këshillin e administrimit të shoqërisë së investimeve**

1. Këshilli i administrimit i shoqërisë së investimeve me ofertë publike përbëhet nga një numër tek anëtarësh, si dhe ka minimumi pesë anëtarë dhe maksimumi nëntë anëtarë.

2. Jo më shumë se 40 % e anëtarëve të këshillit të administrimit të shoqërisë së investimeve me ofertë publike mund të jenë punonjës ose të kenë lidhje pronësie me shoqërinë administruese.

3. Anëtarët e tjerë të këshillit të administrimit duhet të jenë të pavarur dhe të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) të mos jenë të punësuar kontraktuar nga shoqëria administruese, depozitari, audituesi ose avokati i shoqërisë së investimeve ose shoqërisë administruese në dy vitet e fundit;

b) të mos zotërojnë aksione të shoqërisë administruese ose të depozitarit të shoqërisë së investimeve ose të shoqërisë që vepron si shoqëri komisionere e kësaj shoqërie të investimeve.

4. Të paktën një anëtar i pavarur i këshillit duhet të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në post profesional ose drejtues në një institucion financiar të licencuar.

5. Këshilli i administrimit të shoqërisë së investimeve me ofertë publike, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ka edhe këto përgjegjësi:

a) miraton, mbikëqyr dhe trajton mosmarrëveshjet që lindin gjatë ecurisë së kontratave ndërmjet shoqërisë administruese dhe depozitarit, të cilat duhen lidhur për një periudhë jo më të gjatë se një vit;

b) zgjidh kontratat në rast të mospërmbushjes së kontratave. Në këtë rast asnjë prej pagesave që duhen shlyer, si pasojë e zgjidhjes nuk tejkalon shpërblimin e tre muajve në bazë të kontratës së zgjidhur;

c) u rekomandon aksionarëve projekt vendime për emetimin e aksioneve dhe ristrukturimin e shoqërisë së investimeve;

ç) njofton autoritetin për çdo moszbatim të këtij ligji dhe aktet rregullative në zbatim të tij nga shoqëria administruese dhe depozitari;

d) përcakton raportet financiare të shoqërisë së investimeve me propozimin e shoqërisë administruese.

## Neni 74

### **Kërkesa për licencë si shoqëri e investimeve**

Kërkesa për licencë si shoqëri e investimeve me ofertë publike paraqitet në emër të shoqërisë vetëm nga një shoqëri administruese e njohur ose e licencuar ose degë dhe duhet të përmbajë:

a) dokumente që vërtetojnë statusin e licencimit ose të njohjes të shoqërisë administruese ose të degës dhe emrin e plotë, adresën, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të përfaqësuesit të autorizuar;

b) informacion për çdo delegim të administrimit të investimeve dhe të funksioneve administrative të shoqërisë së investimeve;

c) prospektin dhe projektstatutin e shoqërisë;

ç) dokumentin e informacionit kryesor për investitorin e shoqërisë së investimeve;

d) marrëveshjen me depozitarin e licencuar;

- dh) dokumente që vërtetojnë statusin e licencuar dhe të pavarur të depozitarit;
- e) dokumentet që vërtetojnë se këshilli i administrimit të shoqërisë së investimeve përmbush kërkesat e neneve 72 dhe 73 të këtij ligji;
- ë) dokumente që vërtetojnë se kapitali minimal fillestar, sipas nenit 71, të këtij ligji, është paguar plotësisht në para dhe se kapitali rrjedh nga burime legjitime, siç parashikohet në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 17, të këtij ligji;
- f) dokumente që vërtetojnë pronësinë në shoqëri, përfshirë të dhëna për pjesëmarrjet influencuese dhe madhësinë e këtyre pjesëmarrjeve dhe për aftësinë dhe përshtatshmërinë e këtyre pronarëve, sipas nenit 14 të këtij ligji;
- g) konfirmim me shkrim për marrëveshjen e një audituesi të pavarur për të vepruar me këtë cilësi kundrejt fondit dhe dokumente që vërtetojnë përputhshmërinë e audituesit me nenin 35 të këtij ligji.

## Neni 75

### **Dhënia e licencës**

1. Autoriteti konsultohet paraprakisht me autoritetin e huaj rregullator të shoqërisë administruese ose të administruesit të huaj të fondeve të investimeve alternative në lidhje me licencimin e shoqërisë së investimeve në Republikën e Shqipërisë, të krijuar nga këto subjekte.
2. Autoriteti vlerëson nëse kërkesa është e plotë ose jo dhe e informon për këtë subjektin kërkues.
3. Autoriteti informon subjektin kërkues brenda gjashtë muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë lidhur me miratimin ose refuzimin e licencës.
4. Kërkesa për licencë mund të tërhiqet me njoftim me shkrim në çdo moment përpara se autoriteti të marrë vendim për të.
5. Autoriteti, në rast të refuzimit të licencës, jep me shkrim arsyet për mosdhënien e kësaj licence.
6. Shoqëria investimeve fillon veprimtarinë e saj vetëm pas marrjes së licencës nga autoriteti.

## Neni 76

### **Refuzimi i licencës**

Autoriteti refuzon dhënien e licencës shoqërisë së investimeve nëse vlerëson se nuk janë përmbushur kriteret e mëposhtme:

- a) kërkesa nuk përmbush kërkesat e këtij ligji dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji;
- b) shoqëria administruese e fondeve, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative apo administruesi i fondeve të investimeve alternative të emëruar nuk janë të licencuar ose të njohur nga autoriteti, sipas dispozitave të këtij ligji;
- c) shoqëria administruese apo administruesi i fondeve të investimeve alternative dhe depozitari nuk janë të pavarur juridikisht dhe funksionalisht nga njëri-tjetri;
- ç) personat kyç të depozitarit dhe shoqërisë administruese nuk janë të aftë dhe të përshtatshëm, në bazë të nenit 14, të këtij ligji, ose nuk kanë përvojën e mjaftueshme;
- d) anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë së investimeve nuk janë të aftë dhe të përshtatshëm, në bazë të nenit 14, të këtij ligji, dhe nuk kanë përvojën e mjaftueshme në lidhje me llojin e shoqërisë së investimeve për të cilën kërkohet licenca;

dh) personat që zotërojnë pjesëmarrjet influencuese të shoqërisë së investimeve në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk përmbushin kërkesat për përshtatshmërinë dhe aftësitë e parashikuara në nenin 14, të këtij ligji.

e) nëse nuk është paguar tarifa e kërkuar.

#### Neni 77

### **Miratimi paraprak i ndryshimeve të rëndësishme**

1. Shoqëria administruese e shoqërisë së investimeve me ofertë publike informon me shkrim autoritetin 3 muaj përpara çdo ndryshimi të rëndësishëm të shoqërisë së investimeve ose, kur njoftimi paraprak nuk është i mundur, jep njoftim të menjëhershëm. Ndryshim i rëndësishëm i shoqërisë së investimeve me ofertë publike quhet çdo:

- a) ndryshim i statutit të shoqërisë së investimeve;
- b) ndryshim i objektivit dhe strategjisë së investimit të shoqërisë;
- c) ndryshim i shoqërisë administruese ose depozitarit të shoqërisë së investimeve;
- ç) ndryshim i tarifave shtesë kundrejt shoqërisë së investimeve që nuk janë përfshirë më parë në prospekt ose çdo rritje të pagesave të përfshira në prospektin SIK;
- d) ndryshim i prospektit gjatë periudhës së ofertës fillestare;
- dh) ndryshim i anëtarësisë së këshillit të administrimit;
- e) rikonstruktim ose bashkim i propozuar që përfshin shoqërinë e investimeve;
- ë) propozim për mbylljen e shoqërisë së investimit.

2. Ndryshimi i rëndësishëm i shoqërisë së investimit me ofertë publike, në bazë të këtij neni nuk implementohet nëse autoriteti nuk ka dhënë miratimin e tij me shkrim dhe nëse ky ndryshim nuk është miratuar nga aksionarët me anë të një vendimi të jashtëzakonshëm.

3. Autoriteti nuk miraton ose pranon asnjë propozimin për të ndryshuar shoqërinë administruese, administruesin e fondit të investimeve alternative, depozitarin apo audituesin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike nëse nuk gjykon se, shoqëria e investimeve me ofertë publike do të vazhdojë të veprojë në përputhje me këtë ligj edhe pas implementimit të këtij ndryshimi.

#### Neni 78

### **Regjistrimi i shoqërisë së investimeve si fond investimesh alternative**

1. Shoqëria aksionare, me seli të regjistruar dhe zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë, e cila është shoqëri e investimeve për klientë profesionistë dhe të kualifikuar regjistrohet si fond investimesh alternative nga autoriteti.

2. Kërkesa për regjistrimin e shoqërisë së investimeve si fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar kryhet në emër të shoqërisë së investimeve nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative e licencuar ose nga administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative, në bazë të këtij ligji ose nga dega e administruesit të njohur të fondeve të investimeve alternative. Kërkesa për regjistrim shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) dokumente që vërtetojnë statusin e licencimit ose të njohjes së shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative ose të administruesit të fondeve të investimeve alternative ose të degës së administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe emrin e plotë, adresën, numrin e telefonit, si dhe adresën e postës elektronike të përfaqësuesit të autorizuar;

b) prospekti dhe statuti i shoqërisë, ku përcaktohet qartë se shoqëria e investimeve është

fond investimesh alternative vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar;

c) marrëveshja me depozitarin e licencuar të fondit të investimeve alternative;

ç) dokumente që vërtetojnë pavarësinë dhe statusin e licencuar, emrin dhe adresën e depozitarit;

d) konfirmim me shkrim për marrëveshjen me audituesin e pavarur për të vepruar me këtë cilësi kundrejt fondit dhe dokumente që dëshmojnë përputhshmërinë e audituesit me nenin 35 të këtij ligji.

dh) dokumentet, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

3. Autoriteti njofton shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesin e njohur të fondeve të investimeve alternative nëse mund të procedojë ose jo me marketimin përkatës, brenda një muaji pas marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 2 të këtij neni.

### SEKSIONI 3

#### THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQËRISË KOMANDITE TË SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

##### Neni 79

#### **Sipërmarrja e investimeve kolektive si shoqëri komandite**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive e themeluar si shoqëri komandite, në bazë të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, regjistrohet pranë autoritetit si fond i investimeve alternative në bazë të këtij ligji.

2. Shoqëria komandite, që është sipërmarrje e investimeve kolektive, ka seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

3. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i fondeve të investimeve alternative i shoqërisë komandite të sipërmarrjes është i pavarur juridikisht dhe funksionalisht nga depozitari i sipërmarrjes.

4. Objektivi i shoqërisë komandite në marrëveshjen midis ortakëve është ofrimi i fitimeve për ortakët nga investimi në një portofol që ofron diversifikim dhe shpërndarje të riskut. Shoqëria komandite, që është fond i investimeve alternative, kryen vetëm veprimtari të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e këtij objektivi.

5. Shoqëria komandite e sipërmarrjes së investimeve kolektive emëron nëpërmjet një kontrate me shkrim një depozitar të pavarur të fondeve të investimeve alternative. Në përjashtim nga pika 3, e këtij neni, depozitari i fondeve të investimeve alternative mund të jetë ortak i kufizuar dhe ortak i kufizuar pa asnjë kontribut në shoqërinë komandite.

##### Neni 80

#### **Krijimi i shoqërisë komandite**

Fondi i investimeve alternative, i krijuar si shoqëri komandite, themelohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nga një shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative ose një administrues i fondeve të investimeve alternative ose degë e një administruesi të fondeve të investimeve alternative të licencuar ose njohur nga autoriteti në bazë të këtij ligji.

## Neni 81

### **Emërtimi i shoqërisë komandite**

1. Shoqëria komandite e sipërmarrjes së investimeve kolektive, e regjistruar në bazë të këtij ligji, përmban në emërtimin e vet fjalët “shoqëri komandite e sipërmarrjes së investimeve kolektive” ose “shoqëri komandite SIK”.

2. Emërtimi i shoqërisë komandite të sipërmarrjes së investimeve kolektive pasqyron saktë natyrën e fondit dhe nuk duhet të jetë keqorientues.

3. Emërtimi “shoqëri komandite e sipërmarrjes së investimeve kolektive” ose një emërtim i ngjashëm përdoret në Republikën e Shqipërisë, vetëm nga një shoqëri komandite e regjistruar nga autoriteti, në zbatim të këtij ligji.

## Neni 82

### **Regjistrimi i shoqërisë komandite**

1. Kërkesa për regjistrim e shoqërisë komandite të sipërmarrjes së investimeve kolektive, si fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar kryhet në emër të shoqërisë komandite nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose nga administruesi i fondeve të investimeve alternative, që është licencuar ose njohur në bazë të këtij ligji ose nga dega e administruesit të njohur të fondeve të investimeve alternative dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) dokumente që vërtetojnë statusin e licencimit ose të njohjes së shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative ose të administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe emrin e plotë, adresën, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të përfaqësuesit të autorizuar;

b) prospekti dhe kontrata mes ortakëve të shoqërisë, ku përcaktohet qartë se shoqëria komandite e sipërmarrjes së investimeve kolektive është fond i investimeve alternative ofruar vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar;

c) marrëveshja me depozitarin e licencuar të fondit të investimeve alternative;

ç) dokumente që vërtetojnë statusin e licencuar dhe të pavarur të depozitarit;

d) konfirmim me shkrim për marrëveshjen me audituesin e pavarur për të vepruar me këtë cilësi kundrejt fondit dhe dokumente që vërtetojnë përputhshmërinë e audituesit me nenin 35 të këtij ligji;

dh) dokumentet, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

2. Autoriteti njofton shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesin e njohur të fondeve të investimeve alternative nëse mund të procedojë ose jo me marketimin përkatës, brenda një muaji pas marrjes së kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 1 të këtij neni.



## SEKSIONI 4

### STATUSI I AKTIVEVE TË SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE QË MBAN DEPOZITARI

Neni 83

#### **Statusi i aktiveve që mban depozitari**

1. Të gjitha aktivet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive që mban depozitari i fondeve të investimeve alternative ose depozitari, ruhen dhe mbahen në një llogari të veçantë për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive ose nënfond.

2. Depozitari i fondeve të investimeve alternative ose depozitari nuk përdor aktivet e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nënfondit, as drejtpërdrejt, as në mënyrë të tërthortë, për llogari të tij ose për të marrë ndonjë përfitim për veten a punonjësit e tij, personat e tij kyç, personelin e tij kyç apo palë të lidhura me të.

3. Aktivet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që mban depozitari i fondeve të investimeve alternative ose depozitari veçohen dhe nuk përfshihen në aktivet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe as për shlyerjen apo ekzekutimin e pretendimeve kundrejt depozitarit të fondeve të investimeve alternative ose kundrejt depozitarit.

4. Në rastin e paaftësisë paguese të depozitarit të fondeve të investimeve alternative ose të depozitarit dhe/ose të palës së tretë, që i është deleguar kujdestaria e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nënfondit, aktivet e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nënfondit nuk përdoren për shpërndarje të kreditorët e depozitarit dhe/ose të tretët dhe nuk shiten për të siguruar mjete monetare për llogari të kreditorëve të lartpërmendur.

## KREU V

### FUNKSIONIMI I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

## SEKSIONI 1

### AKTI THEMELUES I SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 84

#### **Kërkesat për aktin themelues**

1. Akti themelues i fondit të investimeve me ofertë publike është rregullorja e tij, ndërsa akti themelues i shoqërisë së investimeve me ofertë publike është statuti i saj. Akti themelues përmban dispozitat në këtë seksion lidhur me natyrën dhe llojin e sipërmarrjes në fjalë.

2. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbushë parashikimet e përcaktuara në këtë seksion dhe miratohet nga autoriteti përpara ofertës publike të sipërmarrjes.

3. Statuti ose rregullat e sipërmarrjes nuk përmbajnë dispozita që bien ndesh me këtë ligj apo me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të këtij ligji dhe që cenojnë interesat

e pjesëmarrësve në përgjithësi ose të mbajtësve të çdo klase pjesëmarrjeje.

4. Akti themelues duhet të përmbajë dispozita që përcaktojnë se të gjitha kontratat që lidhen me veprimtarinë e sipërmarrjes, përcaktojnë se shoqëria administruese, këshilli i administrimit (nëse ka) dhe depozitari deklarojnë në një formë të saktë dhe në kohën e duhur njëri-tjetrit, të gjithë informacionin që kërkohet nga secila palë për të përmbushur detyrimet ndaj mbajtësve të kuotave apo aksioneve në këtë sipërmarrje.

5. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmban dispozitat e përcaktuara më poshtë:

a) përcakton që mbajtësi i aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të sipërmarrjes; dhe

b) kufizon përgjegjësinë e mbajtësit të aksionit ose kuotës së sipërmarrjes brenda vlerës që, në momentin kur është i pagueshëm borxhi, është e barabartë me vlerën neto të aktiveve në atë moment të aksioneve ose kuotave të mbajtësit;

c) përcakton që çdo kuotë e fondit të investimeve me ofertë publike ose çdo aksion i shoqërisë së investimeve me ofertë publike jep të drejtë të barabartë në sipërmarrje.

6. Rregullat e fondit të investimeve me ofertë publike të themeluar në Republikën e Shqipërisë duhet të përcaktojnë nëse sipërmarrja është:

a) sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike ose sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm;

b) sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, sipërmarrje me intervale ose sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur;

c) sipërmarrje e veçantë ose sipërmarrje ombrellë;

ç) sipërmarrje kryesore;

d) sipërmarrje furnizuese.

7. Rregullorja e fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale të themeluar në Republikën e Shqipërisë mund të përmbajë përcaktimet e mëposhtme:

a) mundësinë e emetimit të kuotave të pjesshme të sipërmarrjes;

b) mundësinë e emetimit të klasave të ndryshme të kuotave me kusht që:

i. klasa e kuotave të mos përmbajë avantazhe në lidhje me atë klasë që do të cenonte mbajtësit e klasave të tjera të kuotave në të njëjtën sipërmarrje apo në të njëjtin nënfond;

ii. prospekti të përcaktojë qartë natyrën, funksionimin dhe të drejtat e çdo klase.

8. Klasat e kuotave mund të përfshijnë klasa valutore, nga të cilat çmimi i kuotës shprehet në një shumë në monedhë të huaj e ekuivalente me çmimin e kuotës në monedhën shqiptare dhe ku shitblerja e kuotave e pagesa e shpërndarjeve bëhet në të njëjtën monedhë të huaj.

9. Lejohet emetimi i klasava të kuotave që kanë të drejta të ndryshme për klasa të ndryshme kuotash, me kusht që kjo të ketë lidhje vetëm me:

a) akumulimin e të ardhurave nëpërmjet kreditimit periodik në kapital dhe jo në shpërndarje (“kuota akumulimi”) në dallim nga shpërndarja e të ardhurave (“kuota me të ardhura”);

b) pagesat dhe tarifatat që zbriten nga pasuria e sipërmarrjes ose që paguhen në momentin e hyrjes apo daljes së mbajtësve të kuotave nga sipërmarrja; ose

c) monedhën me të cilën shprehen çmimet ose vlerat e kuotave të sipërmarrjes ose bëhen pagesat.

10. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike mund të parashikojë një ofertë fillestare të pjesëmarrjes me çmim fiks.

11. Statuti i shoqërisë së investimeve me ofertë publike përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) lejon shoqërinë të emetojë tituj, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit të zbatueshëm;

b) kërkon miratimin e një vendimi të jashtëzakonshëm të aksionarëve në rastin e ngjarjeve të mëposhtme:

i. zmadhimi i tarifës vjetore të administrimit që i paguhet shoqërisë administruese ose administruesit të njohur të fondeve të investimeve alternative përtej nivelit të deklaruar në prospektin SIK të shoqërisë së investimeve, ose përfshirja e një tarife të re;

ii. ndryshimi i objektivit të investimit të shoqërisë së investimeve nga ai, i deklaruar në prospektin SIK të shoqërisë së investimeve;

iii. shlyerja e aksioneve të shoqërisë së investimeve;

iv. në rastin e shoqërisë së investimeve të krijuar me afat të përcaktuar, zgjatja e afatit të veprimtarisë të shoqërisë së investimeve përtej këtij afati;

v. bashkimi me një shoqëri tjetër investimesh ose ndarja e shoqërisë së investimeve ose marrja në kontroll e një shoqërie investimesh apo nga një shoqëri tjetër investimesh.

12. Rregullorja e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale nuk detyron sipërmarrjen për të shlyer kuotat e këtij fondi investimesh me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, nëse nuk është kryer pagesa për këtë kuotë.

13. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur mund të parashikojë nënshkrimin e pjesëmarrjeve në natyrë. Kjo kryhet vetëm me një metodikë të përcaktuar qartë në prospektin SIK, për të cilin është rënë dakord me depozitarin e sipërmarrjes dhe në varësi të vlerësimit të pavarur të jashtëm të aktiveve të dhëna si kontribut.

14. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, që është fond i tregtuar në bursë mund të parashikojë nënshkrimin dhe shlyerjen e kuotave në natyrë nëpërmjet këmbimit të një vlere portofoli me tituj të indeksuar, kundrejt një vlere të barabartë kuotash të sipërmarrjes. Kjo kryhet vetëm me një metodikë të përcaktuar qartë në prospektin SIK, për të cilin është rënë dakord me depozitarin e sipërmarrjes.

Neni 85

### **Përmbajtja e aktit themelues**

1. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike rregullon marrëdhënien juridike midis shoqërisë administruese dhe pjesëmarrësve të sipërmarrjes.

2. Rregullorja e fondit të investimeve me ofertë publike dhe statuti i shoqërisë së investimeve me ofertë publike përbëjnë shtojcën e prospektit SIK të sipërmarrjes, me përjashtim të rastit kur prospekti SIK përcakton qartë se statuti ose rregullorja e plotë dhe e përditësuar duhet t'i vihet në dispozicion sipas kërkesës çdo kërkuesi dhe nëse përcakton se mund të merret menjëherë dhe pa pagesë.

3. Akti themelues i sipërmarrjes së investimeve kolektive përmban:

a) emërtimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive, si dhe strukturën juridike;

b) të dhëna nëse sipërmarrja është sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike ose sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm;

c) në rastin e fondit të investimeve të dhëna nëse është me pjesëmarrje të hapur, me intervale ose me pjesëmarrje të mbyllur, dhe në rastin e fondit me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, të dhëna nëse është fond i veçantë investimesh apo fond ombrellë dhe në rastin e fondit me pjesëmarrje të hapur nëse është fond kryesor apo furnizues investimesh;

ç) në rastin e fondit ombrellë të investimeve, informacion lidhur me numrin dhe emrat e nënfondeve të fondit ombrellë dhe objektin e tyre të investimit;

d) datën e themelimit të sipërmarrjes dhe në rastin e fondit të investimeve me pjesëmarrje të mbyllur nëse është themeluar me afat të përcaktuar apo pa afat, dhe afatin nëse është themeluar me afat;

dh) shumën minimale dhe maksimale të aktiveve monetare, që synohet të grumbullohet dhe

veprimet që do të ndërmerren në rast se nuk arrihet shuma e caktuar minimale;

e) deklaratën ku shprehet se:

i. pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive mbahet nga depozitari për llogari dhe në emër të investitorëve;

ii. shumat që ndodhen në llogarinë e parave për t'u shpërndarë mbahen nga depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje;

ë) monedhën bazë të fondit;

f) datat në vitin kalendarik, në të cilat fillon dhe mbaron periudha kontabël, që, në rastin e një sipërmarrjeje ombrellë duhet të jetë e njëjtë për të gjitha nënfondet përbërëse;

g) datën në vitin kalendarik, që është jo më vonë se dy muaj pas datës në të cilën mbaron periudha paraardhëse e kontabël dhe që është data e deklarimit të shpërndarjes së të ardhurave vjetore;

gj) të drejtat që burojnë nga kuotat ose aksionet apo aksionet me të drejta të veçanta, si më poshtë:

i. e drejta për të votuar në asamblenë e përgjithshme të zakonshme ose të jashtëzakonshme të një shoqërie investimesh;

ii. e drejta për informacion (raporte dhe pasqyra financiare gjashtëmuajore dhe vjetore);

iii. e drejta për shpërndarje të të ardhurave ose pjesë në fitimin e shoqërisë;

iv. në rastin e fondit me pjesëmarrje të mbyllur, e drejta e mbajtësve të kuotave për të transferuar ose shitur aksionet ose kuotat e sipërmarrjes dhe detyrimi lidhur me fondet me pjesëmarrje të hapur ose fondet me intervale që sipërmarrja t'i shlyejë këto kuota;

v. e drejta e pagesës nga fondet e përfituara nga likuidimi në përpjesëtim me secilin aksion ose kuota;

vi. në rastin e sipërmarrjes me pjesëmarrje të mbyllur, sipas rastit, informacionin për tregjet e rregulluara ku do të tregtohen aksionet;

h) përshkrimin e objektivave të investimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe natyrën e portofoleve të sugjeruar ose ekzistues, duke specifikuar sektorët e ekonomisë, mënyrën me të cilën mund të arrihen këta objektiva dhe rreziqet që lidhen me investimet dhe strukturën e sipërmarrjes së investimeve kolektive;

i) të dhëna nëse objektivat e sipërmarrjes përfshijnë ndonjë investim me natyrë specifike, deklarimin e këtij fakti dhe karakteristikat e kësaj natyre specifike;

j) deklaratën se objektivi i investimit është replikimi i një indeksi, në rast se sipërmarrja e investimeve kolektive ka qëllim të replikojë një indeks aksionesh ose instrumentesh borxhi dhe indeksin që replikohet dhe nëse është rasti se sipërmarrja është fond i tregtuar në bursë (FTB);

k) investimin minimal në sipërmarrje dhe investimin maksimal, nëse ka;

l) mënyrën e shlyerjes së kuotave për fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale;

ll) mënyrën e llogaritjes dhe frekuencën e shpërndarjes së të ardhurave dhe fitimeve kapitale të fituara nga sipërmarrja, te mbajtësit e kuotave nëse ka;

m) bazën e llogaritjes së tarifave vjetore të administrimit dhe një pasqyrë të kostove që mund t'i ngarkohen sipërmarrjes, si dhe përshkrimin e ndikimit të tyre në fitimet e investitorëve në të ardhmen;

n) në rastin e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, pagesat që ngarkohen në rastin e blerjes së kuotave (komisioni i hyrjes) ose në rastin e shlyerjes së kuotave (komisioni i daljes), nëse ka;

nj) në rastin e sipërmarrjes ombrellë, një deklaratë që autorizon shoqërinë administruese të sipërmarrjes ombrellë të vendosë një tarifë fikse për shkëmbimin e kuotave ndërmjet nënfondeve dhe përcaktimin e maksimumit të kësaj tarife;

o) sqarim të shkurtër për legjislacionin tatimor të zbatueshëm për sipërmarrjen e

investimeve kolektive;

p) datën e publikimit të rregullave të fondit;

q) të dhënat për shoqërinë administruese ose shoqërinë e njohur administruese apo degën e njohur, si më poshtë:

i. emrin e shoqërisë dhe formën ligjore, selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore, nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numrin e licencës të dhënë nga autoriteti ose nga autoriteti i huaj rregullator dhe, për shoqërinë administruese të autorizuar nga autoriteti, datën e themelimit dhe regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

ii. në rast se shoqëria administruese administron edhe sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike, listën e këtyre sipërmarrjeve të tjera;

iii. emrat e anëtarëve të këshillit të administrimit të shoqërisë administruese të licencuar/njohur, CV-të e tyre dhe të dhëna treguese, nëse ata kanë lidhje me njëri-tjetrin në ndonjë mënyrë;

iv. shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese të licencuar/njohur dhe emrat e pronarëve të shoqërisë administruese, formën ligjore dhe treguesin e pjesëmarrjes së pronarëve në kapitalin e regjistruar;

v. emërtimin, format ligjore, selinë e regjistruar, numrin e licencës së lëshuar nga autoriteti dhe datën e themelimit dhe të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rolin e shoqërive që vepronë si administrues të investimeve të fondit dhe emrin e kryetarit të këshillit të administrimit ose të personave të tjerë përgjegjës në këto shoqëri;

vi. informacionin për depozitarin, përfshirë emërtimin, formën ligjore, selinë e regjistruar dhe adresën e zyrës qendrore të depozitarit, si dhe numrat dhe informacionet për licencat e dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe autoriteti për kryerjen e veprimtarisë si i tillë;

vii. rrethanat që çojnë në prishjen ose mbylljen apo likuidimin e sipërmarrjes dhe procedurat që ndiqen në secilin rast.

## SEKSIONI 2

### PROSPEKTI SIK I SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE TË THEMELUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 86

#### **Kërkesat për prospektin SIK**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike e themeluar në Republikën e Shqipërisë nuk nis veprimtarinë e saj nëse prospekti SIK i sipërmarrjes nuk miratohet paraprakisht nga autoriteti.

2. Çdo sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike e themeluar në Republikën e Shqipërisë harton dhe përgatit një prospekt SIK. Në rastin e sipërmarrjes ombrellë prospekti SIK përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) informacioni në prospektin SIK jepet në lidhje me çdo nënfond në rast kur informacionet për këtë nënfond janë të ndryshme nga informacionet për nënfondet e tjera; dhe

b) për sipërmarrjen ombrellë në tërësi, por vetëm kur informacioni ka të bëjë me sipërmarrjen ombrellë në tërësi.

3. Prospekti SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive të themeluar në Republikën e Shqipërisë përmban informacion nëse sipërmarrja është:

a) fond investimesh ose shoqëri investimesh;

b) në rastin e fondit të investimeve, nëse është sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur,

sipërmarrje me intervale ose sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur;

c) në rastin e sipërmarrjes me pjesëmarrje të hapur, nëse është sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike ose sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm;

ç) sipërmarrje e veçantë ose sipërmarrje ombrellë;

d) në rastin e sipërmarrjes ombrellë, emrat dhe objektivat e investimit të nënfondeve;

dh) sipërmarrje kryesore;

e) sipërmarrje furnizuese.

4. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të themeluar në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe përcakton qartë statusin e licencimit të sipërmarrjes në bazë të këtij ligji dhe përcakton datën e publikimit të prospektit.

5. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmban informacione, të cilat i nevojiten investitorëve, me qëllim marrjen e një vendimi për t'u bërë pjesëmarrës i sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe në veçanti për risqet që kanë lidhje me këtë pjesëmarrje.

6. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbushë kërkesat e këtij seksioni.

7. Prospekti në vetvete nuk përbën një ftesë për të blerë aksione ose kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat, rreziqet për të qenë pjesë e sipërmarrjes së investimeve kolektive.

8. Prospekti duhet të jetë i qartë, i saktë dhe jo keqorientues e duhet të jetë i përditësuar.

9. Prospekti përmban një formular-kërkesë ku përfshihet deklarata e nënshkruar nga investitori i mundshëm, sipas së cilës investitori deklaron se i ka lexuar dhe i ka kuptuar kushtet e ofertës dhe risqet e përfshira.

10. Blerja e pjesëmarrjeve në sipërmarrjen e investimeve kolektive të përshkruar në prospekt nënkupton pranimin e kushteve të prospektit SIK.

11. Prospekti hartohet për emetimin fillestar të aksioneve të shoqërisë së investimeve dhe për çdo emetim të mëpasshëm.

12. Prospekti vihet në dispozicion nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi ose me anë të një faqe në internet. Një kopje në letër do t'i dorëzohet investitorëve me kërkesë dhe pa pagesë.

Neni 87

### **Përmbajtja e prospektit SIK**

1. Prospekti SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmban të paktën informacionet që kërkon shtojca 1 e këtij ligji.

2. Prospekti SIK informon se në cilat kategori të aktiveve është e autorizuar të investojë sipërmarrja.

3. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm investon kryesisht në çdo lloj kategorie aktivesh, të parashikuar në seksionin 3, të kreut VII, të këtij ligji, përveçse në tituj të transferueshëm dhe instrumente (SIKTT/UCITS) të tregut të parasë ose replikon një indeks të aksioneve ose të instrumenteve të borxhit, në përputhje me shkronjën "j", të pikës 3, të nenit 85, të këtij ligji, prospekti i saj dhe, sipas rastit, marketimi ose reklamat përmban një deklaratë të qartë ku theksohet politika e investimit dhe, sipas rastit, fakti se sipërmarrja është fond i tregtuar në bursë.

4. Kur vlera neto e aktiveve për kuotë e një sipërmarrjeje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm me ofertë publike mund të ketë luhatshmëri të lartë për shkak të përbërjes së

portofolit ose të teknikave të administrimit të portofolit që mund të përdoren, prospekti SIK dhe, sipas rastit, komunikimet e marketimit duhet të përfshijnë një deklaratë të dukshme ku theksohet kjo karakteristikë e sipërmarrjes.

5. Shoqëria administruese jep edhe informacione shtesë lidhur me kufizimet sasiore që zbatohen në administrimin e risqeve të sipërmarrjes, mbi metodat e përzgjedhura për këtë qëllim dhe mbi zhvillimet e fundit të risqeve kryesore dhe kthimet e kategorive të instrumenteve, në përputhje me rregullat e miratuara nga autoriteti ose me kërkesë të investitorit.

#### Neni 88

### **Përgjegjësia për prospektin SIK**

1. Prospekti SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përcakton personat e licencuar/njohur që janë përgjegjës për prospektin SIK të sipërmarrjes dhe çdo përgjegjësi përkatëse.

2. Shoqëria administruese e licencuar e sipërmarrjes me ofertë publike, që është fond i investimeve, është përgjegjëse për prospektin SIK të kësaj sipërmarrjeje.

3. Këshilli i administrimit të sipërmarrjes me ofertë publike, që është shoqëri e investimeve me ofertë publike, mban përgjegjësi bashkërisht dhe individualisht me shoqërinë administruese të licencuar të kësaj sipërmarrjeje për prospektin SIK.

4. Personat përgjegjës për prospektin SIK, në bazë të pikave 2 dhe 3, të këtij neni, i paguajnë dëmshpërblim personit që ka pësuar humbje ose dëm për shkak të deklaratave të pavërteta, mashtruese ose keqorientuese në prospektin SIK ose për shkak të mospërfshirjes në prospektin SIK të informacionit me rëndësi materiale që duhej të ishte përfshirë në prospekt, në bazë të këtij ligji dhe të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij.

#### Neni 89

### **Vënia në dispozicion e prospektit SIK dhe dokumentit me informacionin kryesor për investitorin**

1. Prospekti SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin u vihen në dispozicion pa pagesë investitorëve të mundshëm përpara lidhjes së një kontrate për blerjen e pjesëmarrjeve.

2. Në rastin e sipërmarrjes furnizuese, prospekti SIK i sipërmarrjes kryesore, ku investon sipërmarrja furnizuese dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin u vihen në dispozicion pa pagesë sipas kërkesës.

#### Neni 90

### **Miratimi i prospektit SIK**

1. Autoriteti miraton prospektin SIK të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike në kuadër të licencimit të saj.

2. Prospekti SIK publikohet vetëm pasi autoriteti njofton me shkrim shoqërinë investuese për licencimin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, përfshirë edhe miratimin e prospektit SIK.

3. Autoriteti njofton me shkrim subjektin kërkues, brenda tre muajve nga data e marrjes së

prospektit të plotë SIK, lidhur me miratimin ose jo të tij.

Neni 91

### **Mosmiratimi i prospektit SIK**

1. Autoriteti nuk miraton prospektin SIK ose ndryshimin e rëndësishëm të prospektit SIK nëse:

- a) sipërmarrja me të cilën lidhet prospekti SIK nuk është sipërmarrje me ofertë publike;
- b) prospekti SIK nuk përmbush kërkesat e këtij ligji ose nuk jep informacionet që kërkon ky ligj për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Autoriteti jep arsye me shkrim për mosmiratimin e prospektit SIK të sipërmarrjes me ofertë publike apo për mosmiratimin e ndryshimeve të konsiderueshme të prospektit SIK.

Neni 92

### **Ndryshimi i rëndësishëm i prospektit SIK**

1. Nëse pas publikimit të prospektit SIK dhe gjatë ofrimit të sipërmarrjes me ofertë publike ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm, që ndikon në informacionet që përmban prospekti SIK ose në rast të një informacioni të ri të rëndësishëm, në prospektin SIK bëhen shtesat dhe ndryshimet përkatëse dhe prospekti SIK i përditësuar i dorëzohet autoritetit dhe i vihet në dispozicion, sipas kërkesës, autoritetit të huaj rregullator.

2. Ndryshime të rëndësishme të prospektit SIK të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike janë ndryshimet që ndryshojnë qëllimin ose natyrën e sipërmarrjes, që mund të kenë pasoja të rëndësishme të padëshirueshme për mbajtësin e aksionit ose kuotës, që ndryshojnë profilin e riskut të sipërmarrjes ose përfshijnë dhe një mënyre të re pagese. Në këto ndryshime përfshihen:

a) rritja e komisioneve të hyrjes, komisioneve vjetore të administrimit ose komisionit të daljes, mbi vlerat e deklaruara më parë në prospektin SIK ose përfshirja e një komisioni të ri të padekluar më parë në prospektin SIK;

b) ndryshimi i objektivave të investimit të sipërmarrjes dhe risqeve të lidhura me investimet e parashikuara të sipërmarrjes së investimeve;

c) ndryshimet në politikën e shpërndarjes së të ardhurave;

ç) mundësia e mbajtësit të aksionit ose kuotës për të ushtruar të drejtat në lidhje me aksionet ose kuotat, përfshirë shpeshhtësinë e shlyerjeve ose vonesat në shlyerje të sipërmarrjeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale;

d) bashkimi dhe shkrirja në një sipërmarrje tjetër të investimeve kolektive me ofertë publike ose ndarja e sipërmarrjes.

3. Ndryshimet, sipas pikës 2, të këtij neni, janë objekt i miratimit paraprak të autoritetit.

4. Pas miratimit nga autoriteti:

a) njoftimi për ndryshimet e propozuara u dërgohet drejtpërdrejt me postë normale ose postë elektronike të gjithë mbajtësve të kuotave dhe publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese gjatë gjashtëdhjetë ditëve pune, përpara ditës së implementimit të ndryshimeve;

b) të gjithë mbajtësit e kuotave të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale njoftohen se kanë të drejtë të kërkojnë nga fondi shlyerjen e kuotave të tyre, pa zbritur asnjë komision daljeje të aplikueshëm;

c) shlyerja e të gjitha kuotave, sipas kërkesave të dorëzuara kryhet para implementimit të ndryshimeve në prospektin SIK, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.



5. Prospekti SIK i fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale përditësohet për çdo ndryshim të rëndësishëm në ditën e implementimit të ndryshimit.

6. Prospekti SIK i fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale rishikohet çdo vit, përditësohet dhe depozitohet pranë autoritetit.

7. Autoriteti nuk miraton ndryshimet e prospektit SIK, të cilat nëse implementohen rezultojnë në mospërmbushjen e kërkesave të këtij ligji.

8. Autoriteti njofton me shkrim subjektin kërkues, brenda 1 muaji nga afati i dorëzimit të të gjithë informacionit të nevojshëm, nëse janë miratuar ose jo ndryshimet e rëndësishme që do të përfshihen në prospektin SIK të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike.

Neni 93

### **Informacioni kryesor për investitorin**

1. Shoqëria administruese harton një dokument me informacionin kryesor për investitorin për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, që është sipërmarrje e veçantë dhe për çdo nënfond të sipërmarrjes ombrellë me ofertë publike.

2. Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin informon investitorin në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe jo keqorientuese mbi informacionet bazë të nevojshme për të marrë një vendim investimi. Aspektet me rëndësi të informacioneve duhet të mbahen të përditësuara. Versioni i përditësuar i dokumentit me informacionet kryesore për investitorët publikohet gjithmonë në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

3. Çdo ndryshim dhe përditësim i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin i komunikohet autoritetit duke i dërguar një kopje të dokumentit të përditësuar.

4. Shoqëria administruese dhe personat e tjerë që marketojnë sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike u mundësojnë pa pagesë të gjithë investitorëve dokumentin me informacionin kryesor për investitorin, përpara nënshkrimit të kontratës për blerjen e pjesëmarrjes. Shoqëria administruese i mundëson agjentëve, sipas kërkesës, dokumentin me informacionin kryesor për investitorin, në përputhje me nenin 101, të këtij ligji, si dhe ofruesve të produkteve ku është e përfshirë sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike.

5. Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin përcakton qartë se prospekti SIK, raporte dhe pasqyra financiare vjetore/ndërmjetme vihen në dispozicion pa pagesë, duke përcaktuar edhe mënyrën e marrjes së këtij informacioni.

6. Përmbajtja e dokumentit me informacionin kryesor për investitorin është në përputhje me prospektin aktual SIK dhe duhet të jetë në përputhje me kërkesat e shtojcës 2 të këtij ligji.

7. Përgjegjësia dhe detyrimi për dokumentin me informacionin kryesor për investitorin e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike është i njëjtë me përgjegjësinë për prospektin SIK, siç parashikohet në nenin 88 të këtij ligji. Përgjegjësia për dokumentin me informacionin kryesor për investitorin bazohet në çdo deklaratë të përfshirë në dokumentin me informacionin kryesor të investitorit, që është mashtruese, e pasaktë ose në mospërputhje me pjesët përkatëse të prospektit të sipërmarrjes ose të nënfondit në fjalë.

### SEKSIONI 3

#### MARKETIMI I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 94

##### **Marketimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive**

1. Marketimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike kryhet vetëm nga shoqëria administruese ose dega e shoqërisë së huaj administruese e licencuar ose e njohur në zbatim të këtij ligji dhe subjekteve të përcaktuara në nenet 101 dhe 102 të këtij ligji.

2. Marketimi i sipërmarrjes së njohur të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë kryhet nga shoqëria administruese ose dega e shoqërisë administruese të kësaj sipërmarrjeje, në varësi të parashikimeve të kreut IX të këtij ligji.

3. Shoqëria administruese e fondit të investimeve është përgjegjëse për integritetin dhe saktësinë e informacioneve të publikuara për marketimin e fondeve të investimeve me ofertë publike.

4. Këshilli i administrimit i shoqërisë së investimeve dhe shoqëria administruese mbajnë përgjegjësi bashkërisht për integritetin dhe saktësinë e informacioneve të publikuara, për marketimin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike.

Neni 95

##### **Shoqëritë administruese që kryejnë veprimtari jashtë vendit**

1. Shoqëria administruese e themeluar në Republikën e Shqipërisë, e licencuar në bazë të këtij ligji, që do të administrojë një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike në një vend tjetër ose nëpërmjet themelimit të një dege ose nëpërmjet ofrimit të shërbimeve nga Republika e Shqipërisë njofton për këtë me shkrim autoritetin.

2. Njoftimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përmban programin e veprimtarisë dhe vendin ku synon të ushtrojë veprimtari dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike që kërkon të administrojë. Programi i veprimtarisë përfshin shërbimet që do të ofrohen, sistemet e shoqërisë për administrimin e riskut dhe masat që do të ndërmerren për kryerjen e pagesave të aksionerëve ose mbajtësve të kuotave, për të shlyer aksionet ose kuotat për mundësimin e dhënies së informacioneve dhe për trajtimin e ankesave të klientëve.

3. Njoftimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përmban gjithashtu informacionet e mëposhtme:

a) strukturën organizative të degës;

b) adresën në vendin e origjinës së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike;

c) emrin dhe të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës për administrimin e degës;

ç) kontratën me shkrim me depozitarin;

d) informacion për masat mbi delegimin lidhur me administrimin e investimeve dhe të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

4. Nëse autoriteti gjykon se struktura administrative ose situata financiare e shoqërisë administruese është e përshtatshme, duke pasur parasysh veprimtaritë e parashikuara, brenda dy muajve pas marrjes së njoftimit me të gjithë dokumentacionin e plotë, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, autoriteti i transmeton njoftimin autoritetit rregullator të vendit përkatës. Autoriteti i bashkëlidh këtij njoftimi konfirmimin që shoqëria administruese është e licencuar të kryejë

veprimtari në përputhje me këtë ligj dhe çdo kufizim të zbatueshëm. Autoriteti informon menjëherë me shkrim shoqërinë administruese për transmetimin e njoftimit në fjalë.

5. Shoqëria administruese njofton me shkrim autoritetin për ndryshimin e çdo informacioni të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, të paktën një muaj përpara implementimit të ndryshimit ose menjëherë pas një ndryshimi të paplanifikuar. Nëse ndryshimi cenon përputhshmërinë e shoqërisë administruese me dispozitat e këtij ligji, autoriteti informon pa vonesë për këtë ndryshim autoritetin e vendit të pritës të shoqërisë administruese.

6. Dega fillon të ushtrojë veprimtarinë e saj dy muaj pas marrjes së njoftimit nga autoriteti përkatës rregullator në vendin pritës ose dy muaj pas përcjelljes së njoftimit të vendosjes së degës në autoritetin e vendit pritës.

7. Nëse autoriteti gjykon se struktura administrative ose situata financiare e shoqërisë administruese lidhur me veprimtarinë e planifikuar nuk është e përshtatshme, atëherë ai mund të refuzojë transmetimin e njoftimit. Arsyetimi i këtij refuzimi i jepet me shkrim shoqërisë administruese brenda dy muajve, pasi autoriteti ka marrë të gjitha informacionet e praktikës.

8. Shoqëria administruese informon me shkrim autoritetin dhe autoritetin rregullator të vendit pritës përpara implementimit të ndryshimeve në informacionet që ka dhënë më parë. Në rastin e themelimit të degës, informimi për çdo ndryshim jepet të paktën një muaj përpara implementimit të ndryshimit.

9. Administrimi ndërkufitar nga shoqëritë administruese shqiptare në një vend të huaj lejohet vetëm nëse janë në zbatim rregullat e duhura të bashkëpunimit midis autoriteteve rregullatore të vendit të origjinës dhe autoritetit dhe nëse shoqëria administruese është në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

10. Autoriteti konsultohet me autoritetin e huaj rregullator të vendit të origjinës të çdo sipërmarrjeje të huaj të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm të administruar nga një shoqëri administruese e licencuar nga autoriteti, përpara heqjes së autorizimit të kësaj shoqërie administruese.

## Neni 96

### **Ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së huaj administruese në Republikën e Shqipërisë**

1. Shoqëria e huaj administruese ose dega e shoqërisë së huaj administruese mund të ushtrojë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Shoqëria administruese e licencuar në një vend të huaj për të kryer administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike mund të njihet nga autoriteti për të kryer veprimtari në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë, drejtpërdrejt nga vendi i veprimtarisë së tyre ose nëpërmjet themelimit të degës.

3. Shoqëria e huaj administruese ose dega e shoqërisë së huaj administruese, e licencuar në një shtet anëtar të Bashkimit Europian, njihet nga autoriteti, si dhe ushtron veprimtarinë e saj në Republikën e Shqipërisë, sipas parashikimeve në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA-së) BE-Shqipëri.

4. Njohja, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet vetëm nëse subjekti përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose autoriteti rregullator i vendit të origjinës së shoqërisë administruese i ka përcjellë autoritetit informacionet e përcaktuara ose të kërkuara nga autoriteti;

b) ekziston bashkëpunimi i duhur mbikëqyrës midis autoritetit rregullator të vendit të

originës të shoqërisë administruese dhe autoritetit në Republikën e Shqipërisë;

c) shoqëria administruese është objekt i mbikëqyrjes së duhur në vendin e vet të originës;

ç) shoqëria administruese përmbush kërkesat e përcaktuara për ushtrimin e veprimtarisë në vendin e originës dhe këto kërkesa ofrojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje investitorëve në Republikën e Shqipërisë, me atë të që i ofrohen investitorëve të shoqërive administruese vendase;

d) shoqëria administruese e sipërmarrjes ndërmerr masat e nevojshme për pagesën në Republikën e Shqipërisë të pjesëmarrësve, për shlyerjen e pjesëmarrjes dhe vënien në dispozicion të informacionit që sipërmarrja harton dhe përgatit sipas rregullave të vendit të tij të originës;

dh) procesi i shitjes nga ana e sipërmarrjes në Republikën e Shqipërisë kryhet ose drejtpërdrejt nga selia e shoqërisë administruese të sipërmarrjes nëpërmjet një përfaqësie në Republikën e Shqipërisë ose nëpërmjet një shoqërie administruese të licencuar në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër ose një shoqërie administruese të njohur, në bazë të këtij neni ose një agjenti, në bazë të nenit 102 të këtij ligji.

5. Autoriteti gjatë procesit të miratimit për njohjen e shoqërive të huaja administruese merr në konsideratë ekzistencën e marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit për njohjen e shoqërive të huaja administruese në legjislacionin e vendit të originës së sipërmarrjes përkatëse.

6. Autoriteti mund të heqë vendimin e njohjes së subjektit nëse:

a) nuk përmbushen më kërkesat e shkronjave “ç”, “d” ose “dh”, të pikës 3, të këtij neni;

b) janë shkelur kushtet e përcaktuara për njohjen në bazë të këtij ligji;

c) nuk përmbushen kërkesat e parashikuara në seksionin 3, të kreut XII, të këtij ligji;

ç) nuk përmbushen kërkesat për dokumentet në gjuhën shqipe.

7. Shoqëria administruese e njohur nga autoriteti informon me shkrim autoritetin për çdo ndryshim lidhur me veprimtarinë e saj në Republikën e Shqipërisë përpara implementimit të ndryshimit, me përjashtim të rastit kur ky ndryshim komunikohet nëpërmjet autoritetit rregullator të vendit të originës së shoqërisë administruese. Ndryshimet lidhur me degën implementohen vetëm një muaj pas dhënies së informacionit në lidhje me ndryshimin.

8. Dispozitat e kapitujve III, IV, V, VII, VIII, IX dhe X të këtij ligji zbatohen për shoqëritë e huaja administruese ose degët e shoqërive të huaja administruese që themelojnë sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë nga vendi i tyre i originës dhe shoqëria administruese është përgjegjëse ndaj autoritetit për përputhshmërinë me këto kërkesa.

9. Nëse shoqëria e huaj administruese synon të marketojë sipërmarrje të huaja të investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë, pa themelimin e një dege dhe nëse sipërmarrja administrohet nga kjo shoqëri administruese, atëherë mjafton njoftimi i kryer në bazë të kreut IX të këtij ligji.

10. Shoqëria e huaj administruese ose dega e shoqërisë së huaj administruese duhet të garantojë se është në gjendje t'i japë autoritetit informacionet e nevojshme për monitorimin e përputhshmërisë së saj me këtë ligj dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji, sipas kërkesës.

Neni 97

## **Parimi i saktësisë**

Të gjitha veprimtaritë promociionale duhet të përputhen me prospektin SIK të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të nënfondit në fjalë dhe duhet të jenë të qarta,

të rregullta dhe jo keqorientuese.

## Neni 98

### **Miratimi i veprimtarisë promovionale dhe ruajtja e evidencave**

1. Të gjitha veprimtaritë promovionale të publikuara në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike miratohen nga një person kyç i shoqërisë administruese në emër të shoqërisë administruese të licencuar.

2. Shoqëria administruese ruan të dhënat në lidhje me çdo veprimtari promovionale, së bashku me burimet e informacioneve të publikuara, sipas periudhës kohore që parashikohet në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Këto të dhëna i vihen në dispozicion autoritetit për çdo inspektim të mundshëm.

## Neni 99

### **Mënyra e marketimit**

1. Veprimtaritë promovionale që përmbajnë informacione konkrete për një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike nuk përmbajnë të dhëna që bien ndesh ose zvogëlojnë rëndësinë e informacioneve që përmban prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin.

2. Të gjitha veprimtaritë promovionale bëjnë të ditur se ekziston prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin. Ato përcaktojnë vendin dhe në cilën gjuhë mund të gjenden këto dokumente dhe si mund të aksesohen.

3. Në rastin e veprimtarive promovionale për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike dhe shoqërive të tyre administruese përmbushen përcaktimet e mëposhtme:

a) qëllimi i marketimit nuk fshihet apo prezantohet në mënyrë mashtruese;

b) paraqitet një përshkrim i saktë dhe i vërtetë i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike që po promovohet, si dhe i detyrimeve të pritshme dhe i risqeve që lidhen me to;

c) faktet dhe kuotimet e dhëna duhet të jenë të sakta, të qarta, të vërteta dhe të kuptueshme, në datën në të cilën jepen, si dhe nuk duhet të jenë çorientuese dhe çdo fakt i dhënë të jetë i vërtetueshëm;

ç) kuotimi i dhënë sipas shkronjës “c”, të kësaj pike, të jetë i plotë dhe i qartë dhe të shprehet se për përdorimin e mëtejshëm të tij është marrë miratimi nga shoqëria administruese; si dhe

d) çdo krahasim i bërë të bazohet në fakte, të cilat janë të sakta dhe të përditësuara. Gjithashtu përfundimet kryesore të këtyre krahasimeve duhet të jepen në mënyrë të qartë dhe çdo krahasim të jepet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, i cili, në asnjë mënyrë nuk është çorientues dhe bazohet në të gjithë faktorët kyç për një krahasim të këtij lloji;

dh) nuk duhet të jepet asnjë keqprezantim në veçanti për sa i përket njohurive profesionale të personave përgjegjës, aktiveve dhe qëllimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese dhe pronësisë apo numrit të aksioneve apo të kuotave në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike;

e) të garantohet që paraqitja, përmbajtja ose forma e informacionit të reklamave nuk shtrembëron, fsheh apo ul rëndësinë e deklaratave, paralajmërimeve ose referencave, që jepen sipas këtij ligji apo aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij;

ë) të garantohet që asnjë licencë e dhënë nga autoriteti rregullator të mos citohet pa lejen e këtij autoriteti, si dhe duhet të garantohet se asnjë palë e tretë të mos besojë që licenca e dhënë nga autoriteti rregullator ka kuptim të ndryshëm nga certifikata që vërteton se subjekti në fjalë

ka përmbushur të gjitha kushtet për përfitimin e statusit ligjor të treguar në licencë;

f) çdo e dhënë duhet të përfshihet nëse mospërfshirja e kësaj të dhëne do ta bënte veprimtarinë promocionale të pasaktë, të pavërtetë, të paqartë ose çorientuese.

Neni 100

### **Paraqitja e kthimeve nga investimet**

Paraqitja e kthimeve nga investimet e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) nuk përbën garanci ose premtim;

b) nuk kryhet në formën e vlerësimeve të përafërta në asnjë lloj forme vlerësimi;

c) reflekton performancën e investimit nga çasti i themelimit të saj deri në ditën e paraqitjes, e cila paraqitet për çdo vit dhe në formë kumulative ose performancën në pesë vitet e fundit, cilado nga të dy periudhat është më e shkurtër;

ç) bëhet në bazë të të dhënave më të fundit, të disponuara në çastin e paraqitjes së kthimeve të fondit të investimeve;

d) hartohet në mënyrë të standardizuar për sa u përket periudhave të mbuluara, me përfshirjen ose përjashtimin e faktorëve të caktuar, që prekin këto rezultate (si, për shembull, bazën për çmimin, kostot, taksat, dividendët), sipas kërkesave të parashikuara nga aktet rregullative të miratuara nga autoriteti;

dh) nuk duhet të paraqitet në mënyrë që të interpretohet si parashikim për rezultatet e mundshme të veprimtarisë në të ardhmen.

## **SEKSIONI 4**

### **SHITJA E AKSIONEVE OSE E KUOTAVE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

Neni 101

#### **Subjektet e lejuara të shesin aksione ose kuota**

1. Shitja e aksioneve ose e kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike ose të njohura në Republikën e Shqipërisë kryhet nga:

a) vetë shoqëritë administruese të licencuara/njohura ose nga dega e një shoqërie administruese të njohur, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) personat juridikë që janë të licencuar të shesin fonde dhe që mund të shesin edhe produkte të tjera nga ofrues të tjerë shërbimi, të cilët janë agjentë shitjeje. Në këtë rast shoqëria administruese e fondeve/dega e shoqërisë administruese nuk është përgjegjëse për agjentët e shitjes, pasi ato veprojnë si një entitet i pavarur;

c) agjentët e lidhur, të cilët janë persona fizikë apo juridikë, që shesin vetëm fondet e shoqërisë administruese të fondeve/degës së shoqërisë administruese dhe për të cilët shoqëria administruese është përgjegjëse.

2. Në përputhje me pikën 1, të këtij neni, shitja e aksioneve ose e kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike mund të realizohet nga subjektet e mëposhtme juridike, të cilat kanë lidhur një kontratë me shoqërinë administruese ose me degën e shoqërisë administruese dhe që janë të licencuara për të ushtruar aktivitetet në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) bankat;
- b) shoqëritë e sigurimit;
- c) shoqëritë komisionere;
- ç) persona të tjerë juridikë që kanë licencën e nevojshme nga autoriteti në zbatim të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, të cilët kanë lidhur kontratë me shoqërinë administruese ose degën e shoqërisë administruese.

3. Të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në kuptim të këtij ligji, quhen distributorë.

#### Neni 102

### **Veprimtaria si agjent i shoqërisë administruese dhe investitorëve**

1. Gjatë shitjes së aksioneve ose të kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike ose të njohura, bankat ose shoqëritë e sigurimit dhe personat e tjerë juridikë, të parashikuar në pikën 2, të nenit 101, të këtij ligji, veprojnë si agjentë të shoqërisë administruese ose të degës së shoqërisë administruese, në bazë të një kontrate me shkrim, të lidhur me këtë shoqëri/degë.

2. Gjatë shitjes së aksioneve ose kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike ose të njohura, shoqëritë komisionere dhe bankat e licencuara, për të kryer veprime me titujt veprojnë si agjentë të klientëve në blerjen e aksioneve ose të kuotave për llogari të tyre, bazuar në një kontratë të lidhur me shkrim.

3. Gjatë shitjes së aksioneve ose të kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike ose të njohura, agjentët e lidhur që janë persona juridikë ose fizikë veprojnë si agjentë të shoqërisë administruese ose të degës së shoqërisë administruese, në bazë të një kontrate me shkrim të lidhur me këtë shoqëri administruese ose me degën.

4. Autoriteti mund të miratojë rregulla të mëtejshme për përcaktimin, veprimtarinë dhe kontrollin e personave juridikë ose fizikë si distributorë, agjentë ose agjentë të lidhur të shoqërive administruese ose të degëve të shoqërive administruese.

#### Neni 103

### **Njoftimi i pezullimit të licencës**

1. Personat e përmendur në nenin 101, të këtij ligji, nuk duhet të përfshihen në transaksionet e shitjeve, që përfshijnë kuota ose aksione në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike ose të njohur, gjatë periudhës në të cilën autoriteti përkatës rregullator ka pezulluar përkohësisht licencat e tyre.

2. Personat e përmendur në nenin 101, të këtij ligji, njoftojnë menjëherë për pezullimin e licencës së tyre, shoqërinë administruese ose degën e shoqërisë administruese, me të cilën kanë lidhur kontratë për kryerjen e transaksioneve të shitjeve.

#### Neni 104

### **Mënyra dhe kushtet e shitjes**

Subjektet e parashikuara në nenin 101, të këtij ligji, të licencuara për shitjen e aksioneve ose të kuotave në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike ose të njohura duhet të përmbushin përcaktimet e mëposhtme:

a) u garantojnë investitorëve disponueshmërinë e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave përkatëse, konkretisht prospektin SIK, dokumentin me informacionin kryesor për investitorin, raporte dhe pasqyra financiare vjetore e të ndërmjetme, çmimet e kuotave etj.;

b) kontrollojnë nëse kërkesat për blerjen dhe shlyerjen janë kryer në mënyrë të rregullt;

c) i dërgojnë rregullisht shoqërisë administruese ose degës së shoqërisë administruese kërkesat për shitje dhe shlyerje;

ç) në promovimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të njohura përdorin vetëm prospektin SIK, dokumentin me informacione kryesore, raporte dhe pasqyra financiare vjetore e të ndërmjetme dhe materialet e marketimit ose prezantimit që janë miratuar nga shoqëria administruese;

d) nuk u japin informacion të rremë ose informacion çorientues investitorëve lidhur me gjendjen e sipërmarrjes apo deklarata të tjera të rreme rreth sipërmarrjes, objektivave të saj të investimit, risqet e lidhura me to, çmimet, kthimet e investimit apo çështje ose informacion tjetër për sipërmarrjen apo shoqërinë administruese ose ndonjë deklaratë tjetër, e cila bie në kundërshtim me përmbajtjen e prospektit SIK, dokumentin me informacione kryesore ose raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme të tij;

dh) mbajnë përgjegjësi para shoqërisë administruese për çdo gabim ose pakujdesi të punonjësve të tyre dhe për çdo mospërputhshmëri me këtë ligj dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti;

e) informojnë investitorin e mundshëm mbi faktin se cilën shoqëri administruese përfaqësojnë dhe nëse ai ofron për shitje vetëm produktet e një apo më shumë shoqërive;

ë) garantojnë që sipërmarrja apo sipërmarrjet e investimeve kolektive të propozuara plotësojnë nevojat e palës së interesuar dhe se rekomandimet e bëra lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive janë të përshtatshme dhe/ose të duhura për nevojat e klientëve dhe për kategorinë e klientëve në fjalë (klient profesionist dhe të kualifikuar, klient individual;

f) veprojnë në çdo kohë në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, dhe me aktet rregullative përkatëse të miratuara nga autoriteti.

## Neni 105

### **Dhënia e rekomandimeve**

Gjatë dhënies së rekomandimeve, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, personi që vepron si agent i klientit zbaton dispozitat e nenit 104, të këtij ligji, me përjashtim të shkronjës “dh”, të nenit 104, të këtij ligji, dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

## Neni 106

### **Shpërblimi për shitjet**

1. Personat e përcaktuar në nenin 101, të këtij ligji, që veprojnë si agentë të shoqërisë administruese të licencuar/njohur në shitjen e aksioneve ose të kuotave marrin shpërblim vetëm lidhur me shitjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe vetëm nga shoqëria administruese, si dhe duhet t'i bëjnë të ditur investitorit të mundshëm shumën e komisionit të paguar për angazhimin e tyre në shitjen e aksioneve ose kuotave, të llogaritura si përqindje e komisionit të hyrjes ose komisionit të daljes ose të komisionit vjetor të administrimit.



2. Personat e përmendur në nenin 101, të këtij ligji, që veprojnë si agjentë për klientin, marrin shpërblim nga klienti vetëm në zbatim të një marrëveshjeje të lidhur me shkrim me klientin.

## SEKSIONI 5

### SHITJA DHE SHLYERJA E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

#### Neni 107

#### **Përgjegjësia për shitjen dhe shlyerjen**

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me ofertë publike është përgjegjëse për shitjen, emetimin, riblerjen, shlyerjen dhe anulimin e kuotave të fondit të investimeve, me përjashtim të fondeve të tregtuara në bursë që regjistrohen dhe tregohen në një treg të rregulluar, rast në të cilin shoqëria administruese është përgjegjëse vetëm për emetimin dhe anulimin e kuotave.

2. Këshilli i administrimit i shoqërisë së investimeve dhe shoqëria administruese e shoqërisë së investimeve mbajnë përgjegjësi të përbashkët për shitjen, emetimin dhe anulimin e aksioneve të shoqërisë së investimeve me ofertë publike.

3. Depozitari i fondit të investimeve me ofertë publike emeton ose anulon kuotat e fondit të investimeve me ofertë publike nëse i kërkohet nga shoqëria administruese.

4. Kërkesa, sipas pikës 3, të këtij neni, nga shoqëria administruese e fondit të investimeve përmban, për secilën klasë të kuotave që kërkohet të emetohen ose anulohen, sasinë e emetimit ose anulimit, e shprehur ose si numër kuotash ose si vlerë (ose të dyja bashkë).

#### Neni 108

#### **Oferta fillestare dhe përcaktimi i çmimit të kuotave ose aksioneve**

1. Periudha për ofertën fillestare të kuotave të fondit të investimeve me ofertë publike ose të aksioneve të shoqërisë së investimeve me ofertë publike nuk është më e gjatë se tridhjetë ditë dhe kryhet me një çmim fiks të caktuar nga shoqëria administruese. Gjatë kësaj periudhe kohore, shumat totale të aktiveve monetare të mbledhura duhet të mbahet si depozitë dhe nuk duhet të investohet derisa kapitali i siguruar nga sipërmarrja me ofertë publike të ketë tejkaluar vlerën minimale të aktiveve nën administrim, siç përcaktohet nga ky ligj dhe nga prospekti SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Aktivitetet monetare të mbledhura nuk investohen para kalimit të periudhës së ofertës fillestare, përveçse në formën e depozitës.

3. Çmimi i emetimit fillestar ose të parë të aksioneve të shoqërisë së investimeve me ofertë publike është çmimi nominal i çdo aksioni dhe bëhet i ditur në prospektin SIK. Çmimi i emetimit të mëpasshme të shoqërisë së investimeve me ofertë publike të regjistruar në një treg të rregulluar është i lidhur me çmimin e tregut të çdo aksioni të shoqërisë së investimeve, por kjo nuk cenon të drejtën e aksionarëve ekzistues për të marrë oferta për aksione shtesë, në përpjesëtim me aksionet e tyre aktuale në shoqëri.

4. Çmimi i emetimit fillestar ose të parë të aksioneve të shoqërisë së investimeve me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike duhet të jetë çmimi fiks i caktuar nga shoqëria administruese, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, dhe bëhet i ditur në prospektin SIK. Fondi i

investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur nuk kryen emetime të mëpasshme.

5. Çmimi i kuotës në ofertën fillestare ose ofertën e parë të fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale përcaktohet nga shoqëria administruese dhe pasqyrohet në prospektin SIK. Pas ofertës fillestare, çmimi i kuotës së fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, me përjashtim të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur që janë fonde të tregtuara në bursë duhet të jetë i barabartë me vlerën aktuale të vlerës neto të aktiveve për kuotë, plus një komision hyrjeje i llogaritur sipas parashikimeve të kreut V, seksionit 5, të këtij ligji.

## Neni 109

### **Çmimet e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve**

1. Shitja dhe shlyerja e kuotave të fondeve të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale kryhet vetëm në përputhje me këtë ligj dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe me vlerën neto të aktiveve për kuotë me përjashtim të faktit, që mund të shtohet një komision hyrjeje në momentin e nënshkrimit të kuotave dhe që mund të zbritet një komision daljeje nga vlera neto aktuale e aktiveve për kuotë në momentin e shlyerjes së kuotave. Nuk lejohet shitja ose shlyerja e kuotave të fondeve të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale me një çmim që nuk është vlera aktuale neto e aktiveve për kuotë.

2. Shoqëria administruese është përgjegjëse për llogaritjen e çmimit të shitjes dhe të shlyerjes së kuotave të fondeve të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, me përjashtim të çmimit të kuotave të fondeve të tregtuara në bursë, i cili vendoset në tregun e rregulluar, në të cilin regjistrohen dhe tregtohen kuotat.

3. Shitja dhe shlyerja e kuotave të fondeve të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, me përjashtim të fondeve me pjesëmarrje të hapur që janë fonde të tregtuara në bursë, kryhet me çmimin tjetër të llogaritur pas marrjes së një kërkesë të vlefshme për shlyerje të kuotave.

4. Çmimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotës së fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, me përjashtim të fondeve me pjesëmarrje të hapur që janë fonde të tregtuara në bursë, llogaritet duke pjesëtuar vlerën aktuale neto të aktiveve të fondit të llogaritur, sipas nenit 32, të këtij ligji, me numrin e kuotave në emetim të fondit në momentin e llogaritjes. Komisioni i hyrjes mund të shtohet ose komisioni i daljes mund të zbritet nga vlera aktuale neto e aktiveve për kuotë, në përputhje me informacionet e deklaruara në prospektin SIK.

5. Mbajtësi i kuotave të fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale mund t'i këmbjë kuotat e veta me kuota të një fondi tjetër të investimeve me pjesëmarrje të hapur. Çdo këmbim kuotash të mbajtura nga mbajtësi i kuotave në fondin e investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale nga shoqëria administruese kundrejt kuotave të një fondi tjetër investimesh me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur që administrohet nga e njëjta shoqëri administruese bëhet me çmimin tjetër të radhës, të llogaritur pas marrjes së një kërkesë të vlefshme për këmbim kuotash. Këtij çmimi mund t'i shtohet një komision hyrjeje, në përputhje me informacionet e deklaruara në prospektin SIK ose në vend të komisionit të hyrjes mund të mbahet një komision standard këmbimi, në përputhje me informacionet e deklaruara në prospektin SIK.

6. Nënshkrimi dhe shlyerja e kuotave në fondet e investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, me përjashtim të fondeve me pjesëmarrje të hapur që janë fonde të tregtuara në bursë, bëhet me aktive monetare, me përjashtim të rastit kur parashikohet në prospektin SIK të fondit të investimeve në fjalë, që shlyerja e kuotave bëhet

në natyrë për shlyerjet me vlerë të madhe.

7. Nënshkrimi dhe shlyerja e kuotave në fondet e tregtuara në bursë bëhet nëpërmjet këmbimit të një vlere portofoli me tituj të indeksuar kundrejt një vlere të barabartë kuotash të sipërmarrjes, që është fond i tregtuar në bursë. Vlera neto e aktiveve për kuotë e fondit me pjesëmarrje të hapur që është fond i tregtuar në bursë llogaritet nga shoqëria administruese, duke pjesëtuar vlerën aktuale neto të aktiveve të fondit të llogaritur, sipas parashikimeve të nenit 32, të këtij ligji, me numrin e kuotave në emetim të fondit në momentin e llogaritjes.

8. Autoriteti mund të lejojë që një fond i veçantë investimesh me pjesëmarrje të hapur ose me intervale ose një kategori fondesh investimesh me pjesëmarrje të hapur ose me intervale të kryejë të gjitha shlyerjet në natyrë, nëse shlyerja nuk mund të kryhet nëpërmjet mjeteve alternative.

## Neni 110

### **Komisionet e hyrjes dhe të daljes**

1. Përveç komisioneve të hyrjes dhe të daljes, investitorit nuk i ngarkohet asnjë tarifë apo kosto tjetër në momentin e nënshkrimit ose shlyerjes së kuotave në një fond investimi me ofertë publike.

2. Komisionet e hyrjes dhe të daljes bëhen të ditura veçmas nga çmimi i kuotave.

3. Shuma e komisioneve të hyrjes dhe të daljes që kërkohet të paguhet mund të ndryshojë në varësi të klasës së kuotave të emetuara në përputhje me informacionet e deklaruara në prospektin SIK.

4. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike mbyllet për shkak të mosarritjes së kapitalit minimal në ofertën fillestare ose në një ofertë të mëpasshme dhe likuidohet, nuk ngarkohet asnjë komision daljeje.

5. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike bashkohet ose transformohet nuk kërkohet asnjë komision hyrjeje ose daljeje.

6. Komisionet e hyrjes ose daljes janë të ndryshme nga shifra maksimale e deklaruar në prospektin SIK, vetëm në përputhje me një tarifë të publikuar standard, e cila shkallëzohet sipas shkallës së transaksionit të parashikuar në prospektin SIK.

Ndryshimi i komisioneve të hyrjes dhe daljes lejohet vetëm në përputhje me këtë pikë të këtij neni.

## Neni 111

### **Detyrimi për të shitur dhe shlyer kuotat**

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike shet dhe shlyen kuota çdo ditë pune.

2. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me intervale me ofertë publike shet dhe shlyen kuota, jo më pak se një herë çdo gjashtë muaj, në intervale të rregullta.

3. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike kryen shitjen e kuotave të fondit, në përputhje me kushtet e rregullave të fondit dhe prospektit SIK, nëse transaksioni nuk bie ndesh me këtë ligj ose me rregulloren apo prospektin SIK të fondit.

4. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike duhet, me kërkesë të çdo mbajtësi të kuotave të kryejë riblerjen dhe shlyerjen e kuotave të fondit, në përputhje me kushtet e rregullave të fondit dhe prospektit SIK, nëse

transaksioni nuk bie ndesh me këtë ligj ose me rregulloren apo prospektin SIK të fondit ose nëse nuk zbatohet neni 112 i këtij ligji.

#### Neni 112

### **Kufizimet mbi shitjen ose shlyerjen e kuotave**

1. Prospekti SIK mund të parashikojë që, nëse brenda një dite tregtimi bëhen kërkesa për shlyerje të kuotave, për më shumë se 10 % të vlerës ose numrit të kuotave në emetim të një fondi me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike, atëherë shlyerja e shumës a vlerës përtej këtij kufiri mund të shtyhet deri në pikën e ardhshme të vlerësimit.

2. Në rast se kërkesat për shlyerje të kuotave kalojnë kufirin e vendosur në një ditë tregtimi, shoqëria administruese garanton trajtim të njëjlojtë të të gjithë mbajtësve të kuotave, të cilët kërkojnë t'i shlyejnë kuotat në cilëndo pikë vlerësimi në të cilën shtyhet shlyerja e kuotave. Të gjitha tregtimet lidhur me një pikë vlerësimi të mëparshme kryhen përpara se të merren në konsideratë ato të cilat lidhen me një pikë vlerësimi të mëpasshme.

#### Neni 113

### **Çmimi i pasaktë i shitjes ose shlyerjes**

Në rastin e llogaritjes së pasaktë të çmimit të një kuote në një fond të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike me mbi 1 %, krahasuar me vlerën e llogaritur nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së përcaktuar në nenin 32, të këtij ligji, dhe aktit nënligjor, autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë administruese përgjegjëse për këtë llogaritje të pasaktë që të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

a) në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i ulët se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie, të kompensojë çdo mbajtës të kuotave për çdo diferencë në shumën e marrë nga kuotat e shlyera dhe të kompensojë fondin për çdo diferencë në shumën e arkëtuar për kuotat e shitura;

b) në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i lartë se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie, të kompensojë çdo mbajtës të kuotave që i blen kuotat nëpërmjet shpërndarjes së kuotave shtesë dhe të kompensojë fondin për çdo vlerë përtej çmimit të paguar për kuotat e shlyera.

#### Neni 114

### **Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes**

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike pezullon përkohësisht riblerjen ose shlyerjen e kuotave vetëm në përputhje me këtë nen.

2. Nëse shoqëria administruese pezullon shlyerjen e kuotave, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, në të njëjtën kohë duhet të pezullojë edhe shitjen e kuotave.

3. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike pezullon shlyerjen e kuotave kur, sipas gjykimit të shoqërisë administruese dhe depozitarit, kjo është e nevojshme për të mbrojtur interesat e mbajtësve të kuotave të fondit. Nëse shoqëria administruese vendos ta pezullojë emetimin dhe shlyerjen e kuotave dhe nëse depozitari nuk është dakord me këtë vendim, depozitari njofton menjëherë autoritetin.

4. Çdo pezullim i shitjes dhe shlyerjes së kuotave, sipas pikës 3, të këtij neni, i njoftohet menjëherë autoritetit nga shoqëria administruese, së bashku me një informacion orientues se kur do të rifillojë shlyerja. Informacioni për pezullimin e shlyerjes së kuotave publikohet menjëherë nga shoqëria administruese në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese. Autoriteti urdhëron shoqërinë administruese për ta rifilluar shitjen dhe shlyerjen e kuotave, nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave.

5. Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo përfundojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditëve pune nga pezullimi, me përjashtim të rastit kur autoriteti ka dhënë pëlqimin me shkrim për shtyrjen e këtij afati. Shoqëria administruese informon autoritetin menjëherë me të rifilluar shitjen dhe shlyerjen dhe rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave publikohet menjëherë nga shoqëria administruese në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

6. Ndalohet shitja dhe shlyerja e kuotave:

a) gjatë periudhës kur nuk ka shoqëri administruese ose depozitar;

b) kur shoqëria administruese ose depozitari vendoset në likuidim ose shpallet e falimentuar ose hyn në procedurë likuidimi ose është objekt i procedurave të ngjashme.

7. Autoriteti urdhëron shoqërinë administruese dhe depozitarin të pezullojë riblerjen dhe shlyerjen e kuotave të fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale me ofertë publike, nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave. Ky pezullim mund të jetë me afat të caktuar ose pa afat.

8. Urdhri i autoritetit, sipas pikës 7, të këtij neni, jepet me shkrim dhe përcakton periudhën e pezullimit ose që periudha e pezullimit është pa afat të caktuar dhe arsyet e pezullimit.

9. Autoriteti urdhëron shoqërinë administruese dhe depozitarin e një grupi të përcaktuar të fondeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike ose i të gjitha fondeve me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me ofertë publike të pezullojë shitjen dhe shlyerjen e kuotave, nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave ose në rastet e forcës madhore.

10. Rifillimi i shitjes dhe shlyerjes kryhet menjëherë sapo pushojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes. Në rast se rifillimi nuk është i mundur për ndonjë ose të gjitha fondet me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale me ofertë publike në fjalë, autoriteti kërkon ndryshimin e këtyre fondeve në fonde me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike ose që këto fonde të prishen dhe likuidohen.

## SEKSIONI 6

### REGJISTRIMI I PRONËSISË SË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 115

#### **Regjistri i pronësisë**

1. Regjistri i pronësisë së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përbën dëshmi përfundimtare të të drejtave të personave mbi aksionet ose kuotat e regjistruara në të.

2. Regjistri i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmban:

a) emrin dhe adresën e secilit mbajtës të aksioneve ose kuotave dhe, sipas rastit, numrin

personal të identifikimit ose numrin e dokumentit të barasvlershëm të huaj; dhe

b) numrin e kuotave të çdo klase që mban secili mbajtës i kuotave ose numrin e aksioneve që mban aksionari; dhe

c) datën kur është regjistruar mbajtësi i aksioneve ose i kuotave për aksionet ose kuotat e vendosura në emrin e tyre; dhe

ç) numrin e kuotave të çdo klase në qarkullim ose numrin e aksioneve në qarkullim.

3. Personat përgjegjës për regjistrin e pronarëve të pjesëmarrjeve në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike garantojnë që regjistri të jetë i plotë, i saktë dhe i përditësuar.

4. Aksionet ose kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike janë të dematerializuara dhe regjistri i tyre mbahet në formë elektronike.

Neni 116

### **Përgjegjësia për mbajtjen e regjistrit të pronësisë**

1. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me ofertë publike është personi përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të fondit, depozitari i fondit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistër, është në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Në rast se fondi i investimeve me ofertë publike është i listuar në një treg të rregulluar, depozitari mund të delegojë mbajtjen e regjistrit të një regjistruesi i licencuar, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon fushën e tregjeve të kapitalit, ose depozitarin qendror të titujve, siç kërkohet nga rregullat e këtij tregu.

Neni 117

### **Transferimi i kuotave të fondit të investimeve me ofertë publike**

1. Çdo pjesëmarrës në fondin e investimeve me ofertë publike ka të drejtë t'i transferojë kuotat e mbajtura në regjistër nëpërmjet një akti transferimi të pronësisë në çfarëdo formë që miratohet nga shoqëria administruese si person përgjegjës për regjistrin, por ky person nuk pranon dhe nuk kryen kalimin në fjalë nëse ai nuk lejohet nga ky ligj ose nga akti themelues i sipërmarrjes.

2. Çdo akt transferimi në lidhje me kuotat e një fondi të investimeve me ofertë publike nënshkruhet nga ose në emër të mbajtësit të kuotave që transferon kuotat (ose, në rastin e subjektit juridik, duhet të mbajë vulën e këtij subjekti ose të nënshkruhet nga një ose më shumë nëpunës të subjektit që kanë autorizimin përkatës për nënshkrim) dhe transferuesi trajtohet si pjesëmarrës deri në momentin kur emri i marrësit të jetë regjistruar në regjistër.

3. Çdo akt transferimi (me vulën përkatëse, sipas rastit) depozitohet për regjistrim pranë personit përgjegjës për regjistrin, shoqëruar me:

a) dokumentet e nevojshme që kërkon legjislacioni; dhe

b) çdo dëshmi tjetër që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga shoqëria administruese, e cila ia dërgon depozitarit të gjithë dokumentacionin.

### **Certifikata e blerjes së aksioneve dhe kuotave**

1. Certifikata e blerjes lëshohet nga shoqëria administruese me kërkesë të investitorëve brenda 7 ditëve nga data e marrjes së pagesës së bërë në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike.
2. Certifikata përfshin:
  - a) datën e blerjes së aksioneve ose kuotave;
  - b) emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese;
  - c) sipas rastit, klasën e kuotave të blera;
  - ç) numrin e kuotave ose aksioneve të blera;
  - d) çmimin e kuotave ose aksioneve të blera;
  - dh) vlerën totale të transaksionit;
  - e) emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave;
  - ë) vendin dhe datën e lëshimit të certifikatës;
  - f) nënshkrimin e personit të autorizuar të subjektit përgjegjës.
3. Arkëtimet nga shlyerja e kuotave të fondit me pjesëmarrje të hapur ose me interval me ofertë publike i dërgohen mbajtësit, brenda 7 ditëve kalendarike pas kryerjes së shlyerjes së kuotave. Shlyerja e kuotave bëhet pas marrjes së një urdhri të vlefshëm për shlyerje.

### **SEKSIONI 7**

#### **TARIFAT DHE KOSTOT E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

### **Kostot dhe tarifat**

1. Kostot dhe tarifat i ngarkohen sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, vetëm sipas parashikimeve të këtij ligji dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji, si më poshtë, lidhur me:
  - a) tarifën vjetore të administrimit, që i paguhet shoqërisë administruese;
  - b) tarifat dhe kostot që i paguhet depozitarit;
  - c) kostot e komisioneve ose komisionet lidhur me blerjen dhe shitjen e pasurive të sipërmarrjes dhe kostot ligjore, që shoqërojnë këto transaksione dhe pronësinë e këtyre pasurive;
  - ç) kostot e regjistrimit dhe shërbimit të mbajtësve të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes dhe kostoja e shpërndarjes së të ardhurave e mbajtësve të aksioneve ose kuotave;
  - d) kostot e auditimit vjetor;
  - dh) kostot e hartimit dhe shpërndarjes së raporteve dhe pasqyrave financiare vjetore dhe të ndërmjetme të investitorët e sipërmarrjes;
  - e) tarifat dhe kostot e vlerësuesit të pavarur lidhur me transferime në natyrë në sipërmarrjet me pjesëmarrje të mbyllur;
  - ë) kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospektin SIK;
  - f) tarifat e licencimit ose tarifa të tjera, që i paguhet autoritetit;
  - g) tatime të pagueshme nga sipërmarrja;
  - gj) në rastin e shoqërisë së investimeve, tarifat dhe shpenzimet e këshillit të administrimit.

2. Vetëm shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me interval merr komision (komision hyrje) nga investitorët në momentin e blerjes së kuotave. Në momentin e blerjes, vlerës neto të aktiveve i shtohet edhe komisioni i hyrjes.

3. Vetëm shoqëria administruese e fondit të investimeve me pjesëmarrje të hapur ose me interval me ofertë publike merr komision (komision dalje) nga investitorët në momentin e shlyerjes së kuotave. Në momentin e shlyerjes, vlerës neto të aktiveve për kuotë i zbritet komisioni i daljes.

4. Tarifat që lidhen me kthimet e investimeve të arritura të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike, nga shoqëria administruese ose nga një person tjetër i licencuar nuk lejohen.

5. Sipërmarrja me ofertë publike nuk paguan asnjë tarifë ose kosto nëse nuk është deklaruar qartë në prospektin SIK.

6. Sipërmarrja me ofertë publike nuk paguan asnjë tarifë ose kosto marketimi ose shitjeje, me përjashtim të rastit të shoqërisë së investimeve me ofertë publike në lidhje me ofertën fillestare, siç e lejon pika 3, e nenit 71.

7. Tarifa vjetore e administrimit, që i paguhet shoqërisë administruese pasqyrohet si përqindje e vlerës mesatare neto të aktiveve. Tarifa vjetore në përqindje, që paguhet për kuotë mund të ndryshojë vetëm sipas secilës klasë të kuotave në emetim dhe përcaktohet qartë në prospektin SIK.

8. Kostoja totale vjetore e shfrytëzimit e sipërmarrjes me ofertë publike nuk është më e madhe se 3,5 % e vlerës neto të aktiveve të sipërmarrjes.

9. Kostoja totale vjetore e shfrytëzimit (“tarifat e vazhdueshme”) të sipërmarrjes me ofertë publike llogaritet sipas rregullave të autoritetit dhe publikohet në dokumentin me informacione kryesore për investitorët. Kostoja totale vjetore llogaritet sipas kërkesave të shtojcës 2 të këtij ligji.

## SEKSIONI 8

### AUDITIMI, RAPORTET DHE PASQYRAT FINANCIARE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 120

#### **Auditimi**

1. Çdo sipërmarrje me ofertë publike cakton një auditues ligjor të pavarur, i cili miratohet nga autoriteti dhe e mban këtë detyrë gjatë gjithë vitit financiar. Kriteret për përzgjedhjen e audituesit ligjor të pavarur përcaktohen nga autoriteti në rregullore.

2. Audituesi ligjor është i regjistruar pranë regjistrat publik të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

3. Audituesi vepron si auditues i jashtëm i së njëjtës sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, jo më shumë se katër vjet radhazi.

4. Raporti i audituesit, përfshirë edhe kualifikimet e mundshme përfshihet i plotë në raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara të sipërmarrjes.

5. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, në zbatim të nenit 121, të këtij ligji, auditohet nga një auditues i pavarur që përmbush kërkesat e këtij neni.

6. Audituesi njofton me shkrim autoritetin menjëherë, nëse pas një shqyrtimi të fakteve që



disponon ose të rrethanave beson në mënyrë të arsyeshme se shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ka shkelur këtë ligj ose mund të ketë vepruar në kundërshtim me këtë ligj ose me aktin themelues të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të nënfondit.

7. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare, të parashikuara në pikën 5, të këtij neni, auditohen nga një auditues ligjor i pavarur që është i regjistruar në regjistrin publik të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

8. Auditimi, për qëllime të këtij ligji, konsiderohet me interes publik dhe çdo angazhim auditimi ligjor konsiderohet si angazhim auditimi ligjor i një njësie me interes publik dhe i nënshtrohet detyrimeve ligjore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

#### Neni 121

### **Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike**

1. Shoqëria administruese, për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike që administron, harton raportin vjetor dhe pasqyrat financiare në përputhje me standardet kontabël SNRF të pranuar ndërkombëtarisht, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij.

2. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare dorëzohen në autoritet brenda katër muajve pas mbylljes së vitit financiar dhe u vihen në dispozicion investitorëve pa pagesë, sipas kërkesës.

3. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare publikohen jo më vonë se katër muaj pas mbylljes së vitit financiar ose, në rastin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike të regjistruar në një treg të rregulluar, brenda një afati më të shkurtër nga fundi i vitit financiar, siç kërkohet për titujt që tregtohen në tregjet e rregulluara.

4. Raporti vjetor i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbajë:

- a) pasqyrat financiare vjetore dhe letrën për drejtimin;
- b) çdo ndryshim të rëndësishëm të sipërmarrjes gjatë periudhës së raportimit;
- c) informacione me rëndësi, që u japin mundësi investitorëve të bëjnë një gjykim të informuar për ecurinë e veprimtarive të sipërmarrjes dhe të rezultateve të saj;
- ç) raportin e audituesit, i cili duhet të përfshihet i plotë në raportin vjetor;
- d) vlerën e shpërblimit, e ndarë në shpërblim fiks dhe të ndryshueshëm, të paguara nga shoqëria administruese dhe shoqëria e investimeve punonjësve dhe numrin e përfituesve dhe, sipas rastit, çdo shumë të paguar drejtpërdrejt nga vetë sipërmarrja, përfshirë ndryshimet në politikën e shpërblimit, sipas rregullave të miratuara nga autoriteti;
- dh) informacionet e kërkuara sipas përcaktimeve të shtojcës 3 të këtij ligji.

#### Neni 122

### **Raporti dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme**

1. Shoqëria administruese, për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike që administron, harton raport të ndërmjetëm dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

2. Raporti dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme i dorëzohen autoritetit brenda dy muajve pas mbylljes së gjashtëmujorit të parë të vitit financiar dhe u vihen në dispozicion investitorëve pa pagesë sipas kërkesës.

3. Raporti i ndërmjetëm dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme publikohen jo më vonë se dy muaj pas mbylljes së gjashtëmujorit të parë të vitit financiar ose, në rastin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike të regjistruar në një treg të rregulluar, brenda një afati më të shkurtër nga fundi i vitit financiar, siç kërkohet për titujt që tregtohen në tregjet e rregulluara.

4. Raporti dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme përfshijnë informacionet e parashikuara në seksionet I deri në IV, të shtojcës 3, të këtij ligji, të cilat nuk auditohen. Kur sipërmarrja ka paguar ose propozon të paguajë dividend të ndërmjetëm, shifrat pasqyrojnë gjithashtu edhe rezultatet pas tatimit për gjashtëmujorin në fjalë dhe dividendin e ndërmjetëm të paguar ose të propozuar.

## SEKSIONI 9

### INFORMIMI I INVESTITORËVE

#### Neni 123

#### **Informimi i detyrueshëm**

1. Dhënia e detyrueshme e informacioneve në bazë të këtij neni bëhet në gjuhën shqipe, përveç rastit ku parashikohet nga rregullat e miratuara nga autoriteti.

2. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike vendos në dispozicion prospektin aktual SIK, dokumentin me informacione kryesore për investitorin dhe raportet më të fundit vjetore dhe të ndërmjetme dhe pasqyrat financiare, sipas kërkesës dhe pa pagesë për secilën sipërmarrje të veçantë të investimeve kolektive me ofertë publike dhe për secilin nënfond të sipërmarrjes ombrellë të investimeve kolektive me ofertë publike që ka në administrim.

3. Prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin, në lidhje me çdo sipërmarrje të veçantë të investimeve kolektive me ofertë publike dhe çdo nënfond i vihet në dispozicion investitorit pa pagesë, në formë të shtypur në letër përpara nënshkrimit të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të nënfondit dhe, sipas kërkesës, i mundësohet edhe në format elektronik nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi. Prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin i përditësuar i çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale me ofertë publike dhe i çdo nënfondi gjithashtu vendoset për t'u shkarkuar edhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

4. Shoqëria administruese mundëson raportet vjetore dhe pasqyrat financiare më të fundit, sipas mënyrës së parashikuar në prospektin SIK dhe në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin dhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Një kopje në letër e raporteve u dorëzohet pa pagesë investitorëve, sipas kërkesës, ndërsa një kopje elektronike nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi mundësohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

5. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe çdo person juridik, që vepron si agjent shitjeje, në zbatim të nenit 102, të këtij ligji, vendos në dispozicion të investitorëve prospektin SIK dhe dokumentin aktual me informacionin kryesor për investitorin për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij neni, përpara nënshkrimit të aksioneve ose kuotave. Shoqëria administruese mundëson pa pagesë prospektin SIK dhe dokumentin me informacionin kryesor për investitorin

për çdo sipërmarrje të veçantë të investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondi, çdo personi që shet ose ofron këshilla në lidhje me investimin në sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike ose të cilët janë furnizues të produkteve, që përfshijnë fonde të investimeve kolektive me ofertë publike, sipas kërkesës.

6. Shoqëria administruese publikon, përkatësisht çdo ditë, çmimin e emetimit të shitjes dhe të shlyerjes së kuotave të secilit fond të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike ose nënfond që administron, sa herë që i emeton, shet, riblen ose shlyen këto kuota, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti.

7. Shoqëria administruese publikon përkatësisht të paktën dy herë në vit çmimin e emetimit, të shitjes dhe të shlyerjes së kuotave të secilit fond të investimeve me intervale me ofertë publike ose nënfond që administron sa herë që emeton, shet, riblen ose shlyen këto kuota, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti.

8. Shoqëria administruese publikon përkatësisht të patën një herë në vit, me intervale të rregullta, vlerën neto të aktiveve për kuotë ose aksion të secilës sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike që administron sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti.

9. Shoqëria administruese u mundëson investitorëve të saj, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti, një pasqyrë vjetore të aksioneve ose kuotave të mbajtura në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike nën administrimin e saj, ku paraqitet pozicioni në hapje dhe pozicioni në mbyllje, lidhur me pjesëmarrjet e investitorëve dhe ndryshimet e këtyre pjesëmarrjeve dhe çdo shpërndarje të të ardhurave gjatë periudhës në fjalë.

## KREU VI

### VEPRIMTARIA E FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE

#### SEKSIONI 1

#### TRANSPARENCA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE

#### Neni 124

#### **Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare të fondit të investimeve alternative**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative harton, për çdo fond që administron ose marketon, raportin vjetor dhe pasqyrat financiare, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të vendit të origjinës të fondit të investimeve alternative.

2. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare i dorëzohen autoritetit dhe autoritetit të huaj rregullator në vendin e origjinës të fondit të investimeve alternative dhe u vihen në dispozicion investitorëve pa pagesë, sipas kërkesës.

3. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare publikohen jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të vitit financiar ose, në rastin e fondit të investimeve alternative që licencohet për ofertë publike, brenda një afati më të shkurtër nga fundi i vitit financiar, sipas parashikimeve të këtij ligji ose në rastin e fondit të investimeve alternative të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, brenda një afati më të shkurtër nga fundi i vitit financiar, siç kërkohet për titujt e pranuar për tregtim në bursë.

4. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare të fondit të investimeve alternative përmbajnë:

a) pasqyrat financiare vjetore dhe letrën për drejtimin të audituara nga një auditues i

jashtëm, që plotëson kushtet e legjislacionit në fuqi;

b) çdo ndryshim të rëndësishëm të informacioneve të njoftuara, në bazë të nenit 125 të këtij ligji.

5. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative paraqet një analizë të hollësishme të shpërblimeve, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti, të cilat u janë paguar punonjësve të saj gjatë vitit financiar dhe interesin e mbartur që ka paguar fondi i investimeve alternative dhe shumën totale të shpërblimit që u është paguar kategorive të punonjësve të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative.

6. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative që administron një fond të investimeve alternative, i cili ka fituar kontroll sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 128, të këtij ligji, garanton që në raportin vjetor të fondit të investimeve alternative ose të shoqërisë përkatëse, të përfshihen informacionet e mëposhtme:

- a) përshkrimi i veprimtarisë së shoqërisë përkatëse në vitin financiar;
- b) përshkrimi i zhvillimit të mundshëm të shoqërisë përkatëse në të ardhmen;
- c) ngjarjet e rëndësishme që nga fundi i vitit financiar;
- ç) informacione për blerjen e aksioneve të veta nga shoqëria e kontrolluar.

7. Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, auditohen nga një auditues ligjor i pavarur, që është i regjistruar në regjistrin publik të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

## Neni 125

### **Kërkesat për informim përpara investimit**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative, për çdo fond të investimeve alternative që administron ose marketon, u mundëson investitorëve të mundshëm informacionet e mëposhtme përpara se këta të investojnë në fondin e investimeve alternative në fjalë:

a) dokumentin themelues të fondit të investimeve alternative, objektivin dhe strategjinë e investimit të fondit të investimeve alternative, në cilat lloje të aktiveve mund të investojë fondi i investimeve alternative, teknikat e investimeve që mund të përdoren, profilin e riskut, ndonjë kufizim të zbatueshëm mbi investimet dhe informacionin për përdorimin e levës financiare;

b) përshkrimin e procedurës për ndryshimin e strategjisë së investimeve;

c) nëse fondi i investimeve alternative është fond furnizues dhe, nëse po, ku është vendosur fondi kryesor, së bashku me informacionin se ku janë vendosur fondet bazë, nëse fondi i investimeve alternative është fond i fondeve;

ç) pasojat kryesore ligjore të investimit në fondin e investimeve alternative, përfshirë informacionin për vendin ku është i vendosur fondi dhe nëse ekzistojnë marrëveshje që parashikojnë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të vendit të origjinës të fondit të investimeve alternative;

d) të dhëna mbi shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesin e fondeve të investimeve alternative dhe depozitarin, audituesit dhe çdo ofrues tjetër shërbimi të fondit të investimeve alternative dhe një përshkrim të detyrave të tyre dhe të drejtave të investitorëve;

dh) sigurimin e përgjegjësisë profesionale (nëse ka) ose fondet e veta shtesë të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, lidhur me pikën 6, të nenit 13, të këtij ligji, ose kërkesa të barasvlershme lidhur me administruesin e njohur të fondeve të investimeve alternative;

e) përshkrimin e delegimit të funksioneve të përcaktuara në pikën 5, të nenit 11, të këtij ligji, ose të funksioneve të depozitarit, në bazë të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, të dhëna mbi subjekte deleguese dhe konfliktet e interesit që mund të lindin nga ky delegim;

ë) procedurat e administrimit të likuiditetit, sipas nenit 28, të këtij ligji dhe sipas akteve rregullatore të këtij ligji;

f) procedurat e vlerësimit, sipas nenit 29 të këtij ligji dhe sipas akteve rregullatore të këtij ligji;

g) shpenzimet dhe vlerat maksimale të këtyre shpenzimeve, të cilat mbulohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga investitorët;

gj) parimet e trajtimit të barabartë të investitorëve dhe një përshkrim të trajtimit preferencial, nëse ka, përfshirë llojin e investitorëve që e përfitojnë trajtimin preferencial dhe, sipas rastit, lidhjet pronësore ose lidhjet me subjektet e lidhura me fondin e investimeve alternative dhe/ose shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesin e njohur të fondeve të investimeve alternative;

h) raportin e fundit vjetor dhe pasqyrat financiare;

i) procedurën dhe kushtet e emetimit, anulimit, shitjes dhe shlyerjes së kuotave ose aksioneve dhe çdo marrëveshje shlyerjeje me investitorët;

j) vlerën neto të aktiveve për pjesëmarrje të fondit të investimeve alternative, të llogaritur në bazë të nenit 32, të këtij ligji, ose çmimin më të fundit të tregut të pjesëmarrjes të fondit të investimeve alternative me ofertë publike, që tregohet në një treg të rregulluar;

k) fitimin historik të fondit të investimeve alternative;

l) mënyrën dhe kohën se kur bëhen të ditura informacionet, sipas kërkesave të nenit 124 të këtij ligji.

2. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative informon investitorët e fondit të investimeve alternative për çdo ndryshim të rëndësishëm të informacioneve, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative informon investitorët, përpara se të investojnë në një fond të investimeve alternative lidhur me çdo organizim që ka depozitari për të shkarkuar çdo përgjegjësi kontraktuale, sipas nenit 46, të këtij ligji, dhe informon menjëherë investitorët për çdo ndryshim në lidhje me përgjegjësinë e depozitarit.

4. Nëse fondit të investimeve alternative i duhet të publikojë një prospekt SIK, në bazë të këtij ligji, administruesi i fondeve të investimeve alternative mund ta kufizojë informacionin sipas pikës 1, të këtij neni, duke vënë në dispozicion vetëm ato informacione që nuk janë përfshirë në prospekt.

## Neni 126

### **Kërkesa për dhënie periodike të informacioneve**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative u mundëson investitorëve, të paktën një herë në vit, me intervale të rregullta, informacionet e mëposhtme për fondet e investimeve alternative:

a) përqindjen e aktiveve të fondit të investimeve alternative, që janë objekt i masave të posaçme për shkak të natyrës jolikuide të tyre;

b) çdo ndryshim të sistemeve për administrimin e likuiditetit të fondit të investimeve alternative;

c) profilin aktual të riskut të fondit të investimeve alternative dhe sistemet e administrimit të risqeve të përdorura nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose

administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative.

2. Në rastin e fondeve të investimeve alternative, që janë në gjendje të përdorin levën financiare, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative duhet të vendosë në dispozicion të investitorëve edhe informacionin për çdo ndryshim të nivelit maksimal të levës financiare, si dhe për çdo të drejtë të ripërdorimit të kolateralit ose garancisë së vënë në dispozicion, në funksion të levës financiare dhe shumën, gjithsej, të levës financiare të përdorur nga fondi i investimeve alternative.

#### Neni 127

### **Leva financiare**

1. Në rastin e fondit të investimeve alternative akti themelues i të cilit lejon përdorimin e levës financiare, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative cakton nivelin maksimal të levës financiare, si dhe shkallën e së drejtës për ta ripërdorur kolateralin ose garancinë që mund të jepej në kuadër të marrëveshjes së levës financiare.

2. Në zbatim të pikës 1, të këtij neni, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative mban parasysh, mes të tjerash:

- a) llojin e fondit të investimeve alternative;
- b) objektivin dhe strategjinë e investimit të fondit të investimeve alternative;
- c) burimet e levës financiare të fondit të investimeve alternative;
- ç) çdo ndërlidhje tjetër me institucione të tjera financiare, të cilat mund të përbënin risk sistemik;
- d) nevojën për ta kufizuar ekspozimin ndaj çdo pale;
- dh) shkallën e mbulimit me kolateral të levës financiare;
- e) raportin aktiv mbi atë pasiv; dhe
- ë) ndikimin që ka veprimtaria e fondit të investimeve alternative mbi tregun përkatës;
- f) shkallën dhe natyrën e ndikimit që ka te tregu përkatës veprimtaria e fondit të investimeve alternative.

3. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative vërteton se kufizimet e levës financiare që ka vendosur për çdo fond të investimeve alternative që administron janë të arsyeshme dhe se i zbaton gjithmonë këto kufizime.

4. Autoriteti analizon risqet që vijnë nga përdorimi i levës financiare nga fondet e investimeve alternative. Autoriteti vendos kufizime mbi administrimin e fondeve të investimeve alternative, nëse gjykon se kërcënohet stabiliteti dhe integriteti i sistemit financiar, përfshirë edhe kufizime mbi nivelin e levës financiare që mund të përdorë shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative në lidhje me fondet e investimeve alternative që administron.

#### Neni 128

### **Marrja e kontrollit të shoqërive ose emetuesve të palistuar në bursë**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative informon autoritetin, shoqërinë përkatëse dhe aksionarët e

shoqërisë përkatëse, nëse fondi i investimeve alternative që administrohet prej tyre, veçmas ose në bashkëpunim me fonde të tjera të investimeve alternative, merr kontrollin e një emetuesi aksionesh të palistuara në një treg të rregulluar. Në kuptim të kësaj pike, “kontrolli” mbi emetuesin është pronësia e aksioneve që përbëjnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 50 % të votave të shoqërisë.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshin të dhëna mbi shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative ose administruesit të njohur të fondeve të investimeve alternative, politikën për parandalimin dhe administrimin e konfliktit të interesit, informacionin për financimin e blerjes dhe strategjinë për komunikim të jashtëm dhe të brendshëm.

3. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet jo më vonë se 10 ditë pune, pas marrjes së kontrollit nga fondi i investimeve alternative dhe, gjithashtu, përfshin edhe informacionin lidhur me të drejtat e votimit, datën dhe kushtet e kontrollit, të dhëna mbi aksionarët e përfshirë dhe personat që kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e votës në emër të tyre.

4. Pas marrjes së kontrollit, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative informon shoqërinë përkatëse dhe aksionarët e shoqërisë përkatëse lidhur me planet strategjike dhe pasojat e mundshme për punonjësit e kësaj shoqërie. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative i kërkon këshillit të administrimit të shoqërisë përkatëse të informojë punonjësit.

Neni 129

### **Raportimi i marrjes nën kontroll të pjesëmarrjeve influencuese në shoqëri të palistuara**

Nëse pjesëmarrja e fondit të investimeve alternative, në një shoqëri të palistuar në një treg të rregulluar, në bazë të pikës 1, të nenit 128, të këtij ligji, tejkalon ose bie nën kufirin 10 %, 20 %, 30 %, 50 % dhe 75 % të të drejtave të votës të shoqërisë, shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative ose administruesi i njohur i fondeve të investimeve alternative informon menjëherë dhe jo më vonë se 10 ditë pune, shoqërinë, aksionarët e shoqërisë dhe autoritetin.

## SEKSIONI 2

### MARKETIMI I FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE TE KLIENTËT PROFESIONISTË DHE TË KUALIFIKUAR

Neni 130

### **Marketimi i fondeve të investimeve alternative të themeluara nga shoqëri administruese të fondeve të investimeve alternative shqiptare te klientët profesionistë dhe të kualifikuar**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative, e licencuar në Republikën e Shqipërisë, në bazë të këtij ligji regjistron pranë autoritetit fondet e investimeve alternative, që administron brenda dhe jashtë vendit përpara marketimit të klientët profesionistë dhe të kualifikuar, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Kërkesa për regjistrim përmban:

a) programin e veprimtarisë, ku identifikohet fondi i investimeve alternative dhe përcaktohet vendi në të cilin është vendosur fondi i investimeve alternative;

b) informacione për fondin e investimeve alternative, që u janë vënë në dispozicion investitorëve të fondit të investimeve alternative, përfshirë informacionet e parashikuara në nenin 126 të këtij ligji;

c) pasqyrën e masave, që kanë për qëllim të parandalojnë që fondi i investimeve alternative t'u ofrohet klientëve joprofesionistë dhe të kualifikuar edhe në rastet kur oferta kryhet nëpërmjet një shpërndarësi.

2. Brenda një muaji, pas marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin e plotë, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, autoriteti informon me shkrim shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative për fillimin e marketimit të fondit të investimeve alternative.

3. Marketimi në Republikën e Shqipërisë nuk lejohet vetëm nëse administrimi i fondit të investimeve alternative nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative nuk kryhet në përputhje me këtë ligj ose kur vetë shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative nuk vepron në përputhje me këtë ligj. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative fillon marketimin e fondit të investimeve alternative, duke filluar nga data e njoftimit me shkrim nga ana e autoritetit.

4. Nëse fondi i investimeve alternative është i themeluar jashtë Republikës së Shqipërisë, autoriteti informon edhe autoritetin e huaj rregullator të vendit të origjinës të fondit të investimeve alternative, se fondi i investimeve alternative mund të marketohet në Republikën e Shqipërisë.

5. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative informon me shkrim autoritetin nëse ndodh ndonjë ndryshim i rëndësishëm i të dhënave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Informacionet jepen të paktën tre muaj përpara implementimit të ndryshimit ose menjëherë pas një ndryshimi të paplanifikuar. Nëse pas ndryshimit të planifikuar, administrimi i fondit të investimeve alternative nga shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative nuk do të ishte më në përputhje me këtë ligj, autoriteti merr të gjitha masat e duhura, në bazë të seksionit 5, të kreut XII, të këtij ligji, përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin e marketimit të fondit të investimeve alternative.

#### Neni 131

### **Marketimi i fondeve të investimeve alternative te klientët profesionistë dhe të kualifikuar jashtë Republikës së Shqipërisë**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative, e licencuar në bazë të këtij ligji, regjistron pranë autoritetit fondin e investimeve alternative, që administron në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër përpara se të fillojë marketimin te klientët profesionistë dhe të kualifikuar jashtë Republikës së Shqipërisë.

2. Njoftimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet në gjuhën shqipe dhe përmban informacionet e parashikuara në pikën 1, të nenit 130, të këtij ligji. Njoftimi përcakton gjithashtu se në cilin vend tjetër do të marketohet fondi i investimeve alternative dhe se si do të marketohet fondi i investimeve alternative.

3. Autoriteti u përcjell njoftimin autoriteteve të huaja rregullatore të vendeve, ku do të marketohet fondi i investimeve alternative, brenda një muaji pas marrjes së kërkesës me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 1, të këtij neni. Autoriteti i bashkëlidh këtij njoftimi konfirmimin se shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative është e licencuar të administrojë fonde të investimeve alternative, në përputhje me strategjinë e investimit të fondit të investimeve alternative në fjalë. Ky njoftim përcillet vetëm nëse veprimtaria e shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative dhe administrimi i fondit të



investimeve alternative është në përputhje me këtë ligj. Autoriteti informon me shkrim shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative për transmetimin e njoftimit në fjalë. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative fillon marketimin e fondit të investimeve alternative pas marrjes së njoftimit. Nëse fondi i investimeve alternative është i vendosur në një tjetër vend, autoriteti informon edhe autoritetin e huaj rregullator të vendit të origjinës të fondit të investimeve alternative lidhur me regjistrimin e marketimit.

4. Dispozitat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 130, të këtij ligji zbatohen edhe për këtë nen.

5. Autoriteti nuk regjistron fondin e investimeve alternative për të vepruar jashtë Republikës së Shqipërisë, nëse nuk ekzistojnë marrëveshjet e duhura për bashkëpunimin mbikëqyrës midis autoritetit dhe autoriteteve të huaja rregullatore përkatëse.

## Neni 132

### **Kushtet për regjistrimin e fondeve të investimeve alternative të huaja**

1. Regjistrimi i fondit të investimeve alternative të administruar nga një administrues i huaj i fondeve të investimeve alternative miratohet nga autoriteti, vetëm nëse:

a) administruesi i fondeve të investimeve alternative është në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji;

b) administruesi i fondeve të investimeve alternative ndërmerr hapat e nevojshëm për të kryer pagesat e investitorëve në Republikën e Shqipërisë, për të shlyer pjesëmarrjet dhe për të mundësuar informacionet që administruesi i fondeve të investimeve alternative duhet të hartojë, sipas rregullave të vendit të tij të origjinës;

c) vendi i origjinës i fondit të investimeve alternative nuk është i përfshirë në listën e vendeve jobashkëpunuese nga në përputhje me dispozitat e seksionit 3, të këtij kreu, dhe me parashikimet e nxjerra në bazë të tij;

dh) janë përmbushur kërkesat e shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

2. Autoriteti mund të miratojë rregulla të mëtejshme për vendosjen e kushteve të regjistrimit, në bazë të pikës 1, të këtij neni, për të garantuar mbrojtjen e investitorëve në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe kushtet që vendosin detyrimin për informim të investitorëve dhe autoriteteve publike dhe lidhur me mënyrën si duhet të Task Forca e Veprimit Financiar për Pastrimin e Parave (FATF-ML);

ç) fondi i investimeve alternative dhe administruesi i fondit të investimeve alternative janë objekt i një mbikëqyrjeje të duhur në vendin e origjinës dhe i përmbushin kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në vendin e origjinës;

d) administruesi i fondeve të investimeve alternative është kryhet shitja e pjesëmarrjeve në Republikën e Shqipërisë.

## SEKSIONI 3

### MARKETIMI I FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE TE KLIENTËT JOPROFESIONISTË

Neni 133

#### **Marketimi te klientët joprofesionistë**

Marketimi i fondeve të investimeve alternative të administruara nga shoqëri administruese të fondeve të investimeve alternative të licencuara, në bazë të këtij ligji dhe nga administrues të fondeve të investimeve alternative të licencuar në bazë të ligjit të një vendi tjetër te klientë joprofesionistë në Republikën e Shqipërisë kryhet vetëm sipas kushteve të seksionit 3, të kreut V, të këtij ligji.

## SEKSIONI 4

### ADMINISTRIMI NDËRKUFITAR I FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE

Neni 134

#### **Veprimtaria e shoqërive vendase administruese të fondeve të investimeve alternative në vende të tjera**

1. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative, e licencuar sipas këtij ligji, që kërkon të administrojë një fond të investimeve alternative ose të ofrojë shërbime, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 6, të nenit 11, të këtij ligji, në një vend tjetër ose nga Republika e Shqipërisë ose nëpërmjet vendosjes së një dege, njofton për këtë me shkrim autoritetin.

2. Njoftimi përmban programin e operacioneve, ku përcaktohen shërbimet që synon të ofrojë shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative dhe vendi ku do të ushtrojë veprimtari dhe fondet e investimeve alternative që kërkon të administrojë.

3. Njoftimi, përveç përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni, përmban edhe informacionet e mëposhtme:

a) strukturën organizative të degës;

b) adresën në vendin e origjinës të fondit të investimeve alternative nga mundësohet dokumentacioni zyrtar;

c) emrin dhe të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës për administrimin e degës.

4. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni dhe konfirmimi i autoritetit, sipas pikës 5, po të këtij neni, bëhen në gjuhën e zakonshme të sferës së financave ndërkombëtare.

5. Brenda një muaji pas marrjes së njoftimit, së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 1, të këtij neni, autoriteti njofton autoritetin rregullator të vendit të përcaktuar në njoftim. Autoriteti i bashkëlidh këtij njoftimi konfirmimin se shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative është e licencuar të kryejë veprimtari në përputhje me këtë ligj. Autoriteti informon menjëherë me shkrim shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative për përcjelljen e njoftimit në fjalë. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative fillon ofrimin e shërbimeve pas marrjes së njoftimit nga autoriteti.

6. Shoqëria administruese e fondeve të investimeve alternative njofton me shkrim autoritetin për ndryshimin e çdo informacioni të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, të paktën një muaj përpara implementimit të ndryshimit ose menjëherë pasi ka ndodhur një

ndryshim i paplanifikuar. Nëse ndryshimi cenon përputhshmërinë e shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative me dispozitat e këtij ligji, autoriteti menjëherë informon për këtë ndryshim autoritetin e vendit pritës të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative.

Neni 135

### **Veprimtaria në Republikën e Shqipërisë e administruesve të fondeve të investimeve alternative të huaja**

Administruesi i fondeve të investimeve alternative, i licencuar nga një autoritet i huaj rregullator për të administruar fonde të investimeve alternative apo për të ofruar shërbime, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 6, të nenit 11, të këtij ligji, njihet nga autoriteti në Republikën e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e përmendura në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 6, të nenit 11, të këtij ligji, duke filluar që nga momenti kur autoriteti i huaj rregullator i vendit të origjinës të administruesit të investimeve alternative njofton administruesin e fondeve të investimeve alternative se njoftimi për veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë i është dërguar autoritetit.

Neni 136

### **Kushtet për marketimin dhe administrimin ndërkufitar të fondeve të investimeve alternative**

Marketimi dhe administrimi ndërkufitar i fondeve të investimeve alternative lejohet vetëm nëse janë në zbatim marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve rregullatore të vendit të origjinës ose vendit pritës të fondit të investimeve alternative dhe autoritetit, si dhe të vendit të origjinës ose vendit pritës të administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe autoritetit dhe nëse administruesi i fondeve të investimeve alternative është në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

## **KREU VII**

### **INVESTIMET DHE HUAMARRJA E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

#### **SEKSIONI 1**

### **KUFIZIMET E PËRGJITHSHME MBI INVESTIMET DHE HUAMARRJEN E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

Neni 137

### **Kërkesat e përgjithshme për investimet dhe huamarrjen**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon dhe merr hua brenda limiteve të parashikuara nga ky ligj dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

2. Sipërmarrja furnizuese e investimeve kolektive me ofertë publike investon dhe merr hua vetëm në përputhje me nenin 144 të këtij kreu.

3. Huamarrja e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose e shoqërisë administruese në emër të sipërmarrjes kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji. Përqindja maksimale e vlerës së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, që mund të merret hua është 20 %, lidhur me sipërmarrjen me pjesëmarrje të mbyllur, dhe 10 %, lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, që është fond me pjesëmarrje të hapur ose me intervale.

4. Sipërmarrja me ofertë publike nuk jep hua përveçse përmes investimit në obligacione ose instrumente të tregut të parasë ose përmes vendosjes së depozitave. Dhënia e huave dhe/ose veprimi si dorëzanës në emër të palëve të treta nga ana e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale nuk lejohet as nga sipërmarrja me pjesëmarrje të hapur ose me intervale dhe as nga shoqëria administruese, ose depozitari që vepron në emër të sipërmarrjes me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale.

5. Sipërmarrja me ofertë publike nuk investon në pjesëmarrje të një sipërmarrjeje tjetër të investimeve kolektive ose në një nënfond të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive, përveç rasteve të lejuara nga ky ligj dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji. Nënfondi i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike nuk investon në një nënfond tjetër të së njëjtës sipërmarrje të investimeve kolektive.

6. Shoqëria administruese nuk kryen shitjen e asnjë investimi në emër të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike që nuk është në pronësi të sipërmarrjes në momentin e miratimit të transaksionit.

7. Kufizimet mbi investimet dhe huamarrjen, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji, zbatohen për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike në çdo moment, por ato nuk zbatohen gjatë periudhës së ofertës fillestare të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe zbatohen në rastin e sipërmarrjeve furnizuese ose nënfondeve, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni.

8. Kufizimet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 9, të këtij neni, nuk zbatohen për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike në gjashtë muajt e parë pas marrjes së licencës, duke filluar nga dita e parë e periudhës së ofertës fillestare me çmim të pandryshueshëm, me kusht që shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të kryejë një shpërndarjeje të matur të riskut. Sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, që investojnë në bazë të nenit 143, të këtij ligji, u nënshtrohen kufizimeve të ndryshme nga sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive me ofertë publike, në bazë të shkronjës “b”, të pikës 9, të këtij neni.

9. Autoriteti miraton rregulla më të hollësishme lidhur me:

a) llojet e aktiveve ku mund të investojnë sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike;

b) përqindjen e vlerës së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, që mund të investohet në aktive të çfarëdo lloji ose kategorie;

c) natyrën e transaksioneve që mund të kryejnë sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike;

ç) kriteret e pranimit të klasave të aktiveve dhe klasave individuale, ku mund të investojnë sipërmarrjet e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur, me intervale dhe pjesëmarrje të mbyllur;

d) kriteret e pranimit të tregjeve, ku mund të investojnë sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të indekseve të tregjeve;

dh) ekspozimin maksimal të çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike ndaj një emetuesi, një grupi emetuesish, një banke ose një sipërmarrjeje të investimeve kolektive me ofertë publike;

e) përqendrimin maksimal të pronësisë/influencës mbi një emetues, që i lejohe sipërmarrjes ose të gjitha sipërmarrjeve të administruara ose të influencuara nga e njëjta ose të njëjtat shoqëri administruese me lidhje pronësie ose që janë subjekt i lidhur;

ë) transaksionet me personat me të cilët sipërmarrja e investimeve kolektive ka lidhje pronësie ose transaksionet me sipërmarrjet e investimeve kolektive ose grupimet e tjera të aktiveve të administruara nga e njëjta shoqëri administruese, si dhe për transaksionet e kryera nëpërmjet personave, me të cilët shoqëria administruese ka lidhje pronësie ose të cilët janë subjekte të lidhura;

f) përdorimin e lejuar të derivativëve dhe kontratave private të së ardhmes (*forward*); vetëm në funksion të zvogëlimit të riskut ose zvogëlimit të kostove dhe kërkesat për lejimin e investimit në derivativë dhe kontrata private të së ardhmes (*forward*);

g) kërkesat për nivelin minimal të likuiditetit të aktiveve, që mbajnë sipërmarrjet e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale, përkufizimet e aktiveve likuide dhe aktiveve likuide të cilësisë së lartë dhe përqindjen minimale të detyrueshme të aktiveve likuide dhe aktiveve likuide të cilësisë së lartë;

gj) raportimin në autoritet mbi investimet dhe huamarrjet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

10. Autoriteti miraton rregulla mbi kufizimet në lidhje me huamarrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, sipas pikës 3, të këtij neni, përfshirë:

a) përqindjen maksimale të vlerës së aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive që mund të merret hua;

b) mënyrën, natyrën dhe kushtet e lejuara të huamarrjes;

c) kërkesat lidhur me statusin dhe pranueshmërinë e huadhënësve.

11. Nëse kufizimet e përcaktuara me rregullore, në zbatim të pikave 9 dhe 10, të këtij neni, të çdo lloji kategorie të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike tejkalohe pa dashje për arsye jashtë kontrollit të shoqërisë administruese ose si pasojë e ushtrimit të të drejtave të nënshkrimit, tejkalimi duhet të eliminohet brenda gjashtë muajve, duke mbajtur në konsideratë interesat e mbajtësve të aksioneve ose kuotave, me përjashtim të rastit kur shpallet forcë madhore nga autoriteti, sipas rregullave të miratuara nga ai.

12. Nëse kufizimet e përcaktuara me rregullore, në zbatim të pikave 9 dhe 10, të këtij neni, për çdo lloji kategorie të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të përcaktuara me akt nënligjor tejkalohe me qëllim, për arsye nën kontroll të shoqërisë administruese, tejkalimi duhet të eliminohet sa më shpejt, me shpenzimet e shoqërisë administruese. Depozitari i raporton çdo shkelje autoritetit, së bashku me planin e shoqërisë administruese për ta korrigjuar shkeljen dhe i raporton menjëherë autoritetit nëse shoqëria administruese nuk e ka korrigjuar shkeljen, siç parashikohet në këtë plan.

13. Në përjashtim të përcaktimeve të këtij kreu, autoriteti, nëse e gjykon të nevojshme, pezullon me vendim zbatimin e kufizimeve të veçanta me afat të caktuar ose të pacaktuar, kur lëndin rrethana që janë jashtë kontrollit të shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe të autoritetit, të cilat e bëjnë praktikisht të pamundur respektimin e kufizimit. Njoftimi i një pezullimi të tillë dhe përfundimi i tij publikohet në faqen në internet të autoritetit.

## SEKSIONI 2

### KUFIZIMET MBI INVESTIMET DHE HUAMARRJEN E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Neni 138

#### **Dispozita të përgjithshme**

Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon, merr dhe jep hua, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga ky seksion dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

Neni 139

#### **Investimet e lejuara**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon në:

a) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar ose të tregtuara në një treg të rregulluar të licencuar, të njohur ose të miratuar nga autoriteti me aktet rregullatore, si edhe tituj të emetuar dhe të garantuar nga Qeveria qendrore e Republikës së Shqipërisë;

b) tituj të transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të pranuar në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend anëtar të BE-së ose në tregun e rregulluar të një vendi tjetër, i cili është i rregulluar, vepron rregullisht dhe është i njohur dhe i hapur për publikun dhe është i miratuar nga autoriteti, me kusht që përzgjedhja e tregut të rregulluar të jetë parashikuar në aktin themelues dhe prospektin e sipërmarrjes;

c) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë të sapoemetuara, kur kushtet e emetimit parashikojnë paraqitjen e një kërkesë për pranim në listën zyrtare të një burse ose një tregu tjetër të rregulluar që ushtron aktivitet rregullisht dhe njihet dhe është i hapur për publikun, të një vendi anëtar të BE-së ose në çdo vend tjetër të miratuar nga autoriteti, me kusht që përzgjedhja e tregut të rregulluar të jetë parashikuar në aktin themelues dhe prospektin e sipërmarrjes dhe që pranimi të jetë siguruar brenda një viti pas emetimit;

ç) sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, përfshirë sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, me kusht që:

i. këto sipërmarrje të jenë të licencuara, në zbatim të ligjeve që parashikojnë se janë objekt i mbikëqyrjes, që konsiderohet nga autoriteti si mbikëqyrje e njëjtë me atë që parashikohet në këtë ligj dhe që të jetë garantuar mjaftueshëm bashkëpunimi midis autoriteteve;

ii. niveli i mbrojtjes për pjesëmarrësit në sipërmarrjet e tjera të jetë i barasvlershëm me atë që parashikohet për pjesëmarrësit në sipërmarrjen e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti me rregullat për veçimin e aktiveve, huamarrjen, huadhënien dhe shitjen e pambuluar të titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë që janë të barasvlershme me kërkesat përkatëse në këtë ligj;

iii. veprimtaria e sipërmarrjeve të tjera të raportohet në raportet vjetore dhe të ndërmjetme dhe në pasqyrat financiare për të mundësuar vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe veprimtarisë gjatë periudhës së raportimit;

iv. jo më shumë se 20 % e aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, blerja e së cilës është nën shqyrtim, mund të investohen në total në pjesëmarrje të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike ose të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm, sipas aktit themelues të saj;

d) depozita bankare të pagueshme, sipas kërkesës ose që mund të tërhiqen dhe që maturohen brenda 12 muajve, me kusht që selia e regjistruar e bankës të ndodhet në një vend tjetër, në të cilin aplikohen rregullat e mbikëqyrjes prudenciale, që konsiderohen nga autoriteti si të barasvlershme me ato që parashikohen në këtë ligj;

dh) instrumente të tregut të parasë, përveç atyre që tregtohen në një treg të rregulluar, të cilat përbushin kërkesat e autoritetit mbi likuiditetin dhe kanë një vlerë që mund të përcaktohet me saktësi në çdo moment, nëse emetimi ose emetuesi i këtyre instrumenteve në vetvete është i rregulluar, me qëllim mbrojtjen e investitorëve dhe të kursimeve dhe me kusht që këto investime:

i. të emetohen dhe të garantohen nga një autoritet qendror, rajonal ose vendor ose nga një bankë qendrore e një vendi anëtar të Bashkimit Europian, Banka Qendrore Europiane, Bashkimi Europian ose Banka Europiane e Investimeve, një vend tjetër ose, në rastin e një vendi federal, nga një prej qeverive anëtare të federatës ose nga një organizatë publike ndërkombëtare, së cilës i përkasin një a më shumë vende anëtare; ose

ii. të jenë emetuar nga një subjekt, titujt e të cilit tregtohen në tregje të rregulluara; ose

iii. të jenë emetuar ose garantuar nga një subjekt që është objekt i mbikëqyrjes prudenciale, që konsiderohet nga autoriteti e barasvlershme me atë të parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë; ose

iv. të jenë emetuar nga organe të tjera që u përkasin kategorive të miratuara nga autoriteti, me kusht që investimet në instrumente të tilla të jenë objekt i mbrojtjes së investitorëve, që është e barasvlershme me atë të parashikuar në nënndarjet “i”, “ii” dhe “iii”, të kësaj shkronje, dhe me kusht që emetuesi të jetë shoqëri tregtare, kapitali dhe rezervat e së cilës janë të paktën 1 300 000 000 (një miliard e treqind milionë) lekë dhe që harton dhe publikon raportin vjetor e pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Gjithashtu mund të jetë një subjekt i cili, brenda një grupi shoqërisht që përfshin një ose disa shoqëri të listuara në bursë, funksionon vetëm për financimin e grupit ose mund të jetë një subjekt që funksionon vetëm për financimin e mekanizmave të titullimit që përfitojnë nga një linjë likuiditeti bankare; ose

e) tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të njohura nga autoriteti si të pranuar ose të tregtuara në një treg të rregulluar; ose

ë) kuota të fondeve të investimeve me ofertë publike ose aksione të shoqërive të investimeve me ofertë publike të rregulluara me këtë ligj; ose

f) depozita në banka, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të tërhiqen menjëherë dhe që kanë afat maturimi, jo më shumë se 12 muaj; ose

g) instrumente financiare derivative dhe kontrata private të së ardhmes (*forward*), siç lejohet me rregullore nga autoriteti; ose

gj) instrumente të tregut të parasë, përveç atyre të tregtuara në një treg të rregulluar, siç lejohet me akt nënligjor nga autoriteti; ose

h) mjete monetare dhe depozita pa afat.

2. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon në aktivet e renditura në pikën 1, të këtij neni, vetëm atëherë kur këto investime përbushin kriteret për të qenë aktive të lejuara, të përcaktuara me rregullore nga autoriteti, përfshirë kriteret lidhur me cilësinë, tregtueshmërinë dhe likuiditetin e aktiveve.

3. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon në aksione ose kuota të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive që administrohen, drejtpërdrejt ose me delegim, nga e njëjta shoqëri administruese nga çdo shoqëri tjetër, me të cilën shoqëria administruese është e lidhur nëpërmjet administrimit ose kontrollit të përbashkët ose një pjesëmarrje të konsiderueshme të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kjo shoqëri administruese ose

shoqëri tjetër nuk kërkon tarifë hyrjeje apo largimi për llogari të sipërmarrjes së investimeve kolektive për investimin në aksionet ose kuotat e këtyre sipërmarrjeve të tjera.

4. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, që investon një përqindje të konsiderueshme të aktiveve të veta në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive deklaron në prospektin SIK, nivelin maksimal të tarifave të administrimit që mund të paguajë vetë sipërmarrja dhe sipërmarrjet e tjera në të cilat synon të investojë. Në raportin vjetor dhe pasqyrat financiare përfshihet përqindja maksimale e tarifave të administrimit, që i kërkohej sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe sipërmarrjeve të tjera në të cilat investon.

Neni 140

### **Kufizimet mbi ekspozimin**

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike përmbush parashikimet e mëposhtme lidhur me kufizimin e ekspozimit:

a) nuk investon më tepër se 5 % të vlerës së sipërmarrjes në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara nga një emetues i vetëm, me përjashtim të rastit kur:

i. limiti i 5 % mund të rritet në 10 %, por në këtë rast vlera totale e titujve dhe e instrumenteve të tregut të parasë të disa emetuesve, në të cilat sipërmarrja investon më tepër se 5 % të vlerës së sipërmarrjes, nuk tejkalon 40 % të vlerës së sipërmarrjes;

ii. autoriteti lejon me akt nënligjor një përjashtim lidhur me sipërmarrjet, të cilat kanë si synim replikimin e një indeksi titujsh të borxhit apo të kapitalit, se mund të investohet deri në 20 % në një emetues të vetëm, i cili është pjesë përbërëse e këtij indeksi, me kusht që:

- përbërja e indeksit të jetë mjaftueshëm e diversifikuar;

- indeksi të përfaqësojë një tregues reference për tregun në të cilin bazohet, si dhe publikohet në mënyrën e përshtatshme.

Nëse justifikohet nga kushte të jashtëzakonshme të tregut, dhe në veçanti në tregje ku disa tituj të transferueshëm apo instrumente të tregut të parasë janë dominues, autoriteti mund të lejojë rritjen e këtij limiti deri në kufirin e 35 %, vetëm për një emetues të vetëm;

b) nuk investon më shumë se 20 % të vlerës së aktiveve të sipërmarrjes në depozita pranë një subjekti të vetëm; dhe

c) në përjashtim nga shkronja "a", e kësaj pike, nëse titujt e transferueshëm ose instrumentet e tregut të parasë emetohen ose garantohen nga një vend anëtar i Bashkimit Europian, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose çdo shtet tjetër i lejuar nga autoriteti mund të investojnë deri në 35 % të vlerës së sipërmarrjes në këtë emetues të vetëm;

ç) në rastin e parashikuar nga shkronja "c", të këtij neni, sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike mund të investojë më shumë se 35 % të vlerës së sipërmarrjes në këto tituj të emetuar nga një subjekt i vetëm, me kusht që:

i. shoqëria administruese, përpara se të bëhet ky investim, të konsultohet me depozitarin dhe në bazë të kësaj të vlerësojë nëse emetuesi i këtyre titujve është i përshtatshëm në përputhje me objektivat e investimit të sipërmarrjes në fjalë;

ii. jo më shumë se 30 % e vlerës së aktiveve të sipërmarrjes të konsistojë në tituj të një emetimi të vetëm;

iii. aktivet e sipërmarrjes të përfshijnë këto tituj të emetuar nga i njëjti emetues apo një emetues tjetër, me të paktën gjashtë emetime të ndryshme me numra të ndryshëm ndërkombëtarë të identifikimit të titujve (ISIN) ose të barasvlershëm të tyre; dhe

iv. të jetë pasqyruar ky fakt në prospektin SIK;

d) në lidhje me investimin në obligacionet e mbuluara, kufizimi prej 10 %, në zbatim të



shkronjës “a”, rritet në 25 % të vlerës së sipërmarrjes;

dh) nuk investon më shumë se 10 % të vlerës së sipërmarrjes në aksione ose kuota të një sipërmarrjeje të vetme, me kusht që tërësia e ekspozimeve të mos tejkalojë 30 % nëse këto sipërmarrje nuk janë klasifikuar si SIKTT, në Republikën e Shqipërisë, ose (UCITS) në vendet e Bashkimit Europian;

e) në rastin e sipërmarrjes që investon kryesisht në aksione ose kuota të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive me ofertë publike (fondi i фондеve) sipërmarrja duhet të investojë në jo më pak se pesë sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive.

2. Parashikimet e lartpërmendura të këtij neni nuk e pengojnë sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike të vendosë dhe të zbatojë nivele më të ulëta kufizimesh mbi ekspozimin nga ato të përcaktuara në këtë nen.

Neni 141

### **Agregimi dhe influenza**

1. Shoqëria administruese nuk blen aksione me të drejtë vote të një emetuesi përtej 20 % të drejtave të votimit, lidhur me të gjitha sipërmarrjet e investimeve kolektive që administron.

2. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike mund të zotërojë jo më shumë se:

a) 10 % të aksioneve pa të drejtë vote në të njëjtin emetues;

b) 10 % të titujve të borxhit në të njëjtin emetues;

c) 25 % të pjesëmarrjeve në një sipërmarrje të investimeve kolektive;

ç) 10 % të instrumenteve të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.

3. Kufizimet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij neni, mund të mos merren në konsideratë në momentin e marrjes në pronësi, nëse në atë moment nuk mund të llogaritet vlera bruto e obligacioneve ose e instrumenteve të tregut të parasë, ose vlera neto e instrumenteve në emetim.

4. Shkronja “b”, e pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohet lidhur me titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të emetuara ose të garantuara nga një vend ose nga autoritetet vendore të tij.

Neni 142

### **Përfundimi nga zbatimi**

Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike nuk zbaton kufizimet e parashikuara në nenin 140, të këtij ligji, kur ushtron të drejtat e nënshkrimit që shoqërojnë titujt e transferueshëm ose instrumentet e tregut të parasë, të cilat bëjnë pjesë në aktivet e saj.

### SEKSIONI 3

#### KUFIZIMET MBI INVESTIMET DHE HUAMARRJEN E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE NË TITUJ TË TRANSFERUESHËM

Neni 143

##### **Aktivet e lejuara për sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm**

Autoriteti miraton rregulla lidhur me kërkesat e mëtejshme, përveç atyre të përcaktuara në këtë kre, në nenet 139-141, të këtij ligji, për investimet dhe huamarrjen e lejuar të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, që investojnë në tituj të transferueshëm, përfshirë:

- a) aktivet, emetuesit dhe tregjet e lejuara;
- b) kufizimet mbi ekspozimin ndaj emetuesve, përfshirë sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive;
- c) kufizimet mbi ekspozimin ndaj bankave dhe emetuesve të instrumenteve të tregut të parasë;
- ç) pranueshmërinë e derivativëve, përdorimin e derivativëve për zvogëlimin e riskut ose për qëllime investimi dhe kufizimet mbi ekspozimin ndaj derivativëve;
- d) ekspozimin agregat ndaj emetuesve dhe bankave dhe influencën mbi emetuesit;
- dh) pranueshmërinë e emetimit dhe emetuesve;
- e) lehtësimet për sipërmarrjet e investimeve kolektive që ndjekin një indeks;
- ë) likuiditetin e aktiveve;
- f) huamarrjen; dhe
- g) huadhënien.

### SEKSIONI 4

#### KOMPETENCAT DHE KUFIZIMET MBI INVESTIMET E SIPËRMARRJES FURNIZUESE OSE NËNFONDIT

Neni 144

##### **Kompetencat dhe kufizimet mbi investimet e sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit**

1. Sipërmarrja furnizuese ose nënfondi furnizues investon vetëm në përputhje me parashikimet dhe përcaktimet e këtij seksioni.

2. Sipërmarrja furnizuese ose nënfondi investon të paktën 85 % të aktiveve në kuota të një sipërmarrjeje tjetër të investimeve kolektive ose nënfondi tjetër ("sipërmarrja kryesore"), që është licencuar ose njohur në zbatim të këtij ligji ose është licencuar nga një vend i miratuar nga autoriteti, i cili ka në fuqi ligje që garantojnë një mbrojtje të investitorëve të njëjtë me atë të parashikuar në këtë ligj.

3. Sipërmarrja furnizuese ose nënfondi mban deri në 15 % të aktiveve të veta në mjete monetare dhe depozita pa afat.

## KREU VIII

### SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE KRYESORE OSE FURNIZUESE

#### SEKSIONI 1

#### SIPËRMARRJET KRYESORE OSE FURNIZUESE

##### Neni 145

#### **Kërkesat për licencim**

1. Kërkesa për licencim si sipërmarrje ose nënfond i investimeve kolektive kryesore ose furnizuese kryhet vetëm lidhur me një fond të investimeve me pjesëmarrje të hapur.

2. Kërkesa për licencim si sipërmarrje ose nënfond i investimeve kolektive kryesore ose furnizuese, krahas parashikimeve të nenit 62, të këtij ligji, shoqërohet edhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) rregullat e sipërmarrjes, prospektin SIK dhe dokumentin me informacionin kryesor për investitorin, si për sipërmarrjen dhe nënfondin kryesor, ashtu edhe për sipërmarrjen dhe nënfondin furnizues;

b) marrëveshjen midis fondeve dhe rregulloren e brendshme, në zbatim të nenit 150 të këtij ligji;

c) marrëveshjen midis depozitarëve të fondeve dhe audituesve të fondeve, në zbatim të neneve 151 dhe 152 të këtij ligji;

ç) informacionin në rastin e ndryshimit të sipërmarrjes kryesore në sipërmarrje furnizuese dhe anasjelltas, në zbatim të nenit 146 të këtij ligji;

d) një deklaratë se investimi i sipërmarrjes ose nënfondit furnizues në sipërmarrjen ose nënfondin kryesor do t'i kapërcejë kufijtë e përcaktuar, në zbatim të nënndarjes "iv", të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 139, të këtij ligji.

3. Nëse sipërmarrja kryesore është e themeluar në një vend tjetër, kërkesa shoqërohet nga konfirmimi i autoritetit të huaj rregullator të vendit në fjalë, se sipërmarrja kryesore është në përputhje me rregullat e vendit të origjinës, që janë të barasvlershme me rregullat e parashikuara në këtë seksion.

4. Licenca, si nënfond ose sipërmarrje e investimeve kolektive kryesore ose furnizuese, jepet në zbatim të këtij neni dhe të nenit 6,3 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas marrjes së kërkesës së plotë. Miratimi për licencim jepet vetëm nëse janë përmbushur kërkesat e këtij ligji, sidomos parashikimet e bëra në nenet 147 deri 152, të këtij ligji, dhe në rastin e sipërmarrjes së investimeve kolektive kryesore ose furnizuese, që është sipërmarrje e huaj e investimeve kolektive, me kusht që të ketë marrëveshje bashkëpunimi midis autoritetit të huaj rregullator dhe autoritetit.

##### Neni 146

#### **Ndryshimi i sipërmarrjes furnizuese dhe sipërmarrjes kryesore**

1. Nëse sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ndryshohet në sipërmarrje furnizuese ose sipërmarrja furnizuese ndryshohet në sipërmarrje kryesore, mbajtësit e kuotave kanë të drejtë t'i shlyejnë kuotat e tyre pa pagesë përpara vënies në zbatim të ndryshimit.

2. Në zbatim të pikës 1, të këtij neni, mbajtësve të kuotave u vihen në dispozicion informacionet e mëposhtme, jo më vonë se 30 ditë pune përpara implementimit të ndryshimit:

a) miratimi i autoritetit që sipërmarrja të investojë në një sipërmarrje kryesore;

b) dokumenti me informacionin kryesor për investitorin për sipërmarrjen kryesore dhe për sipërmarrjen furnizuese;

c) data e fillimit të investimit në sipërmarrjen kryesore ose kur investimi e tejkalon kufizimin për investimin në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive;

ç) e drejta e shlyerjes së kuotave pa pagesë brenda 30 ditëve.

3. Këto informacione jepen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën zyrtare të çdo vendi tjetër, në të cilin marketohet sipërmarrja.

Neni 147

### **Kërkesat për sipërmarrjet kryesore**

1. Sipërmarrja kryesore që ka vetëm një ose më shumë fonde furnizuese, si mbajtës të kuotave në një vend tjetër, është e përjashtuar nga zbatimi i kërkesave të kreut IX, të këtij ligji, lidhur me njoftimin e marketimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Sipërmarrja kryesore nuk kërkon komision hyrjeje ose daljeje nga sipërmarrja furnizuese.

3. Sipërmarrja kryesore informon autoritetin se cilat sipërmarrje furnizuese investojnë në sipërmarrjen kryesore.

4. Sipërmarrja kryesore garanton mundësimin në kohën e duhur të të gjitha informacioneve përkatëse që duhet t'u vihen në dispozicion sipërmarrjeve furnizuese, shoqërisë administruese të sipërmarrjes furnizuese, autoriteteve publike dhe depozitarit të sipërmarrjes furnizuese.

5. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë në lidhje me sipërmarrjet kryesore.

Neni 148

### **Kërkesat për nënfondet ose sipërmarrjet furnizuese**

1. Nënfondi ose sipërmarrja furnizuese duhet të monitorojë veprimtarinë e sipërmarrjes kryesore, në të cilën ka investuar në bazë të informacioneve, që merr nga shoqëria administruese depozitari dhe audituesi i sipërmarrjes kryesore.

2. Investitorët kanë të drejtë të marrin pa pagesë nga nënfondi ose sipërmarrja furnizuese një kopje të prospektit SIK, të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, të raportit dhe pasqyrave financiare vjetore dhe të raportit dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme të sipërmarrjes kryesore.

3. Nënfondi ose sipërmarrja furnizuese i mundëson depozitarit të tij informacione për nënfondin ose sipërmarrjen kryesore, të cilat i nevojiten depozitarit në përmbushje të detyrimeve të veta.

4. Nëse shoqëria administruese ose çdo person tjetër, që vepron në emër të nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese ose shoqërisë administruese të nënfondit a sipërmarrjes furnizuese merr tarifë shpërndarjeje, komisione ose përfitime të tjera monetare, kjo tarifë shpërndarjeje, komision a përfitim tjetër monetar kalohet në aktivet e nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese.

5. Nëse nënfondi ose sipërmarrja kryesore ndodhet në një vend tjetër, ajo i përcjell autoritetit, menjëherë pas publikimit, prospektin, dokumentin me informacionin kryesor për investitorin dhe raportin dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme të saj.

### **Prospekti, raportet dhe pasqyrat financiare**

1. Prospekti i nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese, krahas informacioneve që kërkon neni 87, i këtij ligji, përmban gjithashtu informacione lidhur me sipërmarrjen kryesore.

2. Raporti dhe pasqyrat financiare vjetore, si dhe raporti e pasqyrat financiare të ndërmjetme të nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese, krahas informacioneve të parashikuara në nenet 121 dhe 122, të këtij ligji, paraqesin përkatësisht kostot totale dhe fitimin e regjistruar nga nënfondi ose sipërmarrja furnizuese dhe nënfondi ose sipërmarrja kryesore.

3. Raporti dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme të nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese përcaktojnë se ku mund të gjenden raportet dhe pasqyrat financiare përkatëse të nënfondit ose sipërmarrjes kryesore.

4. Materialet e marketimit për nënfondin ose sipërmarrjen përcaktojnë nëse sipërmarrja i investon aktivet e veta në një nënfond ose sipërmarrje kryesore.

### **Marrëdhënia midis nënfondeve ose sipërmarrjeve furnizuese dhe kryesore**

1. Sipërmarrja kryesore ose nënfondi i mundëson sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit dokumentet dhe informacionet, që i nevojiten atyre për të përmbushur detyrimet, në bazë të këtij ligji dhe të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji. Nënfondi ose sipërmarrja furnizuese nënshkruajnë një marrëveshje për këtë qëllim me nënfondin ose sipërmarrjen kryesore të përfaqësuar nga shoqëritë administruese përkatëse. Marrëveshja zbatohet duke filluar nga data kur investimi i sipërmarrjes furnizuese në sipërmarrjen kryesore i tejkalon kufizimet e parashikuara në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 140, të këtij ligji.

2. Nëse sipërmarrja kryesore dhe sipërmarrja furnizuese ose nënfondet administrohen nga e njëjta shoqëri administruese, kjo marrëveshje mund të zëvendësohet me procedura të brendshme.

3. Sipërmarrja kryesore dhe furnizuese ose nënfondet marrin masat e duhura për të bashkërenduar kohën e llogaritjes dhe publikimit të vlerës neto të aseteve të tyre.

4. Sipërmarrja furnizuese ose nënfondi mund të pezullojnë të drejtën e shlyerjes ose shitjes së kuotave në të njëjtën shkallë, siç vepron edhe sipërmarrja kryesore ose nënfondi.

### **Audituesi**

1. Nëse sipërmarrjet kryesore dhe furnizuese ose nënfondet nuk kanë të njëjtin auditues, audituesit lidhin marrëveshje për shkëmbimin e informacionit për të garantuar që të përmbushin detyrimet e tyre, përfshirë edhe bashkërendimin e raporteve të auditimit, në zbatim të pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Marrëveshja duhet të zbatohet duke filluar nga data kur sipërmarrja furnizuese ose nënfondi fillon të investojë në sipërmarrjen kryesore ose nënfondin.

2. Në raportin e auditimit për sipërmarrjen furnizuese ose nënfondin, audituesi merr në konsideratë raportin e auditimit për sipërmarrjen kryesore ose nënfondin. Nëse sipërmarrjet nuk kanë të njëjtin vit financiar, audituesi i nënfondit ose sipërmarrjes kryesore harton një raport të përkohshëm, në datën e bilancit të nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese.

3. Raporti i sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit përshkruan parregullsitë e shtjelluara në

raportin e auditimit të sipërmarrjes kryesore ose nënfondit dhe audituesi i sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit jep opinion për rëndësinë që kanë këto parregullsi për sipërmarrjen furnizuese ose nënfondin.

4. Respektimi i detyrimeve të përcaktuara mbi audituesin, në zbatim të këtij neni, nuk konsiderohen shkelje e detyrimit për ruajtje të fshehtësisë së informacionit, në zbatim të këtij ligji, akteve nënligjore ose marrëveshjes dhe nuk e ngarkojnë me përgjegjësi audituesin apo këdo që vepron në emër të audituesit.

Neni 152

### **Depozitari**

1. Nëse sipërmarrjet kryesore ose nënfondet dhe sipërmarrjet furnizuese nuk kanë të njëjtin depozitar, depozitarët duhet të lidhin marrëveshje për shkëmbimin e informacionit për të siguruar që të dy të jenë në gjendje t'i kryejnë detyrimet e tyre. Marrëveshja zbatohet duke filluar nga data kur sipërmarrja furnizuese ose nënfondi fillon të investojë në nënfondin ose sipërmarrjen kryesore.

2. Depozitari i sipërmarrjes kryesore ose nënfondit i jep autoritetit rregullator të vendit të origjinës të sipërmarrjes kryesore ose nënfondit dhe shoqërisë administruese dhe depozitarit të sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit informacione për çështjet lidhur me nënfondin ose sipërmarrjen kryesore, që mund të kenë pasoja negative për nënfondin ose sipërmarrjen furnizuese.

3. Zbatimi i detyrimeve të përcaktuara ndaj shoqërisë administruese ose depozitarit, sipas këtij neni, nuk konsiderohet si shkelje e konfidencialitetit në pajtim me ligjin, rregulloret ose marrëveshjen dhe nuk ngarkon me përgjegjësi shoqërinë administruese ose depozitarin.

Neni 153

### **Likuidimi, mbyllja dhe bashkimi i nënfondit ose sipërmarrjes kryesore**

1. Nëse sipërmarrja kryesore ose nënfondi prishet dhe likuidohet, nënfondi ose sipërmarrja furnizuese duhet të prishet dhe likuidohet, nëse autoriteti nuk miraton kalimin e investimit në një nënfond ose sipërmarrje tjetër kryesore ose nuk miraton ndryshimin e nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese në një sipërmarrje ose nënfond të investimeve kolektive me ofertë publike, që nuk funksionon si sipërmarrje furnizuese apo nënfond.

2. Në rastin e bashkimit të sipërmarrjes kryesore zbatohen dispozitat e pikës 1 të këtij neni. Në raste të tilla, krahas parashikimeve sa më lart, autoriteti mund të japë miratimin që investimi të vijojë në subjektin e bashkuar.

3. Sipërmarrja kryesore prishet dhe likuidohet jo më parë se tre muaj, pasi ka informuar mbajtësit e kuotave dhe autoritetin rregullator të vendit të origjinës të sipërmarrjes furnizuese për vendimin e mbylljes.

4. Sipërmarrja kryesore mund të bashkohet jo më parë se 60 ditë, pasi u ka dhënë informacionet e përcaktuara në nenin 162, të këtij ligji, pjesëmarrësve dhe autoritetit rregullator të vendit të origjinës të sipërmarrjes furnizuese.

5. Nëse sipërmarrja kryesore ose nënfondi i themeluar në një vend tjetër del nga bashkimi, zbatohen dispozitat e pikave 1 dhe 4 të këtij neni. Në këtë rast, krahas parashikimeve sa më lart autoriteti mund të japë miratimin që investimi të vijojë në subjektin e bashkuar.

### **Komunikimi i autoritetit**

1. Nëse sipërmarrja kryesore ose nënfondi dhe sipërmarrja furnizuese ose nënfondi janë të themeluara të dyja në Republikën e Shqipërisë, autoriteti i komunikon menjëherë sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit çdo vendim, masë, vëzhgim mospërputhshmërie ose çdo raport auditimi, në zbatim të pikës 4, të nenit 120, të këtij ligji, në lidhje me sipërmarrjen kryesore ose nënfondin ose, sipas rastit, shoqërinë administruese, depozitarin ose audituesin e saj.

2. Nëse sipërmarrja kryesore ose nënfondi është i themeluar në Republikën e Shqipërisë dhe sipërmarrja furnizuese ose nënfondi është themeluar në një vend tjetër, autoriteti i komunikon menjëherë sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit, çdo vendim, masë, vëzhgim mospërputhshmërie me kushtet e këtij kreu ose çdo raport auditimi, në zbatim të pikës 4, të nenit 120, të këtij ligji, lidhur me sipërmarrjen kryesore ose nënfondin ose, sipas rastit, shoqërinë administruese, depozitarin ose audituesin e saj dhe autoritetin e huaj rregullator të sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit.

## **KREU IX**

### **MARKETIMI NDËRKUFITAR I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

#### **SEKSIONI 1**

### **MARKETIMI I SIPËRMARRJEVE SHQIPTARE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE JASHTË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

### **Marketimi i sipërmarrjeve vendase të investimeve kolektive me ofertë publike jashtë Republikës së Shqipërisë**

1. Marketimi i sipërmarrjeve shqiptare të investimeve kolektive me ofertë publike jashtë Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm nëse ekzistojnë në marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet autoritetit të huaj rregullator të vendit pritës dhe autoritetit të Republikës së Shqipërisë. Kërkesat e këtij neni zbatohen edhe për nënfondet e këtyre sipërmarrjeve.

2. Shoqëria administruese, që kërkon të marketojë një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike jashtë Republikës së Shqipërisë njofton për këtë autoritetin.

3. Njoftimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, krahas raportit dhe pasqyrave financiare vjetore më të fundit të sipërmarrjes dhe raportit dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme të sipërmarrjes, shoqërohet me versionin më të fundit të aktit themelues, prospektit SIK dhe dokumentit me informacionin kryesor për investitorin të sipërmarrjes.

4. Dokumentet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, hartohen në një gjuhë të lejuar ose të kërkuar nga vendi pritës. Përkthimet reflektojnë me besnikëri dokumentet origjinale dhe këto përkthime janë përgjegjësi e shoqërisë administruese. Kjo përfshin edhe informacionet mbi organizimin e marketimit të pjesëmarrjeve të sipërmarrjeve në Republikën e Shqipërisë, përfshirë, sipas rastit, edhe informacion lidhur me klasat e aksioneve ose të kuotave, ku përfshihet informacion se sipërmarrja marketohet nga shoqëria administruese që e administron sipërmarrjen.

5. Brenda 10 ditëve pune, pas marrjes së njoftimit me dokumentacionin e plotë, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, autoriteti i përcjell njoftimin dhe konfirmimin e statusit të sipërmarrjes autoritetit rregullator të vendit pritës. Autoriteti informon menjëherë shoqërinë administruese për përcjelljen e njoftimit. Shoqëria administruese fillon marketimin duke filluar nga ky moment.

6. Shoqëria administruese mban dokumente të përditësuara dhe të përkthyer, sipas pikës 4, të këtij neni, të gatshme, në versionin elektronik.

7. Shoqëria administruese u mundëson investitorëve në vendin pritës informacionet dhe dokumentet që kërkohen të jepen në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të seksionit 9, të kreut V, të këtij ligji.

8. Shoqëria administruese njofton autoritetin rregullator të vendit pritës për ndryshimet në këto dokumente dhe se ku mund të gjenden në format elektronik këto dokumente. Ndryshimet në lidhje me mënyrën e marketimit nga ana e sipërmarrjes ose ndryshimet lidhur me klasat e pjesëmarrjeve nuk implementohen derisa autoriteti rregullator i vendit pritës të ketë marrë njoftim me shkrim për to nga shoqëria administruese.

Neni 156

### **Marketimi i sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive që publikohet në Republikën e Shqipërisë**

1. Sipërmarrjet e huaja të investimeve kolektive mund t'i marketohen publikut në Republikën e Shqipërisë pas njohjes së këtyre sipërmarrjeve nga autoriteti. Kërkesat e këtij neni zbatohen edhe për nënfondet e këtyre sipërmarrjeve.

2. Autoriteti bën njohjen e sipërmarrjes së huaj nëse përmbushen përcaktimet e mëposhtme:

a) shoqëria administruese ose administruesi i fondeve të investimeve alternative të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose autoritetit rregullator në vendin e origjinës së shoqërisë administruese ose administruesit të fondeve të investimeve alternative i ka përcjellë autoritetit informacionet, që parashikohen ose kërkohen nga autoriteti, siç janë: akti i themelimit, prospekti SIK, dokumenti me informacionin kryesor për investitorin, raporti dhe pasqyrat financiare vjetore dhe, sipas rastit, raporti dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme të sipërmarrjes dhe konfirmimi i statusit të rregulluar të sipërmarrjes dhe shoqërisë administruese ose administruesit të fondeve të investimeve alternative;

b) ekziston marrëveshje bashkëpunimi midis autoritetit rregullator të vendit të origjinës të shoqërisë administruese ose administruesit të fondeve të investimeve alternative dhe autoritetit në Republikën e Shqipërisë;

c) sipërmarrja e huaj e investimeve kolektive është licencuar për ofertë publike në vendin e origjinës;

ç) sipërmarrja dhe shoqëria administruese ose administruesi i fondit të investimeve alternative të sipërmarrjes janë objekt i mbikëqyrjes adekuate në vendin e origjinës;

d) sipërmarrja dhe administrimi i saj i përmbush kërkesat e përcaktuara për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në vendin e origjinës dhe këto kërkesa u ofrojnë investitorëve në Republikën e Shqipërisë të paktën të njëjtën mbrojtje që u ofrohet investitorëve nga sipërmarrjet vendase me ofertë publike;

dh) shoqëria administruese ose administruesi i fondeve alternative i sipërmarrjes ndërmerr masat e nevojshme për të mundësuar pagesën e pjesëmarrësve në Republikën e Shqipërisë, shlyerjen e pjesëmarrjeve dhe vendosjen në dispozicion të informacioneve që duhet të mundësojë sipërmarrja, sipas rregullave të vendit të saj të origjinës;



e) procesi i shitjes nga ana e sipërmarrjes në Republikën e Shqipërisë bëhet drejtpërdrejt nga selia e shoqërisë administruese ose administratori i fondit të investimeve alternative të sipërmarrjes nëpërmjet një përfaqësie në Republikën e Shqipërisë, ose nëpërmjet një shoqërie administruese ose administruesi të fondeve të investimeve alternative të licencuara në Republikën e Shqipërisë, ose nëpërmjet një subjekti, sipas rregullave të autoritetit ose një subjekti të njohur, në bazë të nenit 96, të këtij ligji, ose një agjenti, në bazë të nenit 102 të këtij ligji.

3. Autoriteti, kur vendos për njohjen e sipërmarrjeve të huaja, në zbatim të këtij neni, merr në konsideratë ekzistencën e rregullave ligjore të barasvlershme për njohjen e sipërmarrjeve të huaja në legjislacionin e vendit të origjinës të sipërmarrjes kërkuese.

4. Autoriteti heq vendimin e njohjes së sipërmarrjes nëse:

a) nuk përmbushen më kërkesat e shkronjave “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij neni;

b) janë shkelur kushtet e parashikuara për njohjen;

c) nuk përmbushen kërkesat e kreut V, seksioni 3, të këtij ligji, ose të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji;

ç) nuk përmbushen kërkesat për përpilimin e dokumenteve në gjuhën shqipe.

5. Autoriteti mund të kryejë njohjen e sipërmarrjeve ose nënfondeve të veçanta të investimeve kolektive që janë objekt i një kuadri ligjor rajonal të standardizuar.

Neni 157

### **Regjistrimi në regjistër**

1. Vendet pritëse, në të cilat mund të marketohen sipërmarrjet shqiptare të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të cilat i njoftohen autoritetit, në zbatim të nenit 156, të këtij ligji, regjistrohen në regjistrin që mban autoriteti, në zbatim të nenit 8 të këtij ligji.

2. Sipërmarrjet e huaja të investimeve kolektive, të njohura për ofertë publike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të këtij kreu regjistrohen në regjistrin që mban autoriteti, në zbatim të nenit 8 të këtij ligji.

KREU X

## **BASHKIMI DHE MARRJA NË KONTROLL E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

SEKSIONI 1

### **BASHKIMI I FONDEVE TË INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE TË THEMELUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Neni 158

#### **Bashkimi i fondeve të investimeve me ofertë publike**

1. Nënfondi ose fondi i investimeve me ofertë publike bashkohet vetëm me një tjetër nënfond ose fond të investimeve me ofertë publike.

2. Bashkimi i nënfondeve ose fondeve të investimeve me ofertë publike kryhet sipas parashikimeve, si më poshtë:

a) të gjitha të drejtat dhe detyrimet në një ose më shumë nënfonde ose fonde të investimeve me ofertë publike që bashkohen i kalohen një nënfondi ose fondi ekzistues marrës të investimeve me ofertë publike. Mbjajtësit e kuotave në nënfondet ose fondet pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në nënfondin ose fondin marrës dhe nënfondet ose fondet pjesëmarrëse në bashkim prishen; ose

b) të gjitha të drejtat dhe detyrimet në një ose më shumë nënfonde ose fonde që bashkohen i kalohen një nënfondi ose fondi marrës të krijuar rishtazi, mbajtësit e kuotave në nënfond ose fondet pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në nënfondin ose fondin marrës dhe nënfondet ose fondet pjesëmarrëse në bashkim prishen.

3. Mbjajtësit e kuotave në nënfondet ose fondet që bashkohen përfitojnë një vlerë të barasvlershme kuotash në nënfondin ose fondin pjesëmarrës në bashkim në datën e bashkimit. Për të arritur këtë, nëse është e nevojshme, mbajtësve të kuotave mund t'u ofrohen pagesa të vogla kompensuese në para.

Neni 159

### **Miratimi i bashkimit**

1. Autoriteti miraton paraprakisht çdo bashkim të nënfondeve ose fondeve të investimeve me ofertë publike. Kërkesa për miratimin e bashkimit paraqitet nga shoqëria administruese e nënfondeve ose fondeve të investimeve me ofertë publike pjesëmarrëse në bashkim.

2. Kërkesa për miratim shoqërohet nga:

a) projektmarrëveshja për bashkim;

b) konfirmimi nga depozitarët, në zbatim të pikës 3, të nenit 160, të këtij ligji;

c) draftinformacioni që do t'u dërgohet mbajtësve të kuotave, në zbatim të nenit 162 të këtij ligji;

ç) prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin për nënfondin ose fondin marrës;

d) dokumentacioni që dëshmon se është lidhur marrëveshja me depozitarin dhe audituesin lidhur me përgatitjen e konfirmimit, pas vënies në zbatim të bashkimit, në zbatim të nenit 163 të këtij ligji.

3. Nëse autoriteti e konsideron të paplotë kërkesën për miratimin e bashkimit, njofton shoqërinë administruese, brenda 10 ditëve punë pas marrjes së kërkesës.

4. Autoriteti mund të kërkojë ndryshime në informacionet që u dërgohen mbajtësve të kuotave, nëse informacionet nuk i përmbushin kërkesat e nenit 162 të këtij ligji.

5. Kërkesa për bashkim shqyrtohet brenda 3 muajve, pas depozitimit të kërkesës së plotë. Autoriteti jep miratimin nëse janë përmbushur dispozitat e neneve 160, 162 dhe 163 të këtij ligji.

6. Dispozitat e këtij seksioni nuk zbatohen në lidhje me bashkimet ndërkufitare.

Neni 160

### **Marrëveshja e bashkimit**

1. Këshilli i administrimit i shoqërisë administruese të fondeve bashkuese dhe marrëse duhet të lidhin një marrëveshje bashkimi.

2. Marrëveshja e bashkimit përmban:

a) identifikimin e llojit të bashkimit të nënfondeve ose fondeve të investimeve me ofertë publike të përfshira;

- b) historikun dhe arsyetimin e bashkimit;
  - c) ndikimin e mundshëm të mbajtësit e kuotave të nënfondeve ose fondeve të investimeve me ofertë publike që marrin pjesë në bashkim;
  - ç) kriteret për vlerësimin e aktiveve të nënfondeve ose fondeve të investimeve me ofertë publike dhe, sipas rastit, të pasiveve;
  - d) metodën për llogaritjen e raportit të këmbimit;
  - dh) datën e planifikuar të hyrjes në fuqi të bashkimit;
  - e) rregullat e zbatueshme për kalimin e aktiveve dhe këmbimin e kuotave; dhe
  - ë) sipas rastit, rregullat e sipërmarrjes marrëse të krijuar rishtazi.
3. Depozitarët e nënfondeve ose fondeve të investimeve bashkuese dhe marrëse konfirmojnë, që informacionet e përmendura në shkronjat “a”, “dh” dhe “e”, të pikës 2, të këtij neni, përmbushin kërkesat e këtij ligji dhe të aktit themelues të sipërmarrjeve.

Neni 161

### **Hyrja në fuqi e bashkimit**

1. Bashkimi hyn në fuqi pas dhënies së miratimit, sipas nenit 159, të këtij ligji.
2. Mbajtësit e kuotave të sipërmarrjeve bashkuese dhe marrëse kanë të drejtë t’i shlyejnë kuotat e tyre pa pagesë ose t’i këmbajnë kuotat e sipërmarrjes që do të bashkohet me kuota të një sipërmarrjeje tjetër me natyrë të ngjashme investimi, e cila administrohet nga e njëjta shoqëri administruese. E drejta e shlyerjes dhe këmbimit të kuotave është e vlefshme deri në 5 ditë punë, përpara datës së hyrjes në fuqi të bashkimit.
3. Kuotat administruese të bashkimit nuk i ngarkohen sipërmarrjes ose mbajtësve të kuotave të saj.
4. Në kundërshtim me parashikimet në seksionin 2, të kreut VII, të këtij ligji, nëse autoriteti e gjykon të arsyeshme mund të lejohen përjashtime për kërkesat për investimet, deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të bashkimit.

Neni 162

### **Informimi për mbajtësit e kuotave në rastin e bashkimit**

1. Mbajtësit e kuotave në sipërmarrjet ose nënfondet bashkuese dhe marrëse informohen për planet e bashkimit pasi është dhënë miratimi nga autoriteti për bashkimin dhe të paktën 30 ditë përpara se të përfundojnë të drejtat e parashikuara në nenin 161, pika 2.
2. Informacioni duhet t’u japë mundësi mbajtësve të kuotave që të bëjnë një vlerësim të mirë të bashkimit. Informacioni përfshin:
  - a) arsyetimin e bashkimit të propozuar;
  - b) ndikimin e mundshëm të mbajtësit e kuotave, përfshirë ndryshimet në objektivin dhe strategjinë e investimit, kostot, kthimin e pritur, raportimin periodik, ndonjë rënie të mundshme të performancës dhe, nëse ka lidhje, një paralajmërim të qartë që trajtimi tatimor i mbajtësve të kuotave mund të ndryshojë pas bashkimit;
  - c) një përshkrim të të drejtave të mbajtësve të kuotave në lidhje me bashkimin, përfshirë të drejtën për të marrë informacione të tjera shtesë, të drejtën për të marrë një kopje të konfirmimit, sipas nenit 163, të drejtat e parashikuara në nenin 161, pika 2, dhe datën e fundit për ushtrimin e këtyre të drejtave;
  - ç) aspektet përkatëse procedurale dhe datën e planifikuar të hyrjes në fuqi të bashkimit;
  - d) dokumentet me informacionin kryesor për investitorin e sipërmarrjes marrëse.

Neni 163

### **Konfirmimi i hyrjes në fuqi**

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes marrëse garanton që depozitari ose audituesi i miratuar, në mënyrë të pavarur të konfirmojë që, pas hyrjes në fuqi të bashkimit:

a) bashkimi është kryer në përputhje me kriteret e parashikuara në marrëveshjen e bashkimit për vlerësimin e aktiveve të sipërmarrjes dhe të pasiveve të mundshme të saj, në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 160, të këtij ligji;

b) mënyra e llogaritjes së raportit të këmbimit dhe që raporti faktik i këmbimit është në përputhje me metodën e përcaktuar në marrëveshjen e bashkimit për llogaritjen e raportit të këmbimit, në zbatim të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 160, të këtij ligji.

2. Audituesi i sipërmarrjeve bashkuese dhe marrëse konsiderohet si i pavarur, në kuptim të pikës 1, të këtij neni.

3. Konfirmimi u vihet në dispozicion mbajtësve të kuotave, autoritetit dhe autoriteteve të tjera rregullatore përkatëse.

## **SEKSIONI 2**

### **BASHKIMI NDËRKUFITAR I SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

Neni 164

#### **Bashkimi ndërkufitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike**

1. Dispozitat e seksionit 1, të këtij kreu, nuk zbatohen për bashkimin ndërkufitar të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

2. Miratimi për këto lloj bashkimesh jepet nga autoriteti rregullator i vendit të origjinës së sipërmarrjes që bashkohet.

## **SEKSIONI 3**

### **BASHKIMI I SHOQËRIVE TË INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE TË THEMELUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Neni 165

#### **Bashkimi i shoqërive të investimeve me ofertë publike**

1. Shoqëria e investimeve me ofertë publike mund të bashkohet vetëm me një shoqëri tjetër të investimeve me ofertë publike.

2. Bashkimi i shoqërisë së investimeve me ofertë publike, që është e listuar në një treg të rregulluar, është objekt i kërkesave të rregullores së këtij tregu të rregulluar lidhur me shoqëritë e investimeve dhe bashkimet e shoqërive të investimeve.

3. Bashkimi i shoqërisë së investimeve me ofertë publike kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në rast mospërputhjeje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe me legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

#### Neni 166

### **Miratimi i bashkimit të shoqërive të investimeve me ofertë publike**

1. Bashkimi i shoqërisë së investimeve me ofertë publike është objekt i miratimit paraprak nga autoriteti.

2. Kërkesa për miratimin e bashkimit të shoqërisë së investimeve paraqitet pranë autoritetit bashkërisht nga këshilli i administrimit të shoqërive të investimeve dhe shoqërisë administruese të shoqërive të investimeve, e cila shoqërohet me dokumentet, si më poshtë:

a) projekt marrëveshja për bashkimin;

b) draftinformacioni që do t'u dërgohet mbajtësve të aksioneve, në zbatim të nenit 168 të këtij ligji;

c) dokumentacioni që vërteton lidhjen e marrëveshjes me depozitarin ose audituesin, lidhur me përgatitjen e konfirmimit pas implementimit të bashkimit, në zbatim të nenit 170 të këtij ligji.

3. Nëse autoriteti e konsideron të paplotë kërkesën për miratimin e bashkimit, njofton shoqërinë administruese, brenda 10 ditëve punë, pas marrjes së kërkesës.

4. Autoriteti mund të kërkojë ndryshime në informacionet që u dërgohen aksionarëve, nëse informacionet nuk i përmbushin kërkesat e nenit 167 të këtij ligji.

5. Kërkesat për bashkim shqyrtohen brenda 20 ditëve punë pas marrjes së kërkesës së plotë. Autoriteti miraton kërkesën nëse janë përmbushur dispozitat e neneve 167, 168 dhe 170 të këtij ligji.

#### Neni 167

### **Marrëveshja e bashkimit**

1. Marrëveshja e bashkimit shqyrtohet nga bordi i drejtorëve të shoqërive investuese të bashkimit dhe pranimit.

2. Marrëveshja e bashkimit përmban:

a) identitetin e shoqërive të investimit të përfshira;

b) historikun dhe arsyetimin e bashkimit;

c) ndikimin e mundshëm tek aksionarët e shoqërive të investimeve që marrin pjesë në bashkim;

ç) kriteret e vlerësimit të aktiveve të shoqërive të investimeve dhe, sipas rastit, të pasiveve;

d) metodën për llogaritjen e raportit të këmbimit, në bazë të çmimeve të aksioneve të shoqërive të investimeve bashkuese dhe marrëse;

dh) procedurën e planifikuar dhe datën për vendimin e jashtëzakonshëm mbi bashkimin që do të miratohet nga aksionarët;

e) datën e planifikuar të hyrjes në fuqi të bashkimit.

3. Depozitarët e shoqërive të investimeve bashkuese dhe marrëse konfirmojnë që informacionet e përmendura në shkronjat “a”, “d” dhe “e”, në pikën 2, të këtij ligji, përmbushin kërkesat e këtij ligji dhe të statuteve të shoqërive të investimeve.

## Neni 168

### **Informimi për aksionarët në rastin e bashkimit**

1. Aksionarët në sipërmarrjet bashkuese dhe marrëse informohen për planet e bashkimit, pasi është dhënë miratimi për bashkim nga autoriteti, të paktën 30 ditë përpara datës së planifikuar të bashkimit.

2. Informacioni përmban kërkesën mbi vendimin e jashtëzakonshëm të aksionarëve dhe procedurat që duhen ndjekur për miratimin e këtij vendimi të jashtëzakonshëm.

3. Informacioni duhet t'u japë mundësi aksionarëve që të bëjnë një vlerësim të mirë të bashkimit. Informacioni përfshin:

a) historikun dhe arsyetimin e bashkimit të propozuar;

b) ndikimin e mundshëm të aksionarëve, përfshirë ndryshimet në objektivin dhe strategjinë e investimit, kostot, fitimin e pritur, raportimin periodik, ndonjë rënie të mundshme të performancës dhe, nëse ka lidhje, një paralajmërim të qartë që trajtimi tatimor i aksionarëve mund të ndryshojë pas bashkimit;

c) një përshkrim të të drejtave të aksionarëve lidhur me bashkimin, përfshirë të drejtën për të marrë informacione të tjera shtesë dhe të drejtën për të marrë një kopje të konfirmimit, sipas nenit 170, të këtij ligji, dhe të drejtën për të kërkuar riblerjen ose shlyerjen e kuotave të tyre;

ç) aspektet përkatëse procedurale dhe datën e planifikuar të hyrjes në fuqi të bashkimit.

## Neni 169

### **Hyrja në fuqi e bashkimit**

1. Bashkimi i shoqërisë së investimeve me ofertë publike hyn në fuqi menjëherë pas marrjes së miratimit nga autoriteti, sipas parashikimeve të nenit 166 të këtij ligji.

2. Pavarësisht parashikimeve në seksionin 2, të kreut VII, të këtij ligji, nëse autoriteti e gjykon të arsyeshme, mund të lejohen përjashtime për kërkesat për investime deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të bashkimit.

## Neni 170

### **Konfirmimi i hyrjes në fuqi**

1. Shoqëria administruese dhe këshilli i administrimit të shoqërisë së investimeve marrëse garanton që depozitari dhe audituesi i miratuar në mënyrë të pavarur, konfirmon pas hyrjes në fuqi të bashkimit që:

a) bashkimi është kryer në përputhje me kriteret e parashikuara në marrëveshjen e bashkimit për vlerësimin e aktiveve të sipërmarrjes dhe të pasiveve të mundshme të saj, në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 167, të këtij ligji;

b) mënyra e llogaritjes së raportit të këmbimit dhe që raporti faktik i këmbimit është në përputhje me metodën e përcaktuar në marrëveshjen e bashkimit për llogaritjen e raportit të këmbimit, në zbatim të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 167, të këtij ligji.

2. Audituesi i sipërmarrjeve bashkuese dhe marrëse konsiderohet si i pavarur në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

3. Konfirmimi u vihet në dispozicion aksionarëve, autoritetit dhe autoriteteve të tjera rregullatore përkatëse.

### **Marrja në kontroll e shoqërive të investimeve me ofertë publike**

1. Shoqëria e investimeve me ofertë publike merret në kontroll vetëm:

- a) nëse shoqëria është e listuar në një treg të rregulluar;
- b) nëse merret në kontroll nga një tjetër shoqëri e investimeve me ofertë publike;
- c) me miratimin paraprak të autoritetit.

2. Marrja në kontroll e shoqërisë së investimeve me ofertë publike, që është e regjistruar në një treg të rregulluar, është objekt i rregullave përkatëse të atij tregu dhe i legjislacionit në fuqi për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike, duke përbushur këto kërkesa:

- a) të gjithë aksionarët që zotërojnë të njëjtën klasë aksionesh të shoqërisë së investimeve, që merret në kontroll duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë;
- b) të gjithë aksionarët marrin informacione të duhura në mënyrë që të marrin vendime të mirinformuara;
- c) administratorët e shoqërisë së investimeve që merret në kontroll nuk bëjnë asnjë veprim që do të pengonte marrjen në kontroll pa pëlqimin e aksionarëve të saj.

## KREU XI

### MBYLLJA DHE LIKUIDIMI VULLNETAR DHE I DETYRUAR

#### SEKSIONI 1

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR MBYLLJEN DHE LIKUIDIMIN VULLNETAR E TË DETYRUESHËM

### **Likuidimi i subjekteve të licencuara**

1. Likuidimi i subjekteve të licencuara, sipas këtij ligji, kryhet vetëm pas miratimit paraprak të autoritetit.

2. Mbyllja e nënfondit të sipërmarrjes me ofertë publike bëhet në përputhje me nenin 174 të këtij ligji.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare zbatohen lidhur me procedurat e likuidimit vullnetar dhe të detyrueshëm të shoqërive tregtare të themeluara në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe që janë subjekte të licencimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. Kërkesa për miratimin e likuidimit vullnetar dhe mbylljes të subjektit të licencuar paraqitet në autoritet, në rastet e mëposhtme:

- a) në rastin e fondit të investimeve me ofertë publike nga shoqëria administruese e fondit të investimeve;
- b) në rastin e shoqërisë së investimeve me ofertë publike, bashkërisht nga shoqëria administruese dhe këshilli i administrimit të shoqërisë së investimeve;
- c) në rastin e shoqërisë administruese, nga personat kyç të shoqërisë administruese;
- ç) në rastin e depozitarit, nga personat kyç të depozitarit.

5. Likuidimi vullnetar dhe mbyllja e fondit të investimeve me ofertë publike, i cili ka aftësi paguese, kryhet sipas parashikimeve në seksionin 2 të këtij kreu.

6. Likuidimi vullnetar dhe mbyllja e shoqërisë së investimeve me ofertë publike me aftësi paguese e shoqërisë administruese të fondit, e depozitarit dhe e depozitarit të fondeve të investimeve alternative, kryhet sipas parashikimeve të seksionit 3, të këtij kreu, me përjashtim të depozitarit dhe depozitarit të fondeve të investimeve alternative, që është bankë e licencuar, e cila likuidohet dhe mbyllet në zbatim të legjisllacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

7. Marrja në administrim e subjektit të licencuar, sipas këtij ligji, kryhet në zbatim të seksionit 4, të këtij kreu, me përjashtim të marrjes në administrim të depozitarit dhe depozitarit të fondeve të investimeve alternative, i cili kryhet në zbatim të legjisllacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

8. Likuidimi i detyruar dhe mbyllja e shoqërisë së investimeve me ofertë publike dhe e shoqërisë administruese të fondit, e depozitarit dhe e depozitarit të fondeve të investimeve alternative kryhet sipas parashikimeve të seksionit 3, të këtij kreu, me përjashtim të depozitarit dhe depozitarit të fondeve të investimeve alternative, që është bankë e licencuar, e cila likuidohet dhe mbyllet në zbatim të legjisllacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

## SEKSIONI 2

### LIKUIDIMI VULLNETAR I FONDEVE TË INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE DHE MBYLLJA E NËNFONDIT

Neni 173

#### **Bazat për likuidimin vullnetar dhe mbylljen**

1. Fondi i investimeve me ofertë publike, i cili ka aftësi paguese, mund të likuidohet në mënyrë vullnetare:

a) në datën kur mbaron kohëzgjatja e përcaktuar e fondit të investimeve ose në rast të shfaqjes së rrethanave të prishjes dhe likuidimit, të përcaktuara në aktin themelues të fondit të investimeve;

b) nëse shoqëria administruese bën kërkesë për likuidim, sepse fondi i investimeve nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm dhe nuk përmbush qëllimin e tij;

c) në rast të përfundimit të detyrave të depozitarit ose shoqërisë administruese të fondit të investimeve, nëse ato nuk zëvendësohen brenda 60 ditëve pune;

ç) në rast të falimentimit të shoqërisë administruese;

d) në përfundim të procesit të bashkimit, kur fondi i investimeve që bashkohet mbetet pa aktive, pasi i ka transferuar ato te fondi marrës i investimeve.

2. Fondi i investimeve me ofertë publike likuidohet në momentin e heqjes të licencës nga autoriteti.

Neni 174

#### **Mbyllja e nënfondit të fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me interval**

1. Mbyllja e nënfondit është objekt i miratimit paraprak nga autoriteti.



2. Mbyllja e nënfondit kryhet në rrethanat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 173, të këtij ligji.

3. Shoqëria administruese e nënfondit njofton autoritetin për mbylljen e propozuar të nënfondit brenda 3 muajve, përpara datës së propozuar për mbylljen.

4. Kërkesa për mbylljen e nënfondit, sipas parashikimit të pikës 3, të këtij neni, përfshin:

a) arsyet e mbylljes;

b) datën e planifikuar të përfundimit të mbylljes, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të marrin rimbursimin e vlerës së kuotave;

c) rregulloren e rishikuar të fondit të investimeve;

ç) prospektin SIK të rishikuar për sipërmarrjen, në të cilën bën pjesë nënfondi.

5. Autoriteti njofton shoqërinë administruese për miratimin e mbylljes brenda 3 muajve, pas marrjes së kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 4, të këtij neni.

#### Neni 175

### **Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve**

1. Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve i paraqitet autoritetit, jo më pak se 3 muaj, përpara datës së propozuar të likuidimit.

2. Kërkesa që i paraqitet autoritetit për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve deklaron arsyet e kërkesës dhe një plan kohor për likuidim.

3. Përpara njoftimit të autoritetit mbi likuidimin vullnetar të fondit të investimeve, shoqëria administruese harton një pasqyrë të audituar, ku konfirmohet se fondi ose nënfondi është në gjendje t’i përmbushë të gjitha detyrimet brenda 12 muajve, prej datës së hartimit të pasqyrës (pasqyra e aftësisë paguese).

4. Mbajtësit e kuotave informohen lidhur me likuidimin vullnetar pas dhënies së miratimit nga autoriteti.

5. Informacioni që u vihet në dispozicion mbajtësve të kuotave, sipas pikës 4, të këtij neni, përfshin:

a) arsyet e likuidimit;

b) pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave;

c) kostot përkatëse;

ç) pasqyrat e aftësisë paguese;

d) datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetar, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të kenë pagesën e vlerës së aksioneve ose kuotave.

6. Autoriteti njofton shoqërinë administruese për miratimin e kërkesës së likuidimit vullnetar brenda 3 muajve, pas marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 5, të këtij neni.

#### Neni 176

### **Procedurat për likuidimin vullnetar dhe mbylljen e nënfondit**

1. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 173, të këtij ligji, zbatohen procedurat e mëposhtme:

a) njoftimi i mbylljes ose likuidimit vullnetar u dërgohet menjëherë mbajtësve të kuotave nëse nuk është bërë ky njoftim;

b) ndërpritet vlerësimi dhe vendosja e çmimit;

c) fondi i investimeve ose nënfondi pushon së emetuari ose anuluari kuota, me përjashtim të anulimit përfundimtar;

ç) nuk regjistrohet asnjë transferim kuote dhe asnjë ndryshim nuk mund të bëhet në regjistrin e mbajtësve të kuotave pa sanksionimin e shoqërisë administruese dhe depozitarit;

d) fondi i investimeve ose nënfondi nuk ushtrojnë asnjë lloj veprimtarie, me përjashtim të veprimtarisë së mbylljes;

dh) përgjegjësitë dhe detyrimet e shoqërisë administruese vijnë të zbatohen deri në përfundim të mbylljes;

e) shoqëria administruese kryen veprimet për arkëtimin e pasurisë së sipërmarrjes dhe shlyerjen e pasiveve të sipërmarrjes ose nënfondit me fondet e arkëtuara, sa më shpejt të jetë e mundur pasi të ketë filluar mbyllja;

ë) shoqëria administruese udhëzon depozitarin mbi mbajtjen e fondeve të arkëtuara, sipas shkronjës “e”, të kësaj pike (deri në përdorimin për të shlyer pasivet ose në shpërndarjen e mbajtësit të kuotave) dhe këto udhëzime përgatiten, me qëllim mbrojtjen e kreditorëve dhe mbajtësve të kuotave nga humbja.

2. Nëse ka fonde të mjaftueshme likuide pas mbulimit të shpenzimeve të mbylljes ose likuidimit vullnetar dhe shlyerjes së detyrimeve të mbetura të sipërmarrjes ose nënfondit, shoqëria administruese mund të mundësojë që depozitari të kryejë një ose më shumë shpërndarje të ndërmjetme të mbajtësit të kuotave, në mënyrë përpjesëtimore me të drejtën e kuotave përkatëse të tyre.

3. Shoqëria administruese mundëson që të gjitha kuotat në emetim të anulohen dhe që depozitari të bëjë shpërndarjen përfundimtare të mbajtësit të kuotave, sipas të njëjtit përpjesëtim të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nga teprica e mbetur (pasi zbritet një provigjion për shpenzime të mëtejshme të fondit të investimeve ose nënfondit) ose përpara datës kur llogaria përfundimtare e audituar u dërgohet mbajtësve të kuotave.

4. Shoqëria administruese dhe depozitari njoftojnë autoritetin me të përfunduar mbyllja ose likuidimi vullnetar i fondit të investimeve ose e nënfondit dhe dorëzojnë një llogari përfundimtare të përditësuar deri në datën e mbylljes, e cila është edhe dita e fundit e kësaj llogarie. Në të njëjtën kohë, shoqëria administruese i kërkon autoritetit heqjen e licencës dhe përditësimin e evidencave përkatëse.

5. Në raste të falimentimit të shoqërisë administruese ose të heqjes të licencës së fondit të investimeve ose të shoqërisë administruese, fondi i investimeve ose nënfondi likuidohet nga depozitari. Nëse depozitari likuidon fondin e investimeve, ai lejohet që të arkëtojë pagesat që do t'i ishin paguar shoqërisë administruese në bazë të prospektit SIK.

6. Gjatë periudhës së likuidimit vullnetar, shoqëria administruese vijon të hartojë dhe të publikojë raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme, në zbatim të seksionit 8, të kreut V, të këtij ligji, dhe u mundëson këto raporte mbajtësve të kuotave.

7. Në përfundim të likuidimit vullnetar, periudha ushtrimore kontabël aktuale konsiderohet si periudha kontabël vjetore përfundimtare.

8. Brenda 4 muajve pas fundimit të periudhës kontabël vjetore përfundimtare ose pas mbylljes së nënfondit, raporti dhe pasqyrat financiare përfundimtare të audituara të fondit të investimeve ose nënfondit publikohen dhe u dërgohen mbajtësve të kuotave të fondit të investimeve/nënfondit, si dhe autoritetit.

9. Në përfundim të likuidimit vullnetar ose mbylljes së fondit të investimeve ose nënfondit, sipërmarrja ose nënfondi çregjistrohet nga regjistri, që mbahet nga autoriteti, në zbatim të nenit 8 të këtij ligji.

### SEKSIONI 3

## LIKUIDIMI DHE MBYLLJA VULLNETARE E SHOQËRIVE TË INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE DHE SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE

Neni 177

### **Likuidimi vullnetar i shoqërive të investimeve me ofertë publike dhe i shoqërive administruese të фондеве**

1. Këshilli i administrimit nxjerr vendimin për hapjen e likuidimit vullnetar, vendim i cili duhet të merret nga jo më pak se 75 % e anëtarëve të asamblesë së përgjithshme të subjektit të licencuar. Anëtarët e asamblesë së përgjithshme duhet të informohen për propozimin për likuidim të paktën 30 ditë përpara mbledhjes së asamblesë.

2. Vendimi në bazë të pikës 1, të këtij neni, nuk kërkohet lidhur me shoqërinë e investimeve, nëse kërkesa që shoqëria të likuidohet vullnetarisht bëhet vetëm në rastet e mëposhtme:

a) në datën kur mbaron kohëzgjatja e përcaktuar e shoqërisë ose kur ndodhin rrethanat e përcaktuara në statutin e shoqërisë, si raste të likuidimit të shoqërisë;

b) në rast të përfundimit të detyrave të depozitarit ose shoqërisë administruese të fondit të investimeve, nëse ato nuk zëvendësohen brenda 60 ditëve pune;

c) nëse aktivet neto të shoqërisë së investimeve bien nën nivelin minimal të kapitalit të shoqërisë së investimeve, të deklaruara në prospektin SIK për më shumë se gjashtë muaj;

ç) kur shoqëria e investimeve që bashkohet dhe që i ka kaluar aktivet shoqërisë marrëse të investimeve, në zbatim të kreut X, të këtij ligji, mbetet pa aktive në përfundim të procesit të bashkimit.

3. Kërkesa për likuidim vullnetar i paraqitet për miratim paraprak autoritetit, së bashku me dokumentet e mëposhtme:

a) vendimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë lidhur me likuidimin;

b) arsyet e likuidimit;

c) emrat e propozuar të likuiduesve;

ç) pasqyrën e audituar të aftësisë paguese;

d) një raport të hollësishëm për trajtimin e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë likuidimit, si dhe një vlerësim të kohëzgjatjes së procesit.

4. Të paktën 2 persona fizikë, të aftë dhe të përshtatshëm për kryerjen e detyrave, emërohen si likuidues, të cilët miratohen paraprakisht nga autoriteti dhe të cilët kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara.

5. Autoriteti merr vendim lidhur me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 3, të këtij neni, brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin e plotë, të parashikuar po në pikën 3 të këtij neni. Autoriteti miraton likuidimin vullnetar, vetëm nëse gjykon se mund të paguhet të gjitha detyrimet kundrejt pronarëve dhe kreditorëve të shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe, personat kyç të shoqërisë kryejnë detyrat e zakonshme, por nuk angazhohen në detyrime të reja kundrejt të tretëve.

6. Vendimi i asamblesë së përgjithshme nuk sjell pasoja juridike nëse autoriteti refuzon të japë miratimin për hapjen e procedurës së likuidimit vullnetar.

7. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit vendimin e miratimit për hapjen e likuidimit vullnetar.

8. Në rastet kur autoriteti miraton procedurën e likuidimit vullnetar, ai mund të vendosë:

a) të kufizojë licencën për të ushtruar veprimtarinë e shoqërisë dhe të lejojë kryerjen e veprimtarive të përcaktuara ose ato veprimtari që janë të nevojshme për likuidimin vullnetar;

b) të përcaktojë se deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të riskut në shoqërinë në likuidim vullnetar;

c) pavarësisht nga shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, autoriteti mund t’i kërkojë shoqërisë të ndërmarrë masa të posaçme lidhur me mbrojtjen e investitorëve ose ruajtjen e integritetit të tregut.

9. Shoqëria në procedurë likuidimi vullnetar vijon të ekzistojë në mënyrë që të shlyejë shpenzimet dhe detyrimet kundrejt të tretëve, të arkëtojë huatë, të shpërndajë aktivet dhe të kryejë veprimet e nevojshme për përfundimin e likuidimit vullnetar.

10. Likuiduesit mund të shkarkohen dhe të zëvendësohen sipas të njëjtave kushte të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

11. Paditë apo kërkesat lidhur me kompensimin e likuiduesit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

12. Likuiduesi informon Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për qëllime regjistrimi për të drejtën e tij në përfaqësimin e shoqërisë, si dhe vë në dispozicion të saj dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13. Pas hapjes së procedurave të likuidimit, emërtimi i regjistruar i shoqërisë mban shënimin “në likuidim vullnetar”.

14. Likuiduesi merr të drejtat dhe detyrimet e administratorëve, që nga dita e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, likuiduesit i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet në mënyrë solidare, në përputhje me këtë ligj, me përjashtim të rastit kur akti i emërimit parashikon që likuiduesit të veprojnë veçmas nga njëri-tjetri. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë operacione të një kategorie të veçantë. Likuiduesi është objekt i mbikëqyrjes nga asambleja e përgjithshme.

15. Detyra e likuiduesve është të përmbyllë të gjitha operacionet e shoqërisë, të mbledhin huatë e pambledhura, të shesin aktivet e shoqërisë dhe të paguajnë kreditorët, duke respektuar rendin e klientëve, në përputhje me nenin 191 të këtij ligji.

16. Nëse, në bazë të të drejtave të kërkueshme të kreditorëve, likuiduesit arrijnë në përfundimin që pasuria dhe aktivet e shoqërisë janë të pamjaftueshme për shlyerjen e këtyre të drejtave, likuiduesit pezullojnë procedurën e likuidimit dhe i kërkojnë gjykatës përkatëse hapjen e procedurës së falimentit.

17. Likuiduesi harton një pasqyrë bilanci të situatës së shoqërisë pas emërimit të tij. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 vit, likuiduesi harton edhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pasqyra e bilancit miratohet me vendim të një të dytës së anëtarëve të asamblesë së përgjithshme.

18. Likuiduesi i fton kreditorët e shoqërisë, duke përjashtuar aksionarët, të parashtrajnë pretendimet e tyre në likuidimin vullnetar. Shoqëria publikon 2 herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, si dhe faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

19. Likuiduesi nuk i shpërndan aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit 3-mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve për ngritjen e pretendimeve të tyre.

20. Nëse një kreditor i shoqërisë, për të cilin likuiduesi ka dijeni, nuk parashtron pretendime, shuma përkatëse depozitohet në llogarinë bankare të shoqërisë. Kjo shumë nuk mund të sekuestrohet për detyrime të tjera të shoqërisë. Në përfundim të likuidimit vullnetar, këto shuma i kalohen fondit të edukimit të investitorëve pranë autoritetit.

21. Nëse një detyrim nuk shlyhet dot menjëherë ose është objekt i pretendimeve të kërkueshme, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë një garanci e përshtatshme.

22. Pas shlyerjes së detyrimeve kundrejt kreditorëve dhe anëtarëve, likuiduesi i shpërndan

aktivet e mbetura në mënyrë përpjesëtimore aksionarëve.

23. Pas pagimit të detyrimeve të shoqërisë kundrejt kreditorëve dhe aksionerëve, likuiduesi i dorëzon autoritetit, brenda 12 muajve, një raport për procedurën e likuidimit dhe një propozim për shpërblimin e punës së tij.

24. Nëse autoriteti nuk e miraton raportin, likuiduesi ndjek rekomandimin e bërë nga autoriteti.

25. Pas miratimit të raportit nga likuiduesi, autoriteti heq licencën e dhënë shoqërisë.

26. Pas heqjes të licencës nga autoriteti, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit mbi përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

27. Asnjë ankesë ose kundërshtim nuk mund të bëhet kundër veprimtarisë së likuiduesit pas përfundimit të çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

28. Autoriteti mund të hartojë rregulla të mëtejshme për likuidimin vullnetar të shoqërisë së investimeve alternative, depozitarëve dhe depozitarëve të fondeve të investimeve alternative.

29. Aktivet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që ka nën administrim një shoqëri administruese, nuk mund të jenë objekt ekzekutimi, si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar dhe as të shlyerjes apo ekzekutimit të pretendimeve kundrejt shoqërisë administruese.

#### SEKSIONI 4

### MARRJA NË ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM E SHOQËRIVE TË LICENCUARA TË INVESTIMEVE DHE SHOQËRIVE TË LICENCUARA ADMINISTRUESE TË FONDEVE

Neni 178

#### **Marrja në administrim të përkohshëm**

1. Kur autoriteti gjykon në mënyrë të arsyeshme se shoqëria e investimeve, shoqëria administruese e fondeve, depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative nuk janë në gjendje të shlyejnë të gjitha detyrimet brenda afatit të 6 muajve të ardhshëm ose nëse këto persona të licencuar kanë mundësi të kalojnë në paaftësi paguese brenda 6 muajve të ardhshëm dhe nëse autoriteti e gjykon të arsyeshme që ka mundësi për të rehabilituar veprimtarinë e personit të licencuar, atëherë mund të nxjerrë urdhër administrativ për vendosjen në administrim të përkohshëm të personit të licencuar në fjalë.

2. Autoriteti informon personin e licencuar mbi arsyet e masave të propozuara, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, dhe periudhën e propozuar të administrimit të përkohshëm, që nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj.

3. Çdo urdhër administrativ, që nxjerr autoriteti, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, publikohet në faqen e internetit të autoritetit dhe të personit të licencuar në fjalë.

4. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohen nëse ndaj personit të licencuar janë hapur procedurat e likuidimit.

## Neni 179

### **Pasojat e marrjes në administrim të përkohshëm**

1. Të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve, personave kyç dhe personelit kyç të personit të licencuar pezullohen gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm.
2. Ky pezullim fillon nga data e marrjes së njoftimit të urdhrimit administrativ të autoritetit, në zbatim të pikës 1, të nenit 178, të këtij ligji.

## Neni 180

### **Emërimi dhe shkarkimi i administratorit të përkohshëm**

1. Afati dhe fusha e veprimit të administratorit të përkohshëm përcaktohen nga autoriteti, në vendimin për marrjen në administrim të përkohshëm të personit të licencuar, në zbatim të pikës 1, të nenit 178, të këtij ligji.
2. Në momentin e emërimit, administratori i përkohshëm mund të ushtrojë kompetencat dhe funksionet që përcakton autoriteti për t'i dhënë mundësi këtij administratori të vlerësojë dhe të konstatojë nëse është i mundshëm shpëtimi dhe rehabilitimi i personit të licencuar.
3. Autoriteti përcakton tarifat dhe shpenzimet e administratorit të përkohshëm dhe përcakton nëse ato paguhen nga personi i licencuar që merret në administrim të përkohshëm.
4. Autoriteti përcakton nëse administratori i përkohshëm është i aftë dhe i përshtatshëm, sipas nenit 14, të këtij ligji, dhe nëse zotëron kualifikimet dhe përvojën e përshtatshme për këtë pozicion. Administratori i përkohshëm duhet të zotërojë përvojë pune, jo më pak se 5 vjet në fushën e administrimit të fondeve.
5. Administratori i përkohshëm nuk mund të emërohet si i tillë nëse:
  - a) është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare; për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
  - b) autoriteti gjykon në momentin e caktimit lidhur me aftësinë dhe përshtatshmërinë e tij për të kryer detyrat e administratorit të përkohshëm;
  - c) është subjekt i një vendimi gjykate që e bën të pamundur përmbushjen e detyrave të administratorit të përkohshëm; ose
  - ç) ka konflikt interesi me autoritetin ose me personin e licencuar.
6. Autoriteti mund të shkarkojë dhe të zëvendësojë administratorin e përkohshëm, nëse gjykon se administratori i përkohshëm nuk është i aftë dhe i përshtatshëm për kryerjen e administrimit të përkohshëm, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

## Neni 181

### **Kompetencat dhe detyrimet e administratorit të përkohshëm**

1. Administratori i përkohshëm kryen një administrim të duhur të personit të licencuar, me qëllim rikthimin e personit të licencuar në gjendje të qëndrueshme financiare.
2. Administratori i përkohshëm, pas emërimit, kryen këto detyra:
  - a) sipas rastit, njofton çdo degë të personit të licencuar për datën dhe orën e hyrjes në fuqi të administrimit të përkohshëm;

b) publikon njoftimin në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të autoritetit;

c) i paraqet këtë njoftim autoritetit.

3. Personi i licencuar i mundëson administratorit të përkohshëm të gjitha evidencat, llogaritë dhe çdo dokumentacion tjetër dhe harton një raport për gjendjen financiare të tij për administratorin e përkohshëm dhe për autoritetin.

4. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të kërkojë informacione të tjera shtesë nga personi i licencuar, në funksion të kryerjes së detyrave dhe funksioneve të veta.

5. Administratori i përkohshëm merr të gjitha masat për ruajtjen e aktiveve të personit të licencuar, përfshirë, ndër të tjera:

a) ruajtjen e pasurive ose evidencave (të kompjuterizuara ose të mbajtura në formate të tjera) dhe të drejtën e hyrjes në mjediset e subjektit të licencuar ose në një pjesë të tyre;

b) garantimin e personelit kyç për të kryer veprimtaritë e përditshme të punës;

c) njoftimin e të gjitha palëve përkatëse se autorizimet e dhëna përpara emërimit të tij pezullohen dhe pagesat për shërbimet, duke filluar që nga data e marrjes në administrim të përkohshëm mund të autorizohen vetëm nga personat e caktuar nga administratori i përkohshëm;

ç) ndërprerjen e pagimit të dividendëve ose të çdo forme shpërndarjeje të kapitalit të aksioneve, duke filluar që nga data e marrjes në administrim të përkohshëm.

6. Të gjitha transaksionet e kryera gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm pa autorizim të rregullt nga administratori i përkohshëm janë të pavlefshme.

Neni 182

### **Plani i shpëtimit të biznesit**

Administratori i përkohshëm, pas emërimit, kryen këto detyra:

a) planifikon, nëse është e mundur, rimëkëmbjen e personit të licencuar duke ndërmarrë, të paktën, njërën prej masave të mëposhtme:

i. riklasifikimin e cilësisë së aktiveve të personit të licencuar;

ii. riklasifikimin e veprimtarive të personit të licencuar në veprimtari me shumë pak ose aspak risk;

iii. identifikimin e aktiveve dhe huave, si dhe ndërmarrjen e hapave për të garantuar vlerësimin dhe shlyerjen e tyre;

b) harton dhe dorëzon në autoritet një plan biznesi për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e personit të licencuar, plan i cili mbron më mirë interesat e këtij personi dhe të aksionarëve dhe kreditorëve të tij sa likuidimi i detyruar;

c) shet të gjitha ose një pjesë të aktiveve të personit të licencuar;

ç) negocion bashkimin ose shitjen e personit të licencuar te një person tjetër i licencuar ose kërkon kapital shtesë për personin e licencuar; ose

d) nëse ndërmarrja e masave të parashikuara në shkronjat “a” deri në “ç”, të këtij neni, nuk sjell rezultatet e pritshme, administratori i përkohshëm informon autoritetin se nuk ka alternativë tjetër, përveç fillimit të procedurës së likuidimit të detyruar.

## Neni 183

### **Raportimi në autoritet**

1. Administratori i përkohshëm raporton periodikisht autoritetin për ecurinë e procesit të administrimit të përkohshëm lidhur me:

a) pozicionin financiar dhe gjendjen operative të personit të licencuar gjatë procesit të administrimit të përkohshëm, të paktën 1 herë në muaj;

b) pozicionin financiar dhe gjendjen operative të personit të licencuar lidhur me rehabilitimin e mundshëm, brenda 6 muajve pas marrjes në administrim të përkohshëm, ku përfshihen informacionet dhe të dhënat e mëposhtme:

i. vlerësimi i gatishmërisë së aksionarëve për të mbuluar humbjet përmes futjes së kapitalit shtesë ose përmes burimeve të tjera të injektimit të kapitalit;

ii. mundësia e mbulimit të humbjeve të ngelura pas zbatimit të masave të parashikuara në nënndarjen “i” të kësaj shkronje;

iii. çdo detyrim ose shpenzim i paparashikuar ose i kushtëzuar, që ka ndikim të borxhi i personit të licencuar;

iv. vlerësimi i masave të mundshme për lehtësimin nga vështirësitë financiare dhe një preventiv të kostove për vënien në zbatim të këtyre masave;

v. vlerësimi i kushteve që bëjnë të nevojshëm fillimin e procedurës së likuidimit të detyruar.

2. Gjatë hartimit të raporteve, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, administratori i përkohshëm angazhohet për mbrojtjen e interesave të kreditorëve dhe klientëve të personit të licencuar dhe se asnjë shumë që përfaqëson paratë e klientëve ose që janë caktuar për shlyerjen e transaksioneve ende të pashlyera nuk mund të përfshihet në vlerësimin e aktiveve financiare të gatshme të personit të licencuar në fjalë.

3. Brenda 15 ditëve punë, nga marrja e raportit në zbatim të pikës 2, të këtij neni, autoriteti merr vendim për rekomandimin e propozuar për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e personit të licencuar ose, në rast të kundërt, për fillimin e procedurës së likuidimit të detyruar dhe njofton për këtë personin e licencuar dhe administratorin e përkohshëm.

## Neni 184

### **Vlerësimi i rezultateve të administrimit të përkohshëm**

1. Autoriteti vlerëson rezultatet e administrimit të përkohshëm çdo 3 muaj, duke filluar nga data e marrjes së vendimit për administrimin e përkohshëm.

2. Autoriteti harton një raport vlerësimi përfundimtar të administrimit të përkohshëm të personit të licencuar, brenda 3 muajve nga marrja e raportit përfundimtar mbi administrimin e përkohshëm në përfundim të administrimit të përkohshëm, në zbatim të nenit 185 të këtij ligji.

3. Autoriteti mund të miratojë rregulla të mëtejshme për vlerësimin e marrjes në administrim të përkohshëm të personave të licencuar.

## Neni 185

### **Përfundimi i administrimit të përkohshëm**

1. Administrimi i përkohshëm përfundon në rastet e mëposhtme:

a) në përfundim të afatit të përcaktuar në vendimin e autoritetit për vendosjen në administrim të përkohshëm të personit të licencuar;



b) me vendim të autoritetit përpara përfundimit të periudhës së administrimit të përkohshëm, kur e konsideron personin e licencuar të rehabilituar, në bazë të raportit përfundimtar për vlerësimin e rezultateve të parashikuara në pikën 2, të nenit 184, të këtij ligji, dhe kur:

i. autoriteti konstaton se gjendja financiare e personit të licencuar është përmirësuar gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm;

ii. personi i licencuar ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij;

iii. personi i licencuar mund të kryejë veprimtarinë e tij normalisht;

c) me vendim të autoritetit për të vendosur personin e licencuar në procedurë të likuidimit të detyrueshëm.

2. Vendimi i nxjerrë nga autoriteti, në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, shoqërohet me një plan të hollësishëm rehabilitimi të përpiluar nga administratori i përkohshëm, ku identifikohen pikat e dobëta në administrimin dhe funksionimin e personit të licencuar dhe detajohen:

a) masat korrigjuese të nevojshme për përmirësimin e situatës; dhe

b) një plan financiar për rehabilitimin e propozuar të personit të licencuar.

## SEKSIONI 5

### LIKUIDIMI I DETYRUESHËM I SHOQËRIVE TË LICENCUARA TË INVESTIMEVE DHE SHOQËRIVE TË LICENCUARA ADMINISTRUESE TË FONDEVE

#### Neni 186

#### **Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm**

1. Autoriteti merr vendim për vendosjen në likuidim të detyrueshëm të subjekteve të licencuara, në zbatim të këtij ligji, kur konstaton se ekzistojnë një ose më shumë prej rrethanave të mëposhtme:

a) personi i licencuar nuk është në gjendje të shlyejë borxhet e veta brenda afatit;

b) personi i licencuar kryen ose ka kryer veprimtari në shkelje të këtij ligji;

c) autoriteti gjykon se është vendimi i duhur dhe i drejtë që personi i licencuar të ndërpresë veprimtarinë e tij;

ç) kjo procedurë rekomandohet në kuadër të një procesi të përfunduar rimëkëmbjeje dhe rehabilitimi.

2. Autoriteti, për të garantuar mbrojtjen e investitorëve në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, mund të kërkojë që këto sipërmarrje t'i kalohen një personi tjetër të licencuar si shoqëri administruese ose si depozitar për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.

#### Neni 187

#### **Vendimi për likuidimin e detyrueshëm**

1. Autoriteti vlerëson situatën dhe vendos lidhur me fillimin e procedurave të likuidimit të detyrueshëm.

2. Autoriteti vendos personin e licencuar në likuidim të detyrueshëm menjëherë pasi arrin në një përfundim lidhur me rrethanat përkatëse të parashikuara në nenin 186 të këtij ligji.

3. Autoriteti publikon vendimin e vendosjes së shoqërisë në likuidim të detyrueshëm në faqen e tij të internetit.

Neni 188

### **Likuiduesi i personave të licencuar**

1. Të gjitha kompetencat dhe detyrat e personit të licencuar transferohen tek autoriteti, i cili cakton likuiduesin për të shitur dhe shpërndarë aktivet e personit të licencuar. Likuiduesit janë persona fizikë që janë të aftë dhe të përshtatshëm për të kryer detyrat e tyre dhe kanë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme, sipas nenit 14 të këtij ligji.

2. Procesi i likuidimit të detyrueshëm kryhet nga likuiduesit e emëruar nga autoriteti.

3. Likuiduesit zbatojnë kërkesat ligjore lidhur me ruajtjen e fshehtësisë së informacionit, në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 189

### **Pasojat e likuidimit të detyrueshëm**

1. Vendosja e shoqërisë në likuidim të detyrueshëm ka pasojat juridike të mëposhtme:

a) të gjitha kompetencat dhe detyrat e personit të licencuar i transferohen autoritetit, i cili cakton likuiduesin për të shitur dhe shpërndarë aktivet e personit të licencuar, në zbatim të nenit 190, të këtij ligji, dhe për të mbrojtur interesat e klientëve individualë të personit të licencuar ose për të ruajtur qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e tregut;

b) pezullimin e licencës së personit të licencuar, i cili nuk kryen veprimtari të reja, me përjashtim të atyre që kryhen në funksion të qëllimeve, të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) pezullimin dhe mosfillimin e proceseve ligjore dhe ekzekutimin e detyrueshëm të shoqërisë. Këto procedura nuk fillohen, pezullohen, me përjashtim kur autoriteti jep pëlqimin e tij dhe sipas kushteve të caktuara nga autoriteti;

ç) pezullimin për një periudhë 6-mujore të së drejtës për kompensim për kreditorët e shoqërisë;

d) nuk paguhet asnjë interes apo borxh tjetër i shoqërisë, me përjashtim të sa janë të nevojshme për të kryer ekzekutimin e rregullt të transaksioneve të tregut, në mënyrë që të parandalohet ndërprerja e funksionimit të sistemit financiar. Detyrimet ndaj kreditorëve shlyhen nga shitja e aktiveve të shoqërisë dhe në përputhje me pranimin e të drejtave të kërkuara, siç parashikohet në nenin 193 të këtij ligji;

dh) përfundimi i të gjitha kompetencave dhe përgjegjësisë të asamblesë së aksionarëve dhe këshillit të shoqërisë.

2. Çdo veprim ligjor për kryerjen e pagesave ose për kalimin e titullit të pronësisë të shoqërisë quhet i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) gjatë 3 muajve të fundit, përpara se autoriteti të vendosë shoqërinë në likuidim të detyrueshëm; ose

b) gjatë 12 muajve, përpara se autoriteti të marrë vendim për likuidimin e detyrueshëm, që favorizon përfituesit kundrejt kreditorëve të tjerë të shoqërisë;

c) përtej periudhave të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, në rastet kur likuiduesi vërteton se synimi ka qenë fshehja e pasurisë së shoqërisë nga kreditorët ose që veprimi ka ndikuar në mungesën e aftësisë paguese të shoqërisë.

### **Detyrimet dhe të drejtat e likuiduesit**

1. Likuiduesi kryen administrimin dhe shitjen e aktiveve e të pasiveve dhe shpërndarjen e shumave të arkëtuara te kreditorët.

2. Likuiduesi bashkëpunon me autoritetin dhe zbaton udhëzimet e autoritetit lidhur me procesin e likuidimit të detyrueshëm.

3. Menjëherë pas emërimit, likuiduesi merr në kontroll shoqërinë, duke siguruar aktivet, librat dhe llogaritë e saj. Likuiduesi ka të drejtë akses në të gjitha aktivet, zyrat dhe librat e shoqërisë.

4. Likuiduesi bën inventar të aktiveve dhe pasurive të shoqërisë dhe harton një pasqyrë bilanci dhe relacion shpjegues lidhur me zërat e bilancit brenda 30 ditëve kalendarike, pas fillimit të likuidimit, të cilat i dorëzohen autoritetit, ndërsa një kopje i vihet në dispozicion publikut.

5. Likuiduesi synon arritjen e shumës maksimale nga shitja e aktiveve të shoqërisë, duke kryer këto veprime:

- a) vijon ose ndërpret transaksionet financiare;
- b) punëson nëpunësit, punonjësit ose këshilltarët e nevojshëm profesionalë;
- c) nënshkruan akte në emër të shoqërisë dhe depoziton e ndjek kërkesëpadi në emër të tij, pasi merr miratimin paraprak të autoritetit.

6. Likuiduesi ka të drejtë të zgjidhë:

- a) kontratat e punësimit me cilindo person;
- b) kontratat e shërbimit, në të cilat është palë shoqëria;
- c) çdo detyrim tjetër, që lind nga kontratat e qirasë për pasuri të paluajtshme, që ka shoqëria në cilësinë e qiramarrësit.

7. Brenda 1 muaji pas emërimit, likuiduesi vepron si më poshtë:

- a) u dërgon me postë të regjistruar të gjithë aksionarëve dhe kreditorëve, në adresat e shënuara në regjistrat e shoqërisë, një pasqyrë mbi natyrën dhe shumën e detyrimit e pretenduara sipas regjistrave;
- b) regjistron pretendimet e ngritura e të dokumentuara të kreditorëve.

8. Brenda 1 muaji, pas datës së fundit të përcaktuar në njoftimin e dhënë, në bazë të pikës 7, të këtij neni, për detyrimet e pretenduara likuiduesi:

- a) përcakton shumën, nëse ka, që shoqëria i detyrohet secilit kreditor të ditur;
- b) përgatit për regjistrim pranë autoritetit, një strukturë të detyrimeve të pretenduara.

9. Çdo kreditor ose aksionar që përfaqëson të paktën 10 % të aksioneve të emetuara ka të drejtën të paraqesë kundërshtim lidhur me regjistrimin e detyrimeve të pashlyera, pranë autoritetit brenda 20 ditëve pas regjistrimit të strukturës së detyrimeve të pretenduara, në përputhje me pikën 8, të këtij neni. Autoriteti merr vendim për pranimin ose refuzimin e kundërshtimit, brenda 1 muaji nga data e regjistrimit të pretendimit.

10. Nëse kundërshtimi i parashikuar në pikën 9, të këtij neni, pranohet, likuiduesi ndryshon dhe përmirëson përkatësisht strukturën e detyrimeve të pretenduara ose masat e propozuara për shlyerjen e detyrimeve.

### **Rendi i përmbushjes së pretendimeve**

1. Likuiduesi shpërndan aktivet e shoqërisë, duke shlyer detyrimet ndaj kreditorëve dhe aksionarëve, sipas këtij rendi:

a) çdo kreditor i mbuluar me garanci kolaterali, i cili nuk mund të përdorë pasurinë me të cilën është garantuar detyrimi i tij, për shkak të kufizimeve të përcaktuara me këtë ligj, deri në shumën e të ardhurave nga shitja e kolateralit;

b) shpenzimet e likuiduesit dhe autoritetit, të konstatuara në funksion të likuidimit të detyrueshëm;

c) pagat e punonjësve të shoqërisë, të mbajtur në punë nga likuiduesi, për ta asistuar në likuidimin e rregullt të sipërmarrjes;

ç) kreditorët e mbuluar dhe të pambuluar me garanci lidhur me vlerën e detyrimit, që e tejkalon vlerën e shitjes së kolateralit;

d) aksionarët.

2. Kur shuma për shlyerjen e kreditorëve, me të njëjtin rend përparësie nuk është e mjaftueshme për t'i shlyer plotësisht këta kreditorë, atëherë ato shlyhen në mënyrë proporcionale me detyrimet ndaj tyre.

3. Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara shpërndahet mes aksionarëve në përpjesëtim me të drejtat dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital.

### **Ankimi**

1. Të gjitha detyrimet e pretenduara për dhe në lidhje me paaftësinë paguese të shoqërisë bëhen në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

2. Të drejtën për të kundërshtuar vendimin për likuidimin e detyrueshëm dhe për të kërkuar pezullim të procedurës së likuidimit të detyrueshëm, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimit për likuidimin e detyrueshëm dhe emërimin e likuiduesit në Fletoren Zyrtare, e kanë:

a) aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 10 % të aksioneve të emetuara;

b) kreditorët, të cilët përbëjnë të paktën një të tretën e shumës totale të pasiveve, të pretenduar nga kreditorët e tjerë, me përjashtim të aksionarëve.

3. E drejta për të ngritur padi mund të ushtrohet vetëm nëse:

a) autoriteti ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe me pakujdesi për vendosjen në procedurë likuidimi, sipas rrethanave faktike dhe dispozitave të këtij ligji për likuidimin e detyrueshëm të shoqërisë;

b) autoriteti, likuiduesi dhe punonjësit profesionistë të emëruar për të asistuar likuiduesit janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet, në shkelje të dispozitave të këtij ligji, që lidhen me kryerjen e funksioneve dhe detyrimeve në procesin e likuidimit, përfshirë rastet kur këto veprime ose mosveprime janë qëllimisht të gabuara.

4. Pavarësisht nga shqyrtimi gjyqësor, në bazë të këtij neni, procesi i likuidimit të detyrueshëm i nisur nga autoriteti kryhet pa kufizime, deri në daljen e vendimit të gjykatës, me përjashtim të rastit kur gjykata merr një vendim pezullimi.

Neni 193

### **Raportimi në autoritet**

1. Likuiduesi i raporton autoritetit çdo muaj mbi ecurinë e procesit të likuidimit. Këto raporte përmbajnë informacione për shumën totale të pasiveve të kërkuara, shumën totale të aktiveve të shitura të shoqërisë dhe të shumës së të ardhurave të pritura nga shitja e aktiveve.

2. Likuiduesi i paraqet një raport përfundimtar autoritetit pas mbylljes së procesit të likuidimit.

Neni 194

### **Shpërblimi i punës së likuiduesit**

Punonjësit profesionistë, përfshirë konsulentët, juristët, kontabilistët dhe këshilltarët që veprojnë me kontratë, të caktuar dhe të emëruar nga likuiduesi për ta asistuar, në përputhje me procedurat në zbatim të këtij seksioni dhe në varësi të kërkesës dhe kushteve të shërbimit, nuk paguhën më shumë se punonjësit e shoqërisë për të njëjtat shërbime, me përjashtim kur autoriteti ka autorizuar pagesën e shumave më të mëdha. Autoriteti e jep këtë autorizim, kur konstaton se pagesa e shumave më të larta është më se e domosdoshme për rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të nevojshëm.

## **KREU XII**

### **KOMPETENCAT E AUTORITETIT**

#### **SEKSIONI 1**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 195

### **Roli i autoritetit**

1. Autoriteti mbikëqyr subjektet e mëposhtme:

- a) sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe veprimtarinë e tyre;
- b) shoqëritë administruese të fondeve;
- c) depozitarët;
- ç) depozitarët e fondeve të investimeve alternative;
- d) agjentët e shitjeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- dh) aktivitetin e shoqërive të njohura administruese; dhe
- e) administruesit e fondeve të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti mbikëqyr subjektet e mësipërme duke ndërmarrë masat për të garantuar një mbikëqyrje efektive, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me këtë ligj dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij.

3. Autoriteti e ushtron mbikëqyrjen e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet:

a) monitorimit të veprimtarive, mbledhjes dhe verifikimit të raporteve dhe njoftimeve të depozituara nga shoqëritë administruese të fondeve, depozitarët, depozitarët e fondeve të

investimeve alternative dhe personave të tjerë, të cilët, sipas legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin për të raportuar në autoritet ose për ta njoftuar atë për çdo fakt ose rrethanë të veçantë;

b) kryerjes së inspektimeve në vend të çdo sipërmarrjeje të investimeve me ofertë publike, shoqërive administruese, administruesit të fondeve të investimeve alternative, depozitarit të fondeve të investimeve alternative ose agjentëve të shitjes së fondeve të investimeve alternative, me qëllim që të konstatohet nëse veprimtaria e personit të licencuar është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe kërkesave, sipas licencës së tij, si dhe me instrumentin përbërës të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe të prospektit SIK;

c) kryerjes së hetimeve administrative për çdo veprimtari të personit të licencuar në zbatim të këtij ligji, në mënyrë që të konstatohet nëse ushtron veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) vendosjes së masave mbikëqyrëse në përputhje me këtë ligj;

d) garantimit që informacioni, lidhur me këtë ligj, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji dhe dispozitave administrative të jenë të plota, të qarta dhe lehtësisht të aksesueshme edhe nëpërmjet mjeteve elektronike, të paktën në një gjuhë ndërkombëtare, si dhe të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme.

4. Autoriteti ushtron funksionet e tij mbikëqyrëse, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe metodologjinë me bazë risku.

5. Autoriteti ka kompetencën e hartimit, miratimit dhe ndryshimit të akteve rregullative, rregulloreve dhe udhëzimeve të parashikuara në këtë ligj dhe çdo akti tjetër rregullator, të paparashikuar në këtë ligj, por që autoriteti e gjykon si të nevojshëm në funksion të:

a) plotësimit dhe rregullimit të mëtejshëm të këtij ligji;

b) ushtrimit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi; dhe

c) mbarëvajtjes së vazhdueshme dhe të mëtejshme të tregut subjekt të këtij ligji.

6. Autoriteti ushtron kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga ana e subjekteve të këtij ligji.

7. Në rast se ekziston një dyshim i arsyeshëm se shkeljet lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, autoriteti i raporton autoritetit përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 196

### **Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit**

1. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje ose memorandum mirëkuptimi me çdo autoritet tjetër rregullator vendas dhe të huaj, autoritet rregullator në sektorin financiar, organizatat ndërkombëtare që përfaqësojnë autoritetet rregullatore financiare, agjencitë ose institucione kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose agjenci ligjzbatuese, për të shkëmbyer informacionet e nevojshme apo për të bashkëpunuar për kryerjen e veprimtarisë së mbikëqyrjes, ashtu siç është përcaktuar në këtë ligj.

2. Autoriteti shkëmben me autoritetet e tjera rregullatore, vendase ose të huaja:

a) informacion për lëshimin e licencave;

b) informacion për subjektet e mbikëqyrura;

c) informacion që lidhet me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ç) informacion që lidhet me mashtrimin gjatë ushtrimit të veprimtarive të lidhura me sipërmarrjet e investimeve kolektive;

d) informacion për personat kyç dhe personelin kyç të personave të licencuar në zbatim të këtij ligji.

3. Autoriteti bashkëpunon dhe bashkërendon punën e tij me autoritetet e tjera rregullatore dhe me institucionet e tjera ligjore, vendase ose të huaja, në mënyrë që të mbikëqyrë marketingun ndërkufitar dhe administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Autoriteti dhe autoritetet e huaja duhet të konsultohen me njëra-tjetrën përpara se të ndërmarrin hapa të mëtejshëm.

4. Çdo informacion që autoriteti merr dhe jep, me autoritetet e tjera rregullatore, trajtohet si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes.

5. Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rreth fakteve dhe rrethanave që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij mbikëqyrëse dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

6. Autoriteti rregullator i vendit të origjinës së shoqërisë administruese, në bashkëpunim me autoritetin, pas njoftimit paraprak të tij, mund të kryejë inspektim në vend të një dege të themeluar në Republikën e Shqipërisë.

7. Autoriteti, kur e konsideron të nevojshme, kryen inspektime në vend, të një dege të shoqërisë administruese të themeluar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së kësaj dege me aktet ligjore dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

8. Autoriteti, në zbatim të këtij neni, mund të miratojë rregulla shtesë lidhur me bashkëpunimin, shkëmbimin dhe trajtimin e informacionit me institucionet e tjera të huaja apo vendase.

Neni 197

### **Imuniteti dhe dëmshpërblimi i punonjësve të autoritetit**

1. Bordi i autoritetit dhe punonjësit e autoritetit nuk mund të paditen në asnjë gjykatë për asnjë veprim a mosveprim të kryer në ushtrimin ose realizimin e kompetencave ose detyrave të dhëna të përcaktuara nga ky ligj, përveç nëse ky veprim ose mosveprim vërtetohet se është bërë me keqbesim.

2. Autoriteti dëmshpërblen bordin dhe punonjësit e tij kundrejt çdo shpenzimi ligjor për mbrojtjen në procesin ligjor, të ndërmarrë kundër këtyre personave, lidhur me akuzat për kryerjen ose moskryerjen e funksioneve zyrtare, brenda qëllimit të punësimit ose angazhimit të tyre, sipas këtij ligji, me kusht që ky person të ketë vepruar në mirëbesim.

Neni 198

### **Konfidencialiteti**

1. Autoriteti bën publik objektivat e politikave që ndjek dhe raporton për veprimtaritë dhe efektivitetin në ndjekjen e objektivave, duke përfshirë edhe informacionin e marrë gjatë ushtrimit të detyrave të autoritetit nëse përhapja e tyre nuk cenon interesat tregtare ose emrin e mirë të subjektit apo të personit/institucionit që ka vënë në dispozicion informacionin në fjalë.

2. Çdo informacion që merr autoriteti gjatë ushtrimit të funksioneve të tij trajtohet si konfidencial dhe nuk publikohet nga autoriteti, anëtarët e bordit, punonjësit e tij ose kontraktorët dhe përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes.

3. Informacioni i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, trajtohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mund të bëhet publik pas

marrjes së pëlqimit të personit/institucionit, që e ka dhënë këtë informacion dhe/ose që preket nga ky informacion.

4. Në përjashtim të pikës 3, të këtij neni, autoriteti mund të bëjë publik informacionin në fjalë, nëse e gjykon të nevojshëm, në rastet e mëposhtme:

- a) kur i mundëson autoritetit realizimin e ndonjë prej funksioneve të tij;
- b) për qëllime të parandalimit ose zbulimit të një vepre penale;
- c) për përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve kombëtare/ndërkombëtare;
- ç) për të ndihmuar çdo autoritet rregullator vendas ose të huaj ose agjenci ligjzbatuese, sipas neni 196 të këtij ligji.

5. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit.

Neni 199

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

Përpunimi i të dhënave personale nga autoriteti, në zbatim të këtij ligji, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **SEKSIONI 2**

### **FUSHA E MBIKËQYRJES SË AUTORITETIT**

Neni 200

### **Fusha e mbikëqyrjes**

1. Autoriteti është përgjegjës për mbikëqyrjen e themelimit dhe marketimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të veprimtarive të shoqërive të administrimit të fondeve, degëve të shoqërive të huaja administruese, të administruesve të fondeve të investimeve alternative, të shoqërive administruese të njohura, të administruesve të fondeve të investimeve alternative, depozitarëve, depozitarëve të fondeve të investimeve alternative, si dhe agjentëve/distributorëve të tyre të shitjeve në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo personi tjetër që vepron si i tillë me miratim me shkrim të dhënë në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Ky parashikim zbatohet edhe për personin, të cilit subjektet e lartpërmendura i kanë deleguar funksione në zbatim të këtij ligji.

2. Veprimtaritë mbikëqyrëse të autoritetit kryhen nëpërmjet:

a) hartimit, miratimit dhe ndryshimit të akteve rregullatore, rregulloreve dhe udhëzimeve të parashikuara në këtë ligj;

b) publikimit të udhëzimeve me shkrim lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji dhe të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji;

c) hartimit dhe miratimit të modeleve tip të licencave, njohjes dhe regjistrimit, të parashikuara në këtë ligj dhe që përdoren për raportim në autoritet, në zbatim të këtij ligji;

ç) dhënies, refuzimit, pezullimit ose heqjes së licencave, njohjes dhe regjistrimit, sipas këtij ligji dhe miratimeve të prospekteve SIK për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike brenda afateve, kushteve dhe procedurave, në bazë të legjislacionit në fuqi;

d) miratimit të ndryshimeve të rëndësishme të licencave, njohjes dhe regjistrimit, sipas këtij ligji;

dh) miratimit të ndryshimeve të pjesëmarrjeve influencuese në subjektet e licencuara, në zbatim të këtij ligji;



- e) shqyrtimit të kërkesave për veprimtari jashtë terrorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë hapjen e zyrave përfaqësuese dhe degëve në vende të tjera;
- ë) miratimit ose refuzimit të transferimit të kontratave të administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- f) miratimit ose refuzimit të bashkimeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të marrjeve në kontroll të shoqërive të investimeve me ofertë publike;
- g) miratimit të likuidimit vullnetar të personave të licencuar, në zbatim të këtij ligji;
- gj) hapjes dhe mbikëqyrjes së procesit të administrimit të përkohshëm dhe likuidimit të detyrueshëm të personave të licencuar, në zbatim të këtij ligji dhe emërimit të likuiduesve;
- h) depozitimit të pasqyrave financiare të subjekteve të licencuara, në zbatim të këtij ligji;
- i) miratimit të modeleve tip të raportimit financiar për subjektet e licencuara, në zbatim të këtij ligji;
- j) miratimit të audituesve të pavarur, për shoqëritë administruese të fondeve dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive, bazuar në kriteret e përcaktuara me rregullore;
- k) shqyrtimit të raporteve që depozitohen në autoritet personat e licencuar, të njohur dhe të regjistruar për të vlerësuar përputhshmërinë me këtë ligj dhe me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji;
- l) planifikimit dhe realizimit të inspektimeve në vend të veprimtarive të shoqërive administruese të licencuara/njohura, administruesve të fondeve të investimeve, të depozitarëve të licencuar dhe depozitarëve të licencuar të fondeve të investimeve alternative dhe të agjentëve të shitjeve, në zbatim të këtij ligji;
- ll) kërkimit dhe më pas vlerësimit të informacioneve/dokumentacionit të ndryshëm lidhur me veprimtarinë e të gjithë personave subjekt të këtij ligji, përfshirë komunikimet elektronike, telekomunikacionit dhe evidencave të tyre;
- m) kryerjes së hetimeve administrative ose caktimit të profesionistëve të jashtëm për të kryer hetime në emër të autoritetit;
- n) ndërprerjes së çdo veprimtarie që bie ndesh me këtë ligj;
- nj) ngrirjes së veprimtarisë së subjektit të licencuar jo më shumë se 72 orë dhe njoftimit menjëherë të organeve përgjegjëse për çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që kanë lidhje me pastrim parash ose financim terrorizmi, krimi ekonomik ose vepra penale që kanë lidhje me shoqëritë tregtare;
- o) pezullimit të përkohshëm të një ose më shumë prej elementeve të veprimtarisë profesionale;
- p) pezullimit të emetimit, shitjes, riblerjes dhe anulimit të kuotave ose emetimeve në interes të mbajtësve të kuotave ose aksioneve ose në interes të publikut;
- q) zbatimit të sanksioneve administrative për shkelje të dispozitave të këtij ligji;
- r) dërgimit për ndjekje penale të subjekteve të këtij ligji, për shkelje të këtij ligji rast pas rasti.

Neni 201

### **Tarifa e mbikëqyrjes dhe tarifat e tjera**

1. Shoqëritë administruese të fondeve, depozitarët, depozitarët e fondeve të investimeve alternative dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive (ose nënfondet) të licencuara, të njohura dhe të regjistruara i paguajnë autoritetit tarifë mbikëqyrjeje lidhur me licencën, njohjen ose regjistrimin. Tarifa e mbikëqyrjes paguhet në lekë.

2. Në rast të refuzimit të kërkesës për licencë, njohje ose regjistrim, tarifat e paguara nuk kthehen.

3. Autoriteti miraton rregulla të mëtejshme lidhur me tarifatat që i paguhen autoritetit nga shoqëritë administruese, administruesit e fondeve të investimeve alternative, depozitarëve, depozitarëve të fondeve të investimeve alternative dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike (ose nënfondeve) dhe për procedurat për arkëtimin dhe rakordimin e tarifave të mbikëqyrjes.

### SEKSIONI 3

#### DETYRAT E PERSONAVE TË LICENCUAR

Neni 202

##### **Detyrimi për të dhënë informacion**

1. Shoqëria administruese e fondeve i mundëson autoritetit çdo informacion që kërkohet për çështjet e lidhura me veprimtarinë e subjekteve të licencuara. Detyrimi për dhënie informacioni zbatohet edhe nga agjentët e lidhur me shoqërinë administruese dhe për depozitarët e licencuar dhe depozitarët e licencuar të fondeve të investimeve alternative lidhur me veprimtarinë e tyre, në zbatim të këtij ligji.

2. Autoriteti, në zbatim të parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, kërkon informacionet që i gjykon të rëndësishme në kuadër të kryerjes së detyrave të tij mbikëqyrëse, në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e autoritetit të mbikëqyrjes financiare.

3. Subjektet e licencuara i mundësojnë menjëherë autoritetit çdo informacion që zotërojnë, nëse janë në dijeni apo kanë arsye të besojnë se:

a) informacioni është i rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore të autoritetit lidhur me subjektet e licencuara, sipas këtij ligji;

b) mosdhënia e informacionit çon në keqinformimin dhe mashtrimin e autoritetit për çështje me rëndësi thelbësore në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore të tij lidhur me subjektet e licencuara/njohura, sipas këtij ligji.

4. Shoqëria administruese e fondeve, audituesit e saj, depozitari dhe depozitari i fondeve të investimeve alternative dhe audituesi i tij informojnë menjëherë autoritetin për çdo çështje që kanë dijeni ose që kanë arsye të besojnë sa më poshtë:

a) shoqëria administruese e fondeve, depozitari dhe depozitari i fondeve të investimeve alternative është ose është shumë e mundshme të kalojë në paaftësi paguese për t'i shlyer brenda afatit të gjitha detyrimet e tij ose nëse pasivët janë më të mëdha në vlerë se aktivet e tij;

b) shoqëria administruese e fondeve, depozitari ose depozitari i investimeve alternative nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat për mjaftueshmëri të kapitalit të këtij ligji ose të ligjit për tregjet e kapitalit;

c) gjendja ekzistuese ose e ndryshuar e aktivitetit mund të rrezikojë thelbësisht të drejtat e mbajtësve të kuotave/aksionarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të administruara nga shoqëria administruese e fondeve;

ç) audituesi i jashtëm planifikon të japë opinion me rezerva thelbësore në raportin e tij lidhur me auditimin për sipërmarrjen e investimeve kolektive, shoqërinë administruese të fondeve, depozitarin ose depozitarin e fondeve të investimeve alternative;

d) çdo veprimtari kriminale që lidhet me ofrimin e shërbimeve të tyre, përfshirë veprimtaritë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

### **Raportimi në autoritet**

1. Shoqëritë e licencuara/njohura administruese të fondeve dhe degët e shoqërive administruese të huaja dhe administruesve të huaj të fondeve të investimeve alternative, depozitarët dhe depozitarët e fondeve të investimeve alternative depozitojnë pranë autoritetit raporte dhe pasqyra financiare, sipas intervaleve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti dhe që mbulojnë objektin e informacioneve që kërkon autoriteti.

2. Raportet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive nën administrim ose të marketura nga shoqëria e licencuar/njohur administruese e fondeve ose nga dega e shoqërisë së huaj administruese përmbajnë, ndër të tjera:

a) përputhshmërinë në vazhdimësi me këtë ligj të funksionimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike që kanë nën administrim;

b) investimet dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive nën administrim, tregjet ku investojnë dhe instrumentet në të cilat investojnë sipërmarrjet përfshirë kategoritë e instrumenteve në të cilat bëhet investimi;

c) në rastin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, të dhëna që të vërtetojnë përputhshmërinë e çdo sipërmarrjeje dhe nënfondi në administrim me kërkesat përkatëse të kreut VII, të këtij ligji dhe përputhshmërinë me kërkesat për likuiditetin, të përcaktuara në akt nënligjor, në zbatim të këtij ligji.

ç) vlerën neto të aktiveve në çdo sipërmarrje të investimeve kolektive nën administrim, vlerën totale neto të aktiveve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike nën administrim dhe të fondeve të investimeve alternative nën administrim dhe të gjitha sipërmarrjeve të investimeve kolektive nën administrim, të dhëna për nënfondet sipas rastit;

d) vlerën neto të aktiveve dhe çmimet për çdo aksion ose kuotë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike nën administrim.

dh) vlerën e shitjeve ose shlyerjeve të pjesëmarrjeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive çdo ditë ose në një periudhë të caktuar për sipërmarrjen e investimeve kolektive të administruar dhe vlerën totale për të gjitha sipërmarrjet e administruara, të dhëna për nënfond sipas rastit;

e) numrin e aksioneve ose kuotave në qarkullim të sipërmarrjeve ose nënfondit dhe numrin e aksionarëve ose mbajtësve të kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit, të ndarë sipas kategorive të klientëve (profesionistë dhe të kualifikuar dhe joprofesionistë);

ë) rezultatet e provave të rezistencës që parashikohen nga ky ligj ose nga aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji.

3. Raportet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, lidhur me shoqërinë administruese të fondeve, përmbajnë informacione mbi përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji, përfshirë ndër të tjera për çështjet e:

a) emërimit dhe shkarkimit të personave kyç dhe personelit kyç;

b) emërimit dhe shkarkimit të audituesve të jashtëm;

c) fillimit ose ndërprerjes së planifikuar të veprimtarive;

ç) marketimit;

d) delegimit të funksioneve;

dh) planeve të biznesit;

e) kontratave të lidhura me agjentët e shitjeve.

4. Raportet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, lidhur me depozitarin dhe depozitarin e fondeve të investimeve alternative, përmbajnë informacione mbi përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji dhe me sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilave u ofrojmë shërbime,

përfshirë, ndër të tjera:

- a) emërimin dhe shkarkimin e personave kyç dhe personelit kyç;
- b) emërimin dhe shkarkimin e audituesve të jashtëm;
- c) fillimin ose ndërprerjen e planifikuar të veprimtarive;
- ç) delegimin e funksioneve;
- d) emrat e shoqërive administruese, si dhe emrat dhe vlerën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilave u ofrojnë shërbime dhe pasuritë e mbajtura në emër të këtyre sipërmarrjeve, përfshirë të dhëna që vërtetojnë ekzistencën e këtyre pasurive;
- dh) në rastin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondeve, vlerën neto ditore e aktiveve dhe çmimin për çdo kuotë të sipërmarrjeve me pjesëmarrje të hapur dhe me interval dhe nënfondeve, dhe numrin e përgjithshëm të kuotave në fjalë në secilën sipërmarrje ose nënfond.

5. Raportet, sipas parashikimeve të pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, dorëzohen çdo 3-mujor dhe më shpesh nëse konsiderohet e nevojshme nga autoriteti, sipas kërkesave të tij, me përjashtim të raporteve të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikës 4, të këtij neni, të cilat duhet të dorëzohen çdo ditë.

6. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë lidhur me raportimin, sipas parashikimeve të këtij neni mbi formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të këtyre raporteve lidhur me raportimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera, sipas parashikimeve të këtij neni.

## SEKSIONI 4

### INSPEKTIMI NË VEND

Neni 204

#### **Caktimi dhe raportet e ekspertëve**

1. Autoriteti i kërkon personit të licencuar, nëpërmjet njoftimit me shkrim, vënien në dispozicion të një raporti të hartuar nga një ekspert për çdo çështje që autoriteti ka kërkuar dhënie e informacionit ose mundësimin e dokumentacionit përkatës.

2. Autoriteti, në njoftimin e parashikuar, në pikën 1, të këtij neni, mund të përcaktojë mënyrën e (përzgjedhjes) caktimit të ekspertit në fjalë.

3. Personi i caktuar për të hartuar raportin e ekspertit është personi i propozuar nga autoriteti, i cili, sipas gjykimit të autoritetit, ka dijeni dhe aftësinë e nevojshme për të raportuar për çështjen në fjalë.

4. Personi i licencuar bashkëpunon plotësisht me personin e caktuar për të hartuar raportin e ekspertit.

5. Kostoja e raportit të ekspertit mbulohet nga personi i licencuar ose një subjekt tjetër përgjegjës, që është objekt i raportit.

Neni 205

#### **Inspektimi në vend**

1. Autoriteti kryen inspektime në vend lidhur me veprimtarinë e çdo sipërmarrjeje investimesh kolektive, shoqërie administruese, administruesi të fondeve të investimeve alternative, degë të një shoqërie të huaj administruese ose administruesi të huaj të fondeve të investimeve alternative ose agjentëve/distributorëve të tyre për shitjet, për të garantuar

përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji ose të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij, si dhe me kërkesat për zbatim të licencës, si dhe me aktin themelues të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe prospektin SIK.

2. Personat e licencuar, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, i mundësojnë autoritetit akses në të gjitha librat tregtarë dhe kontabël, dosjet dhe çdo dokument tjetër që printohet nga sistemi kompjuterik ose që ekziston në version origjinal.

3. Autoriteti cakton përfaqësuesit e autorizuar që do të kryejnë inspektimin në vend. Me kërkesë të përfaqësuesit të autorizuar nga autoriteti, personat e licencuar, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet:

a) të vendosin në dispozicion çdo raport dhe informacion për veprimtaritë dhe çështjet funksionale, që kanë lidhje me performancën e mbikëqyrjes që kryen autoriteti;

b) të mundësojnë inspektimin e veprimtarive dhe të lejojnë hyrjen në mjediset e tyre në zyrën qendrore dhe në çdo mjedis tjetër ose në një subjekt, të cilit subjekti i licencuar ka deleguar funksionet, në zbatim të këtij ligji;

c) të mundësojnë inspektimin e dokumentacionit të personit të licencuar, si dhe të dhënat tregtare dhe administrative të tij, në masën e nevojshme për kryerjen e inspektimit apo në masën e përcaktuar nga ligji, metodologjia, manualët ose udhëzuesit për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse, të miratuara nga autoriteti;

ç) të vendosin në dispozicion dokumentet e mbajtura në mënyrë elektronike dhe të printuara nga kompjuteri ose kopje të librave tregtarë/kontabël, dokumenteve dhe të dhëna të tjera administrative dhe tregtare;

d) të mundësojnë intervistim në një orë dhe vend të caktuar të personave dhe personelit kyç dhe punonjësve, sipas kërkesave të autoritetit, për t'iu përgjigjur pyetjeve ose për të dhënë informacione të lidhura me inspektimin, për aq sa është e përcaktuar nga ligji, metodika, manualët dhe udhëzimet për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse të miratuara nga autoriteti;

dh) të sigurojnë ambient pune të përshtatshëm për përfaqësuesit e autorizuar të autoritetit për kryerjen e inspektimit pa ndërhyrjen apo praninë e personave të tjerë;

e) t'u mundësojnë përfaqësuesve të autorizuar të autoritetit asistencën teknike të nevojshme në kontrollin e të dhënave dhe dokumentacionit të digjitalizuar të veprimtarisë së personit të licencuar dhe verifikimin e librave tregtarë dhe të dhënave të përpunuara në mënyrë elektronike;

ë) të vendosin në dispozicion të autoritetit dokumente, ku jepet një përshkrim i hollësishëm i sistemeve kompjuterike që pasqyrojnë çdo sistem apo dosje tjetër që ka lidhje me këto sisteme, si dhe të mundësojnë realizimin e të gjitha kërkesave të autoritetit për të kryer verifikimet përkatëse, duke përfshirë të drejta për të parë mënyrën e veprimit të sistemeve (kompjuterike), procedurat e *software*-it dhe masat kontrolluese që garantojnë përpunime të sakta, në kohë të sigurt të të dhënave, si dhe të masave kontrolluese, që parandalojnë hyrjen ose ndërhyrjen pa leje, të cilat mundësojnë gjurmë kontrolli. Krahas kësaj, ndryshimet e këtyre sistemeve duhet të regjistrohen në mënyrë kronologjike përfshirë datat e ndryshimeve dhe evidencat e këtyre ndryshimeve i vihen në dispozicion autoritetit.

4. Autoriteti mund të kryejë inspektime në vend me ose pa njoftim paraprak.

5. Inspektimet në vend kryhen në çdo vendndodhje që lidhet me veprimtarinë e personave të licencuar, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose të deleguarve të këtyre personave ose të agjentëve të këtyre personave, rast pas rasti, për të përmbushur funksionet mbikëqyrëse dhe rregullatore të autoritetit.

### **Programi i inspektimit të veprimtarisë**

1. Në rastin e inspektimit në vend me njoftim paraprak, autoriteti i dërgon personit të licencuar, të përcaktuar në pikën 1, të nenit 205, të këtij ligji, programin e inspektimit të veprimtarisë, jo më vonë se 10 ditë kalendarike përpara fillimit të inspektimit.
2. Programi i inspektimit të veprimtarisë përmban objektin e inspektimit.
3. Gjatë inspektimit të personit të licencuar, nëse e konsideron të nevojshme, me qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve të personit të licencuar, autoriteti mund të zgjerojë pa njoftim paraprak programin e inspektimit dhe të zgjasë kohëzgjatjen e planifikuar të inspektimit.
4. Autoriteti kryen inspektim edhe në bashkëpunim me autoritetet e tjera rregullatore ose institucione ligjzbatuese vendase ose të huaja, sipas programeve të përbashkëta të inspektimit të miratuar ndërmjet tyre.
5. Pas përfundimit të inspektimit, përfaqësuesi i autorizuar i autoritetit harton një raport për inspektimin e kryer dhe i dorëzon drejtuesve të lartë të personit të licencuar dokumentin kur paraqiten rezultatet e inspektimit.

## **SEKSIONI 5**

### **DHËNIA E MASAVE MBIKËQYRËSE**

#### **Masat mbikëqyrëse**

1. Me qëllim parandalimin, korigjimin apo ndërprerjen e rrethanave të parashikuara në nenet 208 dhe 209, të këtij ligji, apo veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij ligji ose akteve të nxjerra në zbatim të tij, autoriteti ndërmerr masat mbikëqyrëse, të parashikuara në këtë seksion të këtij ligji.
2. Në rastet kur autoriteti gjykon se moszbatimi i masës së mbikëqyrjes mund të sjellë dëm serioz për investitorët aktualë ose të mundshëm të sipërmarrjes së investimeve kolektive, masat mbikëqyrëse mund të kërkohen të zbatohen menjëherë.

#### **Rrethanat e masave mbikëqyrëse**

1. Autoriteti merr masat e mbikëqyrjes, të parashikuara në nenin 209, të këtij ligji, nëse gjykon se:
  - a) shoqëria administruese e fondeve, depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative është ose ka shumë mundësi të kalojë në paaftësi paguese për të shlyer të gjitha detyrimet brenda afatit ose nëse pasivet janë në vlerë më të madhe se aktivet;
  - b) shoqëria administruese e fondeve, depozitari ose depozitari i investimeve alternative nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat për mjaftueshmëri të kapitalit, në zbatim të këtij ligji ose të ligjit për tregjet e kapitalit;

c) gjendja ekzistuese ose e ndryshuar mund të rrezikojë thelbësisht të drejtat e mbajtësve të kuotave/aksionarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të administruara nga shoqëria administruuese e fondeve;

ç) audituesi i jashtëm jep opinion me rezerva thelbësore në raportin e tij për sipërmarrjen e investimeve kolektive, shoqërinë administruuese të fondeve, depozitarin dhe depozitarin e fondeve të investimeve alternative;

d) subjekti i licencuar është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krim ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare; për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

dh) personi i licencuar është shpallur fajtor për shkelje të detyrimeve profesionale, e cila arsyeton se vazhdimi i veprimtarisë mund të dëmtojë të mirën publike;

e) shoqëria administruuese e fondeve, depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative nuk zbaton urdhrin administrativ të nxjerrë, në zbatim të nenit 210 të këtij ligji;

ë) shoqëria administruuese e fondeve, depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative nuk përmbush në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e zbatueshme për licencim;

f) mbajtësi i një pjesëmarrjeje influencuese, personi kyç ose anëtar i personelit kyç të personit të licencuar nuk përmbush në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e nenit 14, të këtij ligji ose nuk e ka marrë miratimin e autoritetit;

g) investitorët e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike pësojnë humbje, si pasojë e shkeljes së dispozitave të këtij ligji;

gj) personi i licencuar nuk i raporton autoritetit, sipas kërkesave të këtij ligji;

h) shoqëria administruuese e fondeve, depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative ka shkelur ose ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti, në zbatim të tij.

2. Autoriteti mund të miratojë rregulla të tjera shtesë lidhur me rrethanat e masave mbikëqyrëse, si dhe lidhur me parimet e kriteret për mbivlerësimin e këtyre rrethanave.

## Neni 209

### **Dhënia e masave mbikëqyrëse**

1. Në rastet kur autoriteti vlerëson se personi i licencuar ndodhet në një apo disa prej rrethanave të përcaktuara në nenin 208, të këtij ligji, merr ndaj tij një ose disa nga masat mbikëqyrëse të mëposhtme:

a) urdhëron të ndalohet kryerja e një veprimi të caktuar ose urdhëron të kryhet një veprim i caktuar sjelljeje etike biznesi apo urdhëron që të kryhet një veprim i caktuar që, sipas gjykimit të autoritetit, është i nevojshëm për përmirësimin e situatës dhe/ose për parandalimin ose korrigjimin e shkeljeve të këtij ligji dhe akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të këtij ligji;

b) nxjerr urdhër administrativ për eliminimin e shkeljeve dhe parregullive;

c) urdhëron personin e licencuar të mundësojë një plan të rimëkëmbjes financiare për të arritur kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit;

ç) urdhëron personin e licencuar të kryejë auditimin e veprimtarisë financiare ose të sipërmarrjes të investimeve kolektive nën administrim, nga një auditues i zgjedhur nga autoriteti, por me shpenzimet e personit të licencuar, ose të shoqërisë administruuese të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike. Ose urdhëron personin e licencuar të shkarkojë audituesin dhe të emërojë një tjetër, sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti;

d) krahas sa parashikohet në shkronjën “ç”, të kësaj pike, autoriteti mund t'i kërkojë

audituesit të jashtëm të kryejë, me shpenzimet e personit të licencuar, një auditim të veçantë në interes të klientëve të personit të licencuar ose investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe t'i raportojë autoritetit për këtë;

dh) urdhëron personin e licencuar që, me shpenzimet e tij të emërojë një person të miratuar nga autoriteti që të këshillojë personin e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së tij në mënyrën e duhur dhe i cili i raporton autoritetit brenda 3 muajve nga data e emërimit të tij;

e) urdhëron personin e licencuar të mundësojë informacione të tjera shtesë dhe, nëse e gjykon të nevojshme, autoriteti rrit shpeshësinë e raportimit dhe kryen inspektimet përkatëse lidhur me këtë raportim;

ë) nëse autoriteti e shikon të nevojshme, zgjeron objektin dhe/ose rrit shpeshësinë e inspektimeve në vend të personi i licencuar, ose cakton punonjësit e autorizuar për kryerjen e inspektimeve për të ruajtur një pozicion në vazhdimësi;

f) urdhëron kryerjen e një vlerësimi të disa ose të gjitha prej aktiveve të personit të licencuar ose të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike nga autoriteti ose nga një person i emëruar nga autoriteti me shpenzimet e personit të licencuar ose të shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të tij;

g) urdhëron kufizimin nga shoqëria administruese, nga administruesi i fondeve të investimeve alternative, nga depozitari ose depozitari i fondeve të investimeve alternative, nga administrimi ose nga ofrimi i shërbimeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

gj) urdhëron shkarkimin e një personi kyç ose të një anëtari të personelit kyç të personit të licencuar;

h) vendos sanksion/e administrative gjobë/pezullim mbi personin e licencuar;

i) e vendos personin e licencuar në administrim të përkohshëm;

j) hap procedurën e likuidimit të detyrueshëm të personit të licencuar.

2. Autoriteti mund të miratojë rregulla të tjera shtesë lidhur me dhënien e masave mbikëqyrëse, në zbatim të këtij neni.

## Neni 210

### **Urdhrat administrativë të autoritetit**

1. Urdhrat administrativë, që nxjerr autoriteti në zbatim të nenit 209, të këtij ligji, jepen me shkrim dhe mund të përfshijnë, ndër të tjera:

a) urdhrin administrativ, drejtuar personave kyç të shoqërisë administruese për të pezulluar shitjen dhe shlyerjen e pjesëmarrjeve në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike;

b) urdhrin administrativ, drejtuar personave kyç të shoqërisë administruese të fondeve, depozitarit, depozitarit të fondeve të investimeve alternative ose shoqërisë së investimeve për të shkarkuar dhe zëvendësuar personat kyç dhe personelin kyç të këtij subjekti;

c) urdhrin administrativ, drejtuar subjektit të licencuar për marrjen e masave ndaj personave përgjegjës në rast të moseliminimit të shkeljeve, moszbatimit të masave të kërkuara, në zbatim të nenit 209, të këtij ligji, mosdorëzimit të raporteve të plota në afat për shkaqe të pajustificuara ose nëse pengon në çfarëdo lloj mënyre ushtrimin e mbikëqyrjes nga ana e autoritetit;

ç) urdhrin administrativ, drejtuar shoqërisë administruese të fondeve për t'ia transferuar kontratat për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive një shoqërie administruese tjetër të licencuar.

2. Urdhrat administrativë të autoritetit përcaktojnë afatin për eliminimin e shkeljes ose parregullsisë.

3. Urdhrat administrativë të autoritetit zbatohen nga personi i licencuar brenda afateve të



kërkuara.

4. Autoriteti mund të miratojë rregulla të tjera shtesë lidhur me urdhrat administrativë, në zbatim të këtij neni.

#### Neni 211

### **Raportimi mbi zbatimin e urdhrat administrativ**

1. Personat e licencuar, të cilëve u drejtohet urdhri administrativ nga autoriteti, i dorëzojnë autoritetit një raport të hollësishëm, duke përcaktuar masat e marra për të korrigjuar rrethanat, që janë objekt i këtij urdhri administrativ. Ky raport dorëzohet në autoritet, sipas shpeshëtisë së përcaktuar në urdhrin administrativ, që mund të jetë në mënyrë të përditshme ose në periudha kohore më të rralla. Së bashku me raportin e hollësishëm, personi i licencuar depoziton gjithashtu çdo dokument apo provë tjetër, që vërteton se janë eliminuar shkeljet apo parregullsitë në fjalë. Nëse e gjykon të arsyeshme, autoriteti mund të kërkojë gjithashtu përfshirjen e një raporti të hollësishëm nga një auditues i jashtëm ose një ekspert tjetër i emëruar lidhur me hapat e ndërmarrë për të korrigjuar rrethanat ose parregullsitë në fjalë.

2. Autoriteti, menjëherë mbas marrjes së raportit, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, verifikon korrigjimin e shkeljeve ose parregullsive, sipas përcaktimeve të urdhrat administrativ të dhënë, në zbatim të nenit 210, të këtij ligji. Autoriteti, përpara marrjes së vendimit, mund të kryejë një inspektim tjetër të veprimtarisë së personit të licencuar, i cili gjykohet si i nevojshëm për të verifikuar nëse janë eliminuar shkeljet dhe parregullsitë.

3. Nëse raporti i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, është i paplotë apo provat bashkëngjitur këtij raporti nuk vërtetojnë që janë eliminuar shkeljet ose parregullsitë, autoriteti i drejton personit të licencuar një urdhër administrativ për plotësimin e raportit të përmendur, në pikën 1, të këtij neni, brenda një afati kohor të caktuar.

4. Mosdorëzimi i raportit të plotë me prova të eliminimit të shkeljeve brenda afatit të përcaktuar, në zbatim të pikës 3, të këtij neni, përbën bazë për heqjen licence nga autoriteti.

5. Autoriteti shqyrton dhe vendos mbi raportin për korrigjimin e shkeljeve dhe parregullsive, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit dhe informacionit të plotë.

#### Neni 212

### **Heqja e licencës**

1. Autoriteti heq licencën e shoqërisë administruese të fondeve, depozitarit ose depozitarit të fondeve të investimeve alternative, nëse:

- a) licenca është mbështetur në dhënien e informacioneve të rreme ose të pasakta;
- b) personi i licencuar nuk e përdor licencën, brenda 12 muajve nga data e lëshimit, me përjashtim të depozitarit dhe depozitarit të fondeve të investimeve alternative që janë bankë;
- c) personi i licencuar nuk ka korrigjuar rrethanat, në bazë të nenit 210, të këtij ligji, brenda afateve të përcaktuara, në bazë të nenit 211, të këtij ligji, ose nuk ka raportuar për korrigjimin e tyre, në bazë të nenit 211, të këtij ligji;
- ç) personi i licencuar kryen veprimtari të tjera shtesë ose të ndryshme nga ato për të cilat është licencuar;
- d) personi i licencuar nuk përmbush më kushtet, për të cilat është licencuar;
- dh) personi i licencuar nuk përmbush në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit, kërkesat me bazë risku të kapitalit, të parashikuara në këtë ligj,

për një periudhë më të gjatë se 4 muaj;

e) kundër personit të licencuar janë marrë në mënyrë të përsëritur masa administrative;

ë) shoqëria mëmë e personit të licencuar është vendosur në procedurë falimentimi ose, nëse është subjekt i licencuar, i është hequr licenca për arsye të mospërputhshmërisë me ligjet përkatëse;

f) personi i licencuar dënohet me vendim të formës së prerë për veprat penale të kryera në sferën ekonomike dhe vepra penale lidhur me shoqëritë tregtare;

g) ndaj personit të licencuar janë hapur procedurat e falimentimit ose procedurat e likuidimit të detyrueshëm;

gj) personi i licencuar nuk ka kryer veprimtari të rregullt tregtare për një periudhë prej më shumë se 6 muaj, me përjashtim të rastit kur ka marrë miratim paraprak të autoritetit për këtë.

2. Nëse autoriteti gjykon se personi i licencuar ose i regjistruar ka shkelur dispozitat e këtij ligji ose të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij ose i ka dhënë autoritetit informacione të rreme, të pasakta ose keqorientuese, autoriteti mund të nxjerrë urdhër administrativ me shkrim që:

a) personi të mos jetë më i licencuar ose i regjistruar; ose

b) licenca ose regjistrimi i personit të pezullohet për një periudhë të përcaktuar ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje të përcaktuar ose deri në përmbushjen e kushteve të përcaktuara.

3. Autoriteti publikon çdo vendim të marrë në faqen zyrtare të autoritetit, sipas procedurave dhe mënyrës së caktuar prej tij për publikimin e njoftimeve zyrtare. Vendimet me karakter individual i njoftohen menjëherë subjekteve të interesuara.

#### Neni 213

### **Heqja e pjeshme e licencës**

Në përjashtim nga përcaktimet e nenit 212, të këtij ligji, autoriteti mund të heqi licencën e personit të licencuar vetëm për një veprimtari të caktuar, nëse licenca që ka ky person lejon më shumë se një veprimtari.

#### Neni 214

### **Procedurat për urdhrat administrativë dhe për heqjen e licencës ose regjistrimit**

1. Përpara dhënies së urdhrit administrativ ose heqjes të licencës ose regjistrimit, autoriteti:

a) paralajmëron me shkrim personin në fjalë dhe i jep mundësi këtij personi që të përgjigjet me shkrim;

b) ndërmerr hapa për njoftimin e personave të tjerë, të cilët, ka të ngjarë të preken nga ky vendim;

c) krahas paralajmërimit, udhëzon personin e licencuar ose të regjistruar të eliminojë shkeljet ose të zbatojë masa, që lidhen me marrjen e vendimit për paralajmërim të heqjes së licencës ose regjistrimit brenda një afati të përcaktuar në urdhrin administrativ. Autoriteti përcakton kufizimet apo kushtet për t'u përmbushur nga personi i licencuar ose i regjistruar gjatë periudhës kohore të përcaktuar nga autoriteti.

2. Nëse autoriteti e gjykon si të nevojshëm për mbrojtjen e investitorëve ose për mbrojtjen e stabilitetit të tregjeve financiare, mund të japë urdhër administrativ:

a) pa zbatuar procedurën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni; ose

b) nëse autoriteti ka filluar zbatimin e kësaj procedure, pavarësisht nëse ka përfunduar periudha e përgjigjes me shkrim.

3. Nëse autoriteti lidhur me një çështje të caktuar ka zbatuar procedurën e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, ai nuk e zbaton përsëri këtë procedurë, nëse vendos të marrë masa të tjera të ndryshme lidhur me këtë çështje.

Neni 215

### **Heqja e licencës ose regjistrimit në rast shkeljeje të përsëritur**

Nëse personi i licencuar ose i regjistruar kryen shkelje të përsëritura të këtij ligji, të njëjta me ato të cilat kanë qenë shkak për marrjen e vendimit për paralajmërim të heqjes së licencës, njohjes ose regjistrimit, në zbatim të pikës 1, të nenit 214, të këtij ligji, ose nuk përmbush kushtet e përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 214, të këtij ligji, autoriteti ka të drejtë të heqë licencën, njohjen ose regjistrimin.

Neni 216

### **Njoftimi për heqjen e licencës ose regjistrimit**

Vendimi i autoritetit për heqje të licencës ose regjistrimit i njoftohet personit të licencuar ose të regjistruar brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së këtij vendimi.

Neni 217

### **Pasojat e heqjes së licencës**

1. Pas marrjes së njoftimit për heqjen e licencës ose regjistrimit, personi i licencuar ose i regjistruar ndërpret:

- a) lidhjen e kontratave të reja;
- b) shitjen dhe shlyerjen e pjesëmarrjeve në sipërmarrjet e investimeve kolektive.

2. Heqja e licencës ose regjistrimit:

- a) nuk e bën të pavlefshme një marrëveshje, transaksion ose veprim të kryer nga personi në fjalë përpara heqjes ose pezullimit;
- b) nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e asnjë personi, që lindin nga marrëveshja, transaksioni apo veprimi në fjalë.

3. Në rast heqjeje të licencës, autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, mund t'i kërkojë personit në fjalë të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- a) të mos administrojë paratë ose pasuritë e investitorëve/klientëve, sipas mënyrës që konsiderohet si e duhur nga autoriteti ose të kalojë paratë ose pasuritë e këtyre investitorëve/klientëve apo dokumentet ose evidencat elektronike që kanë lidhje me to, të një personi tjetër të përcaktuar në njoftim nga autoriteti; ose

- b) t'i lejojë personit në fjalë të kryejë veprime të caktuara, në varësi të kushteve të përcaktuara në njoftim nga autoriteti, si më poshtë:

- i. të kryejë funksione të caktuara të veprimtarisë tregtare, të cilat janë thelbësore për mbrojtjen e interesave të klientëve gjatë periudhës së pezullimit; ose

- ii. të kryejë funksione të caktuara të veprimtarisë tregtare, me qëllim mbylljen e kësaj veprimtarie.

4. Personi i licencuar ose i regjistruar dorëzon licencën ose regjistrimin në autoritet, brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit me shkrim të vendimit për tërheqje licence ose regjistrimi. Heqja e licencës ose e regjistrimit nuk e përjashton personin e licencuar

ose të regjistruar nga detyrimet aktuale kontraktore apo nga përputhshmëria me kërkesat e këtij ligji.

5. Vendimi për heqje të licencës ose regjistrimit është objekt i së drejtës së ankimit në gjykatë, në zbatim të dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm.

6. Në rast të heqjes së licencës së shoqërisë administruese të fondeve, kontrata për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive i transferohet një personi tjetër të licencuar, brenda 3 muajve, nga data e njoftimit për heqje ose, në të kundërt, sipërmarrjet e investimeve kolektive likuidohen.

7. Në rast të heqjes së licencës së depozitarit ose depozitarit të fondeve të investimeve alternative, kontrata e depozitarit i transferohet një personi tjetër të licencuar, brenda 3 muajve nga data e njoftimit për heqje ose, në të kundërt, sipërmarrjet e investimeve kolektive likuidohen.

8. Në rast të heqjes së licencës së shoqërisë së investimeve, shoqëria likuidohet.

## Neni 218

### **Kërkesat për heqje të licencës ose regjistrimit**

1. Personi i licencuar ose i regjistruar, në zbatim të këtij ligji, mund të bëjë kërkesë pranë autoritetit për heqje të licencës ose regjistrimit të tij.

2. Personi i licencuar ose i regjistruar e paraqet kërkesën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përpara ndërprerjes së veprimtarisë së tij në zbatim të licencës ose regjistrimit. Në këtë rast, personi i licencuar ose i regjistruar i bashkëlidh kërkesës për heqje një plan me afate kohore, ku paraqitet mënyra e ndërprerjes së veprimtarisë së licencuar ose të regjistruar, jo më pak se 6 muaj pas datës së parashikimit të kërkesës. Gjithashtu kërkesa për heqje shoqërohet me arsyet e heqjes, si dhe me një kopje të vendimit të këshillit ose të asamblesës së përgjithshme të personit të licencuar ose të regjistruar për parashtrimin e kërkesës për heqje.

3. Autoriteti konfirmon menjëherë me shkrim marrjen e kërkesës së parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Autoriteti mund të kërkojë informacione të mëtejshme me shkrim nga subjekti kërkues, në veçanti lidhur me mënyrën si do të mbrohen interesat e investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, si do të përmbushen detyrimet kundrejt këtyre investitorëve dhe si do të zgjidhen ankesat akoma në proces.

5. Autoriteti mund të kërkojë paraqitjen e raporteve, të mbuluara me shpenzime nga personi i licencuar ose i regjistruar, të hartuara nga ekspertë të pavarur ligjorë ose auditues të pavarur, ku konfirmohet vlefshmëria e masave të marra për të transferuar kontratat ose pasuritë e klientëve/sipërmarrjeve të investimeve kolektive të një personi tjetër të licencuar ose të regjistruar ose për të verifikuar kontabilizimin e saktë të kësaj transferte.

6. Autoriteti nuk miraton heqjen e licencës/regjistrimit për arsyet e mëposhtme:

a) ka ankesa ende të pazgjidhura lidhur me personin e licencuar ose të regjistruar;

b) autoriteti ose një autoritet tjetër rregullator ka filluar një hetim të personit të licencuar ose të regjistruar ose ka një urdhër administrativ ende të pazbatuar, sipas parashikimeve të nenit 210, të këtij ligji, ndaj këtij personi;

c) ka çështje të cilat, sipas mendimit të autoritetit, kërkojnë hetim përpara marrjes së vendimit për heqje të licencës/regjistrimit;

ç) personi i licencuar ose i regjistruar nuk i ka shlyer borxhet ndaj autoritetit.

7. Autoriteti nuk jep miratimin për heqje të licencës ose të regjistrimit, deri në ndërprerjen e plotë të të gjitha aktiviteteve të licencuara ose të regjistruara.

8. Autoriteti refuzon kërkesën për heqje nëse e gjykon të nevojshme në mbrojtje të interesit

publik apo të interesit të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

9. Autoriteti njofton subjektin kërkues me shkrim për vendimin e heqjes të licencës ose të regjistrimit.

10. Pas këtij njoftimi, autoriteti përditëson zërin përkatës në regjistrin e mbajtur, në zbatim të nenit 8, të këtij ligji, për të pasqyruar se personi nuk është më i licencuar ose i regjistruar.

## SEKSIONI 6

### MBIKËQYRJA E VEPRIMTARIVE TË ADMINISTRUESVE TË HUAJ TË FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE DHE SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 219

#### **Detyrimi për dhënie informacioni**

1. Autoriteti i kërkon administruesit të huaj të fondeve të investimeve alternative, që ushtron veprimtari në zbatim të neneve 132 e 135, të këtij ligji, ose shoqërisë administruese të huaj, që ushtron veprimtari, në zbatim të nenit 156, të këtij ligji, të dorëzojë raporte lidhur me veprimtarinë e tyre.

2. Autoriteti, nëse e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë paraqitjen e informacioneve përkatëse për administruesit e huaj të fondeve të investimeve alternative dhe shoqërive administruese të huaja dhe për degët e tyre për të verifikuar përputhshmërinë me rregullat, që zbatohen për veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Neni 220

#### **Urdhri administrativ i korrigjimit**

1. Autoriteti vendos dhënien e urdhrit administrativ për korrigjim ose për ndërprerje të aktivitetit ndaj administruesit të huaj të fondeve të investimeve alternative ose degës së tij, që ushtron veprimtari në zbatim të neneve 132 dhe 135, të këtij ligji, ose ndaj shoqërisë së huaj administruese ose degës së saj, që ushtron veprimtari, në zbatim të nenit 156, të këtij ligji, nëse veprimtaria e këtyre subjekteve ushtrohet në kundërshtim me këtë ligj ose me aktet rregullative të miratuara nga autoriteti, në zbatim të këtij ligji.

2. Përpara dhënies së urdhrit administrativ, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, autoriteti vë në dijeni autoritetin rregullator të vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative ose shoqërisë administruese, duke i dhënë mundësi të marrë masat përkatëse për eliminimin e shkeljeve në fjalë.

3. Nëse masat e marra, në zbatim të pikës 2, të këtij neni, nuk janë të mjaftueshme për eliminimin e shkeljeve, autoriteti merr masat e tij përkatëse që i gjykon si të nevojshme, përfshirë edhe masat për parandalimin e kundërvajtjeve të reja. Përpara marrjes së këtyre masave, autoriteti informon paraprakisht autoritetin rregullator të vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative së shoqërisë administruese.

4. Autoriteti mund të marrë masa për të ruajtur stabilitetin financiar dhe paprekshmërinë e tregut apo për të mbrojtur investitorët në Republikën e Shqipërisë, nëse nuk zbatohen rregullat e vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative ose shoqërisë administruese. Përpara marrjes së masave, autoriteti informon paraprakisht autoritetin rregullator të vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative ose

shoqërisë administruese, duke i dhënë mundësi të marrë masat përkatëse për eliminimin e shkeljeve.

#### Neni 221

### **Heqja e njohjes dhe regjistrimit për të vijuar marketimin në Republikën e Shqipërisë**

1. Autoriteti heq regjistrimin e fondeve të huaja të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë, të kryer në zbatim të nenit 132, të këtij ligji, nëse kërkesat e nenit 132 nuk përmbushen më.

2. Autoriteti heq njohjen e sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive me ofertë publike, në zbatim të nenit 156, të këtij ligji, nëse janë shkelur kushtet për njohjen ose dispozitat e këtij ligji. Autoriteti, në raste të veçanta, heq njohjen, në zbatim të nenit 156, të këtij ligji, nëse gjykon se është në interes të mbrojtjes së investitorëve.

3. Autoriteti heq njohjen e administruesit të huaj të fondeve të investimeve alternative për të themeluar ose marketuar fonde investimesh alternative në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të nenit 135, të këtij ligji, nëse janë shkelur kushtet për njohjen ose nëse janë shkelur dispozitat e këtij ligji.

4. Autoriteti heq njohjen e shoqërisë së huaj administruese për të themeluar ose marketuar sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të nenit 96, të këtij ligji, nëse janë shkelur kushtet për njohjen ose nëse janë shkelur dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 222

### **Bashkëpunimi mbikëqyrës me autoritetet e tjera rregullatore**

1. Autoriteti lejon autoritetet e vendeve të tjera të kryejnë mbikëqyrje në Republikën e Shqipërisë.

2. Pas njoftimit paraprak të autoritetit, autoriteti rregullator i vendit të origjinës së administruesit të fondeve të investimeve alternative ose shoqërisë administruese, në bashkëpunim me autoritetin mund të kryejnë inspektime në vend të një dege të themeluar në Republikën e Shqipërisë.

3. Pika 2 e këtij neni nuk e pengon autoritetin të kryejë inspektime në vend, të cilat i gjykon të nevojshme për të verifikuar përmbushjen e dispozitave ligjore, që zbatohen për veprimtarinë e degës në Republikën e Shqipërisë.

4. Autoriteti i përcjell informacionin e marrë në përputhje me këtë ligj, autoritetit rregullator të vendeve të tjera.

#### Neni 223

### **Pasojat e heqjes së njohjes**

1. Heqja ose pezullimi i njohjes:

a) nuk bën të pavlefshme një marrëveshje, transaksion ose veprim të kryer nga personi në fjalë, përpara heqjes ose pezullimit;

b) nuk cenon të drejtat ose detyrimet e asnjë personi, që lindin nga marrëveshja, transaksioni apo veprimi i kryer.

2. Në rast heqjeje ose pezullimi, autoriteti, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, mund t'i kërkojë personit në fjalë të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

a) të administrojë paratë ose pasuritë e investitorëve/klientëve, sipas mënyrës që konsiderohet si e duhur nga autoriteti ose të kalojë paratë ose pasuritë e këtyre investitorëve/klientëve apo dokumentet ose evidencat elektronike që kanë lidhje me to, të një personi tjetër të përcaktuar në njoftim nga autoriteti;

b) të kryejë veprime të caktuara, në varësi të kushteve të përcaktuara në njoftim nga autoriteti, si më poshtë:

i. të kryejë funksione të caktuara të veprimtarisë tregtare, të cilat janë thelbësore për mbrojtjen e interesave të klientëve gjatë periudhës së pezullimit; ose

ii. të kryejë funksione të caktuara, me qëllim mbylljen e kësaj veprimtarie.

Neni 224

### **Kërkesa për heqje të njohjes**

1. Njohja e dhënë nga autoriteti mund të hiqet po nga autoriteti me kërkesë të personit të njohur.

2. Autoriteti nuk e miraton kërkesën e heqjes së njohjes nëse:

a) ka ankesa ende të pazgjdhura lidhur me personin e njohur;

b) autoriteti ose një autoritet tjetër rregullator ka filluar një hetim të personit të njohur ose ka një urdhër administrativ ende të pazbatuar ndaj personit të njohur, në përputhje me nenin 210 të këtij ligji;

c) ka çështje të cilat, sipas mendimit të autoritetit, kërkojnë hetim paraprak përpara marrjes së vendimit për heqje të njohjes;

ç) personi i njohur nuk ka shlyer borxhet ndaj autoritetit.

3. Autoriteti nuk miraton heqjen e njohjes deri në ndërprerjen e plotë të veprimtarisë së personit të njohur.

4. Autoriteti refuzon kërkesën për heqje nëse e gjykon të nevojshme në mbrojtje të interesit publik apo të interesit të investitorëve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

5. Autoriteti njofton subjektin kërkuar me shkrim për marrjen e vendimit të heqjes së njohjes.

6. Pas këtij njoftimi, autoriteti përditëson zërin përkatës në regjistrin e mbajtur, në zbatim të nenit 8, të këtij ligji, për të paraqitur se personi nuk është më i njohur.

## **SEKSIONI 7**

### **MBROJTJA E INVESTITORËVE**

Neni 225

#### **Roli i autoritetit**

1. Objektivi parësor i autoritetit është mbrojtja e investitorëve duke garantuar që tregjet janë të drejta, efikase dhe transparente, nëpërmjet zvogëlimit sa më shumë të riskut të sistemit dhe nëpërmjet rregullimit të procedurës së licencimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së personave juridikë për të nxitur përputhshmërinë, me kërkesat e këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi.

2. Autoriteti mund të përdorë një sërë instrumentesh, teknikash për arritjen e këtij objektivi, përfshirë, ndër të tjera:

- a) kryerjen e saktë të procedurave të licencimit, njohjes ose regjistrimit, të parashikuara në këtë ligj;
- b) garantimin e zbatimit të detyrueshëm të akteve rregullative të miratuara nga autoriteti për informimin e investitorit, kodeve etike dhe dispozitave për konfliktin e interesit;
- c) garantimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji nëpërmjet monitorimit dhe inspektimit të subjekteve të licencuara, të njohura dhe të regjistruara;
- ç) ndërmarrjen e procedurave disiplinore dhe, sipas rastit, vendosjen e gjobave dhe sanksioneve të tjera të parashikuara në këtë ligj;
- d) garantimin e transparencës;
- dh) vënien në dispozicion të publikut të të dhënave të rëndësishme dhe të informacioneve të tjera përkatëse;
- e) edukimin e investitorëve;
- ë) krijimin e një procedure për ankesat e investitorëve.

## Neni 226

### **Procedura e ankesave në autoritet**

1. Autoriteti harton procedurat për ankesat e investitorëve, në kuadër të detyrimit të tij për kujdesin e duhur ndaj investitorëve.
2. Autoriteti harton me akt nënligjor rregulla lidhur me procedurat e ankesave dhe e publikon atë në faqen e tij të internetit.
3. Fillimisht, të gjitha ankesat i drejtohen drejtpërdrejt subjektit të licencuar në fjalë. Ankesa lidhur me një veprim ose mosveprim të subjektit të licencuar mund të paraqitet në autoritet, vetëm pas shterimit të rrugëve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.
4. Ankuesi mund të depozitojë ankesë kundër një pale tjetër, vetëm për veprimtari të cilat janë të rregulluara dhe të mbikëqyrura në zbatim të këtij ligji.
5. Vendimi për ankesën merret duke u bazuar në çfarë autoriteti gjykon si të rregullt, të drejtë dhe të arsyeshme, në përputhje me rrethanat e çështjes.
6. Autoriteti duhet të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për të kryer një hetim të plotë të çdo ankese.
7. Nëse autoriteti ka marrë vendim lidhur me ankesën, atëherë ai njofton me shkrim për vendimin në fjalë subjektin e licencuar, ndaj të cilit është drejtuar ankesa dhe ankuesin.
8. Nëse autoriteti konstaton se subjekti i licencuar ka vepruar në mënyrë të gabuar dhe të parregullt, atëherë ai urdhëron subjektin e licencuar të korrigjojë situatën ose t'i japë dëmshpërblim investitorit ose të dyja këto masa së bashku, me shpenzimet e subjektit të licencuar.
9. Autoriteti përjashtohet nga përgjegjësia ligjore për çdo dëm që lind nga ankesa apo nga kryerja e funksioneve të tij gjatë hetimit të ankesës.
10. Pika 9 e këtij neni nuk zbatohet nëse vërtetohet se autoriteti ka vepruar me keqdashje.
11. Autoriteti mund të përdorë ankesën si bazë për të filluar një inspektim të subjektit të licencuar.
12. Autoriteti mund të përdorë ankesën si bazë për të filluar një procedurë disiplinore kundër subjektit të licencuar.
13. Autoriteti mund të publikojë të gjitha ose pjesë të raportit të tij lidhur me një ankesë, nëse e gjykon se kjo çështje duhet sjellë në vëmendjen e publikut.
14. Pikat e mësipërme të këtij neni nuk cenojnë asnjë procedurë gjyqësore që mund të ndjekë ankuesi.



## Neni 227

### **Parandalimi i pastrimit të parave dhe marrja e masave për eliminimin e shkeljeve të konstatuara**

1. Çdo subjekt i licencuar, sipas këtij ligji, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe akteve rregullative të miratuara nga autoriteti.

2. Subjektet e licencuara janë të detyruara që, pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit të Parave dhe autoritetin për çdo rast kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

## Neni 228

### **Marrja e masave administrative mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**

Në rastet kur autoriteti vlerëson se subjekti i licencuar ka shkelur detyrimet ligjore mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, merr ndaj tij një ose disa nga masat e mëposhtme:

- a) pezullon ose heq pjesërisht ose plotësisht licencën;
- b) vendos sanksione administrative mbi personat përgjegjës, si gjobë, pezullim dhe/ose largim nga detyra.

## KREU XIII

### SHKELJET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

#### SEKSIONI 1

### SHKELJET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

## Neni 229

### **Dispozita të përgjithshme**

1. Çdo shkelje me faj e dispozitave të këtij ligji, e kryer me veprim ose mosveprim, për të cilat parashikohen masa administrative, do të quhen shkelje administrative.

2. Përveç masave të mbikëqyrjes, të parashikuara në këtë ligj, shkeljet administrative të parashikuara në nenet e mëposhtme sanksionohen me gjobë.

3. Gjatë vendosjes së masës administrative, autoriteti sigurohet që masa administrative të jetë:

- a) efektive dhe parandaluese; dhe
- b) në proporcionalitet me shkallën e pasojave, që çuan në vendosjen e masës administrative, gjobë.

4. Autoriteti përcakton shumën e masës administrative, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke vlerësuar, gjithashtu, natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi pjesëmarrësit në sipërmarrjet e investimeve kolektive.

5. Autoriteti, gjatë vendosjes së masës administrative zbaton parimin e njëtrajtshmërisë, sipas të cilit për shkelje të ngjashme vendos sanksione të ngjashme.

Neni 230

### **Masat administrative ndaj subjekteve të licencuara dhe të njohura**

1. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga 2 000 000 (dy milionë) lekë deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë ndaj shoqërisë administruese dhe administruesit të fondeve të investimeve alternative, si dhe gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ndaj depozitarit dhe depozitarit të fondeve të investimeve alternative të licencuara nëse:

a) kryen një veprimtari për të cilën nuk ka licencën e nevojshme, në zbatim të këtij ligji ose të një ligji tjetër të sektorit financiar;

b) nuk informon autoritetin, paraprakisht, për ndryshim të zotëruesit të pjesëmarrjes influencuese dhe/ose nuk merr miratim paraprak të autoritetit për këtë ndryshim;

c) nuk informon autoritetin, paraprakisht, për ndryshim të personit kyç ose personelit kyç dhe/ose nuk merr miratim paraprak të autoritetit për këtë ndryshim;

ç) nuk informon autoritetin, paraprakisht, për çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve të licencës dhe/ose nuk merr miratim paraprak të autoritetit për këtë ndryshim;

d) nuk informon autoritetin paraprakisht për blerjen e pjesëmarrjes influencuese në një shoqëri tjetër dhe/ose nuk merr miratimin paraprak të autoritetit për këtë;

dh) në rastin e shoqërisë administruese të fondeve, nëse:

i. themelon sipërmarrje të investimeve kolektive pa i paraqitur kërkesë paraprake autoritetit për regjistrim, licencim dhe/ose miratim të këtij regjistrimi ose licence;

ii. hap degë pa miratimin paraprak të autoritetit;

iii. u shkakton mbajtësve të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike humbje financiare, si pasojë e shkeljes së këtij ligji, nëpërmjet veprimit ose mosveprimit;

iv. nuk emëron depozitarin e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nuk zëvendëson brenda afateve depozitarin;

v. nuk emëron audituesin e jashtëm të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nuk e zëvendëson brenda afateve audituesin;

vi. jep informacione të rreme ose të pasakta në prospektin SIK, dokumentin me informacion kryesor për investitorin, raportin dhe pasqyrat financiare vjetore ose të ndërmjetme për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike.

e) nuk i raporton autoritetit siç parashikohet nga ky ligj;

ë) pengon autoritetin në ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe këtë ligj;

f) në rastin e shoqërisë administruese të fondeve, nëse u shkaktohet humbje financiare investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, përmes veprimit ose mosveprimit për të përmbushur detyrimet e shoqërisë administruese, sipas nenit 23, të këtij ligji, ose përmes veprimit ose mosveprimit për të përmbushur kërkesat e nenit 24, të këtij ligji, lidhur me konfliktin e interesit ose nenit 25, të këtij ligji, lidhur me delegimin;

g) në rastin e depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, nëse

u shkaktohet humbje financiare investitorëve të sipërmarrjes, përmes veprimit ose mosveprimit për të përmbushur detyrimet e depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, sipas nenit 43, të këtij ligji, ose përmes veprimit a mosveprimit për të përmbushur kërkesat e nenit 44, të këtij ligji, lidhur me konfliktin e interesit, ose nenit 45, të këtij ligji, lidhur me delegimin;

gj) në rastin e administruesit të fondeve të investimeve alternative, nëse u shkaktohet humbje financiare investitorëve të fondeve të investimeve alternative, përmes veprimit a mosveprimit për të përmbushur detyrimet e depozitarit, sipas nenit 56, të këtij ligji, ose përmes veprimit a mosveprimit për të përmbushur kërkesat e nenit 57, të këtij ligji, lidhur me delegimin;

h) nuk dorëzon në mënyrë të përsëritur raportet e kërkuara në autoritet.

2. Krahas kësaj, autoriteti i kërkon personit të licencuar të shkarkojë ose të pezullojë për një periudhë kohore të përcaktuar një person kyç ose një anëtar të personelit kyç përgjegjës për shkelje të legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga (300 000 lekë në 400 000 lekë) ndaj një personi kyç të shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative, depozitarit ose depozitarit të fondeve të investimeve alternative të licencuar, përgjegjës për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë ndaj shoqërisë administruese të licencuar/njohur dhe shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative të licencuara, si dhe gjobë nga 800 000 (tetëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për depozitarin dhe depozitarin e fondeve të investimeve alternative për shkeljet e mëposhtme:

a) mosdorëzimi i raporteve në autoritet, sipas përcaktimeve të këtij ligji, përfshirë mosdorëzimin e raporteve dhe pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, në zbatim të neneve 121 dhe 122, të këtij ligji, dhe të fondeve të investimeve alternative, në zbatim të nenit 124, të këtij ligji; si dhe pasqyrave financiare vjetore të audituara për të gjitha llojet e shoqërive administruese të fondeve, në zbatim të nenit 34 të këtij ligji;

b) mosdorëzimi i raporteve në autoritet, në zbatim të shkronjës “a”, të kësaj pike, brenda afateve kohore të përcaktuara;

c) moszotërimi i kapitalit përkatës, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji;

ç) pengimi i ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse të autoritetit, sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi;

d) shkelja e çdo kërkesë të zbatueshme të përcaktuar në krerët IV, V, VII dhe IX, të këtij ligji;

dh) moskryerja dhe mosraportimi me saktësi i rezultatit të provës së rezistencës, sipas parashikimeve të këtij ligji ose akteve rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij;

e) mospagimi i tarifave të mbikëqyrjes, në zbatim të nenit 201 të këtij ligji.

5. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga (2 000 000 lekë në 3 000 000 lekë) ndaj shoqërisë administruese të njohur, që ka themeluar një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë, e cila shkel kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në krerët III, IV, V, VII dhe IX të këtij ligji.

6. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga (2 000 000 lekë në 3 000 000 lekë) ndaj administruesit të njohur të fondeve të investimeve alternative, që ka themeluar një fond të investimeve alternative në Republikën e Shqipërisë në shkelje të kërkesave të zbatueshme të krerëve III, IV dhe VI të këtij ligji.

Neni 231

### **Përsëritja e shkeljeve**

Në rast se shkelja përsëritet nga i njëjti person i licencuar ose i njohur, gjoba dyfishohet me çdo përsëritje të shkeljes.

Neni 232

### **Sanksioni me gjobë ndaj personave të tjerë**

1. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga (500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë) ndaj agjentit të shitjes, në bazë të nenit 102, të këtij ligji, që nuk përmbush kërkesat për dhënie informacioni, sipas seksionit 9, të kreut V, të këtij ligji.

2. Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga (500 000 lekë në 1 000 000 lekë) ndaj çdo personi të palicencuar, që përdor emërtime të cilat, sipas parashikimeve të këtij ligji, përdoren vetëm nga subjektet e licencuara.

Neni 233

### **Masat administruese ndaj administratorëve të përkohshëm dhe likuiduesve**

Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga (500 000 lekë në 1 000 000 lekë) ndaj administratorëve të përkohshëm, që nuk dorëzojnë raportet e kërkuara, në zbatim të nenit 183, të këtij ligji, ose likuiduesit që nuk dorëzon raportet e kërkuara në zbatim të nenit 193 të këtij ligji.

Neni 234

### **Masat administrative për shkelje të kërkesave mbi konfidencialitetin**

Autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga 200 000 lekë në 400 000 lekë ndaj subjektit të licencuar, drejtuar personit kyç ose anëtarëve të personelit kyç, për shkelje të kërkesave lidhur me konfidencialitetin.

Neni 235

### **Shkelje të tjera**

Për çdo shkelje tjetër të paparashikuar shprehimisht në këtë ligj, autoriteti vendos masa administrative me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

Neni 236

### **Procedura e hetimit administrativ, njoftimi dhe ankimi**

1. Autoriteti, gjatë hetimit administrativ për verifikimin e shkeljeve, sipas këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë nga subjekti i licencuar në hetim administrativ, informacion dhe shpjegime, si

dhe të marrë materialet e dokumentacionin e nevojshëm, që kanë lidhje me hetimin administrativ, sipas këtij ligji.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, autoriteti i cakton subjektin të licencuar një afat për përgjigje ndaj kërkesave të tij për informacion, për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, si dhe për dërgimin e observacioneve dhe/ose shpjegimeve të nevojshme, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative dhe këtij ligji.

3. Pas përfundimit të hetimit administrativ, autoriteti, njofton me shkrim për vendimin e marrë, subjektin e licencuar, brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e marrjes së këtij vendimi.

4. Ndaj vendimit të autoritetit, subjekti i licencuar ka të drejtë të ankohet në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, brenda 45 ditëve, nga e nesërmja e marrjes së vendimit.

5. Ankimi në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të autoritetit.

Neni 237

### **Ekzekutimi i vendimeve**

1. Masat administrative, të parashikuara në këtë seksion, arkëtohen në një llogari të posaçme të autoritetit, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të parashikuar në nenin 236 të këtij ligji.

2. Kur shuma e masës administrative nuk shlyhet brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, subjekti i licencuar dhe personi përgjegjës paguajnë kamatëvonesë prej 0,01 % të masës administrative për çdo ditë vonesë, pas kalimit të afatit.

## **KREU XIV**

### **DISPOZITA KALIMTARE**

Neni 238

### **Shoqëritë administruese dhe depozitarët e licencuar**

1. Licenca që autoriteti i ka lëshuar një shoqërie administruese të themeluar në Republikën e Shqipërisë për të administruar sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike konsiderohet e vlefshme edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Licenca që autoriteti i ka lëshuar një depozitari të themeluar në Republikën e Shqipërisë për t'u ofruar shërbime depozitari sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike konsiderohet e vlefshme edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Shoqëria administruese dhe depozitari i licencuar, në zbatim të ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përshtatin aktivitetin e tyre me kërkesat e këtij ligji.

4. Çdo kërkesë e re për licencim nga shoqëria administruese e fondeve ose depozitari, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji, përmbush dhe respekton kërkesat e këtij ligji.

### **Sipërmarrjet e investimeve kolektive të licencuara**

1. Fond investimi, me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike i licencuar nga autoriteti, sipas nenit 54, të ligjit nr. 10 198, “Për sipërmarrje të investimeve kolektive”, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon të jetë i licencuar, si një fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas nenit 62, të këtij ligji, me kusht që brenda 18 muajve nga miratimi i rregulloreve të zbatueshme për fondin e investimeve të hapura, sipas këtij ligji, fondi i investimeve me pjesëmarrje të hapur të përshtatet me kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe rregulloreve të tij.

2. Çdo kërkesë e re për licencim nga sipërmarrja e investimeve kolektive, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji, përmbush dhe respekton kërkesat e këtij ligji.

### **Shoqëritë administruese të huaja dhe administruesit e huaj të fondeve të investimeve alternative dhe degët e tyre**

Shoqëria administruese e huaj ose administruesi i huaj i fondeve të investimeve alternative ose dega e shoqërisë administruese të huaj ose administruesit të huaj të fondeve të investimeve alternative nuk njihen, në zbatim të këtij ligji, derisa autoriteti të miratojë aktet rregullative, që rregullojnë njohjen dhe procedurat për njohjen e shoqërive të huaja administruese dhe degëve të tyre.

Shoqëria administruese e themeluar në një shtet anëtar të Bashkimit Europian ose administruesi i fondeve të investimeve alternative në një shtet anëtar të Bashkimit Europian ose dega e shoqërisë administruese, e themeluar në një shtet anëtar të Bashkimit Europian, njihen në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.

### **Sipërmarrjet e huaja të investimeve kolektive**

1. Sipërmarrja e huaj e investimeve kolektive nuk njihet për t’iu ofruar publikut në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të këtij ligji, derisa autoriteti të miratojë aktet rregullative që rregullojnë njohjen dhe procedurat për njohjen e sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive.

2. Sipërmarrja e huaj e investimeve kolektive nuk regjistrohet për t’iu ofruar vetëm klientëve profesionistë dhe të kualifikuar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të këtij ligji, derisa autoriteti të miratojë aktet rregullative që rregullojnë njohjen dhe procedurat për njohjen e fondeve të huaja të investimeve alternative.

KREU XV  
DISPOZITA TË TJERA

Neni 242

**Miratimi i akteve**

Autoriteti miraton akte rregullative brenda 1 viti nga hyrja në fuqi të këtij ligji, sipas kompetencave të dhëna nga ky ligj, për çdo veprimtari që ajo kontrollon, mbikëqyr apo licencon.

Neni 243

**Shfuqizimi**

Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe çdo akt tjetër që bie ndesh me të shfuqizohen.

Neni 244

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 30.4.2020

## **SHTOJCA 1**

### ***Përmbajtja e prospektit SIK për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike***

Fondi i investimeve me ofertë publike	Shoqëria administruese	Shoqëria e investimeve me ofertë publike
1. Informacion lidhur me fondin e investimeve me ofertë publike	1. Informacion lidhur me shoqërinë administruese, përfshirë të dhëna nëse shoqëria administruese është themeluar në një vend tjetër, të ndryshëm nga vendi i origjinës i sipërmarrjes.	1. Informacion lidhur me shoqërinë e investimeve me ofertë publike
1.1. Emërtimi i fondit të investimeve	1.1. Emri ose lloji, struktura ligjore, selia e regjistruar dhe selia qendrore nëse	1.1. Emri ose lloji, struktura ligjore, selia e regjistruar dhe selia qendrore nëse është e



	është e ndryshme nga selia e regjistruar	ndryshme nga selia e regjistruar
1.2. Data e themelimit të fondit të investimeve, të dhëna mbi kohëzgjatjen, nëse është me afat.	1.2. Data e themelimit të shoqërisë. Të dhëna mbi kohëzgjatjen, nëse është me afat.	1.2. Data e themelimit të shoqërisë. Të dhëna mbi kohëzgjatjen, nëse është me afat.
Në rastin e fondit ombrellë të investimeve, emrat dhe objektivat e investimit të nënfondeve	1.3. Nëse shoqëria administron fonde të tjera të investimeve, tregues i këtyre fondeve të tjera; dhe nëse shoqëria administron shoqëri të tjera të investimeve, të dhëna mbi këto shoqëri të tjera.	
1.4. Vendi ku mund të aksesohet rregullorja e fondit, nëse nuk i bashkëlidhet këtij dokumenti, dhe raportet e pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme.		1.4. Vendi ku mund të aksesohet akti themelues, nëse nuk i bashkëlidhet këtij dokumenti dhe raportet e pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme.
1.5. Informacion i shkurtër për mbajtësit e kuotave në lidhje me sistemin tatimor të zbatueshëm për investimin. Informacion nëse zbritja mbahet në burim nga të ardhurat dhe fitimet kapitale nga investimi që u paguhet mbajtësve të kuotave.		1.5. Informacion i shkurtër për aksionarët në lidhje me sistemin tatimor të zbatueshëm për shoqërinë. Informacion nëse zbritja mbahet në burim nga të ardhurat dhe fitimet kapitale që shoqëria u paguan aksionarëve.
1.6. Datat e kontabilitetit dhe të shpërndarjes.		1.6. Datat e kontabilitetit dhe të shpërndarjes.
1.7. Emrat e personave përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të fondit.		1.7. Emrat e personave përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë.

	<p>1.8. Emrat dhe postet në shoqëri të personave kyç dhe personelit kyç. Të dhëna për veprimtaritë e tyre kryesore jashtë shoqërisë, kur janë me rëndësi lidhur me shoqërinë.</p>	<p>1.8. Emrat e personave kyç të shoqërisë. Të dhëna për veprimtaritë e tyre kryesore jashtë shoqërisë, kur janë me rëndësi lidhur me shoqërinë.</p>
<p>1.9 Vlera minimale e kapitalit të synuar, nëse ka</p>	<p>1.9. Shuma e Kapitalit të nënshkruar, duke dhënë informacion mbi kapitalit e shlyer.</p>	<p>1.9. Vlera minimale e kapitalit të synuar, nëse ka</p>
<p>1.10. Të dhëna për llojet dhe karakteristikat kryesore të kuotave dhe në veçanti: natyra e të drejtave (të paluajtshme, të luajtshme ose të tjera) që përfaqëson kuota, karakteristikat e kuotave: aksion i regjistruar ose i prurësit. Të dhëna të të çdo denominimi që mund të parashikohet, tituj ose certifikata origjinale që përbëjnë dëshmi të titullit; regjistrim në regjistër ose në llogari, rastet e vendosjes në likuidim të fondit të investimeve dhe procedurat e likuidimit, në veçanti në lidhje me të drejtat e mbajtësve të kuotave.</p>		<p>1.10. Të dhëna për llojet dhe karakteristikat kryesore të aksioneve dhe në veçanti: tituj ose certifikata origjinale që përbëjnë dëshmi të titullit; regjistrim në regjistër ose në llogari, karakteristikat e aksioneve: aksion i regjistruar ose i prurësit. Të dhëna të të çdo denominimi që mund të parashikohet, tregues i të drejtave të votës së aksionarëve, rastet e vendosjes në likuidim të shoqërisë së investimeve dhe procedurat e likuidimit, në veçanti në lidhje me të drejtat e aksionarëve.</p>

<p>1.11. Sipas rastit, të dhëna të tregjeve të rregulluara ose të tregjeve ku janë regjistruar ose tregtohen kuotat.</p>		<p>1.11. Sipas rastit, të dhëna të tregjeve të rregulluara ose të tregjeve ku janë regjistruar ose tregtohen aksionet.</p>
<p>1.12. Procedurat dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së kuotave përfshirë informacione për çdo ofertë fillestare me çmim të pandryshueshëm dhe periudhën e saj.</p>		<p>1.12. Procedurat dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së aksioneve përfshirë informacione për çdo ofertë fillestare me çmim të pandryshueshëm dhe periudhën e saj.</p>
<p>1.13. Procedurat dhe kushtet për riblerjen ose shlyerjen e kuotave, dhe rastet kur mund të pezullohet riblerja ose shlyerja e kuotave. Në rastin e fondeve të investimeve me nënfonde të ndryshme, informacion se si mbajtësi i kuotave mund të transferojë kuotat nga njëri nënfond në tjetrin dhe komisionet që zbatohen në raste të tilla.</p>		
<p>1.14. Përshkrim i rregullave për llogaritjen dhe përdorimin e të ardhurave.</p>		<p>1.14. Përshkrim i rregullave për llogaritjen dhe përdorimin e të ardhurave.</p>
<p>1.15. Përshkrim i objektivave të investimeve, përfshirë objektivat financiarë (p.sh., rritjen e kapitalit ose të ardhurave), politikën e investimeve (p.sh., specializimi në sektorë gjeografikë ose industrialë), kufizimet e politikës së investimeve dhe të dhëna mbi mënyrën dhe instrumentet apo të drejtat e huamarrjes që mund të përdoren në administrimin e fondit të investimeve.</p>		<p>1.15. Përshkrim i objektivave të investimeve, përfshirë objektivat financiarë (p.sh., rritja e kapitalit ose të ardhurat), politikën e investimeve (p.sh., specializimi në sektorë gjeografikë ose industrialë), kufizimet e politikës së investimeve dhe të dhëna mbi mënyrën dhe instrumentet apo të drejtat e huamarrjes që mund të përdoren në administrimin e shoqërisë.</p>

1.16. Rregullat për vlerësimin e aktiveve.		1.16. Rregullat për vlerësimin e aktiveve.
1.17. Përcaktimi i vlerës neto të aktiveve për kuotë dhe çmimit të shitjes ose emetimit dhe i çmimit të riblerjes ose shlyerjes së kuotave, në veçanti: — metoda dhe shpeshtësia e llogaritjes së këtyre çmimeve, — informacion lidhur me komisionet për shitjen ose emetimin dhe riblerjen ose shlyerjen e kuotave, (komisionet hyrëse dhe dalëse) — mënyrat, vendet dhe shpeshtësia e publikimit të këtyre çmimeve.		1.17. Përcaktimi i vlerës neto të aktiveve për aksion, në veçanti: — metoda dhe shpeshtësia e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve, — mënyrat, vendet dhe shpeshtësia e publikimit të vlerës neto të aktiveve për çdo aksion dhe të çmimeve të tregut.
1.18. Informacione lidhur me mënyrën, shumën dhe llogaritjen e shpërblimit që fondi i investimit i paguan shoqërisë administruese, depozitarit ose të tretëve, dhe rimbursimin e kostove që i bën fondi i investimeve shoqërisë administruese, depozitarit ose të tretëve.		1.18. Informacione lidhur me mënyrën, shumën dhe llogaritjen e shpërblimit që shoqëria u paguan personave kyç, shoqërive administruese, depozitarit ose të tretëve, dhe rimbursimin e kostove që u bën shoqëria anëtarëve të këshillit të administrimit, depozitarit ose të tretëve.

## 2. Informacion lidhur me depozitarin:

2.1. Identiteti i depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe përshkrim i detyrave të tij dhe i konflikteve të interesit që mund të lindin;

2.2. Përshkrim i funksioneve të ruajtjes, të cilat depozitari i ka deleguar, lista e të deleguarve dhe të nëndeleguarve dhe çdo konflikt interesi që mund të lindë nga delegimi;

2.3. Deklaratë se investitorëve u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, informacione të përditësuara, në lidhje me pikat 2.1 dhe 2.2 të kësaj pike.

3. Informacion lidhur me shoqëritë e jashtme të administrimit të portofolit, të cilët japin këshilla sipas kontratave të nënshkruara, që paguhen nga aktivet e sipërmarrjes:

3.1. Emri ose forma e firmës ose emri i shoqërisë së administrimit të portofolit;

3.2. Dispozitat thelbësore të kontratës me shoqërinë administruese ose shoqërinë e investimeve që mund jenë me rëndësi për mbajtësit e kuotave ose aksioneve të sipërmarrjeve

të investimeve kolektive me ofertë publike, përjashtuar dispozitat në lidhje me shpërblimin e punës;

3.3. Veprimtari të tjera të rëndësishme.

4. Informacion në lidhje me masat rregulluese për kryerjen e pagesave mbajtësve të kuotave, riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe vendosjen në dispozicion të informacionit lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike. Gjithashtu, kur kuotat marketohen në një vend tjetër, këto informacione jepen lidhur me këtë vend në prospektin SIK të publikuar atje.

5. Informacione të tjera për investimet:

5.1. Ecuria historike e sipërmarrjes (nëse ka) – ky informacion mund të përfshihet brenda prospektit ose t'i bashkëlidhet;

5.2. Profili i investitorit tipik, për të cilin është krijuar sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondi.

6. Informacione ekonomike:

6.1. Shpenzime ose tarifa të mundshme, përveç komisioneve dhe pagesave të përmendura në pikën 1.17 të kësaj shtojce, duke bërë dallimin midis atyre që paguajnë mbajtësit e kuotave dhe atyre që paguhen nga aktivet e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike.

## **SHTOJCA 2**

### ***Përmbajtja e dokumentit me informacionin kryesor për investitorin***

1. Kjo shtojcë përmban kërkesat kryesore lidhur me informacionin kryesor për investitorin, i cili parashikohet nga kërkesat e këtij ligji. Kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë do të zbatohen nga çdo shoqëri administruese në lidhje me çdo Sipërmarrje të Investimeve Kolektive (SIK), që ajo ka nën administrim.

2. Karakteristikat thelbësore të informacionit kryesor për investitorin:

a) Informacioni kryesor për investitorin duhet të jetë i paanshëm, i qartë dhe jo çorientues.

b) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin jepet në mënyrë të tillë, që investitori të jetë në gjendje ta dallojë atë nga materiale të tjera për SIK. Veçanërisht, informacioni nuk duhet të paraqitet ose të shpërndahet në mënyrë të tillë që investitorët ta konsiderojnë atë si më pak të rëndësishëm se informacionet e tjera rreth SIK dhe risqeve e përfitimeve të saj.

c) Informacioni kryesor për investitorin duhet të jetë në përputhje me pjesët përkatëse prospektit.

ç) Informacioni kryesor i jepet investitorit pa pagesë.

3. Koha e vënies në dispozicion të informacionit kryesor:

a) Shoqëria administruese, përpara se investitori të nënshkruajë kuotat/aksionet e SIK, i jep këtij të fundit informacionin kryesor për çdo SIK që ka nën administrim.

b) Në rastin e shitjes së kuotave/aksioneve SIK, nëpërmjet një agjenti, ky i fundit është i detyruar t'i japë investitorit informacionin kryesor përpara nënshkrimit të kuotave/aksioneve të SIK.

4. Prezantimi dhe gjuha e dokumentit të informacionit kryesor:

a) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin duhet të jetë:

i. i paraqitur dhe i parashtruar në një mënyrë të lehtë për t'u lexuar, duke përdorur shkronja të një madhësie të lexueshme;

ii. i shprehur qartë dhe i shkruar me një gjuhë që i krijon lehtësi investitorit të kuptojë informacionin të cilin po i komunikohet, veçanërisht gjuha e përdorur duhet të jetë e qartë, e përmbledhur dhe e kuptueshme;

duhet të shmangë përdorimin e fjalëve të huaja dhe të pakuptueshme për publikun, si dhe dialektalizmat; të përmbajë, aty ku mundet, fjalë të përditshme dhe duhet të shmangë termat teknikë;

iii. i fokusuar tek informacioni kryesor për të cilin ka nevojë investitori.

b) Në rastin kur dokumenti origjinal me informacionin kryesor është i përgatitur me ngjyra printimi apo fotokopjimi në bardhezi nuk duhet të ndikojë në zvogëlimin e shkallës së të kuptuarit të informacionit.

c) Përdorimi i logos së shoqërisë administruese apo grupit të cilit ajo i përket, duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos i tërheqë vëmendjen investitorit apo të nënvlerësojë tekstin e dokumentit.

ç) Dokumenti i printuar me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të jetë më shumë se dy faqe të formatit A4.

5. Elementet që duhet të përmbajë informacioni kryesor:

a) Informacioni kryesor për investitorin duhet të japë informacionin mbi SIK, mbështetur në elementet e mëposhtme:

i. pjesa hyrëse dhe identifikimi i SIK;

- ii. një përshkrim i shkurtër i objektivave dhe politikave të investimit;
- iii. profili i riskut dhe i përfitimit nga investimi, duke përfshirë udhëzues të duhur dhe paralajmërime në lidhje me risqet që shoqërojnë investimin në SIK përkatëse;
- iv. komisionet dhe tarifat;
- v. paraqitja e ecurisë dhe rezultateve në të kaluarën (kur është e përshtatshme), si dhe skenarë të rezultateve për të ardhmen;
- vi. informacion tjetër praktik.

b) Këto elemente thelbësore duhet të jenë të kuptueshme për investitorin dhe duhet të sqarohen qartë, pa qenë nevoja të jepen referenca në dokumente të tjera.

c) Formati i standardizuar në lidhje me elementët e përcaktuar më lart jepet në mënyrë të detajuar në tabelën, pjesë përbërëse të kësaj shtojce.

#### 6. Pjesa hyrëse e dokumentit dhe identifikimi i SIK:

a) Titulli i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin vendoset në krye të faqes së parë, duke përdorur shprehjen: “*Informacion kryesor për investitorin*”.

b) Poshtë titullit jepet një deklaratë, ku thuhet: “*Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t’ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.*”.

c) Poshtë deklaratës jepen të dhëna identifikuese mbi SIK, duke përfshirë të paktën llojin e SIK (fond apo shoqëri investimi), emërtimin e SIK, llojin e SIK duke u nisur nga politika e investimit, emrin e shoqërisë administruese. Në rastet kur shoqëria administruese bën pjesë në një grup shoqërisht, për qëllime ligjore, administrative ose marketingu, mund të jepet edhe emërtimi i grupit. Emërtimi i grupit jepet nëse nuk krijon pengesë për investitorin që të kuptojë elementet kryesore të investimit dhe pakëson mundësinë e tij për të krahasuar produktin investimit.

ç) Në pjesën hyrëse të dokumentit duhet të përfshihet edhe një deklaratë ku të theksohet se kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, se investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, se SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe se rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

#### 7. Përshkrim i shkurtër i objektivave dhe politikave të investimit:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “*Objektivat dhe politika e investimit*” përbën një nga seksionet e rëndësishme për informimin e investitorit. Ky seksion është i detyrueshëm për t’u përfshirë në dokument edhe në rastet kur përshkrimi i objektivave dhe i politikës së investimit nuk është paraqitur në prospekt. Ky seksion duhet të përmbajë:

a) Kategoritë kryesore të instrumenteve financiare që janë objekt i investimit.

b) Deklaratën që investitori mund të shlyejë/shesë kuota/aksione të SIK, sipas kërkesës së tij/saj, dhe sa shpesh mund ta bëjë këtë.

c) Një objektiv të caktuar të SIK (nëse ka) në lidhje me sektorët e industrisë, terrenin gjeografik apo sektorë të tjerë të tregut ose klasa specifike të aseteve.

ç) Deklaratën nëse SIK lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme dhe nëse SIK i referohet një *benchmark*-u dhe cili është ky.

d) Deklaratën nëse të ardhurat nga SIK shpërndahen apo riinvestohen.

dh) Informacion tjetër, që vlerësohet se është i përshtatshëm, si:

i. kur SIK investon në letrat me vlerë të borxhit, duhet të tregohet nëse ato janë emetuar nga shoqëritë, qeveritë apo subjekte të tjera;

ii. informacion në lidhje me ndonjë pagesë të paracaktuar dhe faktorët që parashikohet të ndikojnë në performancën e SIK;

iii. nëse strategjia e investimeve udhëhiqet nga rritja, përzgjedhja e instrumenteve, bazuar në vlerësimin e brendshëm ose dividendët më të lartë;

iv. si mund të ndikojnë në performancën e SIK përdorimi i teknikave, të tilla si: teknikat e mbrojtjes, arbitrazhi apo përdorimi i levës financiare;

v. nëse kostot e transaksioneve të portofolit do të kenë një ndikim material mbi performancën;

vi. afati minimal i rekomanduar për investimin në SIK.

8. Profili i riskut dhe përfitimi nga investimi:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “*Profili i riskut dhe përfitimit*”, duhet të përmbajë:

a) Një tregues sintetik mbi riskun dhe përfitimin e përlllogaritur, sipas metodologjisë së nxjerrë nga autoriteti me udhëzim.

b) Një shpjegim me fjalë të treguesit dhe kufizimeve të tij kryesore, i cili duhet të përfshijë informacionin, si më poshtë:

i. një deklaratë se të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna të besueshme për profilin e ardhshëm të riskut të SIK;

ii. një deklaratë se kategoria e treguar e riskut dhe e përfitimit nuk garantohej se do të mbetet e pandryshuar dhe se kategoria e riskut me kalimin e kohës mund të ndryshojë;

iii. një deklaratë se kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk;

iv. një shpjegim i shkurtër se përse SIK është në kategorinë përkatëse;

v. detaje për natyrën, kohën dhe shtrirjen e çdo garancie apo mbrojtjeje të ofruar nga SIK për kapitalin e investitorit, duke përfshirë këtu efektet e mundshme për shlyerjen e kuotave jashtë periudhës së garantuar ose të mbrojtur.

c) Një shpjegim me fjalë të risqeve materialisht të lidhur me SIK dhe që nuk paraqiten mjaftueshëm nga treguesi sintetik, siç janë:

i. risku i kredisë, në rastet kur instrumentet e borxhit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të portofolit;

ii. risku i likuiditetit, në rastin kur investimi është në një nivel të konsiderueshëm në instrumente financiare, të cilat prej natyrës, në rrethana të caktuara, mund të kenë një nivel të ulët likuiditeti, aq sa mund të ketë një ndikim mbi nivelin e riskut të likuiditetit të SIK në tërësi;

iii. risku i kundërpalës, kur SIK garantohej nëpërmjet garancisë së një pale të tretë ose kur ka ekspozim material, si rezultat i ekspozimeve me palë të treta;

iv. risku operacional që rezulton nga kujdestaria apo ruajtja e aktiveve;

v. ndikimi që ka përdorimi i teknikave, siç mund të jenë përdorimi i derivativeve, kur këto teknika përdoren për të rritur, për të zvogëluar ekspozimin e aseteve.

9. Komisionet dhe tarifat:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Komisionet dhe tarifat e SIK”, duhet të përmbajë fillimisht një deklaratë rreth rëndësisë së komisioneve dhe tarifave, të cilat përdoren për të paguar kostot e administrimit të SIK, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave/aksioneve të SIK. Deklarata duhet të cilësojë se komisionet dhe tarifat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

a) Komisionet dhe tarifat në seksionin “Komisionet dhe tarifat e SIK” paraqiten në formën e një table, ku përfshihen:

i. komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit. Këtu përfshihen komisionet dhe tarifat e hyrjes dhe daljes nga SIK. Këto pagesa shprehen në përqindjen maksimale të tyre, që nënkuptojnë shumën maksimale që duhet të paguhet nga investitori për llogari të SIK, para investimit dhe shumën maksimale para daljes nga SIK;



ii. komisionet dhe tarifat e vazhdueshme, që paraqiten në një shifër të vetme dhe që njihen si detyrime në vazhdim;

iii. komisionet dhe tarifat e SIK në kushte të veçanta, ku tabela duhet të listojë dhe shpjegojë edhe çdo komision apo tarifë tjetër, sipas kushteve specifike të SIK, bazën mbi të cilën llogaritet dhe aplikohet ky detyrim.

b) Për secilën nga komisionet apo tarifat e specifikuar në tabelë duhet të jepet një shpjegim me fjalë, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

i. në lidhje me “komisionet apo tarifat e hyrjes dhe daljes” duhet të bëhet e qartë se shifrat e paraqitura janë shifra maksimale, pasi në disa raste investitori mund të paguajë më pak, për këtë fakt investitori mund të informohet nga këshilltari i tij i investimit;

ii. në lidhje me “komisionet apo tarifat vjetore të vazhdueshme”, duhet të bëhet një deklaratë se kjo shifër bazohet në shpenzimet e fundit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihen:

- tarifa e performancës; dhe

- kostot e transaksioneve të portofolit, duke përfshirë rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten kuota/aksione të SIK, të tjera.

c) Seksioni për komisionet apo tarifat duhet të japë referencën për ato pjesë të prospektit të SIK, ku jepet informacioni më i detajuar rreth komisioneve apo tarifave.

10. Paraqitja e performancës së kaluar:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Paraqitja e performancës së kaluar”, jep informacion rreth performancës së SIK për periudhat e mëparshme, duke e paraqitur në një grafik dhe duke treguar performancën e SIK (normën e kthimit) për 10 vitet e fundit:

a) Paraqitja grafike e lartpërmendur duhet të jetë e lexueshme, por në asnjë rrethanë nuk duhet të jetë më shumë se gjysmë faqe e formatit A4, të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin.

b) SIK, me një aktivitet më pak se pesë vite të plota kalendarike, duhet të përdorë një prezantim, ku paraqiten vetëm pesë vitet e fundit. Për çdo vit për të cilin nuk ka të dhëna, ai duhet të paraqitet bosh dhe nuk bëhet asnjë shënim tjetër përveç datës.

c) SIK, për të cilën ende nuk ka të dhëna mbi performancën për një vit të plotë kalendarik, duhet të paraqesë një deklaratë ku shpjegohet se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të siguruar një tregues të dobishëm për performancën e kaluar të investitorit.

ç) Grafiku duhet të shoqërohet nga deklaratat, ku të shfaqen dukshëm:

i. paralajmërimi për vlerën e kufizuar që ai ka si udhërrëfyes për performancën e ardhshme;

ii. paraqitja shkurtimisht e komisioneve apo tarifave, të cilat janë përfshirë apo përjashtuar në përlllogaritjen e performancës së kaluar;

iii. paraqitja e vitit, kur SIK filloi të emetojë kuota/aksione;

iv. paraqitja e monedhës në të cilën është përlllogaritur performanca e kaluar.

d) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të përmbajë asnjë të dhënë të vitit aktual kalendarik, duke e konsideruar si performancë e kaluar.

dh) Përlllogaritja e shifrave të performancës së kaluar duhet të bazohet në vlerën neto të aseteve të SIK, dhe duhet të mbahet parasysh nëse të ardhurat nga investimi i aseteve të SIK janë riinvestuar.

e) Në rastin e një ndryshimi në objektivat dhe politikën e investimit me efekt material gjatë periudhës së paraqitur në grafik, performanca e kaluar e SIK vazhdon të pasqyrohet para këtij ndryshimi material. Periudha para ndryshimit me efekt material duhet të tregohet në grafik dhe të etiketohet me një paralajmërim të qartë se kjo performancë është arritur në rrethana që nuk aplikohen më.

11. Informacioni praktik:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Informacion praktik”, përmban informacionin, si më poshtë:

a) Emrin e depozitarit.

b) Ku dhe si do të sigurohet informacioni i mëtejshëm rreth SIK (prospekt, raporte dhe pasqyra financiare).

c) Ku dhe si do të sigurohet informacioni praktik (p.sh. çmimet me të fundit të kuotave/aksioneve).

ç) Një deklaratë që legjislacioni tatimor mund të ketë një ndikim në tatimin personal të investitorit - shtetas i huaj.

d) Një deklaratë me këtë përmbajtje “*Shoqëria administruese mund të konsiderohet përgjegjëse e vetme për çdo keqkuptim, pasaktësi ose parregullsi që gjendet në këtë dokument, në ndryshim nga pjesët përkatëse të prospektit të SIK*”.

12. Seksioni përmbyllës i dokumentit:

a) Në seksionin përmbyllës të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin përfshihen detajet e licencës së shoqërisë administruese dhe të SIK.

b) Dokumenti mbyllet me deklaratën: “*Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit*”.

13. Rishikimi i informacionit kryesor për investitorin:

a) Shoqëria administruese duhet të bëjë një rishikim të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin të paktën çdo dymbëdhjetë muaj.

b) Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, rishikimi i dokumentit duhet të bëhet përpara ndryshimit të propozuar të prospektit dhe të rregullave të SIK.

c) Rishikimi duhet të kryhet përpara ose gjatë çdo ndryshimi që konsiderohet me efekt materi për informacionin që përmban dokumenti me informacionin kryesor për investitorin.

14. Publikimi i dokumentit të rishikuar:

Dokument i rishikuar duhet të vihet menjëherë në dispozicion të investitorit:

a) Dokumenti i rishikuar duhet të vihet në dispozicion të investitorit, përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi.

b) Dokumenti i rishikuar, si rezultat i korigjimit të seksionit mbi performancën e kaluar të SIK duhet të vihet në dispozicion të investitorit, jo më vonë se 35 ditë pune, pas datës 31 dhjetor të çdo viti.

15. Mënyrat e dhënies të informacionit kryesor për investitorin:

a) Shoqëria administruese dhe çdo SIK nën administrimin e saj jep informacion kryesor për investitorin, duke e publikuar në formë dokumenti elektronik në *website*, ose *mjet të qëndrueshëm të komunikimit*. Kopja e dokumentit i dërgohet investitorit me letër, sipas kërkesës dhe pa pagesë.

b) Dokumenti i rishikuar me informacionin kryesor për investitorin publikohet në *website-in* e shoqërisë administruese.

16. Kushtet për dhënien e informacionit nëpërmjet *një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit*:

a) Informacioni kryesor për investitorin jepet nëpërmjet *një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit*, kur plotësohen kushtet si më poshtë:

i. marrëdhënia e biznesit ndërmjet shoqërisë administruese dhe investitorit ka filluar ose po fillon; dhe

ii. investitori zgjedh të marrë informacionin kryesor për investitorin nëpërmjet *mjetit të qëndrueshëm të komunikimit*.

b) Kur dokumenti, mbi informacionin kryesor për investitorin do të jepet nëpërmjet *website-it* dhe ky informacion nuk do të adresohet personalisht tek investitori, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. marrëdhënia e biznesit ndërmjet shoqërisë administruese dhe investitorit ka filluar ose po fillon; dhe

ii. investitori zgjedh të marrë informacionin kryesor për investitorin nëpërmjet *website*-it;

iii. investitori duhet të njoftohet në mënyrë elektronike për adresën e *website*-it dhe vendin e *website*-it, ku informacioni është i aksesueshëm;

iv. informacioni duhet të jetë i përditësuar;

v. informacioni në këtë *website* duhet të jetë i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme, për sa kohë investitori mund të ketë nevojë për ta kontrolluar.

17. Dërgimi në autoritet:

a) Shoqëria administruese për çdo SIK nën administrim dërgon në autoritet një kopje të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, si dhe çdo amendim të këtij dokumenti;

b) Ky dokument, me informacionin kryesor për investitorin duhet të përmbajë informacionet më të fundit.

#### 18. TABELA: FORMAT I STANDARDIZUAR MBI PËRMBAJTJEN E DOKUMENTIT: INFORMACIONI KRYESOR PËR INVESTITORIN

Informacioni kryesor për investitorin
<p><b>Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.</b></p> <p><b>Kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.</b></p>
<p><b>Fondi (SIK) "123", nënfond i fondit "ABC" (ISIN: 4321)</b></p> <p>Ky fond administrohet nga shoqëria administruese "Administrues të fondeve ABC sh.a.", pjesë e grupit të shoqërive "XYZ"</p>
<b>Objektivat dhe politika e investimit</b>

*Përshkrim i përbashkët i objektivave dhe politikës së SIK, me një gjuhë të thjeshtë (të mos kopjohet fjalë për fjalë nga prospekti)*

Karakteristikat kryesore të produktit, të cilat duhet t'i bëhen të ditura investitorit si në vijim:

kategoritë kryesore të instrumenteve financiare të lejuara, që janë objekt i investimit;

një deklaratë që investitori mund të shlyejë kuotat sipas kërkesës, dhe sa shpesh tregtohen kuotat;

nëse SIK ka një objektiv të veçantë në lidhje me investimet e kategorizuara në sektorë, industriale, gjeografike, apo çfarëdo kategorizimi tjetër të tregut apo nëse ka objektiv investimin në klasa të veçanta të aktiveve;

nëse lejohen ose jo zgjedhjet diskrecionare lidhur me investime të caktuara dhe nëse SIK mbështetet ose jo në një tregues referencë (*benchmark*), nëse po, në cilin;

deklaratë nëse të ardhurat që lindin nga SIK shpërndahen apo riinvestohen.

*Informacione të tjera, nëse kanë lidhje, si më poshtë:*

në cilat lloje të letrave me vlerë të borxhit investon SIK;

informacion lidhur me pagesa të paracaktuara dhe faktorët që pritet të përcaktojnë performancën;

nëse përzgjedhja e aktiveve orientohet nga rritja, vlerësimi apo dividendët e lartë;

cili është ndikimi i teknikave të mbrojtjes/arbitrazhit/levës financiare në performancën e SIK;

që kostot e transaksioneve të portofolit kanë ndikim material te performanca;

periudha minimale e rekomanduar e mbajtjes.

### **Profili i riskut dhe përfitimit**

Risk i ulët	Risk i lartë
Përfitime	Përfitime
zakonisht të ulëta	zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

*Shpjegim narrativ i treguesit dhe i kufizimeve kryesore të tij:*

Të dhënat historike nuk mund të përdoren si indikatorë të qëndrueshëm për të përcaktuar të ardhmen;

Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës;

Kategoria më e ulët nuk nënkupton mungesën e plotë të riskut;

Përse SIK ndodhet në kategorinë specifike;

Të dhëna për natyrën, kohën dhe shtrirjen e çdo garancie apo mbrojtjeje mbi kapitalin.

*Paraqitje narrative e risqeve të rëndësishme për SIK, të cilat nuk janë mbuluar sa duhet nga treguesi:*

Risku i kreditit, kur arrihet një nivel i konsiderueshëm investimesh në letra me vlerë të borxhit;  
 Risku i likuiditetit, kur arrihet një nivel i konsiderueshëm investimesh në instrumente financiare, që kanë të ngjarë të kenë nivel të ulët likuiditeti në rrethana të caktuara;  
 Risku i kundërpalës, kur SIK mbështetet me një formë garancie nga një i tretë ose ka ekspozim të konsiderueshëm investimi, si pasojë e kontratave të lidhura me palë të treta;  
 Risqet operative, përfshirë mbajtjen në kujdestari dhe ruajtjen e aktiveve;  
 Efekti i çdo lloj teknike të përdorur, si për shembull përdorimi i derivativeve.

**Komisionet/tarifat e SIK**

Komisionet/tarifat që paguani përdoren për të shlyer kostot e administrimit të SIK, përfshirë kostot e marketimit dhe shpërndarjes së tij. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit tuaj

**Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit**

Komisioni/tarifa i/e hyrjes - [ ] %  
 Komisioni/tarifa i/e largimit - [ ] %

Ky është maksimumi që mund të zbritet nga paratë tuaja [përpara se të investohet][përpara se të merrni të ardhurat e investimit tuaj].

**Komisioni i hyrjes dhe i largimit** paraqiten këtu me shifra maksimale. Në disa raste mund të paguani më pak – këtë mund ta mësoni nga këshilltari juaj financiar.

Shifra e **tarifave të vazhdueshme** mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më [ ]. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihen:

Tarifat e performancës

**Komisionet/tarifat që mbahen nga SIK gjatë periudhës së një viti**

Komisione/tarifa [ ] % në vazhdimësi

Kostot e veprimeve të portofolit, me përjashtim të rastit kur SIK paguan komision hyrjeje/dalje kur blen ose shet kuota të një sipërmarrjeje tjetër investimesh kolektive

**Komisionet/tarifat e mbajtura nga SIK në kushte të veçanta**

Komisioni/tarifa e performancës [ ] %

**Për më shumë informacion për komisionet, ju lutemi shihni faqet nga x deri në x të prospektit të SIK, të cilin mund ta gjeni në [ faqen e internetit ]**

**Ecuria në të shkuarën**

**Kthimi në %**

\_\_\_\_\_ 10% \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ 7,5% \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ 5% \_\_\_\_\_

Ky grafik plotësohet me fjali të qarta, të cilat:

paralajmërojnë për vlerën e limituar të tij si udhëzues për performancën në të ardhmen;

shpjegojnë shkurtimisht se cilat komisione e tarifa janë

	<p>përfshirë, e cilat nuk janë përfshirë;</p> <p>tregojnë vitin në të cilin është krijuar SIK;</p> <p>tregojnë monedhën me të cilën është llogaritur ecuria e së shkuarës.</p>
<p><b>Vitet</b> 2010 2011 2012 2013 2014 2015 2016 2017 2018 2019</p>	

### Informacione praktike

Emri i depozitarit;

Ku dhe si mund të merren informacione të mëtejshme për SIK (prospekti, raportet & pasqyrat financiare);

Ku dhe si mund të merren informacione të tjera praktike (p.sh., ku mund të gjenden çmimet më të fundit të kuotave);

Deklarim se legjislacioni tatimor i vendit të origjinës të SIK mund të ketë ndikim te pozicioni tatimor personal i investitorit;

Deklarim se “[Emri i shoqërisë administruese] mban përgjegjësi ligjore vetëm në bazë të atyre që thuhet në këtë dokument, të cilat janë keqorientuese, të pasakta ose jo në përputhje me pjesët përkatëse të prospektit të SIK”;

Informacion specifik lidhur me fondet ombrellë (psh çdo transferim të drejtash ndërmjet nënfondeve);

Informacion për klasat e tjera të aksioneve, nëse ka (informacionet kryesore për investitorin mund të mbështeten në një klasë përfaqësuese).

Ky SIK është miratuar në [emri i vendit] dhe rregullohet nga [identiteti i autoritetit kompetent].

[Emri i shoqërisë administruese] është licencuar në [emri i vendit ku është licencuar shoqëria administruese] dhe rregullohet nga [identiteti i autoritetit kompetent].

Këto informacione kryesore për investitorin janë të sakta në [datën e publikimit].

## **SHTOJCA 2.A**

### ***Llogaritja e shifrës së tarifave të vazhdueshme***

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes:

a) është përgjegjëse për llogaritjen e shifrës së tarifave të vazhdueshme dhe për paraqitjen me saktësi në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin;

b) përcakton procedura që janë përputhje me këtë metodikë dhe dokumentohen në mënyrë të duhur;

c) mban evidenca të çdo llogaritjeje për një periudhë 5-vjeçare, pas datës së fundit që ky version i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin është publikuar.

### **Përkufizimi i tarifave të vazhdueshme që duhen deklaruar**

2. Në kuadër të dokumentit me informacione kryesore për investitorët, tarifave të vazhdueshme janë pagesat që u zbriten aktiveve të sipërmarrjes, kur këto zbritje kërkohen ose lejohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, nga akti i themelimit të sipërmarrjes ose nga prospekti SIK. Shifra që përfshihet në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin mbështetet në totalin e të gjitha këtyre pagesave që bëhen gjatë një periudhe të veçantë, pa përfshirë përjashtimet e identifikuar më poshtë, në pikën 5 të kësaj shtojce.

3. Shifra e tarifave të vazhdueshme përfshin të gjitha llojet e kostove që mbulon sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, duke përfshirë shpenzime të domosdoshme gjatë veprimtarisë së saj, si dhe shpërblimet e çdo pale që ka lidhje me të ose që i ofron shërbime. Këto kosto mund të shprehen ose llogariten në një shumëllojshmëri mënyrash (psh tarifë e sheshtë, përqindje e aktiveve, komision për transaksion etj.).

4. Lista e mëposhtme është orientuese, por nuk i shteron të gjitha llojet e tarifave të vazhdueshme që, nëse zbriten nga aktivet e sipërmarrjes, merren në konsideratë në shumën e deklaruar:

a) të gjitha pagesat e personave të mëposhtëm, përfshirë çdo person të cilit i janë deleguar funksione:

- shoqëria administruese e sipërmarrjes;
- personat kyç të sipërmarrjes nëse është shoqëri investimesh;
- depozitari;
- kujdestari/kujdestarët të cilit depozitari i delegon ruajtjen e aktiveve;
- çdo shoqëri e administrimit të protofolit;

b) të gjitha pagesat e personave që i ofrojnë shërbime me kontratë personave të lartpërmendur, përfshirë:

- ofruesit e shërbimeve të vlerësimit dhe kontabilitetit të fondeve;
- ofruesit e shërbimeve të mbajtësve të kuotave ose aksioneve, si agjenti i transferimit dhe subjekte ndërmjetësimi, që janë mbajtës evidencash të aksioneve/kuotave të sipërmarrjes dhe që i ofrojnë nënshërbime kontabiliteti pronarëve përfitues të këtyre aksioneve.

c) taksa regjistrimi, tarifa rregullatore dhe tarifa të ngjashme.

ç) tarifave të auditimit;

d) pagesat për këshilltarët juridikë dhe profesionalë.

5. Komisionet dhe pagesat e mëposhtme nuk bëjnë pjesë në shumën që deklarohet si pjesë e tarifave të vazhdueshme në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin:

a) tarifave ose komisionet e hyrjes/daljes ose çdo shumë tjetër që investitori paguan drejtpërdrejt ose që zbritet nga pagesa që bëhet nga investitori ose që i jepet investitorit;

b) interesa për huamarrje;

c) pagesat ndaj të tretëve për të mbuluar kostot e domosdoshme në lidhje me blerjen ose shitjen e çdo aktivi për portofolin e sipërmarrjes, pavarësisht nëse këto kosto janë të pritshme (për shembull, tarifa ndërmjetësimi, tatime dhe tarifa të lidhura) ose të papritshme (për shembull, kostot e tregtimit të titujve me interes fikse, kostot e ndikimit në treg);

ç) pagesat për mbajtjen e instrumenteve financiare derivative (për shembull, kërkesa e *broker-it* për para shtesë për të mbuluar diferencën e koston);

d) vlerat e mallrave ose shërbimeve, që merr shoqëria administruese ose çdo person i lidhur në këmbim të ekzekutimit të urdhrave të tregtimit (komisionet e tërthorta ose masa të ngjashme).

6. Përjashtimi i kostove të lidhura me transaksionet në shkronjën “c”, të pikës 5, të kësaj shtojce, nuk mbulon:

a) pagesat, të lidhura me transaksionet kundrejt personave të përmendur në shkronjat “a” ose “b”, të pikës 4, të kësaj shtojce, në lidhje me të cilat marrësi nuk jep llogari përpara sipërmarrjes; të gjitha këto shuma të tilla merren në konsideratë në shifrën e deklaruar;

b) kostot e blerjes ose shitjes së kuotave në sipërmarrjen e investimeve kolektive, të cilat duhet të merren në konsideratë në përputhje me shkronjën “dh”, të pikës 8, të kësaj shtojce.

7. Në përputhje me një marrëveshjeje për ndarjen e tarifave, shoqëria administruese ose një palë tjetër mund të mbulojë, tërësisht ose pjesërisht, kostot e shfrytëzimit të cilat normalisht do të përfshiheshin në shifrën e tarifave të vazhdueshme:

a) çdo shpërblim i punës së shoqërisë administruese (ose të një personi tjetër), që bëhet në zbatim të marrëveshjeve të tilla për ndarjen e tarifave merret në konsideratë dhe mblidhet në shifrën totale të tarifave të vazhdueshme. Shembuj të mundshëm përfshijnë shpërblimin e shoqërisë administruese nëpërmjet një marrëveshjeje për ndarjen e tarifave me *broker-in* për kostot e transaksionit ose me kujdestarin për të ardhurat nga huadhënia e aksioneve.

b) në përgjithësi, nuk është e nevojshme marrja në konsideratë e marrëveshjes së ndarjes së tarifave për shpenzimet që janë llogaritur një herë në shifrën e tarifave të vazhdueshme (për shembull, shpërblimi i shoqërisë administruese nëpërmjet marrëveshjes së ndarjes së tarifave me një fond, i cili mbulohet sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të kësaj shtojce). Por, në rastin e sipërmarrjes që investon në sipërmarrje të tjera, çdo marrëveshjeje për ndarjen e tarifave midis shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose subjektit operator ose shoqërisë administruese të saj merret në konsideratë, nëse nuk është përfshirë në rastet e përcaktuara, sipas pikës 8, më poshtë, të kësaj shtojce.

8. Kur sipërmarrja investon një përqindje të konsiderueshme të aktiveve në sipërmarrje të tjera investimesh kolektive, shifra e tarifave të vazhdueshme merr në konsideratë tarifën e vazhdueshme, që u linden sipërmarrjeve bazë. Sa më poshtë përfshihen në llogaritje:

a) përdoret shifra e tarifave të vazhdueshme më e fundit e sipërmarrjes bazë; kjo mund të jetë shifra e deklaruar nga sipërmarrja ose subjekti operator ose shoqëria administruese e saj ose shifra e llogaritur nga një burim i tretë i besueshëm nëse është më e përditësuar se shifra e deklaruar;

b) nëse sipërmarrja bazë vihet në shfrytëzim nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose një shoqëri e lidhur, shoqëria administruese bën çmuarjen më të mirë të tarifave, sipas kësaj metode;

c) nëse sipërmarrja bazë nuk përfshihet në përcaktimet e shkronjave “a” ose “b”, të kësaj pike, dhe nuk deklarohet shifrën e tarifave të vazhdueshme, shoqëria administruese ose përdor informacionet e publikuara, që përbëjnë një zëvendësues të arsyeshëm të kësaj shifre (për shembull, raporti i shpenzimeve totale publikuar nga një burim i besueshëm) ose përndryshe kryen një vlerësim më të saktë të nivelit maksimal në bazë të shqyrtimit të prospektit aktual të sipërmarrjes dhe të raportit dhe llogarive më të fundit vjetore të publikuara;



ç) kur sipërmarrjet që përfshihen në përcaktimet e shkronjës “c”, të kësaj pike, përbëjnë më pak se 15 % të aktiveve të sipërmarrjes, është e mjaftueshme të përdoret tarifa vjetore të publikuar të administrimit për secilën për këto sipërmarrje në vend të vlerësimit të tarifave të vazhdueshme;

d) në çdo rast, shifra e tarifave të vazhdueshme mund të zvogëlohet në rast se ekziston një marrëveshje (dhe që nuk është reflektuar më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të fondit) për sipërmarrjen investuese për marrjen e një rabati ose retrocedimi të tarifave nga sipërmarrja bazë;

dh) në rastet kur sipërmarrja duhet të paguajë tarifa të hyrjes dhe/ose të daljes në lidhje me blerjen ose shitjen e kuotave të një sipërmarrjeje bazë, vlera monetare e këtyre tarifave agregohet për periudhën nën shqyrtim dhe merret në konsideratë në llogaritjen e shifrës së tarifave të vazhdueshme.

9. Në rastin e sipërmarrjes ombrellë çdo nënfond përbërës trajtohet veçmas në kontekst të këtij seksioni, por çdo tarifë që i ngarkohet sipërmarrjes si e tërë ndahet në mënyrë përpjesëtimore mes të gjitha nënfondeve, në mënyrë që të jetë e drejtë për të gjithë investitorët.

### **Metodika e llogaritjes (me përjashtim të fondeve të reja)**

10. Shifra e tarifave të vazhdueshme është raporti i kostove totale të deklarueshme mbi aktivet neto mesatare të sipërmarrjes, llogaritur sipas këtij seksioni. Shifra shprehet si përqindje me dy shifra pas presjes dhjetore.

11. Shifra e tarifave të vazhdueshme llogaritet të paktën një herë në vit, në mënyrë *ex-post*. Nëse nuk vlerësohet e papërshtatshme të përdoret shifra *ex-post* për shkak të ndryshimeve të konsiderueshme (për shembull, rritje e tarifave të administrimit), mund të përdoret një vlerësim tjetër, gjersa të ketë një shifër të besueshme *ex-post* që reflekton ndryshimin e konsiderueshëm.

12. Bëhet një llogaritje e veçantë për çdo klasë aksionesh ose kuotash, por nëse aksionet ose kuotat e dy a më shumë klasave janë *pari passu*, për to mund të bëhet një llogaritje më vete.

13. Shifra *ex-post* mbështetet në llogaritjen e kostove të kohëve të fundit të përcaktuara nga shoqëria administruese mbi baza të arsyeshme, që janë të përshtatshme për këtë qëllim. Shifra mund të mbështetet në kostot e deklaruara në pasqyrën e veprimtarive të sipërmarrjes, e publikuar në raportin dhe llogaritë më të fundit vjetore ose të ndërmjetme të saj, nëse është mjaftueshmërisht i afërt në kohë; nëse jo, në vend të saj përdoret një llogaritje e krahasueshme në bazë të kostove të ngarkuara gjatë periudhës 12-vjeçare më të fundit. Kostot vlerësohen mbi bazën e të gjitha tatimeve të përfshira, që do të thotë se përdoret vlera bruto e shpenzimeve.

14. Aktivet neto mesatare lidhen me të njëjtën periudhë me kostot dhe llogariten duke përdorur shifrat e mbështetura në aktivet neto të sipërmarrjes në çdo llogaritje të vlerës neto të aktiveve (për shembull, vlerat neto të aktiveve të përditshme, kur kjo është shpeshësia normale e llogaritjes së miratuar nga autoriteti kompetent i sipërmarrjes).

15. Në rastin kur duhen marrë në konsideratë tarifat e vazhdueshme që i ngarkohen sipërmarrjes bazë:

a) shifra e tarifave të vazhdueshme (ose e barasvlershmja) e secilës sipërmarrje bazë përpjesëtimohet sipas përqindjes së vlerës neto të aktiveve të sipërmarrjes, që zë kjo sipërmarrje më datën përkatëse (që është data kur merren shifrat e sipërmarrjes);

b) të gjitha shifrat e përpjesëtimuara mblidhen me shifrën e tarifave të vazhdueshme të vetë sipërmarrjes investuese, që përbën një total të vetëm (shifra “sintetike” e tarifave të vazhdueshme).

16. Informacionet për shifrat e tarifave të vazhdueshme, që kanë qenë të vlefshme gjatë viteve/periudhave të mëparshme publikohen në vendin (për shembull, faqen e internetit të

shoqërisë administruese), i cili përcaktohet në dokumentin me informacione kryesorë për investitorët, si burimi i përgjithshëm i informacioneve të mëtejshme për investitorët.

### **Metodika e llogaritjes për fondet e reja**

17. E njëjta metodikë zbatohet si për llogaritjen *ex-post*, subjekt i ndryshimeve të mëposhtme:

- a) nuk zbatohen pikat 13 dhe 14, të kësaj shtojce, dhe në vend të tyre përdoren vlerësimet;
- b) nëse, sipas mendimit të shoqërisë administruese, të shprehurit e një shifre me dy shifra pas presjes dhjetore ka mundësi të krijojë idenë e gabuar të saktësisë tek investitorët, është e mjaftueshme që kjo shifër të shprehet me një shifër pas presjes dhjetore;
- c) nëse nuk përcaktohet ndryshe në prospekt, supozohet që për llogari të sipërmarrjes nuk do të merret asnjë rabat apo përjashtim nga tarifa.

18. Shoqëria administruese garanton që saktësia e shifrës së vlerësuar të mbahet nën shqyrtim. Shoqëria administruese përcakton kur është e përshtatshme të fillojë të përdorë shifra *ex-post* në vend të vlerësimeve. Por në çdo rast, ajo shqyrton saktësinë e vlerësimit, jo më vonë se 12 muaj, pas datës së ofrimit për herë të parë për shitje, duke llogaritur një shifër *ex-post*.

### **SHTOJCA 3**

#### ***Informacionet që duhen përfshirë në raportet vjetore dhe të ndërmjetme***

##### ***I. Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve:***

- tituj të transferueshëm;
- teprica të llogarive bankare;
- aktive të tjera;
- totali i aktiveve;
- pasivet;
- vlera neto e aktiveve.

##### ***II. Numri i kuotave ose aksioneve në qarkullim***

##### ***III. Vlera neto e aktiveve për çdo aksion ose kuotë***

##### ***IV. Portofoli, duke bërë dallimin ndërmjet:***

- a) titujve të transferueshëm të pranuar për tregtim në bursa zyrtare;
- b) titujve të transferueshëm të tregtuar në një treg tjetër të rregulluar;
- c) titujve të transferueshëm të emetuar kohët e fundit;

ç) titujve me vlerë të transferueshme dhe të analizuara në përputhje me kriteret më të përshtatshme, në përputhje me politikën e investimeve të sipërmarrjes (për shembull, në përputhje me kriteret ekonomike, gjeografike ose valutore), si përqindje e aktiveve neto; si dhe për secilin prej investimeve të lartpërmendura përqindjen, që zënë në totalin e aktiveve të sipërmarrjes.

Pasqyra e ndryshimeve në përbërjen e portofolit gjatë periudhës së referimit.

***V. Pasqyra e zhvillimeve në lidhje me aktivet e sipërmarrjes gjatë periudhës së referimit, përfshirë:***

- të ardhurat nga investimet;
- të ardhura të tjera;
- tarifa administrimi;
- tarifa depozitari;
- tarifa dhe tatime të tjera;
- të ardhura neto;
- shpërndarje dhe të ardhura të riinvestuara;
- ndryshime të strukturës së kapitalit;
- vlerësimi dhe zhvlerësimi i investimeve;
- çdo ndryshim tjetër që ndikon mbi aktivet dhe pasivet e sipërmarrjes;
- kostot e transaksioneve, që janë kostot që i lindin sipërmarrjes në lidhje me transaksionet e portofolit.

***VI. Një tabelë krahasuese që mbulon tri vitet e fundit financiare dhe që përfshin, për secilin vit financiar, në mbyllje të vitit financiar:***

- totalin e vlerës neto të aktiveve;
- vlerën neto të aktiveve për kuotë.

***VII. Të dhëna, sipas kategorive të transaksioneve të derivativeve, gjatë periudhës së referimit dhe të shumës së angazhimeve, që del si rezultat.***